Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe nenit 25.1 të Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës,

THËRRAS

Mbledhjen e XXXIII-të (tridhjetetre - mandati VII)-*e rregullt*, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **28 dhjetor 2023, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunën e Podujevës**, në orën **10:00**, me këtë;

REND TË DITËS

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: *27 shtator 2023; 31 tetor 2023; 23 nëntor 2023; 08 dhjetor 2023.*

2. Propozim vendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2024

3. Propozim vendimi për lejimin e mjeteve financiare
   (ndihmë në emër të kompensimit për fermerët e Komunës së Podujevës për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore të ndodhura gjatë vitit 2022)

4. Raportim i Kryetarit të Komunës lidhur me realizimin e projekteve për vitin 2023

5. Propozim vendimi për inicimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm

6. Drafti i Planit Operativ Emergjent Lokal – (*Raporti nga konsultimi publik*)

7. Të Ndryshme

Nr.Prot. 01-060/01-0087974/23
Podujevë, datë; 18 dhjetor 2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e XXIX-të (njëzetenëntë)-*e rregullt*, mandati VII-të, e mbajtur më 27 shtator 2023.

Mbledhja filloi në orën 10:25 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.
Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.
Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:
(Nga LDK, *Valon Demolli; Demokrat Hodolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Adnan Zymeri; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta*; Fahri Hasani; kurse mungoi Arjant Topanica.
Nga LVV, *Fitim Muqolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota*; *Sebastina Vokrri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi;* kurse munguan *Florent Hasani dhe Ragip Fetahu.*
Nga PDK, *Bashkim Syla; Mimoza Abdullahu; Endritë Murati.*
Nga AAK, *Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.*
Nga OBKD, *Gazmend Islami i cili mungoi me arsyetim shëndetësor me shkrim dërguar Kryesuesit të Kuvendit.*

Gjithashtu të pranishëm në fillimin e mbledhjes ishin, z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, znj.Marigona Lahu Nënkryetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;
(Fatlum Osmani-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE; Alban Zeka-Drejtoria e Inspeksionit DI; Lirie Hoti-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR)

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të KFOR, Përfaqësues të OSBE, përfaqësues të mediave lokale dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

z.Hilmi Hoxha, **Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë në këtë mbledhje, konstatoi kuorumin ku për momentin prezent janë 29 anëtarë të Kuvendit kurse mungojnë 6 anëtarë njëri prej tyre është z.Gazmend Islami i cili sërish ka njoftuar zyrtarisht përmes e-mailit se është në rehabilitim / shërim në Gjermani ndërsa për të tjerët nuk kam ndonjë informatë për mungesën e tyre.
Në vazhdim theksoi, para se të fillojmë me mbledhjen, siç jeni të informuar të gjithë, të dielën më 24 shtator 2023 në krye të detyrës u vra nga forcat paramilitare serbe rreshteri i Policisë së Kosovës Afrim Bunjaku tani Hero i Kosovës i shpallur nga Presidentja e Kosovës, andaj në nderim të jetës dhe veprës së tij ju ftoj për 1 minutë heshtje.

Mbahet 1 minutë heshtje në nderim të jetës dhe veprës së Heroit Afrim Bunjaku.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, thirrja dhe materiali për këtë mbledhje ju është dërguar me kohë, po ashtu edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur një ditë më parë ku sigurisht keni vërejtur se janë rekomanduar edhe pika shtesë si dhe një korrigjim / zëvendësim i materialit, për më shumë rreth këtyre mund t'i gjejmë në konstatime, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar si dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur 26.09.2023.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 29 vota Për nga të pranishmit në mbledhje, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar për këtë mbledhje dhe Konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 26 shtator 2023, dhe atë;
Rendi i ditës:

1.Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 15 maj 2023; 19 qershor 2023; 29 qershor 2023 - e vazhduar dhe përfunduar më 07 korrik 2023

2.Propozim Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025/2026

3.Propozim Vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri (projekti për furnizim me mekanizëm bujqësor)

4.Propozim Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024

5.Propozimi i Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare - Raporti nga diskutimi publik

6.Propozim Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027 - Raporti nga diskutimi publik

7.Informatë për përgatitjet për fillimin e vitit shkollorë 2023-2024

8.Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik të draft Planit Operativ Emergjent Lokal-POEL & draft Plani Operativ Emergjent Lokal- POEL

9.Propozim vendimi për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë dhe Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje & draft Strategjia dhe Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2026

10.Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit – shtëpi për qëndrim ditor të personave të moshuar në qytetin e Podujevës (Në procedurë të rishqyrtimit sipas kërkesës nr. 020-586/4 datë 24.07.2023 të MPL-së).

11.Propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri (projekti për furnizim me mëshqerra)

12.Raporti përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në territorin e Komunës së Podujevës

13.Plotësimi i përbërjes së anëtarëve të Komitetit për Komunitete me një anëtarë/e nga radhët e komunitetit ashkali, dhe atë në vend të znj.Naile Ahmeti, nga komuniteti ashkali nominohet znj.Fikmete Qurkolli.

14.Të Ndryshme

1. **Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: *15 maj 2023; 19 qershor 2023; 29 qershor 2023 - e vazhduar dhe përfunduar më 07 korrik 2023***

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kemi tri procesverbale nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, andaj nëse ndokush pretendon se nuk është paraqitur diskutimi ashtu siç ka theksuar, urdhëroni mund ta merrni fjalën.

Nuk pati të lajmëruar për të marr fjalën, pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 29 vota Për, nga të pranishmit në mbledhje, miratohen 3 procesverbalet sipas kësaj pike të rendit të ditës respektivisht sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

2. **Propozim Vendimi për miratimin e projekt buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025/2026**

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse për këtë pikë të rendit të ditës, theksoi, propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës për vitin 2024 dhe projeksionet për vitet 2025 dhe 2026 janë hartuar konform Qarkoreve 01 dhe 02 të lëshuara nga Ministria e Financave. Buxheti total i Komunës së Podujevës për vitin 2024 është 31,043,019.00€ të ndara në programe dhe kategori të ndryshme buxhetore duke filluar nga Arsimi, Shëndetësia, Urbanizmi, Infrastruktura publike dhe programe të tjera.
Nga këto mjete 16,518,288.00€ janë në kategorinë e pagave, pastaj 3,585,500,00€ janë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, 513,000.00€ për shërbime komunale, subvencione dhe transfere 1,670,000.00€ si dhe për investime kapitale janë 8,756,230.5€. Këto limite normalisht janë limite të përcaktuara me Qarkoret buxhetore të lëshuara nga ana e Ministrisë së Financave dhe ne normale si Organizatë Buxhetore që jemi Komuna e Podujevës jemi të obliguar t'iu përmbahemi.
Ky buxhet sikurse edhe buxhetet tjera është i bazuar edh në dokumentet strategjike të cilat i ka miratuar Komuna e Podujevës siç janë Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal si dhe Korniza Afatmesme Buxhetore e cila është miratuar në muajin qershor të këtij viti.
Si prioritete të planifikuara për vitin 2024 vazhdojnë të jenë Arsimi, Kultura, Shëndetësia dhe Infrastruktura ku janë të planifikuara disa projekte madhore infrastrukturore sikurse që janë ndërtimi i rrugës përgjatë lumit Llap, rruga "Xhemajl Mustafa" , rregullimi i hapësirave publike si dhe janë të përfshira projekte infrastrukturore për këto 3 vite pothuajse për çdo lokalitet të Komunës së Podujevës.
Në listën e projekteve që është pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi që ju është dërguar, kemi disa rekomandime nga Ministria e Financave për disa përmirësime teknike që duhet të bëhen:
-Arsimi fillor dhe i mesëm, përshkrimi të jetë vetëm, Arsimi.
-Projekti për meremetimin e rrugëve me zhavorr, riemërtohet, meremetimi i rrugëve me zhavorr nga fshati Bajçinë në fshatin Murgull dhe nga fshati Shajkoc në fshatin Orllan.
-Ndërtimi i rrugëve me elemente të betoni, riemërtohet, ndërtimi i rrugëve me kubza brenda qytetit, në fshatin Kërpimeh dhe nga Sekiraça deri në fshatin Lluzhan.
-Ndërtimi i mureve mbrojtëse specifikohet se bëhet fjalë për ndërtimin e mureve mbrojtëse në Orllan, Llapashticë dhe Kërpimeh
-Riparimi i rrugëve të asfaltuara specifikohet se bëhet fjalë për hapësira në qytet, nga rr."Zahir Pajaziti" te rr."Skënderbeu" dhe rr."Xhemajl Mustafa".

-Te pajisjet mjekësore bëhet fjalë për pajisje mjekësore të rëntgenit dhe EKG ku planifikohet të blehen në vitin 2024.
-Te renovimi i objekteve shëndetësore bëhet fjalë për renovimin e objektit kryesor të QKMF-së.
-Te përmirësimi i infrastrukturës fizike do të rinovoheni shkollat "Isa Boletini", "Dëshmorët e Kombit", "Hamit Sejdiu" në Kërpimeh si dhe shkolla "Afrimi e Fahriu" në fshatin Lluzhan.
-Te infrastruktura e turizmit do të investohet në rrethinën e Orllanit dhe atë të Kërpimehut.
-Te ndërtimi i terreneve sportive bëhet fjalë për qendrën e qytetit, në fshatrat Lupç, Siboc, Surkish, Gërdoc, Lluzhan etj.
-Te renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore bëhet fjalë për renovimin e objektit të shkollës së vjetër në fshatin Orllan dhe objekti i vjetër i ish gërmis që është në qytet.
-Te projekti për shenjëzimi i rrugëve vertikale dhe horizontale, bëhet fjalë për rrugët në qytet dhe atë rrugët "Zahir Pajazit" "Skënderbeu" "Xhemajl Mustafa".
Gjithashtu kemi organizuar edhe dëgjime publike si dhe Drejtoritë përkatëse kanë mbajtur diskutime të vazhdueshme me qytetarë ku kërkesat e paraqitura nga ana e qytetarëve apo grupeve të interesit është bërë përpjekje maksimale që të inkuadrohen në buxhetin e vitit 2024 dhe në projeksionet për vitet 2025-2026. Normalisht që edhe përkundër rritjes së buxhetit, nevojat dhe kërkesat janë shumë më të mëdha se sa mundësitë buxhetore të cilat i ka Komuna e Podujevës, por ajo që mbetet tek ne dhe që kemi bërë përpjekje maksimale në këtë projekt buxhet është që t'i prioritizojmë politikat dhe sektorët prioritar të cilët është e nevojshme të investohet.
z.Valon Demolli, theksoi, përshtypja e parë e këtij buxheti nëse shihet si numra të krijon një përshtypje të gabuar sikur ka rritje reale por në realitet krejt ajo që është rritur është mashtrimi dhe manipulimi me shifra. Kur analizohet nëpër kategori buxhetore shihet se është një buxhet konsumues duke u rritur shpenzimet operative dhe duke zvogëluar investimet kapitale e që do të ishte e kundërta, të rriteshin kapitalet e të zvogëloheshin mallrat.
Ky buxhet është diskriminues pasi që nuk përfshinë gjithë territorin e Komunës së Podujevës dhe qytetarët e saj. Këtij buxheti i mungojnë projektet prioritare, ky buxhet nuk garanton zhvillim ekonomik dhe çka është e rëndësishme të ceket është se përsëri nuk po merren parasysh rekomandimet e auditorit të jashtëm.
Në këtë buxhet është dashur të përfshihen nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të dala nga dëgjimet publike, e jo të ndalet publikimi i tyre pasi që qytetarët u'a përplasen në fytyrë të bëmat e juaja e që TV Llapi nuk ka guxuar t'i publikoj pas kërcënimeve nga i pari i komunës.
Të nderuar qytetarë, shembuj të diskriminimit mund të gjeni në të gjitha projektet dhe në gjithë projektbuxhetin e vitit 2024, kemi rastin e fshatit Gllamnik i cili është një ndër fshatrat më të mëdhenj me afër 4000 banorë kurse janë ndarë 35,000.00€, kurse në fshatin Repë që është një ndër fshatrat më të vogla kemi ndarje shumën prej 44,620.00€.
Unë para vetës kam edhe një kërkesë të banorëve të fshatit Dyz, e cila është dorëzuar në Komunë me të cilën kërkohet shtrimi i trotuari në rrugën kryesore "Jetullah Islami" sepse mungesa e trotuarit po rrezikon nxënësit që lëvizin për në shkollë, pastaj ka mungesë të ndriçimit publik, asfaltim i disa rrugëve dhe mungesë e rëndësishme është shtrirja e rrjetit të ujësjellësit si dhe kërkesa të tjera të cilat është dashtë të përfshihen në buxhetin 2024 ose në projeksionet e viteve 2025-2026.
Në këtë buxhet veç nevojat dhe kërkesat e qytetarëve nuk janë përfshirë, por jeni kujdesuar që investimet t'i orientoni tek aktivistët dhe votuesit tuaj. Keni nënshkruar kontrata në mungesë të mjeteve financiare siç është rasti i rr."Xhemajl Mustafa" në shumë 1.3 milion euro, pastaj rruga lidhëse "Vëllezërit Frashëri" është vitit i tretë që planifikohet në buxhet kurse ende nuk kemi

shpallje të tenderit, ndërtimi i Shtëpisë së kulturës, përpara Qendrës së kulturës qe tri vite planifikim nga 100,000.00€ ndërsa projekti askund por që mjetet harxhohen diku tjetër.
Edhe në këtë vit nuk keni planifikuar buxhet për mallra në Zyrën e Kryetarit, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, në Drejtorinë e Arsimit, në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Qendrës për Punë Sociale e të tjera, kjo sepse kështu e dëshiron Kryetari i Komunës dhe drejtori i DBF për të kamufluar më lehtë.
Prandaj duke marrë parasysh vërejtjet e cekura më lartë dhe një mori shkeljesh tjera ne Grupi i LDK-së nuk e mbështesim një buxhet të tillë diskriminues dhe që nuk garanton zhvillim ekonomik.
z.Haki Rudari, theksoi, sot në këtë mbledhje një ndër pikat më të rëndësishme që kemi është edhe buxhetin e Komunës si një dokument i një rëndësie të lartë për arsye se në këtë buxhet kemi implementimin e kërkesave të pranuara nga qytetarët nëpër të gjitha fshatrat dhe lagjet e Komunës tonë, pra një buxhet prej 31,043,019.00€ i cili shkon për qytetarët dhe banorët e Komunës së Podujevës dhe në tërësi, pa dallime politike, pa dallime racore, pa dallime nacionale e të tjera, për arsye se këto projekte të cilat ne i kemi para vetes janë të shpërndara nëpër fshatra dhe lagje të ndryshme të Komunës tonë të nderuar.
Tek neni 2 i këtij projektbuxheti kemi shpenzimet për sektor të ndryshëm e që unë do të ndalem tek shpenzimet kapitale, 8,756,230.00€ janë mjete të cilat do të shpërndahen nëpër projekte të hartuara dhe ndërtuara nga qytetarët e Komunës së Podujevës, natyrisht që ky buxhet ka marrë edhe kërkesat e qytetarëve sepse ka pasë dëgjime publike me qytetarë dhe me banorë të ndryshëm dhe në të njëjtën kohë kërkesat e paraqitura nga ata sigurisht që janë inkorporuar në këtë buxhet.
Në rast se i shfletojmë projektet nëpër Drejtori të ndryshme, në secilën Drejtori kemi projekte të cilat janë për qytetarin, me qytetarin dhe tek qytetarët.
Te Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit kemi më shumë se 30 fshatra ku parashihet buxhet dhe investime si dhe po ashtu kemi një numër të madh të investimeve të planifikuara në qytet e që nuk do t'ju lodhi duke lexuar shumat buxhetore dhe projektet sepse ky dokument është publik dhe und t'i shohin të gjithë.
Te Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit po ashtu kemi një buxhet prej 2,526,870.00€ ku parashihen investime në fshatra të ndryshme dhe në sektorë të ndryshëm duke filluar nga lumi Llap, ndriçim, shenjëzim etj etj, prandaj kjo shumë e mjeteve buxhetore natyrisht se investohet te qytetarët e ndryshëm.
Po ashtu projekte të ndryshme kemi edhe te Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si dhe te Drejtoria e Arsimit për të cilën do të ndalem më shumë dhe po i drejtohem të nderuarve bashkëfshatarëve të fshatit ku jetoj unë, kolegëve, nxënësve dhe prindërve se një kërkesë dhe një dëshirë e banorëve të fshatit që parashtrohet për më shumë se 4 dekada tashmë po bëhet realitet dhe kërkesa apo propozimi që të futet në planifikime ndërtimi i shkollës në fshatin Shajkoc është përkrahur nga Kryetari i Komunës, nga Ekzekutivi dhe po besoj se edhe nga të gjithë anëtarët e Kuvendit për arsye se shkolla nuk është politike dhe se aty nuk vijojnë shkollimin vetëm nxënësit e një bindje apo mendimi politik por në shkollë shkojnë të gjithë nxënësit andaj për këtë arsye ky projekt do të përkrahet fuqishëm nga të pranishmit për arsye se po e përsërisë edhe njëherë që afër 50 vite kemi pritur për këtë projekt, prandaj unë jam falënderues dhe në të njëjtën kohë kolegëve, nxënësve dhe të gjithëve i'u uroj për këtë projekt dhe për një ndërtim sa më të shpejtë.
Po ashtu buxhet, impelmentim dhe projekte kemi edhe nëpër Drejtori të ndryshme, prandaj marrë në tërësi, pa dasht t'iu lodhi shumë sepse këtë projektbuxhet e posedoni të gjithë qe më shumë se 1 javë, Grupi i këshilltarëve të LVV-së do ta përkrahë fuqishëm këtë buxhet, do ta voton dhe do të kërkon që të bëhet implementimi i tij për arsye se është në interes të qytetarëve dhe për qytetarët.

z.Bashkim Syla, theksoi, buxheti i Komunës së Podujevës për vitin 2024 është 31,043,019.00€, ku shuma prej 29,183,361.00€ janë nga grandi qeveritar, kurse nga të hyrat vetanake janë 1,859,659,00€.
Për investime kapitale jan planifikuar 8,756,230.00€, në Urbanizëm 3 milion euro, në Infrastrukturë publike 2,526,000.00€, në Shëndetësi 450,000.00€, në Arsim 1.400,000.00€, në Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik 808,554.00€.
Natyrisht se ne si grup i PDK-së kemi edhe vërejtjet tona dhe vërejtja e parë është mos specifikimi i projekteve vërejtje kjo që është duke u përsëritur për disa vite, pastaj vërejtje tjetër është ku kemi vitin e tretë që planifikohet ndërtimi i rrugës nga magjistralja Podujevë-Prishtinë deri te rruga "Vëllezërit Frashëri" e që edhe në vitin e kaluar ne kemi bërë një rialokim të buxhetit nga ky projekt e që kemi vendosë në një projekt tjetër e që fatkeqësisht të gjithë e dim se si kanë shkuar punimet në atë projekt.
Unë pajtohem plotësisht që në këtë vit shumica e mjeteve për investime kapitale janë orientuar në qytet, mirëpo sa kemi qenë në opozitë ne dhe LVV zakonisht kemi kritikuar se shumica e mjeteve kapitale po shkojnë për asfalt.
Kam pritë që investime të ketë më shumë në Arsim dhe në Shëndetësi, kam pritur që të paktën të jenë 2 Çerdhe (në fshatrat Kërpimeh dhe Gllamnik) të planifikuara në buxhetin e vitit 2024, kurse në fshatin Kërpimeh është planifikuar renovimi i shkollës së vjetër dhe adaptimi i Çerdhes në fshatin Gllmanik fatkeqësisht nuk është planifikuar.
Në Bujqësi kam pritë që buxheti të rritet të paktën për 100,000.00€, pastaj ndarja e buxhetit në shumë 200,000.00€ për familjet me asistencë sociale do të ishte një ndihmesë e madhe por nuk është ndarë asnjë cent për këtë çështje. Vërejtje tjetër është tek të hyrat vetanke të vitit 2025 ku janë planifikuar afër 2 milion euro, mirëpo ne të gjithë jemi në dijeni se shumica e të hyrave vetanake janë nga inkasomi i tatimit në pronë, kurse me Ligjin e ri të tatimit në pronë është problem të realizohet kjo shumë mirëpo mbetet të shihet.
Në këtë buxhet ka edhe projekte të mira siç është ndërtimi i Zonës Industriale, ndërtimi shkollave, ndërtimi, ndërtimi dhe zgjerimi i tri rrugëve kryesore në qytet dhe shumë projekte tjera të cilat prekin direkt mirëqenien e qytetarëve, andaj ne Grupi i PDK-së nuk jemi ta bllokojmë miratimin e buxhetit për vitin 2024 pavarësisht vërejtjeve tona edhe pse është përgjegjësi e Kryetarit të Komunës, e drejtorëve të Drejtorive që këto projekte të realizohen në mënyrën më të mirë.
z.Qëndrim Softolli, theksoi, sa i përket këtij propozim vendimi për buxhetin e vitit 2024 dhe planifikimet për 2025-2026, i nderuar drejtor i DBF ju kam menduar pak më profesionist mirëpo hartimi i këtij buxheti dhe raportet e auditorit e tregojnë të kundërtën.
Rritja e buxhetit tek pagat, mallrat dhe shërbimet, si dhe zvogëlimi i investimeve kapitale e tregojnë të kundërtën.
Pash që shefi i Grupit të LVV-së u krenua me ndarjen e 50,000.00€ për një shkollë në fshatin Shajkoc, ndërsa unë mendoj se me atë shumë nuk mund të ndërtosh një shtëpi të mirëfilltë e lëre më një shkollë, kur e dim se për ndërtimin e shkollave në fshatrat Obranqë dhe Dumosh janë ndarë nga 400,000.00€, mirëpo shefin e Grupit të LVV-së e përgëzoj edhe për emërtimin e rrugës në emër të tij për çka ndoshta nuk i ka rënë të pres gjatë sepse vetëm qe tri vite është që LVV është në pushtet....
z.Haki Rudari ndërhynë duke thënë që kjo e ceku parafolësi është gënjeshtër e tij sepse nuk rrugë të emërtuar me emrin tim në fshatin Shajkoc, prandaj kjo që u cek është një gënjeshtër.

z.Qëndrim Softolli, vazhdoi, atë që e ceka është në dokumente zyrtare të Komunës dhe mund të shihet lehtë, madje e kam printuar dhe jua tregoj nëse nuk e ke parë (prezanton dokumentin përkatës zyrtar ku shkruan ndërtimi i rrugës Haki Rudari), prandaj nuk keni nevojë të më drejtohesh mua duke më thënë që po gënjej sepse kjo është fakt dhe urime për këtë.
Kryesuesi i Kuvendit, kërkon nga anëtari i Kuvendit z.Haki Rudari që të përmbahet dhe të mos ndërhyjë përderisa fjalën e ka dikush tjetër, kur t'i vie radha ta merre fjalën, por jo kështu sepse është në kundërshtim me rregulloren.
z.Qëndrim Softolli, vazhdoi, ne e dim që nuk ka emër të rrugës Haki Rudari në Shajkoc por në dokumente zyrtare të Komunës, për një projekt në fshatin Shajkoc shkruan ndërtimi i rrugës Haki Rudari. Unë e respektoj moshën dhe nuk mund t'jua kthej me të njëjtat fjalë po gënjen, po gënjen, por kërkoj përmbajtje nga ana juaj ngase nuk keni nevojë të nxeheni për këto fakte tash më.
Kryesuesi i Kuvendit, pasi që z.Haki Rudari vazhdon duke diskutuar rreth çështjes së emrit të tij, Kryesuesi sërish tërheq vërejtje që të mos ketë ndërhyrje nga askush në diskutimin e tjetrit, të pritet derisa ta përfundon dhe pastaj të merr fjalën dhe të potencon arsyet dhe mendimet e veta por jo në këtë formë kështu siç po ndodh.
z.Haki Rudari, vazhdon duke theksuar që nuk pranoj gjëra të tilla dhe etiketime të tilla kinse një rrugë në fshatin Shajkoc mban emrin tim, prandaj edhe ndërhyj sepse nuk janë të sakta, kurse kjo që po thuhet nuk është e sakt e që kur thuhet një gjë e tillë unë ju ndërprejë dhe ndërhyjë.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, të mos ngutemi sepse asnjë emër i rrugës nuk mund të ndërrohet pa kaluar përmes votimit në Kuvendin e Komunës, kurse për këtë që po thuhet dhe që u prezantua nuk jam në dijeni çfarë ka ndodh, prandaj të dëgjojmë deri në fund, urdhëroni z.Qëndrim Softolli.
Pra i nderuar z.Haki Rudari je duke e penguar mbledhjen.
z.Qëndrim Softolli, vazhdoi, kjo që e potencoi Kryesuesi i Kuvendit vërtetë ashtu është, mirëpo një gjë të tillë ka arritur ta bëjë shefi i Grupit të LVV-së. Kërkoj të mos ndërpritem më kur jam duke diskutuar unë, përndryshe nëse edhe njëherë ndodh të më ndërprejë ndokush ne Grupi i LDK-së e lëshojmë sallën.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nuk kemi nevojë askush të krijojmë situatë të tilla sepse qytetarët na kanë votuar për t'i përfaqësuar qysh është më së miri e jo ta pengojmë njëri tjetrin apo të lëshojmë mbledhjet, kështu që urdhëro i nderuar Softolli mund të vazhdosh, kurse nga z.Haki Rudari kërkoj të mos e pengoj diskutimin e parafolësit dhe mbledhjen në përgjithësi.
z.Haki Rudari, duke i reaguar Kryesuesit theksoi, gjëra të pasakta që thuhen nuk i toleroj, madje edhe Shpejtim Bulliqi po që se thotë gjëra të pasakta nuk e toleroj.
z.Qëndrim Softolli, vazhdoi, e kuptoj parafolësin sepse është në situatë jo të mirë nga publikimi i dokumentit me emër të rrugës në emër të tij, por si do qoftë kjo çështje përfundoj.
U krenuan me rritjen e buxhetit, por mendoj se kjo tani më është e tepërte pasi që rritja e buxhetit vazhdon për secilin vit dhe nuk është diçka e re kjo, krejt normale është sepse secili vit që vie kemi rritje të buxhetit.
Konsideroj se buxheti është i centralizuar, jo zhvillimor, i orientuar vetëm në disa pjesë të Komunës së Podujevës, shembull shumë të keq kemi edhe rr."Skënderbeu" projekt ky që jeni bërë horë e që sa po e vërej edhe rr."Xhemajl Mustafa" e pret fati i njëjtë ku fillimisht në vitin e kaluar është nënshkruar një kontratë në shumë mbi 271,000.00€ kurse nuk është punuar asnjë punë, ndërsa për vitin 2024 janë planifikuar rreth 400,000.00€ por që ajo që më bënë kurioz është sepse nuk kam mund të dijë se si nënshkruani kontrata pa zotim të mjeteve.
Kam pyetje edhe për drejtorin e DKRS-së edhe pse nuk është prezent këtu, fjala është për një kontratë dy vjeçare të nënshkruar nga DKRS për ndërtimin e fushave sportive në vlerë rreth 430,000.00€ kurse në buxhetin e vitit 2023 të planifikuara ka vetëm 200,000.00€ dhe në buxhetin e

vitit 2024 po ashtu 200,000.00€, do të thotë të planifikuara janë 400,000.00€ kurse kontrata është nënshkruar përtej kësaj shume, mirëpo nuk është i vetmi rast ky sepse kemi shumë raste ku Komuna nënshkruan kontrata pa zotimin e mjeteve.
Nuk kam vërejtur asnjë ndarje buxhetore për ujësjellës kur e dim që është një problem i cili preokupon për çdo vit qytetarët e Komunës së Podujevës, pastaj kemi ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë 100,000.00€ për ndërtimin e një shkolle fillore në qytet por që unë pyes sa është e mjaftueshme kjo shumë për një objekt të tillë në qytet.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe unë kam disa çështje për t'i ngritur rreth kësaj pike, pra për shërbime kontraktuese kemi shumën 764,000.00€ e që nuk e dim çfarë kemi planifikuar me këtë shumë përveç asaj që administrata ka 67,000.00€, urbanizmi 100,000.00€, infrastrukturë publike 160,000.00€, shëndetësi 55,000.00€, zhvillim ekonomik 50,000.00€, kulturë 40,000.00€, inspeksioni 45,000.00€, bujqësi 60,000.00€, asamble 15,000.00€ dhe në arsim 172,000.00€, pra gjitha këto për shërbime kontraktuese që do të thotë se kujt ti teket prej drejtorëve i thërrasin dhe nënshkruajnë kontrata njëburimore pa thirrje publike.
Pastaj terk prioritetet vërejta tek çështja e lumenjve që po na preokupon më së shumti drejtori i Drejtorisë përkatëse nuk ka paraparë fare buxhet përveç që për vitin 2024 pa planifikuar shumën 140,000.00€ për mirëmbajtje të lumenjve, ndërsa në qytet për zbukurimin e tyre me gurë ka planifikuar 466,370.00€, prandaj nuk e kuptoj këtë sepse si duket nuk po shihni dëmet çka po bëhet nga vërshimet dhe nuk e keni prioritet, lumi Dumnica nga fshati Dumnicë e deri në fshatin Llugë vërshon gjitha ekonomitë familjare dhe tokat bujqësore të punueshme e që më së shumti shkakton dëme ai lum e që faktohet edhe me ata banorë të cilët janë në numrin më të madh që bëjnë kërkesa për subvencione dhe kompensim të dëmeve, kurse nuk ka asnjë planifikim për atë lum, mandej kemi lumin Llap që nga fshati Pollatë deri në fshatin Lupç i cili përveç projektit në shumë 805,000.00€ për 700 metra rregullim me gurë, asgjë tjetër, ndërsa ne në pjesën e poshtme qëndrojmë në ujë pas çdo shiu pothuajse, vetëm qe 1 vit e këndej më shumë se 5 herë ka pas vërshime, andaj nuk e di përse nuk e keni parë si prioritet zgjerimin e lumenjve, e që ne nga to jemi duke pasë telashe.
Profesori i nderuar shef i Grupit të LVV-së e potencoj se janë kërkesa të qytetarëve, unë nuk e di se ku e ka parë ai që janë kërkesa të qytetarëve, shembull kemi komunitetin e Orllanit të cilët na kanë dërguar e-mail neve si anëtar të Kuvendit dhe drejtorit si dhe nëpër dëgjime publike buxhetore shumë projekte ndërsa ato 11 fshatra të rrethinës janë përfshirë në një buxhet shumë të vogël sikurse bëhet fshat për një gjysmë fshati. Nëse nuk jeni në dijeni unë kam qenë nëpër dëgjime buxhetore, madje në 2 që janë organizuar në këtë sallë nuk ka marrë pjesë asnjë qytetarë, pastaj në fshatin Kërpimeh nuk ka marrë pjesë asnjë banorë i asaj ane sikurse që ka ndodh edhe në fshatin Tërrnavë, në fshatin Sfeçël dhe në fshatin Dumnicë, do të thotë nuk janë mbajtur fare ato dëgjime, jo që më ka thënë ndokush por unë personalisht kam shkuar në të gjitha këto dhe i kam parë nga afër, pastaj në dy-tre vende ku ka pasë pjesëmarrje janë fsheh incizimet sepse nuk janë ndarë dhe nuk janë pritë aq mirë.
Sa i përket asaj rrugës që u përmend dhe që ti (i drejtohet z.Haki Rudarit) e quajte disa herë rrenë dhe ju referove kolegut rrenc, ti mund t'ia ndalësh drejtorit këtë nëse mundesh mirëpo unë tani e prezantoj para kamerave dokumentin ku mund ta shihni qysh shkruan, pra shkruan ndërtimi i rrugës Haki Rudari s Shajkoc, t'ju them të drejtën unë personalisht kur e kam parë kam menduar se e ka pas emrin gjyshi juaj dhe ajo rrugë mban emrin e tij, por jo në emrin tënd. Në Google maps nuk e kam gjet këtë rrugë me këtë emër por drejtori e ka emërtuar kështu për ta shtruar atë rrugë. Ajo rrugë është 64 metra e gjatë dhe 3 metra e gjer, tenderi është dhënë rruga do të shtrohet në këtë vit, edhe shkolla do t'ju ndërtohet dhe mbetet vetëm edhe një bust ta ndërtojnë ty dhe me ty kryhet.

Po ashtu kemi edhe një asamblist tjetër ku thuhet, ndërtimi i rrugës Artrit Mulliqi, madje ka edhe emra tjerë por çka janë jashtë kuvendit nuk dëshiroj t'i përmend, mund të na thotë edhe Mulliqi po rreni, mirëpo unë prej faqes zyrtare e-prokurimi dhe atë jo këtu në Komunë por në qendër e kam nxjerrë këtë dokument. Ka edhe të tjerë këtu që janë drejtorë dhe kanë përfituar por që i kanë vë në emër të gjyshërve, ne i dim të gjitha këto por mos na fusni në gjëra personale dhe mos mundoni të na "hidhnin hi syve" sepse nuk jemi ne këtu vetëm sa për të thënë por i dim të gjitha çka jeni duke bërë, por të dalësh ti këtu (i drejtohet sërish z.Haki Rudarit) dhe t'i thuash dikujt po rren duke pas dy sy në ballë dhe duke parë që ashtu shkruan unë nuk e di deri ku mund të arrij kjo, nëse edhe këtë e quan rren unë di asgjë. Ti Haki mund t'i kapesh drejtorit tënd që e ka vë emrin tënd në atë rrugë sepse në fakt që ti e ke bërë kërkesën në emër tëndin por ai nuk është dashtë ta vë ashtu rrugën me emrin tënd. Askush nuk po thotë këtu që ajo rrugë të mos shtrohet, por po themi të mos figuroj emri yt sepse në dosje të tenderit shkruan rruga Haki Rudari, andaj nuk di përse shpërtheve ashtu duke i thënë kolegut po rren.

z.Haki Rudari, theksoi, të nderuar këshilltarë të LDK-së dhe ju qytetarë të krejt komunave, emri Haki Rudari (në rrugë) nuk ekziston dhe kjo është rren, shumë më qesharak është ai i cili rren, gjejeni ju komisionin që e ka emërtuar rrugën Haki Rudari, të tjerat çka thuhen këtu janë hajgare, çështjen me drejtorë dhe me Kryetarin e përfundoj unë dhe nuk ka nevojë të më tregoni ju çka të bëjë unë. Në fshatin Shajkoc nuk ka rrugë me emrin Haki Rudari, përndryshe gjejeni ju rrugën ku është vërë emri im Haki Rudari unë do t'ju kërkoj falje, prandaj e them se është rren dhe sa të dëshironi rrimë këtu unë do t'ju them se rren është.

z.Qëndrim Softolli, nga vendi thekson, kontrata është nënshkruar kështu, ndërtimi i rrugës Haki Rudari, prandaj pyes nëse ka mundësi të na tregoni ku është ajo rrugë.

z.Haki Rudari, vazhdoi, prandaj të gjitha çka janë të vërteta dhe të sakta i nderuar koleg Ekrem Rrahmani ti e din që unë jam i hapur dhe i them, nuk i fshehë, çoftë për subjekt politikë, për menaxher dhe për të gjitha. Po jam parimor dhe nuk jam rrenc sikurse ti (i drejtohet z.Qëndrim Softollit)

z.Qëndrim Softolli, nga vendi reagon duke i'u drejtuar që me këtë po del shumë qesharak dhe jo serioz, përndryshe merreni dhe privatizojeni Komunës.

z.Haki Rudari, vazhdoi, gjëra e sakta i pranoj kurse të pasaktat tërë ditën rrimë kështu se nuk i pranoj. Çështja tjetër rreth ndërtimit të shkollës në fshatin Shajkoc mendoj se duhet të përkrahet ngase ka qe 50 vite nevojë për tu ndërtuar shkolla e që tani për fillim kemi 50,000.00€ kurse në vitin 2025 kemi 250,000.00€ plus me të hyra vetanake dhe me rishikim të buxhetit shkolla në Shajkoc do të ndërtohet.

Sa i përket kërkesave të qytetarëve konsideroj se të gjitha këto, kërkesa të qytetarëve janë, edhe unë kam pranuar kërkesën e Orllanit mirëpo ka pasë bukur shumë investime në Orllan dhe tani pse Ekzekutivi paksa po heshtë për këtë nuk e di por e di që ka pasë investime bukur shumë në Orllan.

Nëse dëshiron ti Qëndrim Softolli këtë formë të debatit duke ndërhyrë unë nuk e kam problem fare dhe mund ta vazhdojmë, mirëpo nuk ke fuqi ti sepse në momentin që thua gjëra të pasakta nuk ke fuqi pastaj para askujt, sinqerisht më vie keq prej disa të tjerëve afër teje, madje po që se edhe në familje po të shkoni do t'ju thonë se nuk ka rrugë me emrin Haki Rudari.

Sa i përket dëgjimeve buxhetore natyrisht se edhe unë i kam përcjellë disa prej tyre dhe nuk jam i kënaqur me pjesëmarrjen e tyre në numër, mirëpo fundja njoftimet janë bërë çoftë në Sfeçël apo Kërpimeh dhe tani nuk mund të shkosh dhe të marrësh askënd për të marrë pjesë në ato dëgjime, por që njoftimi ka qenë për pjesëmarrje në ato dëgjime e që po e përsërisë që nuk jam i kënaqur me numrin e pjesëmarrjes. Tani këto kërkesa që u tha se janë të qytetarëve, po është e vërtetë kjo sepse edhe unë kam bërë kërkesa por asnjë kërkesë e imja nuk është për rrugën Rudari, besojeni këtë,

madje po ju tregoj se kam sjellë kërkesa për ato familje të cilat për 20 vite janë anashkaluar dhe janë Familje të Dëshmorëve, njërës i është vrarë baba dhe mixha në luftë dhe askush nuk është marrë fare me këtë, pastaj një rrugë tjetër është një familje të cilës i është vrarë baba dhe djali dhe askush nuk është marrë me atë, pastaj është edhe një rrugë që e kam propozuar e që bëhet fjalë për rrugën e Familjes së Dëshmorit Hasan Ramadani, pra për këto pajtohem se unë i kam sjellë propozimet dhe ende nuk kanë filluar këto rrugë, prandaj kur i sjellni gjërat e vërteta unë pajtohem por jo për diçka që nuk është e vërtetë dhe e sakt, edhe njëherë po e përsërisë që më vie keq prej një pjese të kolegëve për këtë formë të debatit që ndodhi por megjithatë kjo mu imponua.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kërkoj nga anëtarët e Kuvendit që ta zgjedhin gjuhën e komunikimit sepse nuk jemi këtu në rrugë por jemi në Kuvendin e Komunës, andaj ju lus që të jeni më të përgjegjshëm në diskutimet e juaja.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kush nuk e din këtë që po e them mund të hyj në ueb faqe dhe të gjen rubrikën kontratat e dhëna dhe të kërkoj do të sheh se paraqitet kontrata me "Bini" Sh.p.k. Shtedim, në vlerë 458,371.50€ dhe janë 81 rrugë me kubza ku njëra prej këtyre rrugëve shkruan kështu, ndërtimi i rrugës Haki Rudari Shajkoc, gjatësia L-64m, gjerësia 3m (paraqet para kamerave dokumentin përkatës), madje nëse dëshironi unë mund t'jua printoj edhe pjesën tjetër ku figurojnë gjitha të tjera, qoftë sa shodër do të hedhet qoftë gjëra tjera.
Gjithashtu kemi pikën tjetër ku thuhet, nr.60 ndërtimi i rrugës Artrit Mulliqi, 60m e gjatë, dhe 3m e gjerë e që po ashtu i posedoj të gjitha të dhënat.
Pra kemi 81 rrugë që do të ndërtohen, andaj përse ti (i drejtohet z.Haki Rudarit) po e vë në kontekst tjetër duke thënë se nuk rrugë me emrin Haki Rudari, askush nuk e tha që ka rrugë në gjeoportal me emrin Haki Rudari, mirëpo ne e potencuam që ty ta kanë vë emrin (me apo pa qëllim nuk e di) por figuron emri juaj dhe rruga do të të shtrohet në gjatës 64m gjatësi dhe 3m gjerësi në emër të rrugës Haki Rudari, kuptoje këtë sepse askush nuk ka shpikë këtë por në dokumente zyrtare kështu është dhe mund ta kërkosh edhe ti, prandaj nuk e di përse po i thua kolegut "po rren", ndoshta më mirë do të ishte të kërkoje sqarim prej drejtorit të Drejtorisë përkatëse përse është shkruar rruga Haki Rudari. Pra nuk po të thotë askush mos e shtro rrugën.
Pastaj askush nuk e tha që jemi kundër ndërtimit të shkollës, madje e dim qysh ndërtohen këto shkolla sepse ka dy vite që është përmend fillimi i shkollës "Isa Boletini" por që i kanë anuluar 4 operator që kanë qenë më të lirë dhe e kanë dhënë tenderin njërit që ka qenë më i shtrenjtë por që pastaj në OSHP është anuluar dhe nuk është askund për të filluar ajo shkollë. Në të njëjtën formë bëhet edhe me tenderin e druve ku konkurrojnë 5 operator por që nuk e merr ai me ofertën 150,000.00€ por del fitues operatori me ofertën 210,000.00€ (51,000.00€ më shtrenjtë), mandej shpërndahen lopët pa shkuar komisioni në asnjë vend tek ata që kanë aplikuar por janë kujdese që lopët t'ju ndahen vetës ku ka drejtor këtu që e kanë në marrë në emër të gjyshit kurse vitin e kaluar e kanë marrë në emër të babës, parvjet në emër të nënës që i bie se ka marrë 3 lopë për tri vite ndërsa dikush që mbijeton vetëm me ato punë nuk përfiton fare por që këta që kanë rroga këtu dhe bëhen drejtor i marrin rend.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se parafolësi ishte shumë i kjartë në diskutim andaj të kalon tema e emrit të rrugës. Fjalën e ka znj.Donjetë Sheqiri, dhe lus e kërkoj nga kolegu z.Haki Rudari që të mos e pengoj mbledhjen por të respektohet Rregullorja sepse paraprakisht mori fjalën për 2 replika.
z.Haki Rudari, theksoi, fillimisht i kërkoj falje koleges znj.Donjetë Sheqiri, mirëpo dua të sqaroj edhe njëherë çështjen e emrit të rrugës, i nderuar z.Ekrem Rrahmani, atë që e ka bërë drejtoria përkatëse unë do të sqaroj edhe me Kryetarin e Komunës posa të kthehet nga Gjermania, kurse ato që i kam për opozitën i them këtu ndërsa këto tjerat janë gjëra që unë vazhdoj tutje.

Dëshiroj të përfundoj këtë, ajo që ju e posedoni dhe që e keni gjete në prokurim mund të jetë ashtu, por rrugë me emër Haki Rudari nuk ka në Shajkoc.
znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, dua të parashtroj disa pyetje për drejtorin e DBF, pas një analize të buxhetit shihet se në të gjitha Drejtoritë keni planifikuar shërbime kontraktuese e që vlera kap shumën 750,000.00€, andaj a mund të na tregoni i nderuar drejtor cilat janë këto shërbime që janë planifikuar me këto mjete.
Çështja tjetër, keni ndarë rreth 250,000.00€ në DKA dhe në DKRS me kodin blerje mallrash e që e dimë se plani kontabël nuk e njeh këtë kod, andaj a ka mundësi ta dimë përse për të tretin vit radhazi po vazhdoni ta përdorni këtë term.
Pyetja tjetër është për drejtorin e DKA i cili para një viti më ka premtuar në këtë Kuvend ndërtimin e fushës së sporteve në shkollën fillore "Lasgush Poradeci" në fshatin Dumnicë, andaj a keni planifikuar në këtë buxhet mbajtjen e premtimit e para një viti në këtë Kuvend.
znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, kam pyetje për drejtorin e DBF, në kategorinë paga dhe mëditje për vitin 2024 keni planifikuar 16,518,000.00€ e që në krahasim me vitin 2023 i bie 3.5 milion më shumë, andaj a mund të na japësh sqarime më të hollësishme përse është kjo rritje.
znj.Mrika Thaqi, theksoi, kam një propozim të një rëndësie të veçantë e që në këtë projektbuxhet nuk e kam parë, siç e dini bartja e nxënësve mbetet problematikë në përgjithësi, e në veçanti e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në vitin 2022 me kërkesë të drejtuesve dhe arsimtarëve të shkollës është intervenuar për ta përmirësuar sado pak këtë gjendje dhe me këtë rast OJQ në Podujevë Rotary Club Podujeva ka organizuar dhe financuar transportin e tre nxënësve me nevoja të veçanta në njërën prej shkollave të Komunës së Podujevës dhe për këtë qëllim janë blerë edhe pajisje mirëpo gjendja për këtë kategori të peronave ende vazhdon të jetë e rënduar, andaj propozoj që për këtë kategori të nxënësve që vijojnë shkollimin fillor të specifikohet në një nën-linjë të veçantë në kuadër ë DKA-së tek kodi i shërbimeve kontraktuese me specifikim të veçantë shërbime kontraktuese për ofrimin e shërbimit të transportit adekuat në relacion shtëpi – shkollë dhe anasjelltas për kategorinë përkatëse të nxënësve për të cilën po diskutojmë.
Të dhënat për nxënësit dhe shkollat që e kanë këtë nevojë mund t'i gjeni në kuadër të DKA për ta specifikuar edhe vlerën buxhetore në këtë nën-linjë buxhetore.
z.Naim Çunaku, theksoi, një prej vendimeve më kruciale për një vit kalendarik si punë e Kuvendit të Komunës është miratimi i buxhetit, dhe pa dashtë t'i përsërisë ato që u cekën deri më tani dhe pa dashtë të jap kualifikimin tim sepse kualifikimet ishin të faktuara nga ata që i japën propozimet dhe vërejtjet tyre, unë dua t'i qasem këtij projektbuxheti gjegjësisht seancës së Kuvendit që kemi para vetës miratimin e projektbuxhetit të Komunës, nga një kënd tjetër e që këndi që unë dëshiroj ta shfaqë këtu është që më shumë ka të bëjë me ne vet kuvendarët e Kuvendit të Komunës së Podujevës.
U fillua kjo temë duke thënë që buxheti bëhet për qytetarin, e vërtetë e madhe është që një Ekzekutiv dhe një Kuvend i Komunës menaxhojnë dhe drejtojnë, i japin orientim zhvillimit dhe mirëqenies sociale dhe se japin orientim se ku do të shpenzohet taksa e qytetarit, mirëpo lidhur me këtë Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, e ka përcaktuar një procedurë të sakt se duhet të vijmë deri në përfundimin e miratimit të një projektbuxheti komunal, për më shumë mund të lexoj nenet 61 dhe 62 por nuk pop dëshiroj të bëhem i tepërt, por mund edhe ta lexoj pse jo, mirëpo me dy tri fjali po e parafrazoj atë thuhet në Ligj, sigurisht të gjithë ne që jemi këtu në e-mailet tona zyrtare, kushdo që e ka parë e kemi pasë një sugjerim nga Organizata Jo Qeveritare e cila merret me monitorimin e miratimeve të buxheteve komunale, dhe jeni në dijeni se neve si anëtarë të Kuvendit na është sugjeruar ta përmbushim obligimin ligjor që kemi që të organizojmë edhe ne dëgjime publike me qytetarë. E kam thënë disa herë në këtë foltore se një

demokraci e zhvilluar , për mua dhe për librat e funksionimit të demokracisë sa është në nivel të zhvillimit të saj është aq sa kemi arritur ne që qytetarin ta bartim në vendimmarrje, kurse nga ajo që kemi për këtë buxhet është vitit i tretë që prej këtij subjekti politik që miratojmë një buxhet të tillë, edhe përkundër asaj që ne si grup i LDK-së para një viti kemi lëshuar seancën dhe arsyeja ishte që nuk kemi dashtë të jemi pjesëmarrës të miratimit të një buxhet që ka shkelje ligjore ngase është jo normale që të kërkohet prej një zyrtari ashtu siç e ka statusin e vet që quhet zyrtar publik (fjala është për anëtarët e Kuvendit) që ka për detyrë monitorimin dhe kërkim të llogaridhënies prej Ekzekutivit të Komunës, të bëhet vet pjesëmarrës miratimin e në një diçka kundërligjore.
Çka është kundërligjore po kthehem sërish në fillim, janë shkeljet e nenit 61 pika 2 dhe 62 pika 1 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë që na obligon të kemi dëgjime publike buxhetore.
Sa i përket dëgjimeve publike është e vërtetë se prej 6 dëgjimeve publike që janë të parapara, unë personalisht por sigurisht edhe disa nga kolegët tjerë kemi marrë pjesë dhe kemi shfaqë interes që të dëgjojmë qytetarët për prioritetet e tij. Nuk ka diçka më të qëlluar se kur të zbritesh në bazë dhe ta pyesësh qytetarin se cili është problemi i tij.
E potencoj kolegu z.Ekrem Rrahmani disa herë që vet fakti që brenda vitit të kaluar më shumë se tri herë kemi shqetësimin dhe dëmet nga vërshimet dhe po ta pyesësh qytetarin në ato zona sigurisht që prioritet do t'i jap rregullimit të shtratit të lumenjve e jo rregullimit apo lëvrimit të fushës këtu para derës së Komunës ngase nuk është kurrfarë prioriteti për qytetarin sepse nuk ka ende 3 vite që është rregulluar kjo hapësirë.
Për të qenë më konciz, këto projekte që janë këtu në këtë buxhet, u përmend disa herë duke u thënë se kur ishim në opozitë, kur jemi në pozitë e të ngjashme, mirëpo unë e them se prej që jam pjesë e Kuvendit e që është më shumë se një herë, poenta dhe akcenti kryesorë ku është vënë kritika ndaj një buxheti të miratuar i kemi thënë përse buxheti është kaq gjeneral, në një fazë të caktuar ne nuk kemi pas emërtim të rrugëve, mirëpo ka disa vite që Kuvendi i Komunës i ka sakt emërtimin e çdo rruge, andaj përse nuk është i përcaktuar investimi gjegjësisht realizimi i një projekti kapital në vend të caktuar, për qëllimin e caktuar dhe për cilin komunitet bëhet.
Pastaj u shfaqën shumë polemika këtu rreth asaj ka / nuk ka emër rruge Haki Rudari, mirëpo ishte qysh në fillim një keqkuptim sepse nuk ishte akcenti që ka rrugë të emërtuar nga Kuvendi i Komunës me emrin Haki Rudari dhe askush këtë nuk e potencoj, por përse është realizuar një projekt dhe ai projekt mban emrin (artificialisht, qëllimisht, pa qëllimisht) Haki Rudari, nuk ka koment sepse është dokument, si dhe një kolegu tjetër që nuk dëshiroj ta përmend me emër.
Poenta është këtu që derisa ka qenë aq i përkujdesshëm që edhe përkundër faktit që fare nuk ka emër ajo rrugë dhe është emërtuar Haki Rudari, çka me gjitha ato projekte tjera të rrugëve nëpër fshatra tjera që janë të emërtuara dhe askund nuk potencohen.
Unë e di por sigurisht e dini edhe ju të tjerët nëse veç dëshironi ta pranoni nëse jo është në dorën tuaj, që tek përcaktimi gjegjësisht realizimi i projekteve, e kam thënë dhe po e përsërisë, është detyrë e jona si Kuvend i Komunës të përcaktojmë se ku do të investohet paraja publike, menaxhimin e atij projekti e bënë Ekzekutivi i Komunës, ndërsa më tregoni ju ndokush sa projekte sot realizohen dhe që janë realizuar por që nuk figurojnë fare në projektet që i kemi miratuar në këtë Kuvend, çka të bëjmë tjetër ne përveç që ta vëmë në spikam sepse as nuk jem hetuesi as prokurori, por e kemi për detyrë ta mbushim misionin tonë si përfaqësues që të tregojmë që nuk është në rregull.
Për fund, zotëri Kryesues i Kuvendit e potencuat një diçka të vërtetë që edhe sot po dëgjoj që është duke u marrë dikush rreth emërtimit të rrugëve, shesheve dhe lagjeve, e që të paktën këtu jemi të paktën tre nga ata që kemi qenë në atë Komision e një prej tyre është edhe Kryesuesi i Kuvendit, e

vërtetë e madhe është që nuk mund të ndryshoj askush asnjë adresë dhe asnjë rrugë të emërtuar pa kaluar përmes vendimit ë Kuvendit të Komunës, kurse çka është duke ndodh sot është që sot vie dikush dhe thotë nuk po më pëlqen emri i rrugës dhe atyre i'u thuhet që kam ngritur një komision e që në një formë vëhen në lajthitje qytetarët kinse mund të bëjë kushdo çfarë të dojë.
Emërtimi i rrugëve është dokument zyrtar dhe rrugët emërtohen në Kuvendin e Komunës dhe këtu nuk kemi kurrfarë dilemash sepse askush nuk mund të fus apo të heq diçka pa kaluar përmes Kuvendit të Komunës.
Ndoshta e zgjata paksa mirëpo para se t'i kritikoj të tjerët dua që ta kritikojmë ne këshilltarët e Kuvendit veten tonë se a kemi qenë në nivel të përgjegjësisë dhe detyrës tonë për aprovimin e një buxheti e që më duhet ta pranoj, por ju të tjerët keni të drejt të mos e pranoni ngase ka persona që orës 12 të ditës mund t'i thot 12 i natës, por e vërteta është që ne nuk e kemi kryer obligimin ligjor, nuk kemi pasë dëgjime publike dhe kësisoj kemi shkelje ligjore andaj me votimin e këtij buxheti po i bashkëngjitemi një shkeljeje ligjore.
z.Artrit Mulliqi, theksoi, kam replikë për atë që disa herë u përmend emri im mirëpo prita paksa deri sa të qetësohen gjakrat. Disa herë u përmend nga disa prej asambleistëve që një ndër problemet e këtij buxheti është që kërkesat e qytetarëve nuk janë duke u adresuar, do të thotë që kjo rruga Artrit Mulliqi është tamam një adresim i kërkesave të qytetarëve, ajo çka ka ndodhë këtu është një gabim teknik që është lëshuar për çka arsyen nuk e di përse e që mund të jetë ndoshta për arsye politike por që kolegët tanë po dëshirojnë ta keqpërdorin paksa por që në rregull është prej anës së tyre, mirëpo kjo është vetë një kërkesë e qytetarëve dhe asgjë tjetër. Atë rrugë as nuk e kam marrë e ta dërgoj tek shtëpia ime, as nuk është në lagjen time sepse qe 20 vite e kam rrugën e rregulluar, por është një kërkesë e qytetarëve të cilat kanë pasë nevojë në një fshat të caktuar, kështu që për mua është gjithçka në rregull.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, unë e di që ne jemi këtu për t'i paraqitur kërkesat e qytetarëve, shumë mirë që dikush del e viziton një rrugë dhe një lagje që ka nevojë për investime, mirëpo ne nganjëherë nuk i kuptojmë keqkuptimet dhe pastaj po kemi telashe.
z.Xhevdet Maloku, theksoi, sigurisht që diskutimet për buxhetin gjithherë është një moment që kërkon një vëmendje të veçantë për arsye se nga ky dokument dhe llogaritë mbi të cilat ndërtohet ai varet pastaj mbarëvajtja e qeverisjes komunale, punës, reformave dhe projekteve që ndikojnë në zhvillimin e Komunës dhe mirëqenien e qytetarëve të Komunës së Podujevës.
Ky buxhet është një dokument i cili ka për synim projekte në infrastrukturë siç janë, ndërtimi i rrugës lidhëse nga magjistralja Podujevë-Prishtinë deri në rrugën "Vëllezërit Frashëri" si dhe rrugën "Shaban Shala" me rrugën "28 Nëntori" , pastaj ndërtimi, zgjerimi, dhe asfaltimi i rrugës "Xhemajl Musafa", asfaltimi i rrugëve në qytet dhe në mbi 30 fshatra, pastaj ndërtimi i trotuareve, zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të lumit Llap, ndriçimi publik, kolektori, meremetimi i rrugëve me zhavorr, ndërtimi i rrugëve me elemente të betonit.
Ky buxhet siguron mbështetje buxhetore gjithashtu për projektet prioritare në arsim, shëndetësi, bujqësi si dhe projekte të cilat konsiderohen strategjike dhe janë projekte të reja për tu filluar siç është Qendra rezidenciale në bashkëpunim me të nderuarin Halil Kastrati dhe "Jetimat e Balllaknit" , ndërtimi i shkollës së mesme te kampusi i shkollave të mesme, ndërtimi i një objekti të ri të shkollës fillore në qytet, ndërtimi i shkollës së re në Shajkoc, ndërtimi i parkut industrial si dhe shumë projekte, si dhe nëse e analizojmë ka një shtrirje të kënaqshme gjeografike duke prek qytetin dhe shumë fshatra.
z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, dëshiroj të sqaroj paksa çështjen e emrave që u përfol këtu dhe që po mendoj se u stërgjatë paksa si temë ngase për 1 apo 2 gabime që dalin në një projekt, të bëhet kaq e madhe, por e kuptoj edhe anën tjetër sepse ju jeni përfaqësues politik dhe

sigurisht që të gjithë pa dallime jeni këtu për të bërë politika, andaj kjo ishte edhe arsyeja që nuk ndërhyra më herët pa i përfunduar ato politika që dëshironit t'i bënit.
Tani dëshiroj t'ju sqaroj se si ka ardh deri te ai gabim teknik e që me bindje të plotë e them se është gabim teknik. E dini që kërkesa vinë prej secilit qytetarë e aq më shumë prej asambleistve, dhe unë personalisht kur dikush prej asambleistve e sjellë kërkesën, kushdo qoftë ai e ndoshta keni mund ta vëreni edhe vet ju qasjen tonë qysh e kemi bërë ku jemi munduar t'i trajtojmë me prioritet duke u bazuar në atë që ju e sjellni një kërkesë të një lokaliteti apo një qytetari që vie përmes juve, pra ai ju njeh juve dhe dëshiron ta shfrytëzoj paksa autoritetin e juaj si asambleist dhe si përfaqësues të tyre që jeni sjellën kërkesat për juve, ai pra nuk vie në dëgjim publik për të paraqitur kërkesën sikurse që nuk kanë ardh banorët e fshatit Dyz që e përmendi z.Valon Demolli ku 1 javë përpara është mbajtur dëgjimi publik për atë lokalitet dhe nuk ka marrë pjesë askush kurse pas 1 jave kanë ardhur tek unë në zyrë komplet dhe kam diskutuar me ata banorë por që një prej vërejtjeve ka qenë kjo përse nuk keni ardhur në dëgjim publik për t'i paraqitur këto kërkesa, pra atë listë që ju kanë dërguar juve e kam edhe unë në zyrë.
Sa i përket rrugës që është përfshirë në projektin për ndërtimin e rrugëve me elemente të betonit, sigurisht e keni parë që janë 81 rrugë që kanë hyrë në projekt për tu ndërtuar me kubza dhe janë kryesisht rrugë të shkurtra aty ku nuk mund të intervenohet me asfalt për shkak të shkurtësisë së tyre dhe për shkak të pamundësisë që të hyhet me mjete të rënda për asfaltimin e tyre.
Kërkesat kanë ardh edhe prej dy asambleistëve që u përmenden, e keqja dhe gabimi teknik është bërë që kërkesa është pranuar në emër të tyre për një lokalitet krejt tjetër, kurse unë tani ju tregoj saktësisht ku janë ato rrugë, pra kërkesa për rrugën Haki Rudari nuk është tek lagja e z.Haki Rudarit por është për një lagje krejt tjetër që është shumë larg zotëri Rudarit, ndërsa kërkesa për rrugën Artrit Mulliqi nuk është as për qytet madje por është për fshatin Sallabaj. Pra ka edhe emra të tjerë ngase bëhet fjalë për 81 rrugë, por meqë i përmendët vetëm këta të dy unë ju sqarove vetëm për këta, mirëpo t'ju them të drejtën unë ndihem shumë mirë kur ju si përfaqësues të qytetarëve i sjellni kërkesat e tilla sepse fundja kjo është edhe puna juaj e që mua tani më vie keq prej dy kolegëve të cekur që prej 81 rrugëve ju është realizuar vetëm nga 1 kërkesë sepse kanë pasë edhe kërkesa tjera, ndërsa po të analizohen gjitha ato rrugë ka shumë që janë të një pjese prej juve këtu por që nuk ju është përmendur emri. Prandaj e them se gabimi është që ato kërkesa ashtu siç i kam marrë unë ashtu i kam dërguar tek një inxhinier i ndërtimit për t'i përgatitur paramasat dhe ai me ato kërkesa i ka emrëtuar ashtu si kod sepse nuk ka dit si ta emërtoj ndryshe dhe ai inxhinier jam i bindur se nuk i ka njohur as Hakiun as Artritin, por që i ka marrë dhe i ka shënuar emrat e tyre, andaj nuk e di përse bëhet kaq polemik për një kërkesë që vie prej juve, e përsëris sërish që më vie shumë keq që vetëm nga 1 kërkesë ju është realizuar nga numri prej 81 rrugëve, ndërsa po t'iu hyhet në detaje atyre rrugëve tjera shumë prej tyre dalin të juaja që janë sjellë ose në mënyrë direkte ose indirekte, por që nuk i përmendim. Madje më duket paska absurde të diskutohet kaq gjatë për këtë temë, unë e potencova që për inkurajim i kemi pranuar dhe i kemi trajtuar me prioritet të gjitha ato kërkesa që janë sjellë prej juve si përfaqësues të qytetarëve, unë jam Ekzekutiv nuk përfaqësoj por marrë kërkesat prej juve, unë bëjë politika Ekzekutive kurse ju bëni politika përfaqësuese, prandaj ka qenë gabim teknik dhe nuk është dasht as të përmendet dhe të bëhet kaq e madhe por e bëtë e kryet t'juajën krejt në rregull, mirëpo ju inkurajoj të vazhdoni të sjellni kërkesa sepse këtë punë keni ju të sjellni kërkesa ne t'i realizojmë ato aq sa kemi mundësi në bazë të kodeve buxhetore, dhe secilën që do e sjellni ne do e pranojmë.
Sa i përket lumenjve që u përmenden nga parafolësit z.Naim Çunaku dhe z.Ekrem Rrahmani, edhe tek ne është breng gjendja e lumenjve që është sot në Komunën tonë, mirëpo problemi përse nuk është paraparë buxhet më i lartë është sepse nuk ka kod buxhetor dhe nuk ka buxhet të

mjaftueshëm po që se edhe total buxheti i Komunës nuk mjafton për ta bërë meremetimin dhe rregullimin e shtratit të lumenjve duke ditë se në çfarë gjendje janë. Te kodi për mirëmbajtje janë të parapara 140,000.00€, në vitin e kaluar kanë qenë 50,000.00€ do të thotë ka më shumë se dyfishim të buxhetit në këtë kod, kaq ka qenë mundësia. Sa i përket rregullimit të shtretërve jemi duke i rregulluar ato aq sa kemi mundësi por ajo që është e rëndësishme ne e kemi dërguar një kërkesë në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës e që gojarisht janë zotuar se do të ndajnë një buxhet për fillimin e rregullimit të shtretërve të lumenjve, kjo për shkak se buxheti i Komunës nuk e përballon këtë e që një gjë të tillë e them publikisht, jua them e qytetarëve dhe juve si këshilltarë të Kuvendit, rregullimin e shtretërve të lumenjve nuk e përballon kodi buxhetor i Komunës, madje as buxheti total i Komunës e lëre më vetëm kodi përkatës për lumenj sepse vetëm një lloj fizibiliteti që e kemi bërë është afër 7 milion euro rregullimi i shtratit të lumenjve në Komunë të Podujevës aty ku shkaktohen dëme, prandaj ne këtë po mundohemi ta bëjmë bashkërisht me nivelin qendrorë sepse nuk kemi mundësi ta bëjmë ne por në vitet e ardhshme do të mundohemi qoftë me ndarje buxhetore qoftë me rialokime si dhe me mundësi tjera ta fillojmë këtë projekt që është madhor dhe i rëndësishëm për Komunën e Podujevës ashtu siç e cekët edhe ju për çka pajtohem.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, drejtori parafolës u munda paska ta zbutë çështjen e ngritur por nuk e di përse fajin gjithherë mundohet ta orientoj djathtas (tek Grupi i LDK). Askush nuk e akuzoj askënd mirëpo asambleisti juaj gaboi që e potenconte shprehjen po rren. Edhe unë e potencova që ndoshta me shumë qëllim i'a keni bërë këtë duke vë projektin e rrugës me emër të tij për at vë në këtë pozitë. Nuk mund të themi se është gabim teknik vetëm për këta dy asambleista sepse keni 81 rrugë dhe diku rreth 70 rrugë i ke me gabime teknike të tilla me emra të njerëzve pa qenë emri i rrugës fare. Ati personi që e qet tenderin ose thuani ta bëjë specifikimin teknik me emërtime të rrugëve e jo të vëhen emra NN kushdo që shkon e paraqet kërkesë ajo të emërtohet me atë emër sepse ne si asambleistë nuk po e dim ku janë ato rrugë e lëre më qytetarët, madje edhe ata që na kanë votuar neve kërkojnë një lloj përgjegjësie nga ne.

Sa i përket çështjes së rregullimit të lumenjve nuk mund të kapërcej pa ju thënë që ta ndalni pak lluksin dhe të paktën zgjeroni ata shtretër të lumenjve vetëm sa për të mos i vërshuar arat, bahçet dhe tokat bujqësore të punueshme, nuk po themi të rregullohen me gurë e të ngjashme por vetëm të zgjerohen, unë personalisht kam pas 4 hektar grurë dhe i gjithë është vërshuar dhe dëmtuar sa që në korrje nuk ka pasë kurrfarë produkti.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, buxheti i Komunës është padyshim dokumenti më i rëndësishëm që vie para Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, përjashtimisht në rastet e dokumenteve të hartës Zonale apo planeve tjera urbanistike që mund të jenë më të rëndësishme, dhe normale që ngjall kërkesa dhe debat për çka është shumë në rregull e që ju jam mirënjohës edhe për vërejtjet dhe sugjerimet që jepen. Diçka që vlen në kuptim të përgjithshëm është se ne i kemi këto kufizime buxhetore që janë të cilat përcaktohen me Qarkoret Buxhetore nga ana e Ministrisë së Financave, andaj edhe po përpiqem t'ju kthej përgjigjet dhe kërkesat që paraqitët.

U cekë nga disa anëtar të Kuvendit çështja e rritjes së buxhetit në kategorinë e pagave dhe në atë të mallrave, çështje kjo e cila fillimisht përcaktohet me Qarkore Buxhetore ku thuhet këto janë limitet buxhetore brenda kategorive përkatëse që i përcakton Ministria e Financave e që normalisht edhe ata këtë e bëjnë në bazë të një kualifikimi dhe një kalkulimi. Hyrja në fuqi e Ligjit të pagave ka ndikuar në rritjen e buxhetit në kategorinë e pagave dhe normalisht ky është një kalkulim i sakt që duhet t'iu përgjigjemi koeficienteve që i përcakton Ligji i pagave e që ka rritje të pagave nëpër të gjithë sektorët publik si në administratë, shëndetësi dhe arsim ku janë prek të gjithë, disa me një diferencë më të lartë disa më të vogël.

Kemi rritje të buxhetit edhe në kategorinë e mallrave mirëpo kjo ka ndikuar nga një inflacion ku ka pasë rritje të çmimeve e që natyrisht ndikon edhe tek rritja e buxhetit sepse mallrat janë diçka e domosdoshme që duhet të sigurohen, në rast se marrim shembull sektorin e shëndetësisë është e domosdoshme furnizimi me mallra, barna dhe materiale tjera shëndetësore dhe hargjuese për çka është dashtë të rrisim buxhetin në këtë kategori të mallrave në shëndetësi dhe kemi zvogëlim të buxhetit në kategorinë e kapitaleve për shkak se ndërtimi i objekteve shëndetësore në Komunën e Podujevës pothuajse është rrumbullakuar dhe nuk paraqiten nevoja shtesë për ndërtimin e objekteve shëndetësore përkundër që kemi nevoja për pajisje shëndetësore dhe renovim të objekteve shëndetësore.
U tha se nuk është buxhet zhvillimor, mirëpo unë besoj se prioritetet e zhvillimit të cilat duhet të jenë është arsimi, shëndetësia dhe është ekonomia dhe nëse marrim sektorin e arsimit kem i një rritje shumë të madhe të buxhetit nga vitet e kaluara ku janë mbi 1,500,000.00€ që janë investime për ndërtimin e objekteve të reja arsimore dhe për renovim të objekteve ekzistuese arsimore si dhe kemi adaptimin e shkollës së vjetër të Orllanit në Çerdhe duke marrë për bazë që shkolla e vjetër në fshatin Sfeçël ka qenë në plan për rrënim por ne e kemi rinovuar dhe kemi parë që është përshtypje e të gjithëve se ka dal një objekt shumë i mirë dhe shumë funksional për kryerjen e funksionit të Çerdhes e që planifikohet të bëhet e njëjta edhe në fshatin Kërpimeh.
Pastaj kemi sektorin shëndetësor që është mjaftueshëm i mbuluar me buxhet në qoftë se marrim kategorinë e mallrave ngase ashtu qysh e ceka edhe më herët investimet kapitale janë rrumbullakuar dhe nuk ka nevojë për ndërtime të reja të objekteve shëndetësore.
Tek drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Komuna e Podujevës ndoshta projektin më madhor që ka e që ndoshta pak diskutohet për të është ndërtimi i Parkut Industrial ku ne i kemi kryer të gjitha procedurat e shpronësimeve dhe kemi arritur që tani të kemi rreth 30 hektar në pronësi të Komunës dhe jemi në fazën e themelimit të Zonës Industriale që pa dyshim është projekti më madhor në fushën e ekonomisë së Komunës së Podujevës për çka ndjehemi mirë, dhe këto mjete që janë të planifikuara janë për shpronësimin e pronave e që normalisht edhe shpronësimi hynë në kuadër të investimeve kapitale dhe duhet të ketë këtë emërtim në bazë të udhëzimeve të Ministrisë së Financave e që ndërtimin e Parkut Industrial do ta bëjë Ministria e Infrastrukturës.
U cek edhe mungesë e buxhetit për rrjetet e ujësjellësit, mirëpo me vendim të Ministrisë së Financave neve na është ndaluar të investojmë ngase vazhdimisht Komuna e Podujevës e ka pasë një shumë buxhetore për çështje të ujësjellësit mirëpo na është ndaluar që të ndajmë mjete buxhetore për rrjet të ujësjellësit për arsye se e kanë konsideruar që kjo është kompetencë e Kompanive regjionale të ujësjellësit të cilat duhet të merren për investime në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit.
Sa i përket çështjes së shpërndarjes së investimeve nëpër lokalitete, normale që mund të jetë ndonjë fshat më i madh e që në vitin 2024 mund të ketë investime më pak siç është shembull fshati Gllmanik se sa një fshat më i vogël mirëpo fshati Gllamnik për çdo vit është trajtuar me buxhet dhe përgjithësisht kërkesat e qytetarëve janë mbuluar më shumë se në ndonjë fshat tjetër më i vogël por që normalisht edhe aty jetojnë qytetarët dhe është e domosdoshme t'ju përgjigjemi nevojave të tyre infrastrukturore.
Gjithashtu u përmend edhe ndarja e buxhetit në shumë 100,000.00€ për ndërtimin e shtëpisë së Kulturës, e që ka qenë edhe në vitin e kaluar, ne kemi një Memorandum të bashkëpunimit me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit për projektin në vlerë 1.1 milion euro për ndërtimin e shtëpisë së kulturës ku shuma prej 100,000.00€ është participim nga Komuna kurse pjesa tjetër është investim i Ministrisë.

Sa im përket kërkesës për Çerdhe në fshatrat Kërpimeh dhe Gllamnik, ju sqaroj se për Kërpimeh veç u sqaruam më herët kurse për fshatin Gllamnik kemi premtim nga Ministria së Arsimit se ata do ta bëjnë ndërtimin dhe normalisht që një Çerdhe ka një kosto goxha të madhe por që në rast se investon Ministria e Arsimit për neve është një lehtësi buxhetore sepse ato mjete pastaj i rialokojm në projekte tjera që janë nevoja të qytetarëve.
Pati edhe disa pyetje tjera rreth shërbimeve kontraktuese për shërbime dhe mallra, jemi në dijeni se kodi i shërbimeve kontraktuese që u përmend Arsimi, Shëndetësia dhe Shërbimet Publike, janë çështjet e trasportit, dezinfektimit, aparatet fotokopjuese që janë me qira, çështje të ndryshme të shërbimeve teknike dhe normalisht këto mbulohen me shërbime të ndryshme kontraktuese por që kur bëhet fjalë tek plani i prokurimit këto ndahen në projekte të caktuara aty ku ka nevojë të zhvillohet procedurë e prokurimit ngase disa prej tyre janë me Autoritetin Qendrorë të Prokurimit.
Edhe tek shpërndarja e buxhetit nëpër lokalitete, kemi 35 fshatra ku do të investohet në vitin 2024 mirëpo në ato fshatra ku nuk do të investohet në vitin 2024 normalisht se do të investohet në vitin 2025 dhe 2026.
Unë bëra përpjekje të përgjigjem në të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura mirëpo nëse ka diçka që nuk kam arrite të përgjigjem jam i gatshëm të marr fjalën sërish.
z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, u parashtrua një pyetje me vend nga asambleistja e AAK-së znj.Mrika Thaqi, lidhur me transportin e fëmijëve me nevoja të veçanta është e vërtetë se në vitin e kaluar kemi pas një bashkëpunim të mirë me Organizatën Rotary Club ku ne si Komunë kemi qenë bashkëfinancues në atë projekt e që shpresojmë të vazhdoj edhe tutje sepse kërkesat kanë qenë specifike vetëm për qytet, përndryshe transportin e fëmijëve me nevoja të veçanta ne i kemi të përfshirë në kontratë dhe të planifikuar, madje është interesante se në fshatin Gllamnik vetëm një fëmijë është i atij vendi dhe kemi menduar që ata fëmijë ti marrim nga fshatrat e tyre ga vijnë dhe t'i bartim në shkollat "Dr. Ibrahim Rugova" dhe "Enver Maloku" dhe pikërisht atë Qendër që është me investimet e premtuara nga Ministria e Arsimit por edhe ne me kontratën e renovimeve do të realizohet një kërkesë e arsyeshme që e paraqiti asamblisti nga radhët e PDK-së për renovimin e asaj shtëpie ku janë duke qëndruar aktualisht fëmijët me nevoja të veçanta që të shndërrohet në Çerdhe sepse është kërkesë e kamotshme e fshatit Gllamnik.
Gjithashtu ishte edhe një fushë sportive në fshatin Dumnicë, por fushat sportive kanë kaluar me buxhet në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, mirëpo edhe nëse nuk mund të realizohen, ne në planifikim kemi ndërtimin e sallave sportive dhe kemi menduar që jo vetëm fusha të hapura por në secilën shkollë të ndërtojmë fusha të mbyllura për shkak të temperaturave të ulëta që mbizotërojnë në vendin tonë dhe e vetmja formë për të realizuar aktivitetet sportive po është muaji prill – maj dhe qershor eventualisht. Pra si total në buxhet kemi përfshirë ndërtimin e sallave sportive dhe kërkesa në fjalë do të realizohet qoftë nga DKRS qoftë nga DKA.
znj.Mrika Thaqi, theksoi, falënderoj drejtorin parafolës të DKA mirëpo ajo që unë e paraqita nuk ishte pyetje por ishte propozim konkret, andaj të shikohen të gjitha mundësitë se çfarë mund të bëhet në kuadër të këtij buxheti për çështjen në fjalë.
z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, lidhur me kërkesën e parafolëses, theksoi, është e përfshirë në kudër të transportit dhe kur DKA mbledhë nevojat e Drejtorisë, në kuadër të transportit është edhe shërbimi i transportit për fëmijët me nevoja të veçanta, dhe duhet të jetë prioritet.
z.Valon Demolli, theksoi, i nderuar Drejtor, që janë rritë pagat 30% kjo është absurde dhe është e pavërtetë. Ligji për paga ka hyrë në fuqi në muajin shkurt 2023, për këtë vit keni pasë buxhet rreth 13 milion euro kurse në vitin 2024 ke planifikuar buxhet 16.5 milion euro, andaj konsideroj se ky është një manipulim sepse Komuna ka rreth 2000 punëtor e që i bie se rritja mesatare të jetë rreth 140 €.

Sa i përket buxhetit për shërbime kontraktuese, nëse ka mundësi të specifikohen paska sepse janë pyetje 750,000.00€. Pastaj keni planifikuar për asfalt në qytet 325,000.00€ andaj nëse ka mundësi të na tregoni ku janë ato rrugë në qytet sepse vetëm thuhet asfalt në qytet, kurse unë nuk e di që ka rrugë të paasfaltuar në qytet.
Sa i përket busteve, për Ibrahim Rugovën jan ndarë 50,000.00€, kurse për bustin e Adem Demaçit kanë qenë 60,000.00€, andaj nuk e di si është bërë kjo diferencë, nëse krahasohet me madhësi unë e di që Rugova ka qenë paksa më i madh / gjatë, prandaj nuk e di se qysh e keni vlerësuar këtë.
z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit mundohu që specifikisht të dalloni propozimet e dhëna si kode të reja buxhetore, dhe pyetjet që janë bërë. Pra derisa ke propozim për kod me emërtim të sakt të një projekti ai duhet të del në votim në Kuvend se a do ta përkrah Kuvendi apo jo, por jo të jepen sqarime dhe të mbetet në nivel të pyetjes.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, unë procesmbajtës nuk jam dhe nuk mund t'i mbaj mend kodet e propozuara mirëpo është dashtë që kushdo që ka kod të veçantë për propozim të më prezantoj edhe në formë të shkruar dhe unë pastaj e hedh në votim, nuk është problem fare kjo.
z.Naim Çunaku, theksoi, zotëri Kryesues, me gjithë mirëkuptimin për këtë që po e thua jam shumë i vetëdijshëm që nuk je procesmbajtës, mirëpo propozimet e anëtarëve të Kuvendit duhet t'i marrësh si shënim propozime konkrete ku janë dhe propozimet konkrete duhet të dalin në votim, pra kjo është procedura për çdo vendimmarrje në Kuvend.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, normale është kjo që e potencove i nderuar Çunaku, por edhe me Rregullore të punës së Kuvendit është që propozimet duhet të jepen edhe në formë të shkruar nga ana e propozuesit.
z.Naim Çunaku, theksoi, pa dashtë të polemizoj për këtë çështje, si të doni bëjeni, por mendova që sot jemi me fat që sot nuk po e përmendim Rregulloren e punës së Kuvendit, mirëpo aty thuhet që propozimi duhet të jetë në formë të shkruar ose mund të bëhet gojarisht, në fakt para seancën duhet të jetë me shkrim, por është e drejtë ekskluzive e kuvendarit që të jep propozime edhe gojarisht ndërsa validiteti qoftë gojarisht qoftë me shkrim është i njëjtë.
z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, mund të bëhen propozime të tilla dhe të votohen mirëpo duhet të jenë të specifikuara me shuma buxhetore dhe kode e programe buxhetore.
z.Naim Çunaku, theksoi, çdo propozim i një kuvendari që e bënë duke kërkuar që të futet edhe ai projekt, gjegjësisht që e mënon se është e arsyeshme që ai projekt të jetë pjesë e buxhetit duhet të hedhet në votim në mënyrë që të vendos Kuvendi se ai projekt a duhet apo jo të jetë pjesë e buxhetit, kështu është rregullorja dhe kështu është puna e vendimmarrjes.
z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, në rregull është, kjo mund të kaloj sipas propozimit të znj.Mrika Thaqi, mjetet buxhetore afër 300,000.00€ të transportit të nxënësve janë në kuadër të shërbimeve kontraktuese, dhe për transportin e fëmijëve me nevoja të veçanta e që edhe tani është duke u mbuluar ky transport, por që në bazë të një analize të shpejt mjetet buxhetore për këtë çështje nuk mund të jenë më shumë se 20,000.00€, andaj kjo mund të votohet dhe këto mjete merren në kuadër të kësaj e që besoj se jemi në rregull, pra mund të inkuadrohet propozimi i znj.Mrika Thaqi.
z.Naim Çunaku, theksoi, te kategoria e peronave me nevoja të veçanta, edhe pse nuk deshta të diskutoj dhe të merrem me projektbuxhetin sepse diskutuan të tjerët, por deshta të merrem me atë se ku jemi ne si Kuvend dhe përgjegjësitë tona si anëtar të Kuvendit të Komunës, mirëpo në këtë projektbuxhet nuk sheh diçka që shkon në drejtim të peronave me nevoja të veçanta, pavarësisht asaj që mund ta marrim që krejt kjo shoqëri e ka një fokus të veçantë të kësaj kategorie, andaj çka do të ishte për buxhetin e Komunës tonë që të parashiheshin mjete buxhetore ta zëmë për 10 shtëpi që t'jua rregulloj shkallë të pjerrëta për lëvizje më të lirë dhe të lehtë për të lëvizur, pastaj ta zëmë

10 nyje sanitare apo 10 diçka tjetër të nevojshme, pra një diçka më ndryshe në këtë buxhet ngase projektbuxheti vazhdimisht ka qenë një shabllon dhe jemi duke shkuar në të njëjtën rrugë e që në vazhdën e kësaj që e potencova kjo kategori e peronave nuk zë vend të merituar dhe as që përmendet diku në projektbuxhet, andaj vërtetë pa dashtë të prekë atë sentimentin apo anën emocionale, do të ishte mirë që Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të na tregon të paktën një shifër se sa njerëz kemi me nevoja të veçanta e që sigurisht do të na bënte të gjithë neve të mendojmë dhe t'i themi kujtesës tonë që nuk jemi duke bërë asgjë për atë kategori të personave e cila meriton një vëmendje më të madhe dhe të spikatur në projektbuxhetin e Komunës, prandaj kjo më bëri të marrë fjalën dhe intervenoj për këtë çështje.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se diskutimet përfunduan dhe nuk ka të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, andaj e hedh në votim propozim projektbuxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2025-2026, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, plotësim ndryshimet e propozuara nga drejtori i DBF në fjalën hyrëse si dhe propozimin e znj.Mrika Thaqi.

Meqë pati kërkesa që të hedhet fillimisht propozimi i znj.Mrika Thaqi, Kryesuesi i Kuvendit e hedh në votim vetëm këtë propozim, dhe u konstatua se njëzëri me 31 vota Për nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent, mbështetet propozimi i znj.Mrika Thaqi që në kuadër të transportit të nxënësve të ndahet një shumë buxhetore si nën-linjë e veçantë për transportin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 18 vota Për, 1 votë Kundër dhe 1 votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet propozim vendimi i projekt buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025/2026, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe plotësim ndryshimet e deklaruara nga drejtori i DBF në fjalën hyrëse si dhe propozimin e mbështetur paraprakisht të znj.Mrika Thaqi.

Pas kërkesave të një numri të anëtarëve të Kuvendit për një pauzë, Kryesuesi i Kuvendit jep pauzë 1 orë, dhe atë nga ora 12:00

Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 13:25.

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, i cili fillimisht konstatoi kuorumin ku prezent janë 29 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës.
Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin anëtarët/et e Kuvendit, dhe atë:
*(*Nga LDK, *Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta*; Fahri Hasani.
Nga LVV*, Fitim Muqolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota*; *Sebastina Vokrri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi.*
Nga PDK, *Bashkim Syla; Mimoza Abdullahu; Endritë Murati.*
Nga AAK, *Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.*

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;
(Fatlum Osmani-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE; Alban Zeka-Drejtoria e Inspeksionit DI; Lirie Hoti-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR)

Gjithashtu të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin përfaqësues të OSCE, media lokale dhe një numër i zyrtarëve komunal.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, vazhdojmë me rendin e ditës aty ku kemi mbet, kuorumi ekziston dhe mund të vazhdojmë me mbledhjen, pra jemi në pikë e 3-të të rendit të ditës dhe fjalën hyrëse e ka kërkuar drejtori i DBF.

3. Propozim Vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri
(Projekti për furnizim me mekanizëm bujqësor)

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, Komuna e Podujevës ka nënshkruar një Marrëveshje me Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim-Tika për bashkëfinancimin e një projekti në fushën e mekanizmit bujqësor, ku pjesë e kësaj Marrëveshje ka qenë edhe participimi i fermerëve me 15% të vlerës së projektit, që në total vlera e kësaj shume pra 15% të projektit është 5.925.00€, me që rast fermerët e kanë përfunduar participimin e tyre, mirëpo që të bartet kjo shumë buxhetore nga ana e Ministrisë së Financave tani na nevojitet edhe vendimi i Kuvendit Komunal, andaj ju ftoj që ta mbështetni këtë vendim në mënyrë që të mbyllet ky projekt që pjesa më e madhe është financim nga Agjencia Turke Tika.
znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, shtimin e buxhetit dhe kod të ri ne e mirëpresim dhe e përkrahim si Grup i LDK-së, por ajo që ne nuk pajtohemi është pjesa e participimit të qytetarëve, meqenëse Agjencia Turke mbulon 55% të shumës, Komuna merr pjesë vetëm me 30%, kurse ju keni kërkuar që qytetarët të participojnë me 15% të shumës totale.
Në emër të Grupit të LDK-së kërkojmë që Komuna e Podujevës të mbuloj pjesën e participimit të qytetarëve në mënyrë që subvencionet të jenë të plota.
z.Bahri Blakqori, theksoi, drejtori i DBF e arsyetoi shtimin e buxhetit dhe kod të ri, andaj në emër të Grupit të LVV e përkrahim këtë propozim.
z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, sa për sqarim, është pjesë e Marrëveshjes së nënshkruar me Agjencinë Turke, ku edhe fermerët janë pjesë e participimit dhe ka shumë organizata që është

politik e tyre ku nuk bëhen pjesë e subvencionimit pa pjesëmarrjen e fermerëve me participim të cilët furnizohen me mekanizëm bujqësor.
Shumë herë këto janë edhe kritere kur kemi kësi lloje të financimeve të organizatave që është e domosdoshme participimi i atyre që janë përfitues i subvencioneve.
z.Naim Çunaku, theksoi, nga kjo që dëgjuam deri më tani, një donator ka shpreh gatishmërinë të implementoj një projekt, shtim i mekanizmit bujqësor, mirëpo po nga ajo që dëgjova nga drejtori i DBF ai donacion në një formë dikton kushte se si duhet të implementohet.
Nuk dua të përsërisë atë që e theksoi kolegia znj.Donjeta Sheqiri, mirëpo prej kohës që kanë filluar këto subvencione e kemi mbrojtur dhe vazhdojmë ta mbrojmë atë sepse qytetarët duhet të lirohen nga participimi i tyre për subvencione, përndryshe nëse ne vazhdojmë me këtë participim kjo në një formë po i dëmton ato ekonomi familjare. Nëse për një mekanizëm bujqësor, për kultivator detyrohet një përfitues i donacionit të paguaj 500 euro dhe vlera në treg e atij kultivatori që varion në treg me çmime të ndryshme duke shtuar edhe pjesët e procedurës që neve na kushtojnë, pra përfituesit po i del me tepër se gjysma për ta blerë, e që më lirë do ta kishte blerë në treg.
Kur jemi te subvencionet, në këtë rast te mëshqerrat, edhe aty nuk është lehtë për një ekonomi familjare t'i ndaj mbi 800€ për të përfituar një mëshqerrë, unë personalisht dje në KPF por edhe tani në Kuvend të Komunës dua të përsërisë që si rrugëdalje nga kjo, nëse kemi mjete të pamjaftueshme buxhetore, propozimi jon është që të zvogëlohet numri i përfitueseve dhe vërtetë ata që e marrin të mos kenë ngarkesa të participimit me faktin e vetëm që kështu nuk jemi duke i'u ndihmuar dhe nuk jemi duke e arritur qëllimin.
Ne Grup i LDK-së jemi që të hiqet participimi i qytetarëve dhe si rezultat i kësaj te subvencionet të kemi kujdes dhe të krijojmë mekanizma kontrollues nga organet komunale për të parë se çfarë po ndodh me ata përfitues pasi që po përfitojnë subvencione, nuk dua të hyjë në emra apo të bëjë atakimin e një projekti, por pjesë dërmuese e projekteve atë ditë që përfundon pra që përfitojnë, një pjesë prej 25% i keqpërdorin ato dhe i hedhin në treg, andaj ne në një formë nuk jemi duke i kontrolluar se çfarë është duke ndodh me këto mjete të buxhetit e që në një formë është duke u bërë tregti me ato.
z.Burim Hasani, theksoi, së pari dua të bëjë një sqarim sa i përket dy Drejtorive sepse qytetarët por edhe anëtarët e Kuvendit të Komunës i bëjnë disa gabime në mos dallimin e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR, dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS. Pra ta kuptojmë që DSHMS ndihmon nevojtarët ndërsa DBPZHR ndihmon bujqit, fermerët dhe blegtorët.
Duke e pasë parasysh këtë propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri buxhetor, është projekt i mirë që përfitojnë bujqit por njëkohësisht kisha dashtë të sqaroj një pjesë të këtyre projekteve të cilat vazhdimisht dalin si projekte për subvencione ku në shumicën e rasteve tek faza e aplikimit bëhen disa gabime të cilat lëshohen duke filluar nga komisioni, nga faza e aplikimit ku në shumicën e rasteve faza e aplikimit të një projekti e jep kërkesën që bujqit kanë të drejtë të aplikojnë për këtë projekt por duhet të themi që bujqit munden që brenda ditës të regjistrohen si fermerë edhe si bujq, shembull të tillë kemi te projekti për mëshqerra ku kemi kërkesa afërsisht prej 400 fermerëve të cilët kanë aplikuar për rreth 130 krerë mëshqerra, gjatë kësaj periudhe të aplikimit ka një numër të madh të fermerëve ose mund të themi fermerë mashtrues ku dy ditë para projektit janë regjistruar si fermer me qëllim të aplikimit apo përftimit të mëshqerrave dhe projekteve tjera, mirëpo në shumicën e rasteve do të bëjë përpjekje edhe në vazhdim që t'iu ndalohet të gjithë bujqve të cilët krijojnë NIF 2-3 para aplikimit, pra të jetë kriter që të paktën 5 vite e fundit të jetë fermerë, e jo të bëhet fermerë 2 ditë para projektit në mënyrë që të aplikojë për të qenë përfitues.

Ndërsa te pjesa tjetër ku bëhen gabime gjatë aplikimit, kemi raste çdo ditë ku mund t'i hasim ato ku edhe kolegët paraqitën ankesa, ku përfitues mund të jenë babai, gjyshi, djali ose X raste tjera, kjo bëhet vetëm për një arsye, pra kjo të jetë ndalimi i aplikimit të anëtarëve të familjes për fermerin e regjistruar, në rast që brenda një vitit janë 5 projekte në vitin e I-rë fermeri i cili është i regjistruar me emër dhe mbiemër dhe numër identifikues dhe personal aplikon për një projekt dhe kur fillon projekti i II-të ai e din këtë kusht që nëse ka qenë përfitues, në projektin e dytë nuk ka mundësi me marrë me atë emër, mirëpo ka raste kur aplikon djali i X personit me emër të tij por me NIF të prindit si fermer, prandaj që këto gabime të mos ndodhin duhet në të ardhmen t'i përmirësojmë.
Po ashtu një shqetësim tjetër ka të bëjë me përfituesit e subvencioneve ku vazhdimisht përfitojnë por pas një periudhe shumë të shkurt kohore i keqpërdorin dhe i shesin mekanizmat e përfituara nga Komuna, kështu që kërkojë që në mbledhjen e radhës të bëjmë një komision për komisionet komunale të cilat e bëjnë vlerësimin e dëmeve, vlerësimin e subvencioneve që të jetë mbi komisionet, pra të ngritët një komision adekuat që e bënë vlerësimin e dëmeve dhe subvencioneve. pavarësisht këtyre që i ceka ne si Grup i AAK e përkrahim këtë propozim vendim.
z.Xhevdet Maloku, theksoi, një pyetje për drejtoreshën e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, sipas vendimit përkatës nuk e kam parë sa është kriteri minimal që një fermerë duhet të ketë numër krerësh mëshqerra që të përfitojë një të tillë, e them këtë sepse e dimë që herëve të kaluara nganjëherë po anashkalohen disa që nuk i plotësojnë kriteret 5 ose me tepër.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, po ndërlidhem me parafolësin kolegun z.Burim Hasani i cili shqetësime i ceku. Kurdo që ti vendos ta hedhësh në votim atë propozim ne do e përkrahim si Grup i LDK-së, por ai propozim nuk përkrahet sepse subvencionet ndahen nga Zyra e Kryetarit dhe Zyrat e Drejtorëve. Po nisem prej fshatit ku jetoj unë, dy fshatrat e Siboc i Epërm dhe Siboc i Poshtëm është një përfitues dhe ai pa asnjë dokument të fermerit e ka përfituar një mëshqerrë kurse njerëzit që i kanë plotësuar të gjitha kushtet e kërkuara, asnjë komision nuk ka shkuar të verifikoj gjendjen e tyre sa i përket kushteve. Prandaj i nderuar Burim ti merre iniciativën, votën tonë e ke.
znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, siç e theksoi edhe Kryesuesi i Kuvendit, javën e kaluar jam emëruar drejtoresh e DBPZHR, meqë është fjalimi im i parë pranë juve këtu në Kuvend Komunal shpreh rastin të ju përshëndes të gjithëve dhe shpreh vullnetin tim për bashkëpunim në çdo projekt, jam e gatshme për çdo pyetje tuajën të përgjigjem me aq sa unë kamë informacion dhe të jap kontributin tim në çuarjen përpara të të gjitha projekteve që do t'i zhvillojmë së bashku si Drejtori. Patjetër që mirëpres çdo këshillë dhe çdo kritikë tuajën vetëm e vetëm të bëjmë më të mirën për qytetarët e Komunës së Podujevës.
Për t'ju përgjigjur pyetjes së z.Xhevdet Malokut, në këtë kohë nuk po e konsideroj vetën kompetente për shkak se siç e potencova kam ardhur vetëm javën e kaluar dhe atë më datë 18 kam filluar ushtrimin e kësaj detyre, mirëpo pyetjen tuaj e shënova dhe patjetër që sot do të marr informacion lidhur me kriteret për aplikim për mëshqerra dhe do t'iu kthej me kohë përgjigje me shkrim në kohën sa më të shpejtë.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush e dëshiron fjalën nëse jo atëherë e hedh në votim Propozim Vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 28 vota Për, 1 votë Kundër e z.Naim Çunaku, dhe asnjë votë e Përmbajtur, miratohet propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin "furnizim me mekanizëm bujqësor", sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

4. Propozim Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, në bazë të Ligjit për tatim në pronë, Komuna e Podujevës ashtu si çdo Komunë tjetër e ka për detyrë të caktoj normat tatimore duke u bazuar në kategoritë e pronave dhe normalisht duke u bazuar në limitet të cilët i parasheh Ligji për tatim në pronë. Edhe në këtë vit norma tatimore përcaktohet në bazë të kategorive të pronave, ndërsa nga viti 2025 tatimi do të llogaritet vetëm në bazën e vlerave të pronave që nënkupton një tatim progresiv duke u bazuar në vlerën e pronës pa marr parasysh kategoritë e pronave. Propozim vendimin besoj që e keni marr të gjithë në afatin e rregullt për dërgimin e materialeve në Kuvend Komunal dhe këto janë normat e përcaktuara të cilat ne i kemi propozuar.
Vlen të cekët që për vitin 2024 shkalla e përllogaritjes së tatimit në pronë fillon nga 30,000.00€, në vitet e kaluara tatimi është llogaritur nga 15,000.00€, pra në rast se një pronë e ka vlerën 30,000.00€, 15,000.00€ e para ju kanë zbritur dhe është llogaritur mbi bazën e 15,000.00€, ndërsa tani llogaritet deri 30,000.00€, kështu që të gjitha pronat që llogariten deri në 30,000.00€ nuk paguajnë fare tatim në pronë, ndërsa ato që kanë vlerën mbi 30,000.00€, llogariten dhe paguajnë tatim mbi bazën e kësaj vlere, pra nëse prona është 40,000.00€ duhet të paguaj vetëm për 10,000.00€, kështu që duke pasur parasysh këta tregues ne kemi një zvogëlim të faturave të tatimit në pronë për vitin 2024 për pjesën dërmuese të qytetarëve, 30,000.00€ vlen për pronat rezidenciale ndërsa për prona bujqësore është mbi vlerën 50,000.00€, do të thotë që deri në 50,000.00€ vlera në prona bujqësore nuk paguajnë fare tatim.
znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së e përkrahim propozim vendimin për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024.
z.Xhevdet Maloku, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim këtë propozim vendim.
z.Bashkim Syla, theksoi, ne edhe në mbledhjen e fundit të Komitetit për Politik dhe Financa e kemi diskutuar dhe kemi dhënë 3 propozime, sa i përket tri pikave të para pika 1.1 për njësitë bujqësore parcela nga 0.15% të zbritet në 0.10%, pika 1.2 për njësitë bujqësore të objekteve nga 0.15% në 0.10% dhe për njësitë pyjore të parcelave nga 0.15% në 0.10%.
Pra ky është propozim që të bëhet ndryshimi për caktimin e normave të tatimit në pronë, kështu që ju lus ta vëni në votim.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, propozimi im është i njëjtë me propozimin e z.Bashkim Syla, që të zbritet nga 0.15% në 0.10%.
z.Naim Çunaku, theksoi, ne edhe dje në KPF e trajtuam këtë temë, dhe po më vjen mirë që po koicidon me dy parafolësit z.Bashkim Syla dhe z.Ekrem Rrahamni, andaj edhe unë propozoj që norma e interesit të tatimit të zbritet nga 0.15% në 0.10%.
z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, ndoshta po më bie të përsëritëm, vlerësimin e pronave e bënë Ministria e Financave - Departamenti i Tatimit në Pronë, pra nga vlerësuesit e specializuar dhe vlerësimi i tyre bëhet në bazë të zonave të Komunës së Podujevës në këtë rast, qyteti ka disa zona pastaj fshatrat ndahen secili në zonë të veçantë.
E potencova që ka zbritje të theksuar të tatimit në pronë për shkak të shkallëve të përllogaritjes nga 15,000.00€ ka shkuar në 30,000.00€, unë këtu i kam edhe përllogaritjet për prona të ndryshme, shembull në fshatra afërisht është nga 250-300 euro metri katror në prona rezidenciale ku 300 euro është maksimumi në fshatra, kjo nënkupton që për një shtëpi 100 metra katrore në një fshat nuk paguhet fare tatim në pronë, kështu që në rast se ulet akoma më shumë tatimi në pronë që për mendimin tim 30.000.00€ ka qenë e tepruar sepse po i humb funksioni sistemit të tatimit në pronë, dhe në rast se shtëpia është 120 m^2 nënkupton që i bie të paguaj tatim më pak se 5 euro e që

Komuna duhet t'i kryejë disa shërbime këtu, shembull e kemi për obligim ligjor të dërgojmë zarfet në shtëpi përmes Postës që është obligim ligjore ky, pastaj shërbimin e shtypjes, faturës dhe gjitha këto elemente, kështu që po theksoi që i humb tej mase funksioni sistemit të tatimit në pronë.
Pa dashtë t'ju lodhi me shifra të cilat janë për çështjen e tatimit në pronë, po them që për shkak të rritjes së shkallës vlera prej 0.15% është minimale, te parcelat bujqësore është faza kur fillon llogaritja është 50,000.00€, shembull metri katror për livadh është i vlerësuar prej 0.45 cent deri maksimum 3.65 cent që nënkupton që ai duhet mi pas në rastin më të lartë të vlerësuar ti ketë mbi 4 hektar livadh për të filluar të trajtohet ai, ndërsa ne e dimë se si është parcelizimi dhe ndarja e tokave që të paktën janë ata që kanë parcela bujqësore aq të mëdha për tu tatimuar, do të thotë bujqësia tatimohet shumë pak, shembull toka bujqësore - Ara është nga 0.60 cent deri në 4.60 cent, kjo vlen vetëm në zonën përkatëse, kështu që tatimi në pronë ka një ulje të faturës nga vitet e kaluara, pra e njëjta gjë është edhe për pronat rezidenciale ku tatimi për një banesë në qendër të qytetit me këtë 30,000.00€ që ka shkuar si shkallë e përllogaritjes i bie që tatimi është më pak se 10 €, pra një banesë 70 m^2 i bie më pak se 10 euro, normalisht ky është propozimi i jonë kurse vendosja i takon Kuvendit të Komunës, mirëpo unë po bëjë përpjekje për të sqaruar çështjet, ndërsa mbetet të shihet se si do të vendosni.
z.Naim Çunaku, theksoi, falënderoj drejtorin parafolës për sqarimet lidhur me atë se si do duket tatimi, ne e dimë që në programin e subjektit që qeverisë këtu dhe në nivel qendror, kemi ndryshimin e ligjit dhe futjen e tatimit progresiv, dhe propozimi im ishte edhe si orientim programor partiak edhe që duhet të lehtësojmë duke e pasur parasysh gjendjen socio ekonomike të qytetarëve të Komunës së Podujevës, duke shtuar edhe atë që ndodhi me faljen e tatimit në pronë nga 100 € apo them ndryshe mashtrimi që ndodhi me të, ku më pas u implikua edhe Gjykata Kushtetuese dhe këtë vit e kemi një tatim të ngritur dhe duke u bazuar në këto dhe në orientimin programor dhe sidomos që të lirojmë sado pak gjendjen socio ekonomike e sidomos pronat bujqësore, unë qëndroj prapa propozimit që të paktën të zbritet në 0.10%.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, na që jetojmë në fshatra po e shohim se si po punohet në fshatra, të lusin vetëm punoje tokën e jo të ketë tatime, kështu që jemi në telashe e sidomos në vjeshtë që po djegën arat nga zjarret që po shkaktohen. Për biznese të tjera s'po foli fare, por për bujqësi edhe për tokat bujqësore po edhe nëse lihet zero tatim ndoshta do t'ia vlente sepse po e shohim që bujqit nuk po kanë përfitime,.
Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim fillimisht propozimin e z.Bashkim Syla së bashku me përkrahësit tjerë që u paraqiten.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 29 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent, me 16 vota Për, asnjë votë kundër dhe asnjë votë të përmbajtur (të tjerët nuk votuan), mbështetet propozimi i z.Bashkim Syla që për tri njësitë e para në propozim (1-bujqësore të parcelave; 2-bujqësore të objekteve; 3-pyjore të parcelave), norma e tatimit nga 0.15% të zbritet në 0.10%.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani e hedh në votim propozim vendimin përkatës duke përfshirë edhe plotësim ndryshimin sipas konstatimit paraprak.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri nga 29 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent, miratohet propozim vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje si dhe propozimin e mbështetur të z.Bashkim Syla që për tri njësitë e para sipas propozim vendimit, norma e tatimit të jetë 0.10%.

5. Propozimi i Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF
- Raporti nga diskutimi publik

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, në mungesë të drejtoreshës së DSHMS e cila është në udhëtim zyrtar, më lejoni t'i them disa fjalë për Statutin Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Podujevë, është obligim ligjor që Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare të ketë Statutin e vetë, ky Statut është bërë në kuadër të Udhëzimit Administrativ përkatës për Shëndetësi dhe kujdesin primar shëndetësor, që është statut unik i përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë për kujdesin parësor shëndetësor të datës 31.12.2020, pra ky Statut është i harmonizuar me statutin unik të Ministrisë së Shëndetësisë që është hartuar për Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare,
Lidhur me këtë, është mbajtur apo është bërë një njoftim për dëgjim publik dhe sa jam i informuar nuk ka pasur të interesuar për këtë dëgjim publik. Këshilli drejtues i QKMF-së me datën 05.06.2023 me të gjitha votat e anëtarëve ka miratuar këtë version të Statutit dhe është përcjellë në DSHMS ku edhe ka marr konfirmimin ligjor për formën e këtij Statuti, pastaj ka marr edhe miratimin për diskutim publik nga ana e Kuvendit Komunal dhe tani e kemi një Statut të përmbledhur dhe kërkojmë nga ana juaj që të miratoni këtë Statut, që është domosdoshmëri për funksionimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare.
z.Valon Demolli, theksoi, qëllimi i këtij Statuti që sot e kemi para vetës do duhej të ishte ndryshimi për së mbari i shërbimeve që i ofron QKMF, e jo shuarjen e shërbimeve shëndetësore ndaj qytetarëve për shkak të pensionimit të kuadrit mjekësor në QKMF. Në kushte normale ju është dashtë të dërgoni në specializim mjekë të fushave të ndryshme të mjekësisë të cilët do t'i zëvendësonin mjekët specialist të cilët dalin në pension, e jo të shuhen shërbimet shëndetësore ndaj qytetarëve të Podujevës. Për çdo shërbim specialistik qytetarët duhet t'i drejtohen Prishtinës për shkak se ju nuk e keni përtërirë kuadrin me mjek specialist, por që tani më e keqja është se edhe ligjërisht po i largoni ato shërbime ndaj qytetarëve.
Ju gjithashtu nuk jeni duke bërë asnjë veprim të vetëm në drejtim të ndërtimit dhe funksionalizimit të Spitalit të Podujevës.
Për shkak të kriterit të paraqitur për përzgjedhjen e drejtorit të QKMF-së në Podujevë, e që drejtori i QKMF-së në Podujevë duhet në mënyrë decidive të jetë specialist i mjekësisë familjare dhe keni bërë përjashtim arbitrar të mjekëve specialistëve të tjerë, kjo për shkak se drejtorin e QKMF-së e bëni varës të drejtpërdrejtë të Kryetarit të Komunës apo sikurse të emëruar politik dhe me këtë ta politizoni institucionin shëndetësor. Për shkak të reduktimeve të shërbimeve shëndetësore dhe ngecjen në avancim si dhe për shkak të promovimit të politikave të gabuara në shëndetësi, Grupi i LDK-së e vlerëson se ky Statut i QKMF-së në Podujevë nuk është në interes të qytetarëve dhe nuk e mbështesim si të tillë. Ne nuk mund të përkrahim një Statut që është bërë për qefin e Bajram Bajgores dhe Istref Plakollit në mënyrë që ta sundojnë më lehtë QKMF.
z.Artrit Mulliqi, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim propozim Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Podujevë.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush e dëshiron fjalën nëse jo atëherë e hedh në votim propozim Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Podujevë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 13 vota Për, 8 vota kundër dhe 1 votë e Përmbajtur, miratohet propozimi i Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF në Podujevë, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

6. Propozim Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027
- Raporti nga diskutimi publik

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, tashmë jeni pajisur me planin komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027, ne kemi filluar me herët marrjen e vendimit për këtë plan dhe i kemi kaluar të gjitha procedurat e dëgjimit publik, fatkeqësisht dëgjimi publik siç po na ndodh shumë shpesh nuk po ka shumë të interesuar që të marrin pjesë dhe që të dhënë kontributin e tyre në hartimin e këtij plani mirëpo ne sipas obligimeve ligjore kemi qenë të detyruar që të vim deri te kjo situatë ku jemi sot.
Ky plan ka filluar të punohet falë bashkëpunimit që kemi me GIZ-in dhe me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe është hartuar nga organizata KIEV i cili edhe është dërguar në Kuvend si material në mënyrë që të rishikoni/shqyrtoni edhe njëherë dhe t'i jepni mendimet e juaja për këtë Draft Plan i cili pra është tani më është në fazën përfundimtare dhe shpresojë që do të na ndihmojë shumë në menaxhimin e mbeturinave, ripërdorimin dhe riciklimin e tyre si dhe mbledhjen e mbeturinave nga ekonomitë familjare për çka siç jeni në dijeni ka pasur vështirësi të vazhdueshme për shkak të mos inkasimit në total nga të gjitha ekonomitë familjare, por që tani kemi filluar një proces ku po bëhet regjistrimi i ekonomive familjare të cilat nuk kanë qenë në sistemin e inkasimit dhe po shpresojë që ky plan do të na ndihmojë shumë për menaxhimin e integruar të mbeturinave.
Për fund dua t'ju them që si Plan kërkon një kosto buxhetore bukur të madhe dhe ne si Komunë nuk kemi ndarë një shumë të madhe buxhetore e që mund ta shihni në fund listën me shpenzime buxhetore, pra nuk kemi pasur mundësi të ndajmë një buxhet më të madh mirëpo gjithherë jemi në bashkëpunim me Qeverinë dhe Organizatën Gjermane GIZ e cila jep kontribut të madhe në menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe shpresojmë që brenda këtyre 4 viteve këtë plan do ta implementojmë në një shumicë të madhe. Ju ftoj që të përkrahni këtë plan dhe njëkohësisht i pres sugjerimet e juaja.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027 fillimisht nuk është për 4 vite por 5 vite i nderuar drejtor, shembull për vitin 2023 janë të shkruara që janë ndarë 130,000.00€ kurse sa kam informacion unë nuk është ndarë asnjë cent, pastaj për vitin 2024 e keni cek që 95% të ekonomive familjare dhe bizneseve hyjnë në sistem kurse në vitin 2025 100% hyjnë në sistem, ndërsa buxhetin e keni ndarë për deponim ilegale 247,000.00 €, nuk e di a hyjnë të gjithë në sistem, pra përse të ndani këtë buxhet 247,000.00 € për deponi të egra.
Sa i përket draftit e kam lexuar komplet, unë personalisht nuk e di se kush e ka bërë vetëm e di që asgjë të saktë nuk përmban, shembull, po fillojë nga titulli dhjetor 2022, kurse plani është 2023-2027, në faqen tjetër janë shkurtesat gjysma anglisht ndërsa fjalët shqip, shembull këtu e ke Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, unë mendojë që shkurtesa është dashtë të jetë MMPHI ndërsa e keni shënuar MESPI, pra të gjitha janë gabim, pastaj në faqen 10 shkruan se Podujeva gjendet në magjistralen Shkup dhe në magjistralen e Adriatikut, kjo nuk qëndron askund, mandej diçka tjetër që më bëri përshtypje është në draft - në faqen 12, numri i gurëthyeseve në Komunën e Podujevës është 3 dhe dy prej tyre ndodhen në afërsi të fshatit Metehi ndërsa një në fshatin Popovë, veprimtaritë e eksplantimit minerar ushtrohet edhe nga 7 operator ilegal të cilët veprimtaritë e tyre i kanë të lokalizuara kryesisht në këto vendbanime, Repë, Podujevë. Majac, Lluzhan, Batllavë, nuk e di në çfarë mënyre të gjitha këto kompani të mëdha me operua ilegalisht në Komunën e Podujevës, përse ilegalisht, a është dashtë inspektori të shkoj aty, apo nuk ka qenë kurrë. Në faqen 20 të Planit thuhet Komuna e Podujevës ka resurse të konsiderueshme që mundësojnë zhvillimin e bujqësisë dhe krejt në fund të tekstit figuron viti

2011-2014 ku tregon se sa hektar tokë bujqësore kanë qenë në vitin 2011, ndërsa plani është për vitin 2023-2027. Më pas në këtë plan figurojnë statistikat për nxënësit e shkollave, numrin e shkollave dhe të arsimtarëve por viti këtu është 2013-2014, drejtorin e Drejtorisë së Arsimit e keni pasë këtu dhe e din saktë sa shkolla e arsimtarë kanë qenë, por jo të figurojë viti 2013-2014 mirëpo duhet të jetë 2023, pra kjo nënkupton që këtë draft nuk e ka kontrolluar askush por me këtë plan ne jemi 10 vite mbrapa. Sa i përket kësaj çështje të DKA-së komplet gabim e keni sepse statistikat janë të vitit 2013 e jo 2023, madje asnjë datë në këtë draft plan nuk është e vitit 2023-2027 përveç tabelës së buxhetit, të gjitha të tjerat janë të vjetra. Unë nuk e di se kush e ka përgatit këtë plan por me statistika dhe numra është komplet e hartuar gabim. Prandaj i nderuar drejtor të sugjeroj të kontrollosh edhe t'i njëherë këtë plan. Më herët drejtori e theksoi që kanë marr pjesë shumë pak persona në dëgjim publik, këtu emra nuk janë të cekur se kush ka marr pjesë, ndoshta nuk ka marr pjesë askush po për këtë nuk jam i sigurt, mirëpo nëse miratohet ky plan kështu siç është, gjithë ajo shumë e parave për vitin 2024, 760,000.00€ të ndara kurse në projektbuxhet nuk ekzistojnë dhe gjëja më e rëndësishme është shembull ta zëmë për 5 vite janë të ndara 2700 € për shporta, nuk e di saktë sa kushtojnë, nëse pretendon t'i fusësh në sistem komplet dhe në anën tjetër gjithë ky buxhet të ndahet për deponi ilegale, e mos të ndahen më shumë për shporta.
Propozoj t'i shikoni edhe njëherë se shifrat të gjitha janë të vitit 2013, kurse ne jemi në vitin 2023.
znj.Sebastina Vokrri, theksoi, duke pas parasysh që ky plan përmbledh vullnetin dhe përcaktimin e përbashkët për një mjedis me të pastër dhe dukje më të mirë të qytetit ton si dhe më tërheqëse për vizitorët, si dhe ky plan ka për qëllim përmbushjen e obligimeve ligjore në fushën e menaxhimit të mbeturinave si dhe harmonizimin dhe zbatimin e politikave Kombëtare në këtë fushë.
Ky plan gjithashtu i mundëson Komunës së Podujevës një qasje të menaxhimit të integruar të mbeturinave duke zbatuar një sërë masash ku synim kryesor është reduktimi i mbeturinave komunale që të gjenerohen në burim, ngritja dhe zhvillimi i infrastrukturës për trajtimin e mbeturinave, aspektet financiare të sistemit, aspekte tjera që janë monitorimi i gjendjes në këtë sektor, bashkëpunimi me të gjithë akterët, ndërgjegjësimi i popullatës, prandaj ne Grupi i LVV e përkrahim këtë plan për menaxhim të mbeturinave për vitin 2023-2027, dhe gjithashtu ju rekomandoj edhe kolegëve të tjerë për të votuar.
z.Xhevdet Maloku, theksoi, do të doja një sqarim, sa e kam vërejtur unë mund të jetë një lëshim teknik te kapitulli 2 paragrafi 2.1 - të dhënat për mbeturina në Komunë, tek gjenerimi dhe kompozicioni i mbeturinave është një statistikë ku parashihen dhe janë të shënuar 1976 ekonomi familjare ndërsa në raportin e dërguar nga Komuna te agjencia për mbrojtje të mjedisit për këtë vit janë 9176, pra sa e kam vërejtur është një gabim teknik që duhet të sqarohet fillimisht para se të del në votim ky draft Plan.
z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, po mundohem t'i përgjigjem shqetësimeve të ngritura nga z.Ekrem Rrahmani, unë më herët theksova që Komuna nuk ka mundësi me nda buxhet më shumë, mirëpo e përmenda që Organizata Gjermane GIZ jep shumë kontribut në këtë drejtim dhe se përveç që ne si DSHPMSH kemi qenë sponsorizues të këtij plani ata pothuajse komplet janë marr me hartimin e këtij plani për menaxhimin e mbeturinave, ku pothuajse e kanë primare menaxhimin e mbeturinave në tërë territorin e Republikës së Kosovës, por ne si Drejtori po mundohemi sa më shumë të marrim donacione dhe të kemi sa më shumë bashkëpunim në këtë aspekt, kurse Organizatat ajanë zotuar se do të japin edhe shumë.
Sa i përket deponive të egra ilegale që u përmendën se është ndarë një shumë buxhetore për vitin e ardhshëm, janë domosdoshmëri të ndahen sepse ne çdo vit largojmë sasi të mëdha të mbeturinave (mbeturina inerte është fjala), nga demolimet dhe dëmtimet që rrjedhin ngase këto nuk janë mbeturina të ekonomive familjare por janë inerte e që keni mund t'i shihni edhe ju, prandaj është

dashtë të ndahet ai buxhet sepse ne nuk mund të lëmë deri me 2027 që ka qenë supozim që të gjitha ekonomit familjare të futen në sistemin e inkasimit, dhe t'i lëm mbeturinat në rrugë dhe nëpër vende tjera. Sa për informacionin e juaj, ne vetëm në këtë vit i kemi larguar 52 deponi të egra ilegale, mirëpo për një kohë shumë shkurtë kanë filluar në të njëjtin vend të bëhen sërish ato deponi, është e kot që ne vendosim tabela me shkrimin "mos hedhin mbeturina" sepse ka raste që mbi tabelë hedhën mbeturinat, rast të tillë keni mund ta shihni në fshatin Herticë rrugës për Balloc se si janë të vendosura tabelat edhe për mbi tabelë i hedhë mbeturinat, prandaj e them se është domosdoshmëri.
Jam në dijeni se nuk kemi shumë kapacitete buxhetore ta përfundojmë këtë plan ashtu siç parashihet por kam bindjen që me ndihmën e këtyre organizatave do të arrijmë synimin ton, madje tani veç kemi filluar regjistrimin e ekonomive familjare, janë duke punuar ekipet në teren dhe besoj që brenda 2 ose 3 muajve apo ndoshta para vitit të ri 2024 kemi planifikuar të rritim numrin e ekonomive për të inkasuar, mirëpo shumë më shpejt do të bëhet kjo punë e që nuk e nuk e di sa do të zgjatë saktë.
Sa i përket shportave të mbeturinave që po ashtu u përmend si çështje, konsideroj se për shporta nuk kemi nevojë të ndajmë shumë buxhet sepse krejt sillen donacion dhe nuk kemi nevojë të ndajmë buxhet ne si Komunë.
Marrëveshje dhe Kontratë kemi me dy operatorë që veprojnë në Komunën tonë, njëra është Kompani Regjionale që është Ndërmarrja Publike "Pastrimi" e cila mbulon pjesën dërmuese të Komunës, dhe tjetra është Kompania "Natyra" që e mbulon pjesën e epërme të Komunës.
Si Komunë kemi kontratë me Ndërmarrjen Regjionale që përveç mbledhjes së mbeturinave nga ekonomit familjare ajo bënë largimin dhe pastrimin e mbeturinave, pastrimin e sheshit dhe qytetit e që këtë kontratë ne e paguajmë dhe për këtë nevojiten mjete buxhetore sepse kontratën e lidhim në bazë të punës që ata e kryejnë dhe i paguajmë për punën që e bëjnë.
Ndërsa sa i përket gabimeve teknike, t'ju them të drejtën pas procesit të diskutimit publik, është ngritë komisioni në nivel Komune dhe është marr me këtë çështje dhe në fund të dokumentit janë cekur shumë tabela që janë rregulluar sepse këto të dhëna Organizata KIEV e cila e ka punuar këtë dokument, ajo është Organizatë Ndërkombëtare dhe ka mund t'i vë këto ankronime në gjuhën angleze kurse përkthimi të jetë në gjuhën shqipe, mirëpo nuk besoj që mund të jetë ndonjë gabim shumë i madh ky sepse është gabim teknik, fundja kuptohet si anglisht si shqip, ndërsa sa i përket tabelave që ka qenë më problematike ne jemi marr me këtë çështje dhe në fund të dokumentit janë të cekura të gjitha tabelat që janë ndryshuar në Raportin e konsultimit publik, në fakt ti z.Ekrem Rrahmani e paske lexuar por ndoshta është dashtë të japësh edhe kontribut në këtë drejtim e jo të presësh këtë moment ku tani po kërkohet miratim i Planit, madje ka qenë edhe mundësia e dërgimit përmes e-mailit si adresë e sakt në Komunë përmes të cilët ke pas mundësi të drejtohesh për të gjitha këto ankesa që i paraqite.
Sido që të jetë, në fund të këtij dokumenti janë tabelat: 11, 12, 13, 14, 15, 31, 32, 36, 37, 38, 39 dhe të tjera ku janë bërë korrigjimet pas procesit të konsultimit publik sepse të dhënat që i ka marr Organizata e cekur janë nga të dhënat tona në Komunë e që është e vërtetë se kanë qenë më të vjetra ngase nuk kemi regjistrim të popullsisë e as të ekonomive familjare të vonshëm, pra regjistrimi është shumë i hershëm, por ne kur e kemi parë që kemi pak të dhëna për t'u bërë disa korrigjime i kemi bërë aq sa kemi pasur mundësi dhe po pajtohem që ka nevojë për korrigjim të këtyre gabimeve teknike, mirëpo në thelb është një plan që na ndihmon shumë në menaxhimin e integruar të mbeturinave, qoftë ato inerte apo mbeturinave të mbetura nga ekonomit familjare dhe në parim është plan shumë i mirë dhe do të mundohemi që të zbatojmë 100% në mënyrë që viti

2027 Komunën ton ta gjejë shumë më mirë sa i përket menaxhimit të mbeturinave, ky është zotim edhe i joni si Drejtori por edhe Organizatave Ndërkombëtare me të cilat kemi bashkëpunim.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nuk kërkova shumë çështje dhe ne si Grup i LDK-së nuk jemi kundër, por disa gjëra që kanë pas mundësi për t'u bërë, shembull disa statistika është dashtë t'i rregullonit, unë vetëm i përmenda. Këtu prezent është drejtori i DKA dhe ky e din sa shkolla janë të mesme, s ajanë fillore, sa paralele, sa nxënës, sa mësimdhënës, këto i dinë besoj sepse mbajnë statistika për të gjitha. Përndryshe unë edhe shumë gjëra tjera nuk i ceka, shembull, thuhet në fshatin Surdull janë 4 familje ndërsa 10 perona paguajnë për mbeturina, i bie që 250% që kanë paguar, pra i bie që dikush paguan fshehurazi sepse kemi 10 perona që bëjnë pagesa kurse janë 4 familje. Pastaj ka edhe operatorë që operojnë me hekurishte, që mbledhin hekur, andaj përse janë ilegale ato, përse nuk paguajnë për mbeturina edhe ato, të gjithë e dim që një është në fshatin Lluzhan dhe një "Te Qershia e Llapashticës", pra të inspektohen dhe të regjistrohen në sistem ato.
Edhe njëherë e them se në emër të grupit të LDK-së e përkrahim këtë draft Plan edhe përkundër mangësive që ka.
Kryesuesi i Kuvndit, theksoi, vetëm një sqarim, ne regjistrimin e fundit e kemi të vitin 2011, dhe nuk mundemi t'i referohemi regjistrimeve të tjera sepse ai është regjistrimi i fundit, nuk ka ndodhur ende ndryshime për regjistrim të ri të popullsisë.
z.Naim Çunaku, theksoi, rreth propozim planit për menaxhim të mbeturinave 2023-2027 dhe raportit nga diskutimet publike, e kam një pyetje për drejtorin e DSHPMSH, duke pasur parasysh që Komuna jonë është aksionare do të doja të dija se kur mundemi ne si Kuvend Komunal të kemi një raport, jo nga diskutimet publike, por një raport nga aksionarët tanë që i kemi në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Pastrimi", si dhe shembullin e tyre ta përcjellin edhe Kompanitë tjera ku ne jemi aksionarë. E them këtë duke marrë parasysh që kemi më tepër se 2 vite dhe askush nuk ka raportua në Kuvend për një diçka që ne kemi hise atje, gjithësisht jemi aksionar, prandaj vërtetë që do ta mbështesë një plan, vërtetë që sot mbeturinat janë ato që rëndojnë ambientin jo veç tek ne po gjithandej dhe e kuptoj që kërkon përkushtim dhe vëmendje si dhe nuk është e lehtë për tu bërë, urojë që të kemi një plan të jetësuar dhe të ketë sa më pak mbeturina dhe degradim të ambientit.
znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, një pyetje për drejtorin e DSHPMSH rreth gjendjes së deponisë ilegale në Dumnicë, a keni planifikuar të merrni masa për gjendjen e tmerrshme që është shndërruar në atë pjesë të fshatit Dumnicë. Unë e di që kontrata ka qenë e afatizuar për deponi por si Drejtori a keni planifikuar dhe a keni plan të ndërmerrni diçka sepse dita e ditës atje po shkon vetëm duke u përkeqësuar situata sa që edhe kushtet për jetë atyre familjeve që jetojnë atje janë duke i'u vështirësuar.
znj.Tringa Sfishta, theksoi, te menaxhimi i mbeturinave medicinale, janë cek QKMFëtë dhe AMF-të, por nuk janë cekur ordinancat private që operojnë, se ku i hedhin mbeturinat si dhe përse ato i përziejnë me tjerat.
z.Burim Hasani, theksoi, sa i përket propozim planit për menaxhimin e mbeturinave, këtu aktualisht në Podujevë operojnë për veç Ndërmarrjes Regjionale "Pastrimi", është edhe Kompania tjetër "Natyra", edhe këtu Komuna në koordinim me të dyja këto të bëhet një ndarje e pjesës së planit të mbeturinave. Po ashtu do të propozoja që këtë pjesë të propozimit të planit komunal për menaxhimin e mbeturinave të jenë në konsultim edhe me KEDS përkatësisht Zyrën Qendrore këtu në Podujevë sepse është i vërtetë fakti se çdo familje që jeton dhe vepron në Podujevë ka njehsor elektrik, dhe të propozohet që në bazë të njehsorit elektrik t'iu jepet adresa për çdo secilin klient i cili do të pajiset me kontejner të mbeturinave që të mos i hedh mbeturinat në rrugë.
Pra për këtë arsyeje kjo tregon më së miri edhe njehsorët elektrik dhe në bazë të njehsorëve mund të bëhen faturimi i të gjitha ekonomive familjare duke përfshirë edhe bizneset e vogla, kështu që

nuk besoj që ka familje që jeton pa energji elektrike, nëse një familje ka njehsor elektrik ajo duhet të faturohet, vetëm duhet me qenë në koordinim për arsyeje se Kompania "Natyra" operon në disa pjesë dhe kjo me qenë në koordinim edhe me zyrtarët komunal edhe me DSHPMSH që të sqarohen rreth pjesës së cila pjesë i takon Kompanisë "Natyra" dhe cila Kompanisë "Pastrimi" për identifikimin e konsumatorëve të cilët nuk e paguajnë pjesën e faturës së mbeturinave dhe i'u ikin taksave.

z.Naim Çunaku, theksoi, ajo që më bëri të marr fjalën është tema e përmendur nga z.Burim Hasani që propozoi që në bazë të njehsorëve elektrik të kemi edhe faturimin e mbledhjes së mbeturinave, konsideroj që shkakton telashe ligjore dhe nuk është e drejtë, kemi raste që dikush ka më shumë se një njehsor, pastaj është në kundërshtim që Komuna të bëjë kushtëzime të tilla, e them këtë sepse në një formë është kushtëzim kjo që ai që ka njehsor të paguaj edhe mbeturina e që pastaj mund të kemi probleme ligjore.

Sa i përket asaj që në territorin e Komunës së Podujevës operojnë dy Kompani, unë mendoj që Komuna jonë duhet të lirohet nga ajo që kush ofron shërbime më të mira dhe më të lira ne duhet të paguajmë ato, dhe ekonomia e tregut të lirë nuk e njehë ndarjen çfarë kemi bërë ne, operatori ekonomik që menaxhon mbeturinat e ka licencën dhe duhet të jetë në dorën e atij që ofron shërbimin dhe në dorën e ati që e zgjedhë shërbyesin, në këtë rast e di që po të niset një procedurë ligjore jemi duke e bërë një ndarje të padrejtë, ngase konsideroj se është krejt në dorën time që ta zgjedhë operatorin ekonomik me të cilin dëshirojë që të kem marrëveshje për menaxhimin e mbeturinave.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, lidhur me problemin e vërejtur nga z.Ekrem Rrahmani, është një realitet ku në disa fshatra ekzistojnë më shumë inkasime të ekonomive familjare se që ka shtëpi aty, mirëpo e ceka disa herë që të dhënat për këtë plan janë marr në regjistrimin e fundit e që në rastin e fshatit Surdull qe u theksua, kanë qenë 4 shtëpi por me kohën është rritë numri i shtëpive dhe tash janë në sistem për inkasim 10 shtëpi. Nuk është vetëm ai fshat me të njëjtën situatë por nuk kemi pasë mundësi deri tani të bëjmë regjistrim të ri andaj edhe janë këto probleme.

Sa i përket raportit nga KRM "Pastrimi" kemi biseduar edhe njëherë dhe e kam cekur që kjo Kompani raporton në Drejtori dhe një plan të tillë mund ta bëjmë kurdo që e vlerësoni ju të futet në rend të ditës, nuk është problem sepse raportohet përmes anëtarit të bordit që ne e kemi në atë Kompani si aksionar që jemi. Gjendja e deponisë në fshatin Dumnicë vërtetë është shqetësuese alarmante që unë e quaj kështu sepse aty paraqitet rrezik jo vetëm për fshatin Dumnicë por edhe më gjerë sipas matjeve që janë bërë, mirëpo e mira e gjithë kësaj është që deponia në Dumnicë shumë shpejtë do të largohet dhe nuk do të ekzistojë si deponi më aty sepse planin që është duke e bërë tashmë Ministria përkatëse dhe Organizatat që i ceka më herët se japin shumë kontribut në këtë drejtim. Pra tani me planin e ri dhe ndërtimin e deponisë kryesore e cila do të ndërtohet në nivel regjional, Podujeva më nuk do të ketë deponi të mbeturinave por do ta kemi një Qendër të Transferimi për të cilën ende nuk është caktuar lokacioni, pra ajo deponi shumë shpejt nuk do të ekzistojë më sepse e kemi ngritur edhe ne shqetësimin tonë shumë herë në Ministri edhe tek ato Organizata, dhe janë saktësisht në dijeni për gjendjen e saj, madje kanë bërë edhe vizita në atë deponi që gjendet në fshatin Dumnicë. Fatkeqësisht gjendje shumë më e keqe është në fshatin Miroc ku paraqitet rrezik edhe më i madh, mirëpo e mira e krejt kësaj është se asnjëra nga këto deponi shumë shpejt nuk do të jetë ekzistuese më ngase është duke u bërë një projekt i ri i cili tani veç ka hyrë në fazën e shpronësimit të pronave, do të menaxhohet në nivel regjional, por me një bashkëpunim ndër komunal që është duke u përgatitur për regjionin e Prishtinës dhe në bazë të atij

investimi është një vlerë shumë e madhe që është duke e bërë nga Organizatat Ndërkombëtare e që do ta përmirësoj gjendjen.
Tek inkasimi i mbeturinave të ordinancave private që ishte pyetja, ne kemi një Kontratë me Kompaninë "Pastrimi" për disa aktivitete që i kryen ajo, mirëpo inkasimin e ekonomive familjare edhe institucioneve e bënë kjo Kompani në Marrëveshje me ato ekonomi familjare dhe institucionet në këtë rast, secila ordinancë është e obliguar të hyj në Marrëveshje me KRM "Pastrimi" për mbledhjen e mbeturinave ku ato mjetet shkojnë në kompani dhe nuk sjellën këtu në Komunë sepse inkasimin e bënë komplet Kompania, pra ne nuk kemi qasje në inkasomi, andaj krejt çka jemi duke bërë tani jemi duke u munduar që në bashkëpunim me Kompaninë të bëjmë inkasimin e komplet ekonomive familjare e që besojë se secila ordinancë do duhej të ishte në sistem të inkasimit apo në Marrëveshje me Kompaninë "Pastrimi".
Ndërsa sa i përket inkasimit në bazë të njehsorëve elektrik kjo është një çështje që e kemi diskutuar dhe kemi vepruar, ne zyrtarisht i kemi kërkuar KEDS-it listën e ekonomive familjare mirëpo e kemi ditur që nuk do të na sigurojnë të dhënat sepse nuk është ligjore që KEDS të na jep listën e ekonomive familjare që KEDS ka në dispozicion, pra ata e ruajnë privatësinë dhe nuk bëjnë shkelje të privatësisë dhe krejt çka KEDS na ka ndihmuar është që na ka treguar se Komuna e Podujevës i ka 26000 ekonomi familjare duke marrë për bazë njehsorët elektrik të tyre, por listën me emra nuk na e kan ofruar për shkak të ruajtës së privatësisë. Pra nuk mund ta ofrojnë këtë listë dhe si pasoj e kësaj ka ardhur deri te intervenimi i ri apo programi i ri që kemi bërë për inkasim së bashku me KRM "Pastrimi" që tashmë kemi filluar regjistrimin, janë 5 ekipe nga Kompania "Pastrimi" duke punuar në bashkëpunim edhe me ekipet tona të Komunës që janë vetëm në mbikëqyrje sepse nuk kemi fuqi punëtore atyre për këtë regjistrim, pra ata e bëjnë vet dhe ne jemi në menaxhim e që besoj se të gjithë ekonomitë familjare do të regjistrohen në sistemin përkatës i cili do të na lehtësojë shumë menaxhimin e mbeturinave.
z.Naim Çunaku, theksoi, nga fjalimi i drejtorit të DSHPMSH u kuptua që kur Kuvendi Komunal kërkon raport, na jemi të gatshëm me sjellë atë, andaj zotëri Kryesues i Kuvendit kërkojë nga ju që në seancën e ardhme si hartues pikave të rendit të ditës që je në koordinim me Kryetarin e Komunës, ta keni parasysh faktin që ne i kemi 3 organizata / Ndërmarrje komunale, (Stacionin e Autobusëve, Ndërmarrjen Banesore dhe aksionarë në KRM "Pastrimi") dhe ndërmarrjet ku Kuvendi Komunal ka përfaqësuesit e vet të zgjedhur nga ky Kuvend Komunal, të paraqesin raporte në një të ardhme sa më të afërt. Arsyeja është që ju mund t'i keni këto informacione ashtu qysh i paraqiti drejtori parafolës, mirëpo të mos harrojmë që në mbledhjen e datës 28.02.2021 Grupi më i madh në këtë Kuvend që është ai i LDK-së i është cunguar e drejta që të jetë pjesë e atyre komisioneve aksionare dhe të ketë qasje, andaj ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së kërkojmë që sa më shpejtë t'i kemi këto raporte para vetës.
znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, një pyetje për drejtorin e DSHPMSH, kanë qenë disa kërkesa apo propozime nga qytetarët që kostoja e mirëmbajtjes së varrezave të përfshihet në faturat e mbeturinave, a e keni menduar si opsion dhe a ka mundësi të jetë e realizueshme kjo, nëse do të ishte e mundur kjo do të evidentonte një pjesë të madhe të zjarreve në varreza dhe do të ndikonte në ruajtën e ambientit.
znj.Tringa Sfishta, theksoi, i nderuar drejtor, unë e theksova që në raport ceket që QKMF-të, QMF-të dhe AMF-të, por edhe ordinancat private nuk i keni përfshirë kurse ato e shfrytëzojnë shportën e privatit dhe i përziejnë mbeturinat kur jemi në dijeni se janë toksike, infektive dhe radioaktive si materiale.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, e ceka më herët, ato janë në raport sepse janë institucione publike, mirëpo edhe publiket edhe privatet kanë Marrëveshje me KRM "Pastrimi", madje edhe ne si Komunë kemi Marrëveshje me këtë Kompani që ka qenë kërkesë e saj për inkasimin edhe në institucionet publike mirëpo Kompanitë përkatëse e kanë territorin e ndarë për çka edhe unë nuk pajtohem se si e kanë bërë atë ndarje në atë kohë ku nuk i'u është dhënë e drejta e zgjedhjes. Tani KRM "Pastrimi" i'a caktojmë çmimin ne si Kuvend Komunal për çka disa herë e kam cekë këtu që kërkesë nga ana e tyre është që të rritet tarifa mirëpo nuk e kam sjellë asnjëherë këtu në Kuvend dhe nuk e kemi ndërmend ta sjellim njëherë sepse mendojmë që më e rëndësishme është zgjerimi i ekonomive familjare dhe futja e tyre në sistem të inkasimit se sa rritja e tarifës, pra kur të zgjerohet përfshirja e ekonomive familjare dhe të futen në sistem atëherë tarifa rritet vetvetiu.
Sa i përket mirëmbajtjes së varrezave që ato të futen në sistem të faturave të "Pastrimit" kjo nuk mund të bëhet për shkak se mirëmbajtja e varrezave është kategori tjetër, madje kjo çështje më shumë i takon Bashkësisë Islame se sa Komunës por edhe Kompanisë "Pastrimi" nëse nuk gaboj, mirëpo ju ri njoftoj se mirëmbajtjen e varrezave e kemi përfshirë në kuadër të shërbimeve të Ndërmarrjes së re Publike Lokale e cila është miratuar dhe shumë shpejt pritet të funskionalizohet me të cilën pastaj ne si Komunë lidhim kontratë sipas të cilës ne e bëjmë pagesën kurse ata e bëjnë mirëmbajtjen e varrezave.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush e dëshiron fjalën nëse jo atëherë e hedh në votim, Propozim Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 22 vota Për, nga anëtarët sa ishin prezent për momentin në mbledhje, me vendim miratohet Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027 i Komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

7. Informatë për përgatitjet për fillimin e vitit shkollorë 2023-2024

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, e paraqiti Informatën në fjalë, theksoi, Drejtoria e Arsimit ka përgatitur një informatë për fillimin e vitit të ri shkollor duke u bazuar edhe në planin e punës të këtij Kuvendi që ka qenë për këtë vit.
Si DKA për përgatitjen e fillimit të vitit të ri shkollor ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushte për fillimin në kohë viti i ri shkollor, duke filluar nga sigurimi i kuadrit mësimor për vitin shkollor 2023-2024, regjistrimin e nxënësve në klasën e parë dhe në klasat e dhjeta, përmirësimin e infrastrukturës së jashtme dhe të brendshme në disa shkolla ku në kuadër të kësaj gjatë këtij viti kemi planifikuar intervenimin në 10 shkolla me prioritet por edhe në disa shkolla tjera. Jemi të vetëdijshëm që ka pas vonesa deri te nënshkrimi i kontratës për shkak të ankesave në kthimin e përgjigjes nga organi shqyrtues i prokurimit dhe tani kompanitë përkatëse veç kanë filluar punën dhe janë duke punuar në ato shkolla ku janë me një ndërrim dhe gjatë vikendit në ato shkolla ku janë me dy ndërrime.
Gjithashtu jemi në fazën përmbyllëse të ndërtimit të dy sallave sportive, në shkollën e mesme të ulët "Enver Maloku" e cila është në fazën e fundit, si dhe gjithashtu në shkollën "Naim Frashëri" që është projekt nga Ministria e Arsimit, ku për këto të dy salla ne i kemi paraparë këtë vit pajisje me rekuizita sportive për të dyja sallat sportive në fjalë.

Te pajisjet në kabinetet fizik, kimi, biologji i kemi funksionalizuar këto kabinete dhe i kemi përmbyllur projektet për shkollat që kanë qenë me mungesë të tyre. Te pajisjet me kabinete në lëndët gjeografi, histori, matematik këtë projekt jemi duke e realizuar tani, dhe në disa shkolla veç sa ka filluar furnizimi.
Gjithashtu katër Çerdhet publike që janë ne i kemi furnizuar përveç me pajisje të nevojshme edhe me katër TV Monitor. Pastaj kemi projektin e shpresës me Organizatën Zvicerane Caritas ku nga ky projekt do të përfitojmë në ndërtimin e klasave me nxënës të ciklit parafillor pajisje që janë të nevojshme. Mandej kemi bërë instalimin dhe riparimin e të gjithave kamerave në të gjitha shkollat.
Sa i përket sigurimit të transportit të nxënësve, edhe përkundër faktit që këtë projekt e kemi nisur nga muaji qershor për shkak të disa procedurave teknike dhe në aspektin e buxhetit si dhe procedurave të ankesave, tani më gëzoj fakti nga informata që mora sot se është shpallur njoftimi publik dhe kontratat mund të nënshkruhet që nga nesër.
Gjithashtu në kuadër të rinovimeve të objekteve kemi edhe projektin për rrethojat e shkollave aty ku janë të nevojshme.
Gjatë këtij viti kemi planifikuar aktivitete të ndryshme të cilat janë realizuar në këtë periudhë kohore dhe të cilat janë të përshkruara në informatë.
Gjithashtu kemi përmbyllur investimet e projekteve të efiçiencës në disa shkolla dhe jemi në fazën e realizimit edhe në shkollat tjera, shembull, paralelja e ndarë në Lladoc, paralelja e ndarë në Pakashticë dhe shkolla "Shefki Kuleta" në Tërrnavë.
Te edukimi parafillor konsiderojmë që kemi një storie të suksesit për arsyeje se nga 55 fëmijë që i kemi pas ndër vite në vetëm një Çerdhe më gëzon fakti që në katër Çerdhet publike kemi 240 fëmijë dhe kjo ka ndikuar që t'ju lehtësohet jeta qoftë nënave të tyre qoftë aspekti i shpenzimeve që janë më të vogla karshi operatorëve privatë që ofrojnë një edukim të tillë.
Projektet e Drejtorisë së Arsimit veç janë në realizim e sipër, të gjitha i keni të përshkruara me shifra konkrete si dhe po ashtu Marrëveshjet dhe bashkëpunimet që i kemi pas me donatorë të mundshëm.
Po ashtu edhe kapitalet i keni të bashkangjitura në të gjitha aktivitetet që jemi duke i realizuar si Drejtori e Arsimit.
Sa i përket çështjes së sigurisë në shkolla, kemi pas një bashkëpunim të mirë me Stacionin Policor në Podujevë, kemi bërë aktivitet që kanë ndikuar në parandalimin e aktiviteteve të dhunshme nëpër shkolla, kemi mbajtur mbledhje me drejtorë të shkollave duke diskutuar për tema që janë me rëndësi për arsimin e mesëm dhe të ulët.
Gjithashtu kemi fuqizuar dhe funksionalizuar organet qeverisëse në kuadër të shkollave, pastaj kemi bërë një punë të mirë sa i përket zgjerimit të shërbimit psikologjik dhe pedagogjik ku Drejtorinë e Arsimit e kemi gjet me 3 psikolog, ndërsa sot kemi 10 psikolog, kemi pasur vetëm 1 pedagog dhe sot i kemi 3 të tillë, mandej kemi pas gjithsej 4 asistent për fëmijë me nevoja të veçanta dhe sot i kemi 13 e që nevoja është edhe për ende të tjerë.
Gjithashtu kemi pas një bashkëpunim të mirë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit aty ku ka pas mundësi, buxhet dhe hapësirë për të vazhduar me ndërtimin e trotuareve si nevojë për shkollat.
Përveç këtyre, jemi ballafaquar edhe me sfida që kanë të bëjnë me incidentet dhe zënkat ndërmjet nxënësve, lokalet afër shkollave ku disa prej tyre i kemi pasur edhe brenda shkollave por që kemi marr vendim për mbylljen e tyre. Problem tjetër kishim edhe me qenët endacak, komunikacion e kështu me radhë.
Krejt për fund ju dëshirojë të gjithë punëtoreve të arsimit një vit të mbarë dhe të suksesshëm, pres vërejtje dhe sugjerime nga ana juaj.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, fillimisht shprehi shqetësimin tim në emër të Grupit të LDK-së për mënyrën se si trajtohet arsimi në Komunën e Podujevës nga një drejtor abuzues i cili bënë keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe kjo është shqetësuese dhe e dhimbshme. Në mbledhjen e kaluar ne e kemi jep vërejtët tona që shkollat nuk janë furnizuar me material higjenik dhe material shkollorë, nuk janë hapur konkurset për pranimin e stafit, nuk janë rinovuar shkollat gjatë pushimeve verore, por të gjitha vërejtjet tona hasën në vesh të shurdhur të këtij pushteti që abuzon me gjithçka mandej edhe me fëmijë. Të nderuar qytetarë sot jemi në fund të muajit shtator pra është data 27 shtator dhe paramendojini ende nuk e kemi të kompletuar stafin arsimor e fëmijët tanë humbin orët mësimore për shkak të papërgjegjësisë së drejtorit të arsimit.
Para dy dite kemi pasur konkurs të shpallur për kuadër arsimor, e rikujtoj që Ligji për zyrtarët publik, neni 68, hapja e procedurës së konkurrimit shpallet nga njësia e burimeve njerëzore, në ueb faqen e menaxhimit e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore të paktën 30 ditë para datës së planifikuar për paraqitjen e aplikimit nga kandidatët e interesuar. Po shihet se ku je (i drejtohet Drejtorit të DKA) me planifikime dhe rekrutime të stafit, çka është me e keqja se ti manipulon skajshmërish me këto konkurse dhe ky është fakt i ditur dhe i pranuar nga ana e juaj, ti je kampion i punësimeve pa konkurs, dëshmi për këtë është emali i komunikimit tuaj me Agjencinë për Informim dhe Privatësi, ku së paku në dy raste e pranon që ke marr punëtor pa konkurs, i ke punësuar grat e asamblistëve të Grupit tuaj në këtë formë dhe ke konsumuar vepër penale duke bërë keqpërdorim të detyrës zyrtare për çka e ftojë prokurorin të hetojë rastin, ne jemi të gatshëm t'i ofrojmë edhe provat tona. Pra këtë që po e them e gjeni të vërtetuar në vendimin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi të datës 12.10.2023 ku kjo Agjenci i ka shqiptuar gjobë Kryetarit të Komunës për shkak të kufizimit të drejtës për qasje në dokumente zyrtare, pra transparenca zero, përgjegjësia zero.
Një tjetër abuzim i skajshëm i juaji është përzgjedhja e këshilltarëve të karrierës ku pa asnjë kriter ke emëruar këta këshilltarë, mandej vendimet për emërimin e tyre nuk i ke, e mos të flasim për kontrata, ku të gjithë këshilltarët i ki pa kontrata, nëse po sjelle dhe prezantoje vetëm një.
Mësimdhënësit që në ditën e parë të punës i ke bërë këshilltarë të karrierës, të ka mbet me gjysmë norme e për t'jua plotësuar normën i ke bërë këshilltarë të karrierës dhe madje në shumë shkolla 2-3 këshilltarë. Kjo që po e bënë ti drejtor nuk do të kalojë pa një hetim, ne do ti deponojmë në Prokurori faktet dhe shkeljet flagrante që je duke i bërë me stafin arsimore, dhe duke degraduar pozitën e mësimdhënësit, kjo është e turpshme.
Dështimet tuaja vazhdojnë në rinovimin e objekteve shkollore për shkak të keq planifikimit dhe keq menaxhimit tuaj, ti është dashtër të planifikosh rinovimet me kohë, të bësh kërkesë me kohë për zhvillimin e procedurave të prokurimit në mënyrë që renovimet të bëhen në kohën e pushimeve verore e jo tani ti detyrosh nxënësit e shkollës "Shaban Shala" të shkojnë në shkollën "Enver Maloku" për shkak se ty tash të ka ra ndërmend që ta rinovosh shkollën. Kemi edhe rastin e fundit që është paraqitur edhe në media, është shkolla "Zahir Pajaziti" në fshatin Orllan që të gjithë i kanë parë pamjet e tmerrshme të asaj shkolle, kjo është papërgjegjësi totale të maltretohen fëmijët në këtë formë.
Ndërhyrja e juaj në shkolla ka arritur deri në atë pikë ku kujdestarët e klasave në shkollën ekonomike i ke përzgjedhur ti drejtor nga zyra e DKA-së. Gjendja në arsim është e rëndë për shkak se ti me qasjen tënde i ke ngulfatur shkollat ku drejtorët i ke nënshtruar dhe personelin e shantazhin vazhdimësi me orë, cilësia në arsim nuk është fare më temë për ty dhe kjo është shqetësuese. Ne e ftojmë Kryetarin e Komunës që të marr masa ndaj drejtorit të DKA-së dhe të ndryshojë gjendjen në arsim pasi që fundja përgjegjësia bie mbi të, sepse ai ju ka emëruar por duke

të njohur ty sigurisht e ke gjetur ndonjë formë të shantazhit dhe ai nuk guxon të merr asnjë veprim ndaj teje. Gjendja është alarmante dhe ndërhyrja duhet të jetë e menjëhershme.
z.Haki Rudari, theksoi, ne seancën e fundit e kemi pasur një informatë nga DKA rreth përfundimit të vitit të ri shkollorë, po ashtu sot e kemi një informatë lidhur me përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollorë që mendojë që janë dy veprime pozitive, në njërën anë është obligim edhe nga plani i punës së Kuvendit të Komunës, por në anën tjetër në këtë informatë që kemi përpara natyrisht që informohemi për shumë gjëra dhe veprime të cilat janë bërë në arsim në Komunën tonë. Më lejoni ti potencoj disa veprime të cilat janë bërë për fillimin e vitit të ri shkollorë, pa dashtë t'ju marr kohë shumë: pra kemi sigurimin e kuadrit mësimor për vitin 2023-2024, regjistrimin e nxënësve, rregullimin e infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme në shkolla dhe mendojë që është shumë e rëndësishme që të kemi një arsim cilësor, pastaj ndërtimin e sallave sportive, pajisje me lëndët fizike-kimike-biologjike pra shkencat natyrore me kabinete të ndryshme, pajisje me kabinete për lëndët e gjeografisë histori dhe matematikë, pajisje me TV-monitor, instalim të kamerave në shkolla ku mendojë që është një element i rëndësishëm në shkolla e sidomos në këtë kohë kur po kemi raste të ndryshme, mandej sigurimi i transportit për nxënës që u cekë edhe më herët, po ashtu është një veprim që duhet të përkrahet, rrethojat e shkollës ku kanë një element të sigurisë në shkolla.
Këto që unë i lexova edhe shumë çështje tjera të cilat i kemi në informatë, pa dashtë edhe shumë me marr kohë por kemi edhe edukimin parashkollor pastaj investimet e ndryshme si siguria në shkolla që përmenda më herët, pra të gjitha këto janë veprime të cilat ndërlidhen me arsimin dhe cilësinë e arsimit në shkolla.
Të nderuar kolegë, gjithë ata që vinë nga fusha e arsimit po besojë që e dini që nëse mungojnë këto elemente, e këto që unë i lexova janë elemente që e ngritin cilësinë e arsimit, kudo që ka kabinete, pajisje, TV monitor, instalim të kamerave të gjitha këto ndërlidhen me cilësinë sigurinë në arsim në përgjithësi.
z.Naim Çunaku, theksoi, unë me të vërtetë nuk vij nga fusha e arsimit mirëpo vërtetë përvojën që e kemi në Kuvend Komunal me të gjithë këta që vijnë nga fusha e arsimit, nuk jam shumë i kënaqur.
z.Haki Rudari, theksoi, mendojë që vlerësimin për neve të cilët jemi në fushën e arsimit e bëjnë organet e tjera e jo ju (i drejtohet parafolësit z.Naim Çunaku).
z.Naim Çunaku, theksoi, vërtetë nuk jam unë ai që e bëjë cilësinë e arsimit, unë e thash në kuptimin që si politikan që na keni ardhur nga arsimi nuk jam shumë i kënaqur me ju.
z.Haki Rudari, theksoi, unë e thash edhe në aspektin politik edhe në aspektin edukativ arsimor, janë organet tjera të cilat e japin vlerësimin, natyrisht ne kemi mendime të ndryshme dhe për këtë janë partitë dhe programet politike të ndryshme, andaj mua personalisht nuk mundet askush të më udhëzoj si të veprojë, votoj, pra punojë, jam i pavarur prej momentit që e kemi fituar pavarësinë.
znj.Arjeta Abazi, theksoi, në radhë të parë më lejoni të shpreh habinë time se si ka zgjedhur Komuna e Podujevës të trajtojë arsimin, pra të ardhmen e vendit tonë. Është e papranueshme që as prej 3 viteve qeverisje nuk ka ndodhur asnjë progres por ka ndodhur e kundërta dhe për fat të keq kemi keqësim të gjendjes në secilën nivel të arsimit në Podujevë, duke filluar nga Çerdhet për të vazhduar tutje.
Siç e kam potencuar edhe në vitin e kaluar, fëmijët e shkollave të qytetit sidomos shkollat "Shaban Shala" dhe "Naim Frashëri" çdo ditë i ekspozohen rrezikut në rrugë për shkak të katrahurës që bëhet në rrugët afër shkollave gjatë mesditës dhe në mbrëmje. I nderuar Drejtor, a është pedagogjike dhe njerëzore që në shkollën "Naim Frashëri" fëmijët 9 vjeçar të fillojnë mësimin pasdite në orën 15:15, kur në atë kohë janë të lodhur dhe ndikon negativisht në mësim nxënie dhe

nuk mbahet mend ndonjëherë në Komunën tonë që nxënësit e asaj moshe të fillojnë mësimin në atë orar. Po ashtu në shkollën "Shaban Shala" mbahet mësimi nga dy paralele të shkrira në një, që është shumë e vështirë edhe për mësimdhënësit edhe për nxënësit. Paralelet e ndara të shkollës "Shaban Shala" në shkollën "Enver Maloku" konkretisht klasat e IX-ta në shumicën e rasteve i mbajnë vetëm nga tri orë mësimi ku edhe prindërit janë shumë të pakënaqur kur dihet që në fund të këtij viti do t'i nënshtrohen edhe testit të arritshme, kjo është si pasojë e keq planifikimit të punimeve nëpër shkolla, ku gjatë verës nuk punohet dhe në fillim të vitit të ri shkollorë shkolla shndërrohet në vend punishte, konkretisht këtë vit shkolla "Shaban Shala". Ne nuk jemi kundër investimeve, por jo në periudha kur pengohet mësimi.
Është e papranueshme se si e keni shndërruar profesionin e mësuesit nga një profesion fisnik e misionar në mjet punësimi dhe akomodimi për familjarët dhe militant të partisë, ndahen norma në disa vende, keqpërdoren konkurset dhe nuk zhvillohen me kohë procedurat e rekrutimit, shembull, ka shkollë ku për javë të tëra fëmijët nuk kanë zhvilluar mësim fare ose është bërë zëvendësim sepse nuk është pranuar me kohë kuadri arsimor, si duket 1 shtatori vazhdon t'i bie në befasi Drejtorisë së Arsimit, rastet janë në shkollën "Naim Frashëri" dhe në shkollën e fshatit Llapashticë e Poshtme. Shkollat nuk furnizohen me kohë me ditarë dhe as me mjete higjienike, drejtorët dhe stafi nuk guxojnë t'i paraqesin as kërkesat e shqetësimet sepse ndëshkohen nga eprorët e shkollës dhe Drejtoria e Arsimit, fatkeqësisht njëri prej tyre veç është deklaruar në media siç e dimë të gjithë dhe ajo video është e vërtetë, e për faj të nivelit politik fatkeqësisht i ka qitë hije të keqe arsimit Llapjan ku ndershmërisht punojnë shumë mësimdhënës.
Është çudi se si bëhet organizimi i transportit kur lidhen kontratat shkel e shko madje pas kohës thirren operatorët të fillojnë bartjen e fëmijëve ende pa përfunduar procedurat e prokurimit, me gjasë jeni bërë parashikues të mirë ku para kohës po e dini se kush do ta fitoj tenderin.
Ndonëse keni planifikuar buxhet për transportin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, kësaj kategorie ia pamundësoni një të drejtë fondamentale e drejtë e cila është për tu arsimuar, ku këtu prindërit duhet të paguajnë transportin vetë, pra vetëm edhe kjo ju duhet.
Oraret në shkolla ndryshohen dhe nuk konsultohen prindërit, krejt kjo ndodhë në shkollat e qytetit. Vendimmarrja ju është marr shkollave edhe për gjërat me elementare drejtorët të marrin leje nga lart, kjo assesi nuk i ndihmon shkollat në arritjen e rezultateve të mira.
Të gjitha këto drejtor në radhë të parë i theksova sepse kam ndjeshmëri për këtë sektor sepse kam shërbyer disa vite dhe kjo gjendje e krijuar është e papranueshme sepse mbi të gjitha trajtimi me papërgjegjësi të këtij sektori ka shkaktuar edhe pa kënaqësi dhe ka humbur vullnetin edhe te mësimdhënësit dhe kjo ndikon edhe te rezultatet e fëmijëve.
Në fund të mos harrojmë, ndonëse e ke pasur buxhetin e planifikuar për shujta dhe si rrjedhojë e keq menaxhimit dhe keq planifikimit tuaj keni mbetur pa kontratë me operatorin ekonomik dhe kësisoj fëmijët kanë mbetur pa shujta. Urojë që të filloni të këndelleni dhe gjatë punës në arsim të liroheni nga petku partiak dhe t'jua jepni vendin meritor profesionisteve dhe njerëzve punëtor.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kam dy vërejtje sepse tjerat u përmenden dhe nuk është nevoja të përsëriten. Tenderi për transportimin e nxënësve ose është bërë një burimor ose unë nuk e kam parë kur është shpall në faqe të Komunës, nuk e di a ka pasur kontratë kornizë, është vazhdua apo është lidhë ndonjë kontratë tjetër, edhe nuk është publikuar.
Çështje tjetër, qe tri vite, gjatë gjithë kohës del tenderi furnizim me perde në vlerë 20,000.oo€ - 30,000.oo€, e kam përmend edhe njëherë këtu, pa kaluar dy javë fëmijës tim kujdestarja e klasës i ka kërkuara para për blerjen e perdeve. Prandaj për këto dy pika dua sqarim nga drejtori i DKA.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, derisa drejtori i Drejtoritë së Arsimit e gjithashtu edhe shefi i Grupit të LVV-së po krenohen me kabinete, po jua rikujtojë që në shkollën teknike e cila duhet të konsiderohet shkollë elitare për teknologji, kabinetet e informatikës i keni të gjeneratës XP e maksimum ndonjë kompjuterë me Windows 7. Për shkak të performancës së ultë së kompjuterëve kjo shkakton vështirësi në mësim praktik ku të njëjtën gjendje e keni edhe në Gjimnaz, dhe kjo nuk është për tu krenuar por për tu shqetësuar kur dihet se këto dy shkolla së bashku kanë 3000 nxënës. Duhet t'i ndani prioritet drejtor, të investoni në kabinete në ato shkolla ku numri i nxënësve është shumë i madh. Pra kur planifikoni t'i furnizoni ato dy shkolla me kabinete të reja të informatikës.
znj.Edona Shabani, theksoi, e pyes drejtorin e Drejtorisë së Arsimit se ku duhet të marr leje për të vizituar fëmijët me nevoja të veçanta, jo për të inspektuar por të bëhemi një grup t'ia dërgojmë disa letra të bardha dhe disa lapsa ku mund të vizatojnë diçka aty sepse ata nuk kanë asgjë, pra nuk kanë asgjë çka ju nevojitet atyre. Fëmijëve me nevoja të veçanta ju nevojiten gjëra të veçanta, sepse ajo nuk është siç është quajtur më herët shkollë apo objekte, ajo është një klasë shumë e vogël dhe një oborr i cili është i rrethuar e në fshatin Gllamnik.
z.Valon Demolli, theksoi, Gjimnazi "Aleksandër Xhuvani" në Podujevë kjo shkollë dikur elitare. me marrjen e mandatit nga Lëvizja Vetëvendosje fatkeqësisht është shndërruar në çerdhe të militantizmit dhe punësimeve familjare. Në fillim e kishin mbështetjen e një pjese të stafit mirëpo pas një kohe shumë të shkurtë shumica e mësimdhënëseve në Gjimnaz e kanë parë se çfarë jeni dhe si qeverisni, prandaj qe 3 muaj shkollën më të madhe në Podujevë dikur elitare e keni lënë pa drejtor sepse askush nga mësimdhënësit nuk pranon ta marr postin e drejtorit pasi askush nuk po pranon t'i nënshtrohet drejtorit të DKA-së dhe të udhëhiqet me telekomandë nga Komuna.
Në kushte normale ligjore ti drejtor (i drejtohet drejtorit të DKA-s) ish dashtë të hapesh konkurs menjëherë pas dorëheqjes së ish drejtorit zotëri Mulliqi, por problemi është që kriter kryesor t'i e ke nënshtrimin ndaj teje prandaj edhe nuk po e hap konkursin dhe je duke e lënë shkollën më të madhe në Komunën e Podujevës pa drejtorë e duke u menaxhuar nga një militante partiake.
Profesorët e shkollës së mesme të Gjimnazit meritojnë respekt nuk po pranojnë me tu nënshtrua.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, shpresojë që qytetarët nuk janë duke na dëgjuar sepse çka po flitet keq për arsim, mos nuk po i dërgojnë fëmijët në shkollë, unë nuk e shoh vetëm zi, shikoni konkurset dhe krahasimet, Gjimnazi jonë është në listë të parë sa i përket fakultetit të mjekësisë për çdo vit. Pra ky ishte vetëm një sqarim sepse më preku fakti që edhe unë vij nga fusha e arsimit.
z.Naim Çunaku, theksoi, që në fillim e theksova që unë nuk vij nga kjo fushë, krejt çka po i shoh ata të arsimit këtu në Kuvend Komunal si politikan në këtë kontest ke ajo më herët që thash. Dëgjova nga drejtori i DKA-së që theksoi që kemi 13 këshilltarë apo personel asistent për fëmijët me nevoja të veçanta, dhe deshta të di se a ka institucion parashkollor që i trajton këta fëmijë, pra a ka institucion për trajtimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në Komunën tonë.
Vërtetë se çdo profesion jap edhe sëmundje profesionale ku as arsimi nuk i shpëton kësaj, unë po e shoh Kryesuesin është para nesh dhe ka shumë vite para nxënësve dhe fjala e tije është meritore se ka edhe nxënës ku këtu po gërshetohen në Kuvend Komunal, shembull konkret është që ti Kryesues po jep shpjegime për diskutimet e anëtarëve të Kuvendit Komunal, me gjithë respektin edhe ti e ke të drejtën të jesh këshilltar sikurse unë dhe e ke të drejtën të shfrytëzosh foltoren, por jo ti Kryesues të komentosh diskutimet e Kuvendit Komunal.
znj.Tringa Sfishta, theksoi, e kam një pyetje për drejtorin e DKA-së, a parashihet që shkollat fillore të kenë doktorin apo mjekun e vetë dhe logoped për shkollat fillore kurse shkollat e mesme të kenë mjekun e tyre të shkollës.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, premtim elektoral gjatë fushatës zgjedhore e keni pasur që deri në fund të mandatit do të pajisni të gjitha shkollat fillore me psikolog, në çfarë faze keni arritur si Drejtori e Arsimit pas tri viteve qeverisje për realizimin e këtij premtimi.
znj.Sebastina Vokrri, theksoi, më duhet të potencojë që me datën 20 shtator së bashku me drejtorin e DKA-së dhe Kryetarin e Komunës kemi qenë pjesëmarrës në përurimin e projektit ku shkolla e fshatit Sfeqël ka qenë përfituese e përkrahjes me mjete muzikore, një smart tabelë, një llaptop, një projektor si dhe mjete konkretizimi për klasat I deri në V si dhe për lëndët tjera, ku vlera totale e projektit ka qenë 14,987.00€ ku 70% e kësaj vlere është financuar nga Organizata përkatëse ndërsa 30% është financuar nga Komuna e Podujevës, andaj me anë të kësaj e përgëzoj drejtorin e Drejtorisë së Arsimit.
znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, edhe një pyetje e kam për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, a mund të na informoni se si është gjendja në shkollën e mesme "Isa Boletini" dhe pse në këtë shkollë mbahet mësimi me tri ndërrime dhe me orar të shkurtuar që nga koha e pandemisë, a është ende pandemi apo po pritni që të vije një pandemi e re, si dhe a mendoni që është efektive mësimdhënia me 100 minuta brenda ditës.
z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, sa i përket pyetjes për psikologë, për çka kemi dhënë premtim që do ta mbulojmë numrin e tyre deri në fund të mandatit dhe siç ju njoftova më herët kemi gjetur 3 psikolog dhe e kemi rritur numrin e tyre në 10 ku me Udhëzim Administrativ është e caktuar që 1 psikolog mbulon 1500 nxënës, Udhëzim i cili është duke u përpunuar sepse është vlerësuar se nuk është në rregull sepse është e pamundur të mbulohet ai numër i nxënësve.
Jemi munduar që disa psikolog ku kanë qenë në shkolla me nga 500 deri 700 nxënës, t'i delegojmë edhe në një shkollë tjetër për arsyeje se numri është i kufizuar. Mendojmë që mjaftueshëm e kemi rritur numrin ngase 7 psikolog tjerë të shtohen në këtë fazë dy vjeçare mendoj që është mjaftueshëm për të vazhduar tutje edhe me të tjerë psikolog që do të kemi, pra nëse e shikojmë nga ana e numrit të nxënësve ne e kemi mbuluar 70%, po problemi është se në disa shkolla ka rënë numri i nxënësve në 50, 60 nxënës dhe është e pamundur që 1 psikolog të vrapoj në 5-6 shkolla sepse nuk mund t'i mbulon shpenzimet.
Anëtarja e Kuvendit znj.Tringë Sfishta pati një sugjerim me vend për angazhimin e mjekëve dhe fushave tjera që i përmendi, sa jam i njoftuar përmes ueb-site është duke u hartuar një Udhëzim Administrativ nga ana e Ministrisë dhe sikur të lejohen nga 5 asistent për çdo vit të angazhohen, sigurisht do të angazhohen edhe logoped ose fusha tjera që janë të nevojshme në këtë fushë.
Te trajtimi i fëmijëve me nevoja të veçanta që parashtrojë si pyetje z.Naim Çunaku, fillimisht unë e kam gjetur Drejtorinë e Arsimit pa këtë komision përkatës dhe e kemi formuar komisionin i cili ka për obligim me psikolog me staf përcjellës që t'i vlerësojnë nevojat e veçanta që kanë ata fëmijë për t'i trajtuar se a kanë nevojë të qëndrojnë në shkollën "Kongresi i manastirit" që gjendet në fshatin Gllamnik apo brenda shkollës të angazhohen asistent, andaj duke parë numrin qe e kemi rritur nga 4 në 13 konsideroj se dukshëm i kemi mbuluar nevojat e tyre, pra kjo nënkupton që e kemi pasur me vite të tëra Çerdhen që nuk ka pasur asnjë asistent dhe tani kemi asistent.
Gjithashtu z.Valon Demolli parashtroi një shqetësim të vetin lidhur me çështjen e Gjimnazit, shqetësim të cilin e bartim edhe ne. Ne e kemi shpallur konkursin në momentin e parë që ish drejtori na ka njoftuar për dorëheqjen e tij, janë zhvilluar procedurat e konkursit e që janë disa kritere që duhet t'i plotësoj çdo mësimdhënës andaj nuk ka të bëjë me apetite të drejtorit të DKA-së apo Kryetarit të Komunës dhe të jeni të bindur se çdonjëri i cili plotëson kushtet dhe e ka trajnimin për udhëheqje arsimore, po edhe të dëshirojmë nuk mund t'ia ndalojmë sepse është e drejtë ligjore për të aplikuar e që pastaj vlerësohen nga komisioni i përbërë nga Ministria, DKA dhe Këshilli i prindërve. Tani jemi në procedurë dhe po presim epilogun se si po rrjedh.

Sa i përket çështjes së fëmijëve me nevoja të veçanta, e nderuara bashkëvendëse e imja znj.Edonë Shabani, nuk është që nuk po i trajtojmë dhe nuk kanë mbetur ata në një letër, për çka mund të shkojmë së bashku dhe të vizitohen pa asnjë problem ngase është ndjenjë e mirë besojë sidomos për politikanët që të shkojnë t'i shohin ata fëmijë sepse do të vetëdijesoheshin shumë në veprimet e tyre, andaj mos bëni politikë edhe me ata fëmijë. Pra pa problem mund të shkoni t'i vizitoni dhe mos bëni politikë sepse nuk është që nuk kemi punuar, jemi të gatshëm të punojmë dhe për këtë arsyeje është rritur numri i tyre dhe jemi munduar që sa më shumë t'iu bëjmë trajtim më të veçantë atyre nxënësve.
Sa i përket çështjes së ngritjes nga znj.Arnisa Sylejmani rreth gjeneratës XP, një sistem të tillë mund ta ketë vetëm ai që të ka informuar gabimisht-sekretari i shkollës teknike ku ai mundet ende me pas kompjuterin e vetë me XP, përndryshe të dyja shkollat mund t'i vizitojmë dhe e shohim nëse nuk i kemi dërguar kompjuterët e gjeneratës së re. Versionin nuk mund të shkoj unë si drejtor t'jua instaloj aty por ne kompjuterët i kemi dërguar me performanca të cilat i ka përgatit zyra e IT në Komunë dhe e kemi furnizuar kabinetin e Gjimnazit të cilin e kemi gjetur pa kompjuterë sikurse edhe shkollën teknike, për çka janë fotografitë si dëshmi ku dhe i kemi promovua si Komunë.
Jam i vetëdijshëm se janë disa programe, mësimdhënës ndoshta dëshirojnë me prezantua te nxënësit ndonjë font-page ose diçka që i përshtatet atij programi. Jemi në fazën e nënshkrimit të kontratës ku secila shkollë do t'i ketë të paktën 15 kompjuterë.
Shkolla e mesme ekonomike ku edhe kam punuar, është me tri ndërrime ashtu siç e kam gjet, sikurse që e kam gjetur edhe shkollën "Naim Frashëri", tash ne jemi duke e bërë një ndryshim, kemi nisur procedurë për ndërtimin e shkollës së mesme ekonomike dhe të lirohemi nga ai problem e që unë nuk mund ta shfajësojë as vetën sepse kam qenë në partinë e juaj dhe e kemi rrënuar shkollën "Naim Frashëri" me gjithë ato klasë dhe asnjëherë nuk ka ndodhë që një Komunë të rrënoj një shkollë të madhe dhe të ndërtoj një më të vogël, prandaj tani patjetër se jemi të detyruar për shkak numrit të madh të nxënësve. Ndoshta jam prej të vetmit persona që fëmijët e mi shkojnë në shkollë në fshat, kurse ju i keni në qytet dhe për atë arsyeje bëhen ka 3 ndërrime këtu, kështu që për këtë punë fajin e kemi të gjithë kapak. Po në atë gjendje me 3 ndërrime e kemi gjetur shkollën e mesme ekonomike dhe shkollën "Naim Frashëri.
Anëtari i Kuvendit z.Ekrem Rrahmani e parashtrojë një pyetje për tenderin e transportit, unë e them që nuk është një burimor por është i hapur qe tri vite radhazi, pra për tri vite sa unë jam këtu, njëherë ka filluar me kohë me 1 shtator, vitin që e lamë pas kemi pas problemet me greva, kontrata nuk ka qenë kontratë kornizë sepse po duhet çdo vit të shpallet tenderi, procedurat i kemi filluar në muajin qershor por kanë qenë disa pengesa si pasoj që mbaruan mjetet për dru dhe pelet kur është votuar këtu një propozim për shtim të buxhetit deri në përfundim të ankesave, dhe tani u njoftova që janë në fazë përfundimtare.
Te furnizimi me perde, t'ju them të drejtën, është shqetësuese edhe për mua, mësimdhënësit nuk duhet të kërkojnë mjete, mjafton drejtori i shkollës të bëjë paramasën e perdeve dhe të dërgoj në shkollën teknike ku është drejtimi për rrobaqepësi ku pastaj nxënësit në koordinim me profesoreshën i bëjnë prerjet e perdeve për klasat të cilat kanë nevojë.
Sa i përket asaj që e potencoj znj.Arjeta Salihu, fillimisht nisem nga parimi që e ceku edhe ajo, lirim nga petku partiak dhe besoj që e kamë një ndërgjegje të pastër sepse një pjesë të madhe jam i liruar, të jesh e bindur, mund ta merreni listën e të pranuarave dhe e shihni që nuk ka vetëm persona të LVV aty, por me shumë përgjegjësi e theksoi që një pjesë e madhe është e LDK-së, jo që kam dashtë unë por i kanë pasur përgatitjet shkollore dhe nuk mund të anashkalohen asnjë, përndryshe në kushte të barabarta është normale t'i jepet përparësi dikujt e që çdo parti i ka dhënë, madje e dimë që plotë shoqe të znj.Arjetë Salihu kanë hyrë në punë dhe asnjë problem nuk është.

Pastaj e theksuat qe nuk kemi pasur progres, mund të shihni këtu afër shkollën "Shaban Shala" qysh ka qenë dhe si është tani, nuk e di a ke punuar në këtë shkollë, ne nuk kemi mundur që një donacion që vie më shumë se gjysmë milion euro t'i themi jo, pra që nuk është investim i Komunës, por që e bënë shkollën me lift dhe krejt ato probleme që i kemi lënë të gjithë, ne dhe ju të gjithë së bashku, t'i themi donatorit tani që nuk kemi nevojë sepse nuk keni ardhë me kohë, pra donatori vetë i kanë zhvilluar procedurat e prokurimit, nuk e kam zvarritë unë këtë punë por ata i kanë zhvilluar procedurat dhe ne nuk kemi llogari që gjysmë milioni euro t'i humbim ato mjete, e sidomos kur bëhet një investim shumë serioz siç është shkolla "Shaban Shala".
Shkollën fillore "Naim Frashëri" gjithashtu e kemi gjetur me 3 ndërrime dhe për atë që e kemi gjetur ashtu jemi në përpjekje që t'i bartim në objektin e shkollës së mesme ekonomike, ku ta fillojmë ndërtimin edhe të një shkolle të re dhe në vitin 2025 mund që të jenë me një ndërrim edhe shkollat e qytetit. Kurse sa i përket tenderit dhe transportit, është e njëjta përgjigje e mëhershme.
Edhe te çështja e shujtave që e potencuat, kjo kontratë është kontratë me AQP, kjo nuk është kontratë që e ka nisur në procedurë Komuna për blerjen e kifleve dhe që tani po e anashkalojmë apo që po e ndalojmë, kjo është kontratë që e shfrytëzojnë të gjitha Komunat për shumë ushqime që i kanë, ne e kemi vërejtur që prej një çmimi në shumë 0.15 cent ka kaluar në 0.29 cent edhe ju shumë herë keni bërë vërejtje që përse vetëm kifle e kështu me radhë gjëra tjera, dhe e kemi menduar që atë që e kemi premtuar ta ndryshojmë pak, të kemi pemë e gjëra tjera por edhe kifle pse jo, që të kenë nxënësit një meny më të mirë, prandaj kemi planifikuar një buxhet që ndoshta do të ketë vonesa, mirëpo qëllimi është të mos i jepet mundësi asaj kompanie që të luaj çmimin e kifleve nga 0.15 cent në 0.29 cent.
Sa i përket fjalimit të z.Qendrim Softollit që e përmendi fjalën abuzim me detyrën zyrtare dhe ai më pas e potencoj që kemi kryer vepër penale, është çështje që për këtë edhe Gjykatësi kur e merr vendimin mendon mirë, sepse ky është fjalor juridik që e thotë gjykatësi në fund kur i konstaton të gjitha provat. Ju jeni të vetëdijshëm që keni bërë një kallëzim penal dhe ai është hedhur poshtë edhe ju e dini mirë këtë punë. Për të gjitha shpifjet që i keni bërë unë e kam bërë një padi, ku më keni etiketuar me disa elemente të cilat në Gjykatë dalim dhe i dëshmojmë ato.
Sa i përket investimeve, nuk ka ndodhur asnjëherë më shumë, pranojeni ose jo kjo pak ka rëndësi sepse shihen me sy. Stafi është i kompletuar, mirëpo keni parasysh nëse dikush vjen dhe pranohet në një vend tjetër të punës dhe e bënë paralajmërimin në një afat shumë të shkurt kohor, duhet të shpallet konkurs dhe ai konkurs që e keni parë është shpallur në masë të madhe për shkollën teknike dhe shkollën ekonomike për disa mësimdhënëse që shkojnë në pushim të lehonisë dhe për ata/ato që e kanë lënë vendin e punës dhe kanë vazhduar në një punë tjetër, pra ne duhet të shpallim konkursin. Më vie shumë keq që nuk po i shikoni këto sepse nga momenti që auditori e ka dhënë një sugjerim që konkursi të shpallet përmes Zyrës së personelit, çdo herë kemi vepruar ashtu por nuk doni ta pranoni, sepse del në njoftim publik në kohë 30 ditë, çdo konkurs prej asaj date fillon forma e aplikimit për 15 ditë, ku brenda 45 dite komisioni e ka për obligim të bëjë përzgjedhjen dhe kaq është kjo punë. Nuk është gjë e mirë ajo për faktin sepse në sistemin arsimor dikush shkon në pushim, kjo procedurë është e gjatë dhe zgjidhje tjetër nuk kemi, keni dashtë të respektohet dhe atë po e bëjmë.
Agjencia për privatësi nuk e ka dënuar Komunën, kjo është gënjeshtër e juaj andaj mos thuaj diçka çka nuk është, Agjencisë i'a kemi jap të gjitha të dhënat çka kanë qenë sipas kërkesës tuaj.
I kemi gjetur dy raste të cilat ju i keni punësuar, ku njërin prej tyre e keni anashkaluar dhe jemi duke u ballafaquar, një kallëzim penal që e keni dërgua e ka hedhur poshtë prokuroria, keni vazhduar tutje me të dytin dhe jemi në pritje, unë nuk flas pa marr vendim ata, është procedurë dhe njeri normal që është ia lë prokurorisë të vendos për të.

Renovimin e shkollës "Shaban Shala" e potencova që është donacion dhe nuk e kemi vlerësuar që është mirë të humbet ai donacion, prandaj i kemi bartë nxënësit në një shkollë më të afërt.
Tek shkolla e fshatit Orllan, sigurisht jeni në dijeni shumë mirë që njoftimin e fundit që e kemi pas edhe nga drejtori në vend të ngjarjes, qe një vit nuk mbahet mësim aty dhe atë gjendje të shkollës e kemi gjetur ashtu, posa është lidhë kontrata kanë filluar rinovimet në atë shkollë dhe bëhen edhe ato klasa, por ndoshta nuk mund të thuhet që fëmijët tanë kanë mësuar aty sepse nuk kanë mësuar.
Pyetja e fundit ishte në atë mënyrë që u mundua të luhej një lojë politike e që më ngjau sikur ajo LDK që bëjnë kësi lloj shantazhi duke thënë se Kryetari duhet të marrë masa, mirëpo ne jemi shumë mirë duke punuar, jemi edhe prej pozicionit të subjektit politik, ju mua nuk mund të më lëvizni, ndërgjegjen e kam të pastër, kam hyrë në politik me shumë dinjitet dhe dal kur unë dëshirojë, e jo me vendime të partisë tuaj.
z.Qëndrim Softolli, theksoi, i nderuar abuzues i pozitës zyrtare (i drejtohet drejtorit parafolës), është e vërtetë që ke depërtuar te hetuesit policor të cilët për favore që ti i'u ke bërë e kanë bërë një raport që gjithçka është në rregull, por pas deponimit të fakteve të reja që ti e pranon edhe vetë se ke mungesë të dokumentacioni për dy raste të punësuarve, atëherë prokuroria është duke e kryer punën e vetë dhe shpresojmë që të kryej punën në mënyrë të paanshëm dhe drejtë, një rezultat i tillë e di ti qysh përfundon. Nuk e kam ndërmend ta ulë debatin me ty, dëshiroj të merrem vetëm me gjëra konkrete me ty, me pyetjet që ti bëra.
Për dinjitetin tënd politik me na fol ti është e tepërt. Ndërsa rasti i shpalljes së orëve në formë të hakmarrjes për gruan e shefit të Grupit të LDK-së, kur e ke parë që prapë të bie në qaf prokuroria si formë hakmarrje, e ke mbyllur atë konkurs, këtë e dimë gjithë dhe ky është një fakt.
znj.Arjeta Abazi, theksoi, si duket drejtori i DKA-së nuk dha sqarime në të gjitha ato pikat që unë fola paraprakisht, por e kam edhe një pyetje tani, foli për funksionalizimin e kabineteve, dhe do dëshiroja të dija se a janë funksionale të gjitha kabinetet në të gjitha shkollat sepse unë kam informacione se nuk janë. Ndërsa tek nënshkrimi i kontratave me investitor të huaj, para se t'i nënshkruani këto kontrata, a është dashtë të mendoni se ku duhet të transferohen nxënësit në mënyrë që mos të ketë grumbullim të nxënësve ku klasat e para dhe të dyta i vuajnë pasojat sepse të qëndrojnë 50 nxënës në një klasë është e pamundshme të ketë rezultate, pra a është dashtë të mendoni këtë para se të nënshkruhet kontrata. Është mirë që nënshkruhen kontratat dhe mirë që punohet, por jo të shkohet gjithmonë në dëm të mësim nxënies.
z.Haki Rudari, theksoi, nga ana e koleges parafolëse u përmend shkolla "Shaban Shala", unë jap mësim aty qe 4 vite, natyrisht që janë dy investime që bëhen me vlerë 150,000.00€ dhe tjetra 350,000.00€ nga Bashkimi Evropian. Unë pajtohem në parim që nxënësit kur shkojnë në shkollë tjetër kanë vështirësi dhe nuk mund ta mohoj këtë, por kur të përfundon ky investim do jetë një ndër shkollat më bashkëkohore jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon ndoshta.
Pra nuk mund edhe të bësh investime edhe të krijohen kushte komode por në momentin që përfundon ky investim do të jetë një ndër shkollat më moderne.
znj.Arjeta Abazi, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, për çdo ditë i shoh sepse fëmijët e vëllait tim i kam në atë shkollë dhe i shoh sa kanë ngecë, madje brenda për brenda dy mësimdhënës ligjërojnë tema të ndryshme, janë fëmijë shumë të vegjël për t'i kap këto gjëra.
z.Haki Rudari, theksoi, po e përsërisë që ka vështirësi sepse nga një shkollë në shkollën tjetër normale që është vështirësi. Edhe në fshatin Shajkoc unë jap mësim, deri sa të përfundojnë procedurat nuk mund të jap mësim, këto janë procedura edhe të LDK-së që kanë qenë e që janë edhe tani, pra është e njëjta dhe askush nuk mund t'i shkel, përkundër dëshirës së të gjithëve neve që asnjë orë të mos e humbasin nxënësit, po theksoi që në fshatin Shajkoc ku fëmija im shkon aty

në shkollë dhe ka mungesa të tilla për shkak të pushimit lehonisë, sëmundjeve, vizitave, e pamundësojnë që ndokujt t'i thuhet shko aty jep mësim.
znj.Arjeta Abazi, theksoi, për ndërrime e potencova edhe më herët, përse të mos ndërrohen brenda mundësive nxënësit që janë më të vegjël dhe të jenë në një orar më herët, kurse nxënësit më të rritur të jenë në orarin e pasdites, por jo nxënësit e klasës II-të dhe të III-të të fillojnë mësimin 15;15 dhe të mbarojnë në ora 19:00. Kur e them këtë, unë nisem nga fëmijët e mi.
z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar drejtor i DKA-së, dua të di se a kemi institucione parashkollore për fëmijët me nevoja të veçanta në Komunën tonë.
z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, e nderuara znj.Arjeta Salihu, u mundova që të gjitha përgjigjet t'i jap dhe nuk e di që harrova diçka, nëse po lirshëm më thuaj sërish. Nuk ka klasë me 50 nxënës. Mund të ofrohet mësimi me dy mësimdhënës për arsyeje se është duke u punuar dhe nuk kemi se si të menaxhojmë ndryshe. E rëndësishme është se kjo nuk ka qenë kontratë që ka qenë merre ose lëre, por është një investim i madhe dhe ky projekt sa për informacionin e juaj mund të jetë që është nisur edhe në vitin 2020 dhe e kemi përsëritë duke ndarë edhe një shumë buxhetore të Komunës për efiçiencë, i kemi plotësuar kushtet për të fituar atë investim gjysmë milioni euro për ta rregulluar përbrenda siç duhet të rregullohet mirë dhe të mos ketë vështirësi, është e pamundshme. Pra kjo ka qenë zgjedhja dhe mendojë që jemi duke ja dal mirë deri në këtë kohë, nuk ka ndonjë problem të theksuar dhe më së larti në gjysmë vjetorin e dytë na pret një shkollë moderne që e duam të gjithë.

Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës, dhe pas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit për një pauzë të shkurtër, jep pauzë 15 minuta, dhe atë nga ora 15:35.

Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 16;00,
Mbledhjen e vazhdoi duke e udhëhequr z.Hilmi Hoxha Kryesues i Kuvendit i cili konstatoi kuorumin ku prezent ishin 23 anëtarë/e të Kuvendit, dhe atë:
Nga LDK, *Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Donjetë Sheqiri; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta*.
Nga LVV, *Artrit Mulliqi; Kasib Bashota*; *Sebastina Vokrri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi.*
Nga PDK, *Bashkim Syla.*
Nga AAK, *Mrika Thaçi; Arbnor Fazliu.*

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e Drejtorive të Komunës të cilët ishin prezent paraprakisht në mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit, konstatoi kuorumin, theksoi, mund të vazhdojmë me mbledhjen sipas renditjes së pikave të rendit të ditës.

8. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik të draft Planit Operativ Emergjent Lokal

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, theksoi, para vetës e keni propozim vendimin për vënie në diskutim publik të draft planit operativ emergjent lokal, është draft plan që është punuar nga DSHPMSH së bashku me një komision i cili është caktuar në kuadër të Komunës në përgjithësi të cilët kanë punuar me Agjencionin e Emergjencave të Kosovës, UNDP-në dhe Kryqin e Kuq Ndërkombëtar dhe tani para vetës keni draftin në fjalë dhe unë kërkoj nga ju që ta mbështetni propozim vendimin përkatës për vënie në diskutim publik të këtij drafti. Propozimi është që kohëzgjatja e konsultimit publik të jetë sipas ligjeve në fuqi, përkatësisht të paktën 30 ditë, dhe atë nga data 04.10.2023 deri më 03.11.2023, ndërsa debati i përgjithshëm publik të jetë më 31.11.2023.
Rëndësinë e këtij plani sigurisht që do ta shihni gjatë shfletimit të tij dhe përveç që kërkoj të mbështetet vendimi për vënie në diskutim publik, kërkoj që çdo njëri nga ju të jep edhe kontributin e vetë në hartimin sa më të mirë të këtij plani.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, Grupi i LDK-së e përkrah këtë draft plan operativ emergjent lokal edhe pse në seancën e fundit kam pasur replikë me Kryetarin e Komunës i cili theksoi që nuk e keni këtë plan. Unë u mundova që të gjejë autorin se kush e ka bërë këtë plan, por nuk e gjeta, pastaj kam vërejtur edhe mangësia tjera të mëdha, por kur të del në konsultim publik ne do t'i japim vërejtjet dhe sugjerime tona, por do të doja të dija se kush është hartuesi i këtij plani.
z.Kasib Bashota, theksoi, ne Grup i LVV-së e përkrahim këtë draft plan operativ emergjent.
z.Xhevdet Maloku, theksoi, Komuna e Podujevës është mjaft e ekspozuar ndaj fatkeqësive natyrore gjatë viteve të fundit. Fatkeqësitë natyrore më të shpeshta dhe pasoja të rënda janë përmbytjet, për minimizimin e këtyre rreziqeve kërkohet një pasqyrim sa më i drejtë i menaxhimit të tyre të cilat realizohen dhe pasqyrohen nëpërmes këtij plani e që janë, arritja e objektivave të sigurisë në nivel komune dhe reagimi në situata emergjente është sfidë për institucionet përkatëse duke filluar me përmirësimin e proceseve, protokollet e deri tek funksionalizimi pse jo i një Drejtorie për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Ky plan duhet të parasheh objektiva se si duhet të veprohet në të gjitha rastet e rreziqeve të mundshme, të ofrojmë mekanizma të cilët janë në gjendje të përballen dhe të merren me menaxhimin e incidenteve dhe fatkeqësive të të gjitha llojeve. Po ashtu përmes këtij plani parashihet parandalimi, lehtësimi dhe rimëkëmbja e gjendjes nga çdo dëmtim në jetën e njerëzve, gjallesave tjera dhe pronave.
Drafti patjetër ka nevojë që të plotësohet nga bashkëpunimi me ekspert të fushës përkatëse gjatë fazës së dëgjimit publik.
z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, siç e thash edhe më herët që ky draft plan është sponsorizuar nga DSHPMSH, është bërë një komision në nivel Komune dhe jo vetëm prej DSHPMSH të cilët kanë marr pjesë në katër punëtori që janë organizuar nga Agjencia për Mbrojtjen e Emergjencave-AME në nivel të qeverisë, nga UNDP dhe Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, pra këto kanë qenë të përfshira së bashku me komisionin e formuar nga ana jonë si Komunë, kanë marr pjesë në katër punëtori që është organizuar nga AME dhe në fund kanë dal me këtë draft plan. Besojë që drafti ka nevojë për rregullime dhe sugjerime dhe për këtë presim gjatë kësaj kohe të bëhen, personi kontaktues është z.Afrim Mulliqi zyrtar për emergjenca në DSHPMSH ku adresën dhe kontaktin e tij do ta keni në vendimin për vënie në konsultim publik.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ndoshta do të ishte më mirë që edhe dëgjimet publike t'i publikoni më herët, ose të dërgoni ndonjë email Shoqërisë Civile por edhe njerëzve që merren me këto plane emergjente në të gjitha fushat siç janë ushtarët e FSK, përfaqësuesit e QKMF-së, me qëllim që të ftohen në dëgjim publik që të jetë i miratuar një plan më i mirë i mundshëm.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush e dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim propozim vendimin për vënie në diskutim publik draft Planin përkatës Operativ Emergjent Lokal

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 23 vota Për, nga anëtarët sa ishin prezent në mbledhje, miratohet propozim vendimi për vënie në diskutim publik të draft Planit Operativ Emergjent Lokal, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhjes, me plotësim ndryshimin që kohëzgjatja e konsultimit / diskutimit publik të jetë 30 ditë, nga data 04 tetor 2023 deri më 03 nëntor 2023, kurse debati publik me qytetar mbahet më 31 tetor 2023 nga ora 17:00 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit.

9. Propozim vendimi për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë dhe Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2026

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, meqë ky dokument është sponsorizua nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, por në mungesë të drejtoreshës e paraqes fjalën hyrëse. Ky dokument është për vënie në diskutim publik të Strategjisë lokale për mbrojtje nga dhuna në familje për vitin 2023-2026, pra është për vënie në diskutim publik dhe si datë për diskutim publik është caktuar data 27.10.2023 duke përfshirë edhe çështjet tjera sipas propozim vendimit.
znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, duke e pasur parasysh raportet e viteve të kaluara për rastet e dhunës në familje, fatkeqësisht Komuna e Podujevës radhitet në treshen me më së shumti raste të dhunës në familje, konsiderojë që kjo temë duhet të merret në konsideratë me më shumë kujdes dhe profesionalizëm të veçantë për shkak të ndjeshmërisë së kësaj dukurie, andaj në emër të Grupit të LDK-së e përkrahim propozim vendimin për vënie në diskutim publik të draft planit dhe

Strategjisë të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2026, kurse vërejtët dhe sugjerimet tona do t'i japim gjatë fazës në diskutim publik.
znj.Qëndresë Hajrizi, theksoi, duke e parë që Strategjia dhe plani i veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje ka për qëllim të fuqizoj dhe të rris efikasitetin e mekanizmave institucional për mbrojtje, parandalim, ndjekje penale dhe eliminim të dhunës në familje, vetëdijesimin e shoqërisë për të sfiduar sjelljet e dhunshme, duke besuar dhe mbrojtur qëndrimin se dhuna kundrejt cilitdo anëtar të saj është e pa tolerueshme, andaj ne Grupi i LVV-së e përkrahim këtë pikë.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush e dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim propozim vendimin për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë dhe Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2026.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 23 vota Për, nga anëtarët sa ishin prezent në mbledhje, miratohet propozim vendimi për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë dhe Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2026, sipas materialit përkatës të prezantuar dhe proceduar nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa si plotësim ndryshim i materialit të dërguar me thirrjen e mbledhjes, si dhe që kohëzgjatja e konsultimit / diskutimit publik të jetë 30 ditë, nga data 04 tetor 2023 deri më 03 nëntor 2023, kurse debati publik me qytetar mbahet më 27 tetor 2023 nga ora 14:00 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit.

10. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit – shtëpi për qëndrim ditor të personave të moshuar në qytetin e Podujevës *(Në procedurë të rishqyrtimit sipas kërkesës nr. 020-586/4 datë 24.07.2023 të MPL-së)***.**

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kjo pikë ka qenë edhe njëherë në Kuvend, dhe është rikthyer në rishqyrtim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pra kemi të bëjmë me rishqyrtim të një pjese të vendimit.
z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, Komuna e Podujevës dhe Kuvendi Komunal ka marr një vendim për bashkëfinancimin dhe implementimin e projektit për ndërtimin e objektit për qëndrim ditor për personat e moshuar. Kur është marrë ai vendim, ne e kemi pas një pëlqim paraprak së bashku me zyrën ligjore dhe Departamentin ligjor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, pra vendimi i parë që është marr ka qenë në bashkëpunim me MAPL-në, mirëpo pasi që është marr ky vendim na jemi konsultuar me drejtorin e Departamentit Ligjor ku ata pastaj i kanë pasur disa hezitime dhe na e kanë kthyer në rishqyrtim këtë vendim. Tani për këtë vendim të cilin e kemi iniciuar jemi në konsultim me MAPL-në, dhe meqenëse bëhet fjalë për një projekt jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe për një donacion të madh rreth 2,000,000.00 euro, ju ftojë që të mbështetni këtë propozim vendim.
z.Naim Çunaku, theksoi, ne një propozim të tillë për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të cekur e kemi përkrahur edhe më parë, vërtetë që kemi shfaqur edhe në atë kohë dilema që pas donacionit si të veprojmë për lokacionin, se kush është do të menaxhojë me të në fazën tjetër. Nga ajo që kuptova prej drejtorit parafolës që sërish ka konsultim për këtë, shtroj pyetje se a është shpjeguar ana ligjore që Komuna mund të ofrojë parcelën e vetë, gjegjësisht caktimin e lokacionit dhe ai lokacion a kalon në menaxhim apo jepet në shfrytëzim atij që e menaxhon shtëpinë e të moshuarave, nëse është konsultuar baza ligjore e kësaj, Grupi i LDK-së e mbështet.
Një projekt i tillë do të ishte ndihmës e madhe për personat e moshuar.

znj.Qëndresë Hajrizi, theksoi, duke e parë rëndësinë e ndërtimit të objektit të shtëpisë për qëndrim ditor për personat e moshuar të Podujevës, ne Grup i LVV e përkrahim këtë propozim.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush e dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim propozim vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit-shtëpi për qëndrim ditor të personave të moshuar në qytetin e Podujevës sipas propozimit përkatës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 23 vota Për, nga anëtarët sa ishin prezent në mbledhje, miratohet propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - shtëpi për qëndrim ditor të personave të moshuar në qytetin e Podujevës (Në procedurë të rishqyrtimit sipas kërkesës nr.020-586/4 datë 24.07.2023 të MPL-së), sipas materialit të prezantuar dhe procedura nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 26 shtator 2023.

11. Propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri

(Projekti për furnizim me mëshqerra)

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, bëhet fjalë për propozim vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri, përkatësisht për mjetet të cilat janë nga participimi i fermerëve të cilët janë përfitues të subvencionit që duhet të participojnë me 30% të vlerës së financimit të cilin e marrin e që në total është një financim prej 105,300.00€. Në mënyrë që të zbatohet ky projekt duhet që patjetër këto mjete buxhetore të bartën në kod buxhetor dhe siç u bisedua edhe paraprakisht ne e kemi edhe një rregullore për subvencione ku është paraparë kjo ashtu siç është paraparë edhe në bazë të thirrjes publike ky participim i fermerëve në masën 30%.
znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, Grupi i LDK-së është deklaruar edhe më herët ku edhe sot deklarohemi që ne jemi kundër participimit të qytetareve siç kemi të bëjmë me këtë subvencion me mëshqerra. Konsiderojmë që shuma prej 30%, pra mbi 800 € që është paguar herën e fundit është barrë e rëndë për qytetarët, andaj ne Grupi i LDK-së nuk e përkrahim këtë kod.
znj.Drita Pajaziti, theksoi, ne Grup i LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush e dëshiron fjalën nëse jo atëherë e hedh në votim, propozim vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 13 vota Për, 8 vota Kundër, asnjë votë të Përmbajtur, miratohet propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin "furnizim me Mëshqerra", sipas materialit të prezantuar dhe proceduar nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më 26 shtator 2023.

12. Raporti përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në territorin e Komunës së Podujevës

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse rreth raportit në fjalë, theksoi, në Komitetin për Politik dhe Financa është shtuar edhe pika e rendit të ditës, raporti përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në territorin e Komunës së Podujevës.
Arsyeja pse ka ardhur me vonesë si pikë e rendit të ditës sigurisht e dini, komisioni ka qenë në fazën e punimeve dhe koha kur e ka përfunduar në atë moment është dashtër me sjellë në Kuvend në mënyrë që mos të shtyhet edhe 1 muaj procedimi i tij në Komisione përkatëse pran nivelit qeveritar. Pra komisioni përkatës komunal ka përfunduar punën e vetë si çdo herë tjetër dhe ka ardhur në përfundim me këtë listë të cilën e keni para vetës. Nga të gjitha kërkesat që kanë qenë në numër 279, të gjitha janë vlerësuar dhe për të gjitha vlerësimet i keni në listën përkatëse.
Pra siç e keni parë janë 78 vlerësime në ekonomi familjare, 200 vlerësime të personave që kanë pësuar dëme në bujqësi nga vërshimet, si dhe kemi 1 një biznes, e që në total numri është 279 kërkesa të vlerësuara.
Kërkoj nga ana juaj që të votohet dhe të procedohet më tutje në komisionin qeveritar.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ne Grupi i LDK-së e përkrahim këtë raport edhe pse ka shumë vërejtje që nuk është dashtër të ndodhin. E para është që nuk ka pasur as thirrje publike e që kjo nënkupton që dikush që ka punuar në Komunë i ka kontaktua njerëzit e vet të aplikojnë sepse është koha për aplikim, pra është njeri që e njohim të gjithë dhe figuron në listë-numri 167, i cili jeton në Prishtinë dhe ka përfituar 30,500.00€ me arsyetimin se breshëri i'a ka dëmtuar dardhat dhe qershiat dhe krejt kjon i është bërë për këtë vit, ndërsa a ka pasur vërshime për breshër e dim, nuk ka pas dhe nuk ka rënë breshër në Podujevë këtë vit e që do të mund ti bënte dëme atij personi i cili është nga Prishtina dhe vie i merr mbi 30,000.00€, kurse ka njerëz tjerë që jetojnë nga bujqësia dhe e mbajnë familjen, prandaj e them se kjo është shumë shqetësuese.
Ka edhe njerëz tjerë të fshatit tim që nuk i ka mbuluar uji fare por që ka aplikua këtu, kurse fatkeqësisht ata që i ka marr uji nuk kanë aplikuar sepse nuk e kanë ditur, madje mua personalisht me ka mbuluar uji me të gjitha ato që i kam pasur, por unë nuk kam aplikuar dhe nuk aplikoj, mirëpo ne tani po dalim në pozitë të keqe sepse nëse nuk e votojmë qytetarët po thonë pse nuk po e votoni, ndërsa njerëzit po përfitojnë njëjtë, edhe ata që nuk paguajnë taksa në Komunën e Podujevës.
Çështja tjetër është që për dëmet e shkaktuara në muajin janar kanë aplikuar dhe e kemi votuar në Kuvend por që ende asnjë qytetarë nuk është kompensuar për ato dëme të shkaktuara përveç që i'u është dhënë një kartel me një vlerë 50€ që ka qenë ndihmë nga Zvicra.
z.Ardi Hasani, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim raportin përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në Komunën e Podujevës.
z.Naim Çunaku, theksoi, të flasësh për një dukuri që tani më është bërë normale, por kur e kemi potencuar që brenda një periudhe 6 mujore kemi pasur tri herë vërshime me intensitet të ndryshëm dhe e theksova edhe në KPF e që po e them edhe sot që nuk mundesh në këtë formë t'i trajtosh në mënyrë selektive dëmet që janë shkaktuar në Komunën e Podujevës nga vërshimet.
Pse po e them selektive, sepse me vetë faktin kur nuk është një thirrje publike për mundësi të aplikimit, me automatizëm të dërgon që është selektive. Pa dashtë të hyj në personale, si një prej të dëmtuarve të këtyre vërshimeve të 16 qershorit, më shumë se një herë e kam potencuar që kemi pasur dëme në ekonomi familjare si dhe vërshime brenda hapësirave të banuara.

Me vetë faktin që nuk ka një thirrje publike do të thotë që një prej njerëzve që vërtetë unë personalisht nga ajo që e njoh dhe që jetojë buzë lumit i di që dëmet i'u janë shkaktuar dhe ata persona nuk i shoh në këtë listë, arsyetimi është që nuk e kanë ditur që do të bëhen.
Fundja që ky raport mos të ketë fatin e raportit të kaluar, kolegu i përmendi disa bonuse që i kanë marr nga një Organizatë Joqeveritare, mirëpo përgjegjësia institucionale ndaj dëmeve të dhjetorit edhe pse një raport të tillë e kemi pasur në Kuvend dhe është miratuar nga ky Kuvend nuk ka pas asnjë zhdëmtim për dëmet e shkaktuara, sidomos në ekonomitë familjare, ndërsa për dëmet në bujqësi sërish po e them që në mënyrë selektive ka marr dikush disa bona për impute bujqësore.
U tha që ka pasur komision vlerësues, unë nuk e di a ka pas apo jo, por më intereson një gjë, një komision vlerësues që është ngritur nga Komuna në muajin dhjetor, deri kur ka marr pagesë për punë shtesë si komision funksional për inspektimin e dëmeve që kanë ndodhur nga vërshimet, në fakt drejtori i DBF nuk qenka këtu, por sa unë kam njohuri ai komision më tepër se për një periudhë 6 mujore ka marr kompensim për punë shtesë në vlerësimin e dëmeve që janë shkaktuar nga vërshimet.
Kjo që po e bëjmë sot, urojë që të mos të ketë fatin e raportit të kaluar dhe po më vjen paksa rëndë ta them se është një lajthitje apo mashtrim i qytetarëve, dhe nuk mendoj që në projekt buxhet nuk ka zënë vend meritor një trajtim që i kanoset territoreve të caktuara të Komunës tonë nga vërshimet, kjo me vetë me vetë faktin që në rast se krahasojmë janë mbi 2 milion euro dëme sipas këtij raporti dhe i afrohemi kësaj, pra sa kemi të shkaktuara dëme në ekonomi familjare, bujqësore në territorin e Komunës për një vit është shuma mbi 3 milion euro, dhe nuk ka nxënë vend si projekt prioritar.
Nuk dua të replikoj me drejtorin, por po e përmbylli me një fjalë, më shumë popullore (është aq investim i madh që nuk ja vlen, se na nuk mundemi me bë asgjë dhe po e lejmë krejt), mirëpo nuk pajtoj me atë logjikë të veprimit arsyeja pse është që nëse nuk mund të trajtohen të gjithë nga rrezikun që vjen nga vërshimet në nivel Komune, mundemi të paktën pjesërisht vit pas viti t'i afrohemi asaj që mos të na ndodh. Për mua është e pakuptueshme që të merret si prioritet objekti ku ne jemi sot këtu dhe ato 140,000.00€ sa janë dedikuar për këtë projekt të parëndësishëm, por vërtetë nuk po merren prioritet ato që e rëndojnë jetën e qytetarëve.
Normalisht që do ta votoj sepse e di që në këtë listë vërtetë janë dëmtuar dhe me votën time nuk dua që asnjërit t'ia cungoj të drejtën ose të paktën që ai mendon që do të zhdëmtohet e që fare nuk besoj që do të ndodh.
z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, po e filloj nga njoftimi publik që u përmend, ka mundur edhe mos të ketë nuk jam i sigurt për këtë, por një gjë jam shumë i sigurt që ka ndodhur këtu që secila kërkesë që ka ardhur madje edhe jashtë afatit kohor të aplikimit për vlerësim të dëmeve e që ju e dini që ligjërisht është 5 ditë sepse parashihet që është gjendje emergjente dhe pas 5 dite mund që të ndryshoj gjendja në teren por secila kërkesë që ka ardhur në secilën kohë është marr dhe është shqyrtuar, pra asnjë nuk ka mbetur pa u pranuar, unë vetë i kam jep urdhër zyrës pritëse që kërkesat për vlerësim të dëmeve të pranohen në cilën do kohë që sjelle ato dhe i kanë pranuar secilën. Unë nuk mendojë që ka pasur ngecje këtu, e di që ka njerëz që nuk e kanë ditë, mirëpo ne po bëjmë thirrje për dëgjime publike por nuk po vie askush ose nuk po e shohin apo nuk po dëshirojnë të vijnë, është çështje tjetër, prandaj përtej asaj që kemi mundësi nuk mund të dalim, e publikojmë në ueb faqe të Komunës, në facebook dhe në media lokale, diku tjetër nuk kemi ku ta publikojmë atë, por nuk besojë që kanë mbetur për këtë çështje, pra për shkak të njoftimit publik nëse veç ka mbetur dikush.
Sa i përket listës që u cek dhe që njëri prej tyre është nga Prishtina, e them që shumë prej neve kemi banesa në Prishtinë e Fushë Kosovë, por tokat i kemi këtu, unë nuk e di për kë ishte fjala

sepse nuk jam marr me asnjë emër të përveçëm dhe nuk e di kush janë, por e di që shumë prej neve dhe juve këtu jetojnë në Prishtinë dhe Fushë Kosovë dhe vijnë në punë këtu, andaj nuk besojë që është problem kjo, tokat kanë mbetur këtu dhe dëmet ju kanë bërë në tokë e jo në shtëpi.
Te ekonomitë familjare, e kemi biseduar që ka pasur dëme dhe në listë janë 78 ekonomi familjare të cilat janë vlerësuar prej atyre kërkesave që kanë ardhur dhe që të gjitha janë në listë.
Te vlerësimi, nuk do të thotë që për rastin e përmendur dëmet janë shkaktuar nga breshëri, ne kërkesat i marrim në secilën kohë për secilën fatkeqësi që ndodh, në listë e keni edhe rastin në fshatin Peran që janë djegur lopët, pra në listë është sepse ka ardhur ka bërë kërkesë dhe komisioni është i obliguar ta shqyrtoj kërkesën e tij e që në fund është përfshirë në listë. Përveç kësaj edhe çdo kërkesë që vjen për fatkeqësi natyrore jo vetëm nga vërshimet, ai komision është i formuar në nivel të Komunës dhe këtë punë e ka të shqyrtoj secilën.
Te kompensimi i orëve shtesë, është e vërtetë që kanë pasur orë shtesë sepse kanë punuar deri në orët e vona dhe kanë bërë vlerësimet, madje më preku paksa kur parafolësi e tha që nuk kanë dal të bëjnë vlerësime ngase secila kërkesë është vlerësuar (279 kërkesa) dhe të gjitha ato kërkesa të vlerësohen normale është që merr pak kohë. Komisioni është në përbërje prej 5 anëtarëve, e kanë një veturë në dispozicion që Kryetari jua ka dhëne vetëm për atë punë edhe kanë punuar gjatë gjithë kohës, andaj normale është që kur punon jashtë orarit të punës jo vetëm për vlerësim të dëmeve, por për secilën punë që punon jashtë orarit të punës paguhen, të gjithë zyrtarët paguhen për orë shtesë, vetëm drejtorët e drejtorive jo.
Sa i përket asaj që z.Naim Çunaku e tha, urojë të mos e ketë fatin e njëjtë sikur me vërshimet e muajit janar, unë urojë që ta ketë të njëjtin fat sepse sot në mbledhjen e Qeverisë është miratuar propozim vendimi i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për kompensimin e dëmeve të shkaktuara në muajin janar të këtij viti, pra vendimi është në ueb faqe dhe janë ndarë 1.1 milion që do të kompensohen, jo ndoshta në total 100% sepse asnjëherë Ministria nuk kompenson 100% por në bazë të buxhetit që ka e bënë edhe kompensimin, prandaj i nderuar zotëri Çunaku sërish e them që unë urojë që edhe këto të qershorit ta kenë të njëjtin fat edhe të ndahen mjete buxhetore nga ata që janë kompetent dhe përgjegjës dhe të vlerësohet secili që ka pësuar dëme në territorin e Komunës së Podujevës.
z.Naim Çunaku, theksoi, për informatën e fundit që do të kompensohen ne do ta shohim dhe i gëzohem këtij fakti, por kur e theksova që nuk do të doja të kishte fatin e saj, urojë që të mos e ketë at fat, tani më gëzon fakti që ata do të kompensohen. E paraqita një pyetje se sa kohë është paguar komisioni, nuk dua të me tregosh që secili që punon mbas orari paguhet sepse kam njohuri për atë punë, por pyetja ime ishte sa kohë është paguar ky komision.
Pyetja tjetër ishte kur unë theksova që nuk ka pasur njoftim publik, ndërsa t'i drejtor si zyrtar më thua mua që nuk e di a ka pas, derisa e theksoi që nuk ka pasur thirrje publike për vërshimet e 16 qershorit që njerëzit të aplikojnë gjegjësisht të incizojnë dëmet e shkaktuara dhe komisioni të bëjë vlerësimin e dëmit. Nuk dëshiroj të hyjë në personale, por nuk e di a ti besoj vetës apo ty drejtor.
E përmendi edhe kolegu parafolës e që unë e di saktë që e ka pasur shtëpinë e vërshuar, ka edhe raste të tjera që nuk dua t'i përmend me emra por që nuk e kanë ditur sepse nuk ka pasur shpallje publike. Derisa mua si këshilltar i Kuvendit të Komunës më mungon ky informacion, a është e besueshme që e dinë të tjerët, vetëm thirrja publike e largon Komunën nga obligimi, ndërsa afatet ligjore që janë hapur se kush dëshiron të sjellë kërkesë dhe na e dërgojmë komisionin, mua nuk më duket përgjigje institucionale kjo.
Te çështja e banimit, mendoj se u banalizua paksa sepse askush nuk tha që nuk ka të drejtë dikush që të ketë banesë në Prishtinë apo Fushë Kosovë, pra të mos keqkuptohemi, problemi është se ku

kemi pasur dëme komision të na tregon që në atë lokalitet që e përmendi shifrën çfarë dëmesh ka pasur sepse breshër ose vërshime nuk ka pasur.
Sot është tema për raportin përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në territorin e Komunës së Podujevës, pra as nuk po e cek për lopë, e as nga breshëri, por ceket vetëm nga vërshimet në territorin e Komunës së Podujevës që kanë ndodhur me 16 qershor, është vetëm një pikë, një adresë dhe një periudhë kohore e saktë, por duhet me ditë kur, çka dhe pse, nëse dëshirojmë të bëjmë lojëra fjalësh, bëjmë.
Po e përmbyllë me atë se më vjen mirë që sot në bazë të informatës që morëm nga drejtori i DSHPMSH që do të kompensohen dëmet e janarit, ngase vërtetë njerëzit e vërtetë që kanë pësuar dëme kanë nevojë për përkrahje institucionale. Në vërshimet e muajit dhjetor ka qenë thirrja publike dhe afati kohor për aplikim, kështu punon institucioni e jo pa shpallje publike e jo vetëm kushdo që sjellë kërkesë
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, po ndërlidhem edhe njëherë te thirrja publike, vërshimet kanë ndodhur më 16 qershor, seanca jona ka qenë në fund të muajit qershor, një fqinjë timin dhe tuajin (i drejtohet (drejtori të DSHPMSH) nga fshati Llugë e kam takuar duke hyrë në seancë, më tha që ka kaluar afati për ankesë/kërkesë të vërshimeve dhe unë nga ai e kuptova, ndërsa ti drejtor e theksove që ka qenë afati i hapur për kërkesa, unë atë person e kam shok/mik të gjeneratës dhe nuk e di votues i cilës parti është, pra kjo nënkupton që njerëzit nuk e kanë ditur për thirrje publike.
E përmenda personin me numër 167 në listë, shkruan nga breshëri 7 hektarë dardha dhe 8 hektarë qershia dhe shuma është 30,511.97 €, po i'a mundëson këtë shumë të madhe dhe po ia dërgon në Ministri për kompensim kurse në anën tjetër jua zvogëlon shumën atyre që punojnë, dhe këtë e din ti shumë besoj. Ka njëri këtu që e ka dëmtuar uji në shtëpi dhe në bahçe kurse me këtë ai do t'i merr 500.00€. Unë në fillim e theksova se kur po shoh raste të këtyre njerëzve më shkon mendja qe mos ta votoj fare, mirëpo kur po i shoh disa të tjerë që merren me bujqësi nuk mundem mos ta votoj sepse merret me atë punë ai. Prandaj më duhet ta votoj me njërin sy hapur dhe tjetrin mbyllur sepse më dhemb zemra kur e shoh se ai person i merr kot mbi 30,000.00 €.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush e dëshiron fjalën rreth kësaj pike, nëse jo atëherë e hedh në votim Raportin përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në territorin e Komunës së Podujevës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 18 vota për nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, me vendim miratohet Raporti përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në territorin e Komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të prezantuar dhe proceduar nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financave.

13. Plotësimi i përbërjes së anëtarëve të Komitetit për Komunitete me një anëtarë/e nga radhët e komunitetit ashkali, dhe atë në vend të znj.Naile Ahmeti, nga komuniteti ashkali nominohet znj.Fikmete Qurkolli.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kemi të bëjmë me këtë propozim lidhur me anëtaren e komunitetit ashkali në Komitetin për Komunitete znj.Naile Ahmeti e cila është larguar nga ky Komitet dhe tani na duhet ta zëvendësojmë me të nominuarën znj.Fikmete Qurkolli.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 19 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 18 vota Për, asnjë Kundër dhe asnjë të Përmbajtur (1 anëtar nuk votoi), miratohet plotësim i përbërjes së Komitetit për Komunitete, dhe atë; në vend të znj.Naile Ahmeti e cila ka dhënë dorëheqje nga Komitetit për Komunitete, emërohet e nominuara nga radhët e komunitetit ashkali znj.Fikmete Qurkolli.

14. Të Ndryshme

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, e kam një kërkesë për drejtorin e DSHPMSH rreth asfaltimit të rrugës "Avdyl Dushkolli" e cila lidhë fshatrat Llaushë - Dumnicë, edhe pse disa herë e keni premtuar që ajo rrugë do të asfaltohet, nuk e keni asfaltuar, prandaj meqë ajo rrugë e ka të rregulluara bazën, kërkoi edhe njëherë që sa më parë të jetë e mundur të asfaltohet ajo rrugë.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, gjithashtu edhe unë kam pyetje për drejtorin e DSHPMSH, te shkolla në fshatin Sfeqël është kërkuar disa herë që në rrugë të vendosen policët e shtrirë me qëllim të ngadalësimit të shpejtësisë, a është mundësia të bëhet kjo punë.
z.Xhevdet Maloku, theksoi, lagjet Bici dhe Bunjaku gjegjësisht te rruga mbrapa Stacionit Policor në Lluzhan, kanë shprehur shqetësimin e tyre dhe kanë nevojë që të vendosen dy apo tri pengesa në rrugë në mënyrë që veturat në atë pjesë të vozisin me kujdes.
Gjithashtu e kam një pyetje tjetër, a pritet investim me ndriçim publik në fshatin Sfeqël te rruga "Pavarësia", si dhe në fshatin Lluga a është paraparë rregullimi pas djegies së tyre.
Po ashtu pyetja tjetër ka të bëjë me reduktimet e ujit të pijshëm në qytet, nga rrethi deri te shkolla e mesme ekonomike dhe deri te rruga "Skënderbeu" te vendi i quajtur "Tabet e Llapashticës", a ka ndërmarrë diçka Komuna pra a ka veprua në lidhje me ujësjellësin rajonal i cili trajton këtë problem.
z.Naim Çunaku, theksoi, një pyetje po ashtu për drejtorin e DSHPMSH, ka mbase një vit që e kam bërë një pyetje / kërkesë për shtrimin e një trotuari e që sigurisht drejtori në fjalë e din për cilin vend bëhet fjalë, pra rruga "Ibishi" te Govorët, rrugë e cila frekuentohet prej njësiteve që janë të punësuar në Burgun e Sigurisë së Lartë, dhe vërtetë ajo lagje është potencialisht e rrezikuar, me theks fëmijët e tyre që të shkojnë në shkollë. Sigurisht e dini qe edhe Policia për shkak natyrës së punës së tyre për shkak të atij Burgut vozitin me shpejtësi të madhe dhe të mos kenë trotuare aty. Ka një 1 vit që e kam bërë një kërkesë të tillë dhe një premtim më është dhënë që do të bëhet diçka në këtë drejtim, mirëpo ende as nuk ka pengesa (policë të shtrirë) dhe kjo për shkak të natyrës së punës që e bëjnë të punësuarit në burgun e sigurisë së lartë. Për fshatin Llugë nuk do flasë sepse e kemi pasur në diskutim publik dhe e kemi thënë që asnjë metër trotuar nuk është në gjatësinë e

rrugës kryesore 3 kilometra. Pra a mendoni që në të ardhmen e afërt të bëni diçka lidhur me këtë problem për fshatin Llugë dhe Bellopojë.
z.Atrit Mulliqi, theksoi, para një viti kam bërë një pyetje për çështjen e rrugës dhe trotuarit te shkolla "Xheladin Rekaliu" afër ish "Hotel Besiana", a është bërë diçka konkrete-ndonjë projekt sepse aty çdo ditë fëmijët janë të rrezikuar për shkak të mungesës së trotuareve apo është projekt që do të hyjë së bashku me rrugën apo projektin e Stacionit të Autobusëve.
z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, pengesa në fshatin Sfeqël nuk bëhet për arsyeje se në atë vend ku po kërkohet që vendoset pengesa janë të vendosura dy pengesa, prandaj është e tepërt të bëhen tri të tilla. Sa i përket edhe pyetjeve të tjera lidhur me vendosjen e pengesave në rrugë, në atë vend ku ekspertët e komunikacionit nuk e vlerësojnë që rrezikshmëria është e madhe ne nuk vendosim pengesa në rrugë, pra nuk vendosim pengesa aty ku nuk ka rrezikshmëri të madhe.
Sa i përket ndriçimit publik në fshatin Sfeqël, nuk kemi mund të bëjmë në rrugën "Pavarësia" dhe kjo do të shqyrtohet, por jo me kontratën që jemi duke e bërë tani. Rregullimi i ndriçimit publik do të bëhet në çdo vend ku ka dëmtime të ndriçimit publik, kontrata është në përfundim mirëpo ka ankesa nga operatorët dhe është në OSHP, prandaj po sa të lidhet kontrata do të rregullohen të gjitha dëmet që janë bërë.
Sa i përket trotuarit në fshatin Llugë, nuk e bëjmë sepse e kemi bërë ndriçimin dhe sigurisht se ndriçimi e rritë edhe sigurinë për nxënësi dhe për të gjithë.
Pyetja për rrugën te shkolla "Xheladin Rekaliu", e kemi në projekt është dashtë të bëjmë zhvendosje për shkak se tani me ndërtimin e Stacionit të Autobusëve bëhet zgjerimi i rrugës dhe ish dashtë të prishet sërish, pra do të bëhet rruga e re me Stacion të Autobusëve ku do t'i ketë edhe trotuaret dhe do të jetë shumë rrugë më e gjerë, madje besojë që do të jetë me tri korsi.
z.Xhevdet Maloku, theksoi, lidhur me ekspertët e rrugës së shpejtësisë dhe sigurisë, a kanë ndaluar në atë rrugë për të bërë matjen sepse unë nuk jam i informuar që kanë dal, ngase në atë pjesë të rrugës vozitin shumë shpejt, e them këtë sepse unë vetë jam banor i asaj pjese.
z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, nëse ka pas kërkesë me shkrim sigurisht që kanë dalë në vend të ngjarjes, sepse çdo kërkesë që vjen me shkrim ata dalin, por nuk e di a ka pasur kërkesë me shkrim, pra nëse janë drejtuar nëpërmes zyrës pritëse normalisht që dalin në terren.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 17:00

Procesverbalin e mbajtën;
Enis Sheholli
Arbrim Idrizi

Nr.Prot.01-060/04-0071599/23
Podujevë, **Kryesuesi i Kuvendit**
27 shtator 2023 **Hilmi Hoxha**

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e XXX-të (tridhjetë)-*e rregullt,* mandati VII-të, e mbajtur më 31 tetor 2023.

Mbledhja filloi në orën 10:15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.
Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.
Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:
*(*Nga LDK *Valon Demolli; Demokrat Hodolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani;* Fahri Hasani; kurse munguan; *Adnan Zymeri; Qëndrim Softolli; Tringa Sfishta.*
Nga LVV*, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota*; *Sebastina Vokrri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; kurse munguan; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi.*
Nga PDK, *Bashkim Syla; Mimoza Abdullahu; Endritë Murati.*
Nga AAK, *Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.*
Nga OBKD, *Gazmend Islami i cili mungoi me arsyetim shëndetësor me shkrim dërguar Kryesuesit të Kuvendit.*

Gjithashtu të pranishëm mbledhje ishin, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;
(Xhevrie Beqiri-Drejtoria e Administratës DA; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Pajtim Balaj-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH; Lirie Hoti-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të KFOR Laczkovicm Gergo, Përfaqësues të OSCE Samir Calakoviç Caleb Waugh, përfaqësues të mediave lokale dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

z.Hilmi Hoxha, **Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë në këtë mbledhje, në vazhdim theksoi, siç e dini, paraprakisht para kësaj mbledhje është mbajtur mbledhja e Komitetit për Politikë e Financa, e cila i ka rekomanduar dy pika shtesë Kuvendit për shqyrtim, kështu që rendin e ditës e keni marrë dhe besoj të gjithë jeni të përgatitur dhe kështu që paraprakisht para se të fillojmë me rendin e ditës, konstatojmë se a kemi kuorum. Për momentin 22 anëtar/e të Kuvendit janë prezentë, (lexon emrat e atyre që nuk janë prezent momentalisht), njofton të pranishmit se z.Gazmend Islamit i cili më ka njoftuar përmes e-mailit me një dokument të mjekut që është në Gjermani, pra për shkaqe shëndetësore nuk ka mund të merr pjesë.
Pra kuorumi ekziston dhe mund të vazhdojmë me rendin e ditës urdhëroni nëse dikush dëshiron ta marrë fjalën në lidhje me rendin e ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim kush është që të punohet me këtë rend ditë, duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë e Financa – KPF e mbajtur më 27 tetor 2023.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 22 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që janë prezent në sallë, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit të kësaj mbledhje, konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së përfshirë edhe dy pikat shtesë, dhe atë:

- ***Marrja e vendimit për lirim nga taksa për mamografi.***
- ***Propozim vendimin për ngritjen e komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale – "Eko-Llapi" Sh.A.***

1. **Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 31 korrik 2023**

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, njëzëri me 22 vota Për, miratohet pa vërejtje apo plotësim ndryshime Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës mbajtur më 31 korrik 2023

2. **Propozim vendimi për formimin e komisionit ad-hoc për hartimin e Draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024**

z.Hilmi Hoxha, **Kryesues i Kuvendit**, në cilësinë edhe të propozuesit të kësaj pike, theksoi, siç e dini në fund të çdo viti bëhet Plani i punës së Kuvendit për vitin e ardhshëm, kështu që edhe këtë vit planin e punës së Kuvendit duhet ta bëjmë që të jemi në kohë për miratim para vitit të ri dhe kështu që vitin e ardhshëm ta fillojmë me planin e ri të punës së Kuvendit. Kjo është një praktikë që është kanë gjithherë, mirëpo nganjëherë planet s'mund t'i bëjmë për një vit se është një periudhë pak e gjatë, mirëpo kjo është për shkak që po ndodhin ndryshime dhe rrethana të reja që po krijohen edhe shumë herë po kemi kritika që s'po mund t'i përmbahemi planit të punës. Kemi paraparë sikurse praktikave të mëparshme që të përfshihen të gjitha subjektet politike me nga një anëtar, edhe 3 anëtarë të jenë nga Ekzekutivi i Komunës për shkak se ne Planin e punës duhet ta përgatitim bashkërisht me Ekzekutivin ngase ata janë që sjellin pikat në Kuvend.
z.Haki Rudari, theksoi, natyrisht që programi i punës së Kuvendit është i rregulluar edhe me një Rregullore ku neni 87 paragrafi 1, po citoj: Kuvendi miraton programin e punës për vitin përkatës fiskal, në këtë rast për vitin 2024, pastaj paragrafi 3 thuhet: Programi i punës i Kuvendit miratohet mbi bazën e propozimit të programit të punës së Kryetarit të Komunës, përkatësisht Drejtorive të administratës publike duke u mbështetur edhe në propozimet e trupave të Kuvendit, grupeve të këshilltarëve, grupe të veçantë të interesit, të OJQ-ve dhe subjekte tjera të tjera.
Prandaj, ky Plan i punës natyrisht që duhet të miratohet, është në interes të përgjithshëm dhe në bazë të këtij plani të punës, po ashtu i kemi pastaj mbledhjet dhe seancat në vitin fiskal ose vitin e ardhshëm. Mandej kemi neni 88 paragrafi 1 ku thuhet, pas miratimit të programit të punës, Kuvendi e përcakton kalendarin e mbajtjes së mbledhje për vitin përkatës fiskal, paragrafi 2 i të njëjtit nen, datat e caktuara për mbajtjen e mbledhjeve mund të lëvizin më së shumti shtatë ditë pune, do të thotë, me Rregullore duhet të përcaktohen datat e mbajtjes së seancave, por ato mund të lëvizin shtatë ditë pune. Prandaj, është mirë ai komision që do të formohet t'i ketë parasysh edhe këto dhe në momentin që i kanë mbledhjet, takimet, e tjera, të përcaktojnë edhe një datë dhe lëvizja e lejon Rregullorja që mund të ketë një lëvizje prej 7 ditë pune, ndërsa sa i përket propozimeve besoj që pas debatit ne do të dalim propozimet në emër të Grupit të LVV-së.

z.Valon Demolli, theksoi, nga Grupi i LDK-së i propozoj z.Arjant Topanicën.
z.Florent Hasani, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e propozoj z.Fitim Muçollin.
z.Bashkim Syla, theksoi, në emër të Grupit të PDK-së në këtë Komision e propozoj znj.Mimoza Abdullahun.
z.Burim Hasani, theksoi, Nga radhët e AAK-së propozoj z.Arbnor Fazliun.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, Komisioni është paraparë të përbëhet prej 9 anëtarëve, deri tani u propozuan 4 anëtar, ne kemi lanë vend edhe për anëtarin nga radhët e Ballit Kombëtar Demokratik, por përfaqësuesi i këtij subjekti nuk është sot prezent në mbledhje, si dhe 3 anëtar nga Ekzekutivi.
z.Valon Demolli, theksoi, nëse më lejohet atëherë unë propozoj z.Gazmend Islamin që të jetë pjesë e këtij komisioni.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pra tani jemi 6 anëtarë nga Kuvendi, kërkohen edhe 3 anëtarë që të propozohen nga radhët e Ekzekutivit.
z.Vigan Salihu, drejtor i DPZHE, theksoi, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës, propozohen z.Fatlum Osmani, znj.Lirie Hoti dhe z.Leutrim Krasniqi.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pra tani kemi propozimet e 9 anëtarëve të Komisionit dhe mund të vazhdojmë.
z.Naim Çunaku, theksoi, një prej obligimeve që e ka Kuvendi sigurisht që është edhe formimi, gjegjësisht hartimi i Planit të punës për punën e tij dhe nga ajo që kemi parë në këto 2 vite, kemi parë që ne e bëjmë një plan sa për të thënë që kemi plan dhe ai plan e dini kur kemi pasë Raportin e planit të punës nuk është që i është përmbajtur dikush atij plani, për mos me thënë hiç, as 30% e atij plani s'është përmbushur, çështje të cilën e kemi debatuar dhe nuk dua ta përsërisë asgjë, mirëpo më bëri të marrë fjalën një praktikë që nuk di në cilat praktika është thirrur dhe të bësh planin e punës dhe pjesë e planit të punës të jenë anëtarë të Ekzekutivit, vërtetë për mua është e pakuptueshme sepse nuk mundet Ekzekutivi të hartojë Plan të punës për Kuvendin, sipas ligjit, por edhe sipas demokracisë, këto dy funksione janë të ndara dhe roli i Kuvendit është në përfaqësim, monitorim, në llogaridhënie që kërkon nga Ekzekutivi.
Për të mos u parë që Kuvendi s'mund ta përjashton Ekzekutivin, larg asaj dhe nuk desha ta potencoja që Kuvendi e përjashtonte Ekzekutivin sepse fundja Kuvendi është ai që kërkon llogari nga Ekzekutivi, mirëpo jo Ekzekutivi të përcakton agjendën e Kuvendit. Në bazë të ligjit në fuqi, ligjet pozitive, decidivisht në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, rendi i punës i një seance bëhet prej Kuvendit në bashkëpunim me Kryetarin, por jo që pjesë e Planit të punës të jenë personat që bartin funksione Ekzekutive, dhe për mua kjo është e pakuptimtë.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar Kryesues, kjo është një hajgare, nëse ma thua ti që komisioni që e ka bërë Planin e punës të Kuvendit për një vit, nëse ju ke përmbajtur vetëm njëherë, unë e votoj këtë, përndryshe nuk e votoj. Tregom ti para një viti që është bërë Plani i punës i cili është miratuar, çka ka pasë në program për sot apo për muajin tetor, cilat pika kanë qenë dhe a është sjellë ndonjë sot, pastaj ka qenë që të raportoj Kryetari i Komunës dy herë në vit, nuk është, pastaj ke pasë që çdo drejtor të jap informatë, asnjë nuk është bërë përveç drejtorit të Arsimit dhe drejtoreshës së Shëndetësisë, asnjë nuk e kemi parë këtu që kanë dhënë ndonjë raport të punës, as ndonjë informatë tjetër, askush gjë, prandaj nuk e di përse po e bënë këtë komision, nëse është veç obligim ligjor mund ta bëni në zyrë e jo ta na shtini neve këtu të votojmë gjëra pa lidhje.
Nëse veç po dëshiron t'i bësh votat, ne mund ta votojmë dhe ia bëjmë sikur në "Kinë si Mao ce-tungu". Pra nuk e di përse të nevojitet ty Kryesues kjo punë kështu, prandaj e them që mos sjellë këtu gjëra hajgare por bëhu serioz, atë plan që e miratojmë na e tregon këtu para nesh dhe bënë raport çka kemi për çdo muaj, cilat pika janë dhe i përmbahesh ati plani, përndryshe lëshoje atë vend bre burrë, mos e mbaj më hiç, pse po rri "si kukull" aty.

Kryesuesi i Kuvendit, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, faleminderit për kritika, por ato kritika nuk janë me vend sepse kjo praktikë ka qenë gjithë në bashkëpunim me Ekzekutivin i cili i sjellë pikat në Kuvend. Ne nuk mund të obligojmë askënd, ata e kanë rendin dhe planin e tyre dhe i fusin në Plan të Kuvendit, pastaj në qoftë se e shohin të arsyeshme raportojnë dhe sjellin informata në Kuvend, nëse jo nuk i sjellin në Kuvend.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nëse asnjë prej atyre që i ceka nuk janë të vërteta, urdhëro e shikojmë planin e punës se çfarë është paraparë për sot dhe çfarë kemi në rend të ditës sot, unë e lëshoj seancën.
Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolësit, theksoi, mund ta lëshosh seancën kur të duash dhe në këtë nuk të pengon askush. Pra kush është që të votohet ky komision.
z.Naim Çunaku, theksoi, unë u thirra në ligj....
Kryesuesi i Kuvendit, duke i'u përgjigj parafolësit, theksoi, ti përmende ligj por asnjë nen as normë nuk e ceke ku e ndalon apo ku e rregullon, andaj sërish të kërkoj ta prezantosh at ligj që e ndalon bashkëpunimin e Kuvendit me Ekzekutivin në këtë rast.
z.Naim Çunaku, vazhdoi, theksoi, mund të marrim një pauzë të shkurtër dhe shkojmë e analizojmë ligjin dhe ta citoj Rregulloren dhe ligjin, mirëpo i nderuar Kryesues, kur të kesh diskutim, mos e keqpërdor atë karrige të kryesuesit, por dil në foltore edhe diskuto si këshilltar.
Nuk është i jua plani i punës, por është Plan i Kuvendit.
Çështja tjetër, meqë po dëshiron që thirremi në ligje, shikoje bazën ligjore mbi të cilën po e themelon këtë Komision, je thirr në shumë nene, e nuk je thirr në nenin që taksativ e numëron që Kuvendi duhet me pasë Planin e punës.
Dhe për të plotësuar atë që e tha kolegu z.Ekrem Rrahmani, duhet të ndiesh keqardhje dhe atë jo vetëm ti Kryesues por të gjithë që jemi këtu ku asnjë pikë e planit nuk është sjellë në Kuvend, sepse duhet ta dimë pse jemi këtu, ku është raporti financiar nëntëmujor kur jemi në dijeni që pas periudhës tremujore më së larti duhet të sjellët, ligji e thotë kështu, më së larti një muaji ditë duhet të jetë raporti në rend të ditës dhe në plan punës ne e kemi pas që sot ta trajtojmë raportin financiar për periudhën nëntëmujore. Kjo metodë që ti po thirresh në vazhdën e asaj 20 vjeçare, po mundtë thuash ashtu, por e vërteta qëndron ndryshe. Nuk ke asnjëherë që është themeluar Komision miks Ekzekutiv - Kuvend, as edhe një herë.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedhim në votim Komisionin sipas propozim vendimit përkatës dhe anëtarëve të propozuar paraprakisht (Arjant Topanica, Fitim Muçolli, Mimoza Avdullahu, Arbnor Fazliu, Gazmend Islami, Fatlum Osmani, Lirije Hoti dhe Leutrim Krasniqi).

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 24 vota Për, 2 vota Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, miratohet propozim vendimi për formimin e komisionit ad-hoc për hartimin e Draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024, sipas propozim vendimit përkatës dhe anëtarëve të propozuar, si në vijim:
-Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, Kryesues
-Arjant Topanica, anëtar nga radhët e Kuvendit
-Fitim Muçolli, anëtar nga radhët e Kuvendit
-Mimoza Abdullahu, anëtar nga radhët e Kuvendit
-Arbnor Fazliu, anëtar nga radhët e Kuvendit
-Gazmend Islami, anëtar nga radhët e Kuvendit
-Fatlum Osmani, anëtar nga radhët e Ekzekutivit
-Lirie Hoti, anëtar nga radhët e Ekzekutivit
-Leutrim Krasniqi, anëtar nga radhët e Ekzekutivit

Kryesuesi i Kuvendit, i drejtohet z.Ekrem Rrahmanit, nuk e di për çfarë kërkon fjalën kur deri tani diskutuam dhe u hodh në votim dhe u votua ky propozim, ti votove kundër atëherë për çka dëshiron fjalën kur përfundoj kjo pikë.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, për keqardhje që votuan. Po ardhur komisioni dhe të jap vlerësimin se çka ka bërë dhe a i është përmbajtur planit të punës për 1 vit të tërë, qysh këta e votojnë sërish. A e din ndonjëri prej anëtarëve të komisionit se a është përmbushur apo jo Plani i punës, apo nuk e kanë lexuar fare.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, a e kanë lexuar apo jo ne nuk mund t'ia dedikojmë sepse secili individ është i pavarur, mirëpo kanë marrë votat e qytetarëve dhe janë këtu ku janë dhe përfaqësojnë dikë secili prej tyre.
z.Ekrem Rrahmani, duke i'u drejtuar Kryesuesit të Kuvendit, theksoi, e ke bërë Kuvendin e Komunës sikur të jetë "Kuvendi i katundit"
Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolësit, theksoi, Kuvendin e përbëjmë ne dhe qysh jemi ne është edhe Kuvendi komunal.

3. Propozim vendimi për vënien në konsultim publik Draft Planin Lokal i Veprimit për Barazi dhe Diskriminim në Komunën e Podujevës për periudhën 2023-2026

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kjo pikë e rendit të ditës ka të bëjë me vënien në diskutim publik të këtij draft Plani, andaj urdhëroni fjalën hyrëse për këtë do të jap Drejtoresha e DA.
z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues unë i pari kërkova fjalën dhe nuk je ti ai që përcakton që fjalën t'ia japësh dikujt pasi unë e ngrita dorën i pari.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, jemi në hyrje të një pike të rendit të ditës që është sjellë nga Ekzekutivi i Komunës dhe për këtë duhet të paraqet fjalën nga Ekzekutivi, në këtë rast nga Drejtoresha e Administratës, pastaj hapet debati.
z.Naim Çunaku, theksoi, ku e sheh ti (i drejtohet Kryesuesit) atë që duhet drejtoresha së pari të merr fjalën.
znj.Xhevrie Zeqiri, theksoi, duke qenë se pika e tretë e rendit të ditës është propozim vendimi për vënien në diskutim të draft planit lokal të veprimit për barazi dhe diskriminim në Komunën e Podujevës për periudhën 2023-2026, në emër të Ekzekutivit propozoj që ky propozim vendim për vënir në diskutim publik të këtij drafti të realizohet për një kohëzgjatje, duke qenë se kohëzgjatja për diskutim publik është 30 ditë, prej datës 06.11.2023 deri me datën 06.12.2023 dhe brenda kësaj periudhe propozoj që debati publik më qytetar të mbahet më 15.11.2023 nga ora 11:00.
Draft planin lokal të veprimit për barazi dhe diskriminim në Komunën e Podujevës për periudhën 2023-2026 besoj e keni marrë me kohë, keni pasur kohë ta shqyrtoni dhe analizoni, andaj uroj që të votohet dhe t'i jepet drita e gjelbër për të vazhduar tutje.
z.Naim Çunaku, theksoi, do të doja që në këtë seancë të paktën të ishte prezent edhe Kryetari i Komunës dhe atë për një arsye ngase në një nga seancat në këtë Kuvend që ka qenë e jashtëzakonshme sa më kujtohet e që për momentin nuk më kujtohet cila ka qenë, në foltore i është thënë propozuesit të seancës duke i'u drejtuar, të paktën a ka dikush në atë mesin e juaj ndonjë gjuhëtarë që të paktën din të bëjë një formulim të drejtë të një pike të rendit të ditës. Prandaj sot do të doja që vetëm t'ia lexoj, ose të citoj propozimin që e kemi si pikë e rendit të ditës dhe po mundohem takstativisht t'ju orientoj sytë kah monitori dhe të lexojë njëherë pikën e pastaj të

shikojmë a do të ishte dashtë këtu të jetë dikush që të paktën ta bëjë një formulim strukturor që tregon drejt atë çka ka propozuar.
Po e citoj këtë fjalë për fjalë nga monitori. Sot kemi; propozim vendimi për vënie në konsultim publik të draft planit lokal i veprimit (draft planit lokal i veprimit...) për barazi dhe diskriminim, pra edhe barazi edhe diskriminim. dhe kështu nuk kisha dashtë si ky propozim të kalojë këso fare sepse është për keqardhje, andaj të formulohet ndryshe në rend të parë si formulim dhe pastaj ta hedhim në votim dhe të marrim vendim për dëgjim publik.
znj.Sebastina Vokrri, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim draft-planin lokal të veprimit për barazi dhe diskriminim në Komunën e Podujevës për periudhën 2023-2026.
znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së, ne parimisht e përkrahim propozim vendimin për vënien në diskutim publik të draft planit për barazi dhe mos diskriminim për periudhën 2023-2026. Fillimisht kam një kritikë ngase konsiderojmë që ky plan nuk ka ardhur me kohë në Kuvend, për arsye se po votojmë fillimisht për vitin 2023 e që pothuajse ky vit ka edhe dy muaj që bie se ka përfunduar.
Çështja tjetër, kërkoj që të ketë kujdes të veçantë në terminologjinë e përdorur në këtë plan për arsye që në këtë draft mbi 3-4 herë përmenden trajnime mbi higjienën personale të komunitetit RAE, andaj konsideroj se vetë Komuna në start po diskriminon dhe po i fyen.
Vërejtjet dhe rekomandimet tona tjera do t'i japim gjatë fazës në diskutim publik.
z.Naim Çunaku, theksoi, nga ajo që e dëgjuam në emër të Grupit të LDK-së ishte një formulim tjetër që LDK e përkrahë, jo ai që e lexova unë. Pra znj.Donjetë Sheqiri e përmendi, përkatësisht e futi edhe një fjalë në mes fjalës që ishte, ...për barazi dhe mos diskriminim, kurse në propozim fjala mos diskriminim nuk është, por është fjala diskriminim, prandaj zonja Sheqiri propozoi që të shtohet fjala mos diskriminim, përndryshe në këtë formë që është, edhe nëse Grupi i LDK-së e voton, unë nuk mund ta votoj. Propozimi është që t'i shtohet fjala ....dhe mos diskriminim, sepse është keq formulim.
z.Donjetë Sheqiri, theksoi, i nderuar Kryesues, ne parimisht kemi konsideruar si gabim teknik që është bërë dhe se nuk mund të votohet kështu, andaj konsiderojmë që duhet gjithsesi të kaloj me ndryshim, konkretisht të jetë, ...barazi dhe mos diskriminim.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, faleminderit zonja Donjetë, mirëpo unë nuk e kam bërë këtë pikë të rendit të ditës. Pra edhe njëherë i'a japim fjalën Drejtoreshës së DA që të jep arsyetime.
znj.Xhevrie Zeqiri, drejtoresh e DA, theksoi, ky draft plan ka ardhë prej Njësisë për barazi gjinore që është në kuadër të Komunës së Podujevës. Të gjitha këto vërejtje që i keni besoj mund t'i paraqitni në diskutim publik e që besoj se çdo vërejtje dhe korrigjim do të realizohet gjatë mbajtjes së debatit me qytetarët përkatësisht gjatë periudhës një mujore të diskutimit publik.
Unë ndoshta nuk jam kompetente të flas për këtë draft plan, për shkak se nuk e kam krijuar unë, por në bazë të asaj që po e shoh unë, ndoshta edhe jam gabim, draft plani lokal i veprimit për barazi dhe diskriminim, po besoj që termi diskriminim do të trajtohet, nuk do të thotë që do të diskriminohet ndokush. Do të thotë, termi si term, diskriminim, do të trajtohet në atë draft plan edhe normalisht që brenda tij ka me u përmend që nuk duhet të ketë diskriminim, andaj nuk e di sa isha e qartë, pra nuk besoj që ka nevojë të ceket si term, mos diskriminim, sepse krejt e dimë që nuk duhet të ketë diskriminim, por është thjesht si term. Përndryshe të gjitha këto mund të diskutohen gjatë diskutimeve publike, madje unë e di që ka pozita të punës me titullin, zyrtar për mbrojtje ndaj diskriminimit, por nuk ka tituj zyrtar për mbrojtje ndaj mos diskriminimit.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, Kryesuesi i'u referua kësaj duke thënë kështu e kanë sjellë, mirëpo unë i them Kryesuesit që a ka ndonjë obligim që mos me lexu asnjë pikë e as material që vie apo çka, por çka ti sjellin ty ti pastaj i sjell në Kuvend. Pastaj Kryesues, a po të vie zor me hedh në votim dhe të ndërrohet ajo fjalë. Tani nuk po e di a po votojmë draft plan për diskriminim a për barazi, ose hiqeni njërën, ose shkruaje mos diskriminim, të dimë çka po votojmë ne këtu, të mos dalim qesharak.
z.Ragip Fetahu, theksoi, mendoj se kolegët kanë të drejtë për këtë formulim, sepse formulimi i saj është jo i duhur, formulimi i titullit është jo i duhur për shkak se me të vërtetë barazi dhe diskriminim të dyja në të njëjtën vend nuk shkojnë. Po ashtu Mendoj që është mirë që kjo rregullore të mos kalojë në diskutim publik por të kthehet tek formuluesit dhe ata të cilët e kanë bërë këtë, ta korrigjojnë, ta përmirësojnë dhe ta sjellin në Kuvend në formën ashtu si duhet.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ne sot e kemi për ta votuar që ky dokument të dalë në diskutim publik, pastaj në diskutim publik mund të ketë ndryshime, pra gjatë diskutimit publik këto çështje mund të ndryshohen, qoftë edhe termi diskriminim me ternim mos diskriminim.
z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues, propozimin tim duhet ta hedhësh votim.
z.Bashkim Syla, theksoi, i nderuar Kryesues, kemi një propozim që t'i shtohet këtij ë titulli fjala mos diskriminim, kështu që ti Kryesues zbatoj procedurat, e hedh në votim propozimin e z.Naimi Çunakut, pastaj propozimin e drejtoreshës, dhe cila kalon, kalon.
z.Naim Çunaku, theksoi, të jemi më të kjartë, në mes fjalës barazi dhe diskriminim, para fjalës diskriminim të shtohet jo diskriminim ose mos diskriminim, propozimi im ishte ky.
Ndërsa rreth dilemës që u shfaq rreth asaj a kemi drejt ne apo jo, pyes kush është vendimmarrësi këtu, ne jemi vendimmarrës, ne kemi të drejtë edhe ta ndryshojmë, edhe ta votojmë, edhe ta shtyjmë, edhe mos ta votojmë, dhe s'ka dilema këtu, nuk është Bibël as Kuran as Talmud, mos ndryshimi i këtij propozimi, sepse ne vendosim për këtë.
z.Pajtim Balaj, drejtor i DKRS, theksoi, më falni që po ndërhyj sepse nuk është temë e imja dhe nuk është që e di përmbajtjen saktë të këtij draft plani, mirëpo edhe barazia edhe diskriminimi si tema mund të jenë të ndryshme. Nuk e di qysh e kanë trajtuar, por nëse i kanë trajtuar si të ndryshme, është e shkruar drejtë, por nëse e kanë menduar në kuptimin që po e thotë z.Naim Çunaku unë i jap të drejtë zotëri Naimit, mirëpo mendoj se e gjithë kjo mund të sqarohet në diskutim publik, madje jo vetëm në debat publik që të obligohen anëtarët e Kuvendit me ardh, por nëse është bërë gabim, Ekzekutivi, Drejtoria përkatëse duhet të adresoj si çështje tek ata që e kanë hartuar planin dhe të korrigjohet, përndryshe nuk mendoj që duhet të kthehet mbrapa ashtu siç u propozua nga dikush prej parafolësve sepse vetëm humbet 1 muaj sepse sërish sjellët pas një muaji për ta vënë në diskutim publik dhe pastaj shkojnë 3 muaj për këtë dokument.
znj.Edona Shabani, theksoi, unë dua t'i them drejtorit parafolës se më mirë ndoshta është t'i humbin 3 muaj dhe të mos kemi më probleme të tilla, se sa ta lëmë kështu. Ne nuk i dimë mendimet e atyre që e kanë hartuar dhe nuk e dimë çka kanë menduar, mirëpo ne po flasim vetëm për aq sa po shohim. Për mendimin tim është gabim, dhe nuk e shoh si diçka që mos ta ndryshojmë për çka besoj dhe shpresoj të ndryshohet.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë e hedh në votim propozimin që termi barazi dhe diskriminim të formulohet barazi dhe mos diskriminim, ashtu siç e potencoj z.Naim Çunaku.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 15 vota Për, asnjë votë Kundër, 1 votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan) mbështetet propozimi i z.Naim Çunakut për ri formulimin e tekstit të draft planit, konkretisht para fjalës Diskriminim të shtohet Mos Diskriminim.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, tani e hedhim në votim këtë pikë të rendit përfshirë ndryshimin e fomrulimit i cili kaloj paraprakisht.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 16 vota Për, asnjë votë Kundër, 2 vota të Përmbajtura (të tjerët nuk votuan) miratohet propozim vendimi për vënien në konsultim publik Draft Planin Lokal i Veprimit për Barazi dhe mos Diskriminim në Komunën e Podujevës për periudhën 2023-2026, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, propozimeve të Drejtoreshës së Drejtorisë së Administratës rreth kohëzgjatjes dhe konsultimit publik, si dhe ndryshmit plotësimit përkatës të përkrahur paraprakisht.

4. Marrja e vendimit për lirim nga taksa për mamografi

z.Hilmi Hoxha, **Kryesues i Kuvendit**, theksoi, sigurisht keni parë konstatimet e rekomanduara nga KPF ku kjo pikë e rendit të ditës është hyrë si pikë shtesë me propozim të anëtares së Kuvendit znj.Drita Pajaziti, andaj fillimisht i'a japim fjalën për ta paraqitur këtë propozim.
znj.Drita Pajaziti, në cilësinë e propozueses e paraqiti këtë pikë, theksoi, jemi në fund muajit tetor që është muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, ndërgjegjësim ky që duhet të dikonte në zvogëlimin e rasteve apo shërimin e tyre, qoftë edhe një numër më pak apo më shumë të shëruar, kur dihet pasoja që sjell diagnostikimi i vonuar i kësaj sëmundje.
Fakti se numri i të prekurve nga kanceri i gjirit po rritet për çdo vit është mjaft shqetësuese, por është edhe një sinjal se ne duhet të bëjmë akoma më shumë për të sensibilizuar gratë dhe vajzat për masat që duhet marrë paraprakisht, qoftë për të parandaluar apo qoftë edhe për të shëruar, e cila nuk është e pamundur nëse kjo sëmundje do të identifikohet me kohë dhe do të merren masat preventive për pacientë. Pra, jemi dëshmitarë që çdo ditë nëpër familjet tona kjo sëmundje përfundon si vdekjeprurëse, në të shumtën e rasteve si rezultat i zbulimit të vonshëm, qoftë nga mos informimi, qoftë edhe nga mosdija e qoftë edhe dikush nga pamundësia e kushteve materiale, duke anashkaluar kontrollat e vazhdueshme, të cilat mund të ngadalësojnë zhvillimin e sëmundjes e shumë herë edhe parandalimin e saj. Pra kanceri mund të jetë gjithmonë i parandalueshëm, mirëpo gjithmonë mund të zbulohet që në faza të hershëm, kjo rritë shanset të shërohen plotësisht dhe shpejt. Mamografia është mënyra më efikase për të zbuluar kancerin e gjirit qysh në fazat e ardhshme. Komuna e Podujevës tash e tri vite mundëson gjatë muajit tetor mamografi falas për gratë dhe vajzat duke ua dhënë këtë mundësi gjatë muajit tetor të rritë vetëdijesimit të gratë dhe vajzat, por edhe te burrat, ngase ky kancer prek edhe burrat, dhe më lejoni të theksoj që rasti i fundit te burrat është në Komunën e Gjilanit, që është diagnostikuar në këtë sëmundje, por a mjafton vetëm një muaj për me rritë vetëdijesimin për parandalimin e kësaj sëmundje, a duhet t'i lëmë 11 muaj kohë që kanceri të zhvillohet në trupat tanë të familje familjarëve tanë kur shërbimi për mamografi nuk paraqet ndonjë ngarkesë për buxhetin e Komunës, e që mund të jetë parandaluese për pasojat që sjell kjo sëmundje. Shumë qytetarë mund edhe të mos dinë se shërbimi për mamografi nuk kushton edhe aq, por ka edhe të tjerë që mund të mos ta kenë aq shumë simbolike.
Të dashur kolege dhe kolegë, unë sot duke kërkuar përkrahjen e gjithë juve, propozoj Kuvendit që shërbimi i mamografisë në Komunën tonë të jetë si shërbim falas për qytetarët tanë.
Janë disa kauza që shkojnë përtej politikave ditore e lufta kundër kancerit e të gjirit është një kauzë e tillë, e cila duhet të na bashkoj të gjithëve pa dallim.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, nuk dëshiroj të zgjas më shumë për këtë temë për arsye se nuk dëshirojmë ta politizojmë ashtu siç e potencoj edhe iniciatorja e kësaj pike.
Ne në emër të Grupit të LDK-së e përkrahim parimisht këtë vendim. Besoj që propozuesja e këtij vendimi është e konsultuar me Drejtoritë përkatëse dhe kjo kërkesë është e koordinuar me Rregulloret që janë, sidomos në Rregulloren për taksa tarifa dhe gjoba komunale, përndryshe ne e përkrahim këtë vendim dhe nuk dëshiroj të zgjas më shumë.
znj.Adelinë Stublla, drejtoresh e DSHMS, theksoi, çdo iniciativë që ka synim shëndetin dhe mirëqenien e qytetarit, ka pasë, ka dhe do ta ketë përkrahjen time, ngase unë mendoj dhe veproj në radhë të parë si qytetare e thjeshtë e këtij vendi, profesioniste disavjeçare shëndetësore e tashmë edhe si drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e aq më pak si aktiviste partiake. Sigurisht, edhe kjo iniciativë e ka përkrahjen time, por jo duke menduar se është hapi kryesor në arritjen e objektivit për çka mund të mendohet, sepse lirimi nga participimi për mamografi mund të ketë reflektim minor në arritjen e synimit të caktuar, ngase bëhet fjalë për një pagesë 2 €, kurse pasë parasysh listën e bashkë pagesave për shërbime shëndetësore dhe kategoritë e liruara sipas ligjit që i bie që janë shumë pak ata ose ato që participojnë. Thelbi i arritjes së objektivit në luftë kundër kancerit të gjirit është edukimi dhe sensibilizimi në forma të ndryshme i qytetarëve, edukimi dhe përkushtimi i stafit shëndetësor, komunikimi i mirë personel pacient në çdo vizitë, shfrytëzimi i çdo vizite mjekësore, për të krijuar kushte diagnostike e që mendojmë se si qeverisje lokale kemi bërë shumë e më shumë sesa vitet e kaluara dhe shumë e më shumë sesa komunat e tjera dhe jemi në rrugë të mbarë të fuqizimit të luftës, jo vetëm kundër kancerit të gjirit, por edhe shumë problematikave të tjera që kanë kosto për qytetarët, dhe jo vetëm atë kjo mund të kuptohet nga shifrat në vazhdim dhe veprimet tona në qasje të ndryshme në politikat shëndetësore dhe praktikave menaxhuese.
Ju sqaroj se mamografi sot është i njëjti që ishte para shtatë-tetë viteve, përveç që është më i amortizuar, stafi shëndetësor po ashtu është i njëjti në numër por vetëm se këta janë më të moshuar, radiologu është i njëjti, vetëm se është më i moshuar. Për informacionin tuaj dhe qytetarëve, përkatësisht përjashto këto dy vite, mamografia ishte jashtë funksionit, por u funksionalizuar pa shpenzuar asnjë centë në maj të vitit 2021 dhe filloi mamografia për ta për të vazhduar deri më sot e tutje pa asnjë ditë pushim. Për pak më shumë se dy vite u kryen 949 mamografi, apo ndarë në vite këto shifra, në vitin 2021 pas asaj pauze, janë realizuar 287 mamografi, ku punohej tri ditë në javë, me një protokoll të pa përshkruar, me pesë pacientë në ditë. Në vitin 2022, u realizuan 281 mamografi, po me atë pa protokoll, kurse në vitin 2023 deri më sot janë realizuar 331 mamografi, pra vetëm në këtë dhjetëmujor, vetëm në muajin tetor 2023 janë bërë 121 mamografi, dhe për informacion këtë vit me një teknike mamografie, sepse njëra ndodhet në pushim të lehonisë dhe sipas parashikimeve, numri i realizuar i mamografive deri në fund të vitit do të jetë jo më i vogël se 600 mamografi.
Mamografia ishte pa pagesë në muajt tetor të viteve 2021, 2022 ashtu siç është edhe në këtë tetor të këtij viti e që kur kësaj i shtohen edhe shifrat në rritje del se më tepër se pagesa kanë rëndësi faktorët e cekur më lart. Thënë shkurt dhe butë në vitin 2021 janë bërë 287 mamografi, kurse në vitin 2023, deri më tani 381 mamografi, kurse në vitin 2020 është zero mamografi, andaj ky ndryshim është krahasimi dhe është performanca e politikave shëndetësore menaxhuese, performancë kjo dhe në çdo shërbim tjetër.
Pavarësisht nga ky elaborim, jam për iniciativën e propozuar.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, tani po besoj që ose Drejtori i DBF-së e që nuk është prezent apo ndokush nga tjetër nëse është prezent do të ishte mirë të japin përgjigje a është në përputhje kjo çështje, do të thotë a ndikon ose a duhet pastaj të ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja për taksa tarifa dhe gjoba komunale. Pra a mundet të na jap një përgjigje ndokush a është në harmoni të plotë kjo, e jo të ndodh që sot ta votojmë dhe pastaj të merremi sërish me plotësim ndryshim të Rregullores, por që në njërën anë t'ju thuhet grave se e kemi votuar dhe jeni të liruara nga pagesa, ndërsa në anën tjetër t'ju merren paratë deri në ndryshim plotësim të Rregullores, andaj kur ta votojmë ta bëjmë ashtu siç duhet.
znj.Drita Pajaziti, theksoi, në Rregulloren për taksa tarifa dhe gjoba komunale specifikohet shërbimi i memografisë fare. Po ashtu edhe në Udhëzim Administrativ përkatës sipas të cilit parashihen taksat dhe tarifat, nuk specifikohet memografia si shërbim e as si tarifë.
znj.Adelinë Stublla, drejtoresh e DSHMS, theksoi, iniciuesja e kësaj pike të rendit të ditës e shpjegoj, por është problematika e çështjes së Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale si dhe në Udhëzimin Administrativ përkatës nuk specifikohet çështja e pagesës së mamografisë, meqenëse mamografia është shërbim që i takon mjekësisë sekondare, kurse ne si QKMF kryejmë shërbime primare, kështu që duhet të parashihet me ligj dhe me rregullore ashtu siç e ceku edhe asambleistja nga radhët e LDK-së, kështu që gjithçka çka ndërmarrim duhet ta dimë se çka po votohet, në këtë rast ju si të zgjedhur dhe si përfaqësues të popullit, në mënyrë që pastaj të mos ndodh të kthehet e paligjshme nga Ministria, e që pastaj sigurisht që dalim keq në përgjithësi, pavarësisht subjekteve politike, por mbi të gjitha e kemi parim shëndetin, sidomos për këtë kategori, kështu që çdo gjë që merret si vendim, ta merremi bashkërisht dhe njëkohësisht t'i referohemi ligjit, meqenëse duhet të specifikohet në mënyrë që të mos të kthehet e paligjshme.
znj.Drita Pajaziti, theksoi, i nderuar Kryesues, më lejoni të theksoj se këtë praktikë të mamografisë si shërbim falas nuk e ka vetëm Komuna e Podujevës si inicim, realisht e ka iniciuar edhe Kryetari i Prishtinës, pastaj si shërbim falas e ka edhe Komuna e Prizrenit, Komuna e Mitrovicës së Jugut, tani së fundmi edhe Mitrovica e Veriut, andaj besoj që përderisa këtyre Komunave i'u është aprovuar që nuk ka ndonjë shkelje ligjore. Është një gjest human dhe po besoj që janë të pajtimit të gjithë.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, unë mendoj se kjo çështje kalon pothuajse në kompetenca të nivelit më të lartë se sa që jemi ne, mirëpo propozimin e znj.Drita Pajaziti e hedh në votim që të merret vendim për lirimin nga taksa (nga pagesa e shërbimit shëndetësor) për mamografi.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri, me 25 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent, miratohet propozimi për lirimin e të gjitha femrave të Komunës së Podujevës nga pagesa e shërbimit mjekësor Mamografi që ofrohet në QKMF Podujevë.

5. **Propozim vendimin për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale – "Eko-Llapi" Sh.A në Komunën e Podujevës.**

z.Vigan Salihu, drejtor i DPZHE, në emër të Ekzekutivit të Komunës e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, siç jeni të informuar me datën 12.10.2023 Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë vendim për themelimin e Ndërmarrjes së Publike Lokale "Eko Llapi" Sh.a. e cila veprimtari të ndërmarrjes do t'i ketë mirëmbajtjen e kanalizimit, gjelbërimit, shtretërve të lumenjve, varrezave, parkingjeve publike, dekorimin e hapësirave publike, mirëmbajtjen e objekteve banesore, mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve, pyllëzimin e sipërfaqeve, mirëmbajtjen e ndriçimit dhe Dezinfektimin Deratizimin Dezinsektimin DDD, andaj i propozoj Kuvendit ngritjen e

Komisionit Komunal të aksionarëve, do të thotë 2 anëtarë nga radhët e Kuvendit, pastaj mbetet që Kryetari i Komunës të vendosë për anëtarin e Komisionit nga radhët e Ekzekutivit.
z.Haki Rudari, theksoi, Në emër të Grupit të LVV-së përkrahim propozim vendimin për ngritjen e një Komisioni Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrës Publike "Eko-Llapi" dhe në emër të Grupit po ashtu propozojmë z.Bahri Blakçorin që të jetë pjesë e këtij Komisioni.
z.Valon Demolli, theksoi, në emër të Grupit LDK-së për anëtar në këtë Komision propozoj znj.Donjeta Sheqiri.
z.Arbnor Fazliu, theksoi, në emër të AAK-së e propozojmë z.Burim Hasanin.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron propozime tjera, nëse jo atëherë kemi tri propozime, duhet t'i hedhim fillimisht një nga një, dhe fillojmë me rend ashtu siç u propozuan. 1-z.Bahri Blakçori; 2-znj.Donjetë Sheqiri; 3-z.Burim Hasani.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se 25 vota janë Për që z.Bahri Blakçori të jetë anëtar i Komisionit në fjalë.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se 11 vota janë Për që znj.Donjetë Sheqiri të jetë anëtare e Komisionit në fjalë.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se 17 vota janë Për që z.Burim Hasani të jetë anëtar i Komisionit në fjalë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani kemi 2 anëtarët që morën më shumë vota që të jenë anëtarë në këtë Komision, andaj e hedh në votim propozim vendimin përkatës dhe propozimeve paraprake, konkretisht qwë anëtar në këtë Komision të jenë z.Bahri Blakçori dhe z.Burim Hasani.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 16 vota Për, 3 vota Kundër, asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan) miratohet propozim vendimi për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale – "Eko-Llapi" Sh.A, sipas materialit përkatës të dërguar me konstatimet e rekomanduara nga KPF dhe propozimeve dhe votimeve përkatëse paraprake, në këtë përbërje;
z.Bahri Blakçori, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës
z.Burim Hasani, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës

6. Të Ndryshme

z.Arjant Topanica, theksoi, kërkova fjalën me qëllim të ngritjes së disa shqetësimeve në këtë pikë që është Të Ndryshme, besoj që ka shumë por do të mundohem të jem sa më i shkurtë dhe sa më konkret dhe që ato kërkesa dhe ato shqetësime të merren parasysh pasi që nuk do të ndalemi dhe pas çdo seance do t'i përmendim përsëri derisa të realizohen.
Kërkesë e lokalitetit prej nga vije unë pra fshatit Sfeçel, sërish është për vendosjen e një pengese në rrugën te shkolla për arsye që frekuentimi i nxënësve si dhe kërkesa tjetër po ashtu për arsye të frekuentimit të nxënësve është tek vendkalimi te shkolla ku duhet të vendoset po ashtu një pengesë në rrugë dhe të zgjerohet hapësira e shenjëzuar-vendkalimi në rrugë, kërkesa këto duke u mbështetur edhe në praktikat e shumë vendeve tjera kohëve të fundit e cila gjithashtu është më e përballueshme për veturat të kalojnë mbi të por edhe për shenjëzimin mbi të që shërben edhe si vendkalim për këmbësorë e në këtë rast më të shumtit janë nxënësit e shkollës në fshatin Sfeçel.

Kërkesë tjetër po ashtu është një shenjëzim-tabelë komunikacioni, nuk e di sakt a është kompetencë e Komunës apo e Ministrisë së Infrastrukturës, pra shenjëzimi me një tabelë rrugore në afërsi të shkollës në mënyrë që ngasësit e veturave të jenë në dijeni dhe ta kenë parasysh se po i afrohen një vendbanimi ku ka shkollë dhe ku ka nxënës, e që nuk ekziston një tabelë e tillë në rrugët e fshatit Sfeçel.
Po ashtu te Lagjja Vokrri, para një kohe ka ndodh një aksident nga i cili janë dëmtuar rrethojat e urës dhe tani njëra anë e urës është pa rrethoja - pa mbrojtëse të hekurta, andaj kërkohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit ta vizitoj atë urë dhe të verifikojë këtë dhe t'i vendosë rrethojat sa më shpejt që është e mundur për arsye se është me një rrezikim mjaft të veçantë për veturat që mund të bien në lumë, por edhe për këmbësorët që kalojnë nëpër urë.
Kërkesë tjetër të cilën e diskutova jo formalisht me drejtorin e Drejtorisë përkatëse, është edhe dëmtimi i asfaltit nga Kompani e Ujësjellësit, për çka drejtori më tha se është përgjegjësi e jona që ta përmirësojnë infrastrukturën, mirëpo me barrët financiare të Kompanisë Ujësjellësi, andaj kërkoj që rruga në fshatin Sfeçel tek Lagja Tërholli dhe Merovci, janë disa vende ku është prishur rruga dhe aty grumbullohet uji dhe vazhdimisht gërryhet asfalti dhe po prishet në një masë më të madhe.
Kemi edhe shqetësime për shtratin e lumenjve, e di se me buxhetin e vitit 2023 ka pasë shënim për përmirësim të infrastrukturës së lumenjve mirëpo ende asgjë nuk është punuar në këtë drejtim, ndërsa jemi në dijeni se në fshatin Sfeçel kalon Lumi Dumnica dhe nga vërshimet e fundit janë dëmtuar disa pjesë shtratin e Lumit rreth vendbanimeve, dhe tani me një vërshim të vogël që mund të ndodh në Lum do të përshkohen edhe ato shtëpi përreth, me thek të veçantë është tek Lagja Vokrri sërish sepse është dëmtuar bregu dhe shtrati i Lumit e që po sa të ngritët niveli i ujit, do të vërshohen shtëpitë dhe ekonomitë familjare, andaj mendoj se është mjaft urgjente kjo duke parë trendet e fundit të ndryshimeve atmosferike dhe klimatike si dhe vërshimet me të cilat po përballemi thuajse 3-4 herë gjatë vitit.
Pra kërkoj që të merren parasysh këto kërkesa, përndryshe do të qëndrojmë mbrapa tyre deri në realizim.
znj.Sebastina Vokrri, theksoi, kam dy pyetje, njëra është për Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, si vijon; në vitin 2018 ka qenë kërkesë e banorëve të fshatit Barainë për asfaltimin e rrugës "Behram Bislimi" por që në asnjë periudhë kohore nuk është marrë parasysh, do të thotë ajo rrugë dy herë ka qenë e shtruar me zhavorr edhe e gatshme për asfaltim, mirëpo asnjëherë nuk është asfaltuar. Banorët gjithashtu thonë se janë bërë dy projekte tjera në lagjen aty afër duke u bërë nga pika zero dhe që janë asfaltuar, kurse rruga e cekur është lënë anash, rrugë e cila ka një gjatësi 2 kilometra, rezident janë 8 familje, ndërsa dy vitet e fundit kanë ardhë banorë tjerë dhe janë bërë gjithsej 15 familje, andaj pyetja është se a është në plan buxhetor për vitin 2024 asfaltimi i rr."Behram Bislimi" në fshatin Barainë, nëse jo, atëherë nëse ka mundësi të na jepni sqarim dhe informacione të paktën për qytetarët dhe banorët e atij fshati.
Pyetja tjetër është për Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe ka të bëjë me një kërkesë të banorëve të fshatit Surkish të cilët kanë kërkuar që në rrugën "Xhafer Rrahman Mehmeti" të vendoset një pengesë "polic shtrirë", në mënyrë që të ngadalësohet shpejtësia marramendëse e veturave që frekuentojnë atë rrugë e që si pasojë e kësaj po rrezikohet jeta e banorëve, e sidomos fëmijëve që dalin në rrugë, andaj pyetja është se kur do të mund të vendose një pengesë e tillë në atë rrugë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, tani dihet më që në pikën Të Ndryshme më së shumti kemi punë me drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.
Ka një pyetje që më është drejtuar nga një qytetar për rrugën Murgull – Bellosicë, çka po ndodh me atë rrugë 7 kilometra për të cilën qenkan ndarë nga Ministria përkatëse 60,000.00€, janë dërguar disa mjete (eskavator) e kanë hallakatë dhe e kanë bërë edhe më baltë se që ka qenë dhe kanë shkuar, më nuk kanë ardhur, ndërsa sipas atij qytetari ata kanë participuar me mjete financiare për gypa etj, por që nuk është marrë më askush me këtë punë.
Pyetja tjetër ka të bëjë me ndriçim, konkretisht për rr."Brahë Hertica" ku sipas ankesave që më janë dërguar 12 drita janë të prishura e që tani me ndërrimin e orës fëmijëve – nxënësve i'u bie të udhëtojnë nëpër terr e që paraqet goxha probleme, pra kjo është njëra prej rrugëve me probleme të tilla, mirëpo ne po e shohim edhe në sheshin e qytetit. Unë jam në dijeni se është nënshkruar kontrata për mirëmbajtje të ndriçimit, andaj kërkoj që të intervenohet në ato pjesë ku më shumë ka nevojë sepse po e shohim që dritat janë shumë të dobëta dhe nuk po bëjnë, duke u nis nga Sheshi ku marramendja të kap duke kaluar andej sepse duken si vetëtima si pasoj e defekteve ku ndizen fiken vazhdimisht.
Nevojën për zgjerimin e lumenjve e përmendi edhe kolegu parafolës z.Ariant Topanica, dhe nuk e hapi këtë temë më fare.
znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, kam një pyetje rreth Lagjes së re që është financuar nga Fondacioni Elvis Naçi, E di që ndoshta nuk është kompetencë e Komunës, mirëpo a keni koordinim më KEDS-in se kur kjo Lagje mund të ketë energji elektrike.
Po ashtu kam pyetje për rr."Haxhi Sadrija" në të cilën tani e 1 muaj nuk funksionojnë dritat e ndriçimit publik, andaj a ka mundësi ta dimë kur mund të rregullohet ai problem.
z.Valon Demolli, theksoi, unë i kisha disa pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, dhe drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit, mirëpo ata nuk janë prezent këtu, andaj meqë nuk janë prezent, unë për sot vetëm një pyetje e kam, (meqë komisionin ad-hoc për plan të punës e formuam) a ka mundësi që në seancën e radhës drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit të na vije në seancë me një raport deri ku ka shkuar çështja dhe procedura e rrënimit të Villave afër Liqenit të Batllavës, e që unë mendoj se po bëhen rrënime selektive.
z.Artrit Mulliqi, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, dhe atë, deri ku kanë shkuar procedurat edhe çka është duke ndodhë me rrugën re Repë - Sylevicë, do të thotë, segmenti i parë sepse e dimë që ajo rrugë është shumë e gjatë, mirëpo prej hyrjes së fshatit Repë deri te lagja Rrukectë, pra çka është duke ndodhë, rruga mban emërtimin "Marshi i UÇK" që është në gjatësi rreth 3 km, por segmenti në fjalë është afërsisht 1 km. Sa jam në dijeni edhe në kaluarën një Kompani ka dështuar në këtë rrugë, kështu që pyes çka është duke ndodh sërish e njëjta gjë ngase nuk jemi duke parë që janë duke u bërë punime kur kemi parasysh edhe kohën e cila më nuk na premton sepse veç se kemi hyrë në vjeshtë.
Pyetja e dytë është po ashtu për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, dhe atë, çka është duke ndodhë me kontratën për ndriçim, sepse kemi kërkesa me muaj tërë për disa drita nëpër lagje të ndryshme të qytetit dhe të fshatrave, kurse punime nuk ka.
Pyetja e tretë është për drejtorin e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, çfarë është duke ndodh me stadiumin në fshatin Peran, projekt për të cilin kemi shumë ankesa sepse ende nuk janë duke përfunduar punimet.
Pyetja e katërt, nuk e di cilit drejtor t'i drejtohem, por ka të bëjë me emërimin e rrugëve dhe riemërimin e rrugëve, pra çka është duke ndodhë me këtë proces, sepse kemi shumë ankesa, rrugë

të caktuara janë emërtuar në bazë të dëshirave personale, shpeshherë edhe të pushtetarëve në të kaluarën, kështu që çka është duke ndodhë me ankesat që ju i mbani.
z.Kasib Bashota, theksoi, edhe unë i kam disa pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit drejtuar nga peronat lokal të fshatit Llapashticë, pra disa qytetarë kanë ankesa për rrugën te varrezat Llapashticës së Poshtme, andaj a është e mundshme ta bëni të kalueshme me iu vu një pjesë zhavor në mënyrë që të bëhet e kalueshme më me lehtësi.
Gjithashtu për rrugën "Sejdi Potera" e cila është e ngulfatur dhe e dëmtuar nga mjetet e tonazhit të rëndë gjatë ndërtimit të rrugës "Skënderbeu" ngase kanë kaluar nëpër të shumë mjete të tonazhit të rëndë të cilat e kanë dëmtuar në masë të madhe atë rrugë. Gjithashtu është dëmtuar edhe ndriçimi publik në rreth 18 km gjatësi, andaj kërkoj që brenda mundësive ta rregulloni.
znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, e kam parashtruar edhe njëherë këtë pyetje, por përgjigje shumë të saktë s'është që e kam marrë, andaj banorët e asaj lagjeje po dëshirojnë përgjigje konkrete, pra fjala është për premtimin qe 2-3 vite për asfaltimin e rr."Avdyl Dushkolli" që e lidh fshatrat Llaushë-Dumnicë, në gjatësi rreth 650 metra, dhe është totalisht e përfunduar dhe vetëm asfalti i mungon ngase zhavorri dhe të tjerat janë përfunduar qe disa vite, kështu që banorët e asaj lagje po kërkojnë përgjigje konkrete prej Komunës se kur do të asfaltohet ajo rrugë.
z.Ilir Koprani, theksoi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, duke pas parasysh që magjistralja Podujevë - Prishtinë, sidomos kilometri i 4-të është mjaft me rrezikshmëri të lartë, konkretisht për rreth rrotullimin i cili është afër vendit të quajtur "Qershiat e Llapashticës", a keni ndonjë informacion rreth afatit kohorë se kur do të përfundoj, ngase është edhe kërkesë e bizneseve përreth aty që janë të dëmtuara për një kohë të gjatë, prandaj dëshiroj të dijë se kur do të përfundojë ai rreth rrotullim pasi që e dimë që është stërzgjatur.
z.Ragip Fetahu, theksoi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, janë disa qytetarë nga fshati Metehi të cilët në vazhdimësi më shkruajnë për një numër të madh të gropave që janë bërë në rrugën e tyre, andaj pyetja konkrete është se çka do të bëhet me atë rrugë dhe kur do të fillojë riparimi i saj.
z.Burim Hasani, theksoi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit lidhur me shkollën e fshatit Bradash "Nuhi Gashi"-paralelja e dytë, do të thotë prej parashkollores deri në klasën e IX-të, dhe një numër konsiderueshëm i madh i nxënësve kalojnë çdo ditë afër shkollës dhe aty gjendet një mini-prockë për të cilën është bërë kërkesë që ajo të vendoset në gypa dhe të mbulohet me pjesë të dheut dhe të shndërrohet në hapësirë gjelbëruese, për arsye se çdo ditë nxënësit e ciklit të ulët kalojnë andej dhe sjell shumë parregullsi për ata nxënësit si dhe probleme tjera të cilat nga mbeturinat mblidhen qentë endacak si dhe ka shumë probleme, andaj do të kërkoja që të merret parasysh kjo çështje për atë pjesë aty, që të kalon në gypa dhe të shndërrohet në një hapësirë gjelbëruese. Pra bëhet fjalë për këtë problematikë që është afërsisht 30 metra distancë afër shkollës "Nuhi Gashi" në fshatin Bradash.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nuk pata ndërmend të marrë fjalën mirëpo qytetarët duke ditë se jemi në seancë po më shkruajnë. Drejtori i Drejtorisë së Inspekcionit ka pas ardhë si me vrull ndërsa tani ndoshta e ka lënë krejt dhe i është bërë bajate ajo punë, pyetja apo çështja është, përse po i lejoni shitësit e specave në derë të Çerdhes, në fakt unë nuk i kam parë mirëpo kështu po më shkruajnë dhe ashtu po e parashtroj pyetjen. Fjala është për Çerdhen në Podujevë.
z.Naim Çunaku, theksoi, i janë bërë shumë pyetje drejtori të drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, por edhe mua më është bërë e tepërt sepse është hera e tretë që e shtroj si problem shtrimin e trotuareve, konkretisht në fshatin Bellopojë rr."Qerim Imeri" dhe rr."Nazif Ibishi", për të cilat kamë bërë më shumë se dy herë pyetje se kur do të rregullohen, si dhe a do të ketë ndarje të mjeteve buxhetore për ndërtimin e trotuareve.

Për të qenë më i qartë edhe për të tjerët, ajo është një rrugë e cila frekuentohet për automjetet që kalojnë te Burgu i sigurisë të lartë në fshatin Gërdoc, dhe ajo lagje dihet shumë herë prej tyre vozisin më ndryshe duke mos dashtë të hyjë në specifikat e punës që kanë një Burg i sigurisë të lartë, mirëpo qytetarët e atyre dy rrugëve që frekuentojnë, gjegjësisht edhe nxënësish që shkojnë në shkollën "Ilir Konushevci" në fshatin Llugë kalojnë andej dhe vërtetë është një situatë e rrezikshme për frekuentimin, gjegjësisht për nxënësit udhëtarë prej shtëpisë në shkollë.
Gjithashtu pyetja e dytë ka të bëjë me ndriçimet publike, e që i parashtruan edhe kolegët tjerë, e kuptova që s'ka një kontratë, mirëpo janë mbi 6 muaj që janë ato drita të cilat janë vetëm sa për t'i parë por jo edhe që ndriçojnë diçka, konkretisht po foli në fshatin Llugë.
Sa i përket çështjes së përmendur nga kolegu z.Ekrem Rrahmani për Çerdhen, apo për pengesat që paraqesin shitësit ambulant para Çerdhes, unë vërtetë mendova që z.Ekrem Rrahmani fjalën e ka për Çerdhen në fshatin Lluzhan e që është e njëjta situatë ku ka mbi dy muaj që aty është shndërruar në një mini-treg dhe e kanë të vështirë ata që kanë me marrë shërbime në Çerdhen e fshatit Lluzhan, gjegjësisht që t'i dërgoj dhe t'i marrin fëmijët e tyre nga aty.
znj.Arjeta Salihu, theksoi, kam një pyetje për Drejtoreshën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përkatësisht dua ta dijë e nderuar drejtoresh, qytetarët të cilët janë me diabet dhe janë të obliguar t'i marrin insulinat, a i marrin në afatin kohor të caktuar apo ka ndonjë vonesë, kur jemi në dijeni që duhet t'i marrin në kohë të caktuar insulinat.
z.Xhevdet Maloku, theksoi, një problematikë në fshatin Lluzhan tek kthesa që vije nga Prishtina për në fshatin Batllavë, gjegjësisht te Viva Fresh Store ku është ajo pjesa e betonuar / asfaltuar nga Viva Fresh dhe është ngjitur me asfaltin e Komunës apo Ministrisë, pra është bërë sikur të jetë kthesë me 4 korsi, inkuadrohen në rrugë përmes asaj kthese prej Vava Fresh, veturat që vijnë prej Prishtinës dhe bëhet tollovi, prandaj nuk e di a është ndërmarrë diçka sepse vërtetë është shumë e rrezikshme ajo kthesë.
z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, po mundohem t'ju përgjigjem gjithsecilit për aq sa mbajta shënime e që besoj se kam mbajt shënim për të gjitha, por nëse kam harruar diçka sërish përsëriteni.
Sa i përket çështjeve të ngritura nga z.Arjant Topanica për fshatin Sfeçel e që ka parashtruan një numër të madh të pyetjeve, sigurisht për shkak se ka munguar në seancën e fundit dhe tani janë mbledhë ato, por sido që të jetë do të përgjigjem, fillimisht për pengesat në rrugë afër shkollës është kërkesë që është shtruar edhe në seancën e fundit nga një koleg i juaji të cilit i'u kam përgjigjur dhe të njëjtën përgjigje më duhet t'jua them edhe juve, përderisa aty po kërkohet të vendose pengesë, në atë hapësirë janë dy pengesa dhe nuk ka mundësi të vendosen më shumë pengesa. Unë e frekuentoj dhe qarkulloj në atë rrugë çdo ditë, më duket që janë të mjaftueshme.
Deri tani kërkesa ka qenë për një pengesë të re, kurse tani u ndërrua duke u kërkua të hiqen ato dy pengesa në rrugë që janë dhe të vendoset një pengesë së bashku me sinjalizimin si vendkalim i këmbësorëve, andaj kjo mbetet të shqyrtohet por meqë janë dy pengesa në atë rrugë është goxha problematike të bëhet edhe e treta. Vendkalim për këmbësor edhe unë mendoj që ka nevojë sikurse te çdo shkollë tjetër që ka nevojë, por vendkalimi për këmbësor nuk nënkupton që duhet patjetër të jetë edhe pengesë në rrugë sepse mund të bëhet vetëm me shenjëzim, pa pengesë në rrugë, dhe këtë kërkesë do ta shqyrtojmë për një vendkalim, mirëpo por për pengesa edhe njëherë po e them që për momentin qysh është situata nuk mund të bëhen.
Sa i përket kërkesës për tabela të trafikut që sinjalizojnë shkollën, është kërkesë e drejtë dhe nuk e kam pasë ndonjë kërkesë të tillë dhe nuk e kam vërejtur që nuk ka tabelë në atë vend, në fakt ne jemi munduar t'i vendosim disa tabela që bëjnë identifikimin e shkollave por edhe të AMF-ve që janë nëpër fshatra që ka qenë kërkesë edhe e DSHMS dhe shpresoj që shpejt do të vendose ato.

Sa i përket dëmtimit të rrethojave të urës në lagjen Vokrri në fshatin Sfeçel, fillimisht ndoshta do të ishte mirë të gjendet ai që i ka dëmtuar, e them këtë sepse ne po merremi shumë me dëmtimet që po shkaktohen nga vet njerëzit, pra ne po duhet të investojmë dhe të harxhojmë buxhet për të rregulluar diçka që do të duhej të merremi me pasojat, do të thotë për një vepër që bën dikush fillimisht do të duhej të merret me pasojat ai person, përndryshe si rast ka qenë dashtë të njoftohet policia edhe Inspeksioni, të hapej rast dhe pastaj ta rregullonte ai person që i ka dëmtuar sepse ai ka obligim. Raste të tilla ne kemi shumë, mirëpo aty ku mund të hapim rast ne edhe e hapim sepse nuk kemi të drejtë të rregullojmë përderisa nuk është rasti i hapur.
Po ashtu u shtrua çështja e dëmtimit të asfaltit nga Kompania e Ujësjellësi, në fakt kemi shumë probleme të tilla sepse sigurisht e keni parë që Kompania e Ujësjellësit bënë goxha shumë renovime të gypave të ujësjellësit të cilët tashmë janë shumë të vjetërsuar dhe paraqesin probleme të mëdha, mirëpo ashtu siç e potencova në një bisedë para fillimit të kësaj mbledhje ne jemi të obliguar t'i mbyllim gropat dhe t'ia faturojmë KEDS-it dhe tani jemi në fazën e identifikimit të të gjitha gropave në qytet sepse kemi lidhë kontratë për mirëmbajtje të rrugëve të asfaltuara dhe në momentin që përfundojmë me identifikimin e të gjitha gropave do të fillojmë me rregullimin e tyre sepse tashmë siç e ceka kontrata është nënshkruar dhe besoj se shumë shpejt do të fillohet me punime, përndryshe kompania e kontraktuar nuk mund të del vetëm për një gropë.
Sa i përket shtretërve të lumenjve, kemi biseduar gjatë për këtë çështje, është problematikë pak më e madhe dhe që jemi duke u marrë në vazhdimësi, jeni në dijeni që me buxhetin e vitit të kaluar është punua diçka mirëpo është punuar në ato vende ku ne e kemi vlerësuar që kanë qenë më të rrezikuara dhe ku ka pasë vërshime më shumë ku si pasoj uji ka dalë prej shtratit, pra jemi munduar të paktën të gjejmë ato vende sepse i kemi përcjellë në vazhdimësi, nuk do të thotë se ndoshta i'a kemi qëlluar krejt t'i bëjmë ato, por aq sa kemi pasë kontratë dhe sa kemi pasë mundësi e kemi bërë një zgjerim dhe rregullim. Ende jemi duke bërë rregullim në pjesën e qytetit (në pjesën e sipërme – në afërsi të pishinave të "Malësisë") ngase në atë pjesë shtëpitë afër lumit kanë qenë afër rrëzimit, aq keq që ka qenë situata, mirëpo tani është bërë një punë e mirë dhe është larguar lumi goxha shumë prej shtëpive dhe nuk besoj që do të ketë më probleme.
Buxheti për rregullim të shtretërve të lumenjve është shumë i madh dhe Komuna nuk ka mundësi të ndajë shumë buxhet për këtë çështje, por aq sa kemi mundësi qoftë për mirëmbajtje, qoftë sipas kontratës për rregullimin e shtretërve, po e rregullojmë dhe po mundohemi të sanojmë ato pjesë ku janë më të rrezikuara. Kur e përmenda pjesën e lumit në afërsi të pishinave të "Malësisë", janë në pyetje shtëpitë dhe të mirat materiale, përderisa diku janë në pyetje pronat apo tokat bujqësore, tani sigurisht që ne të gjithë jemi dakord që prioritet është e mira apo pasuria materiale, në këtë rast shtëpitë që kanë qenë shumë të rrezikuara në atë pjesë.
Pati kërkesa edhe z.Sebastina Vokrri e që paksa ishte interesante sepse paraprakisht u bënë kërkesa për Lagjen Vokrri në fshatin Sfeçel kurse kjo bëri për fshatin Metehi, a keni bërë marrëveshje (me z.Arjant Topanicën) për këto kërkesa apo si qëndron kjo çështje. Nuk e kam pasë këtë kërkesë për pengesa në rrugë dhe nuk e di a i është drejtuar Drejtorisë, mirëpo ashtu siç ju kam thënë edhe më parë, vetëm nëse ka ndonjë arsye shumë të madhe, përndryshe pengesa në rrugë nuk bëjë unë dhe këtë e kam thënë edhe më parë të paktën tri herë këtu në Kuvend dhe nuk dëshiroj ta përsërisë të njëjtën çështje.
Për rrugën Murgull-Bellosicë që e ceku z.Ekrem Rrahmani, është një kontratë që është bërë në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimi me Ministrinë e Zhvillimit Rural, nëse nuk gaboj, dhe kanë filluar punimet vitin e kaluar ashtu siç e potencuat sepse kompania përkatëse ka kryer një pjesë të punimeve dhe është tërheq prej atij vendi, pra e vërtetë është ajo që ju janë drejtuar ashtu edhe juve sepse njëjtë më janë drejtuar edhe mua dhe kam biseduar me ata banorë. Ne kemi marrë

veprime dhe vazhdimisht jemi duke kërkuar nga kompania përkatëse që të vazhdoj punimet në atë rrugë, bëhet fjalë për të njëjtën kompani që është duke kryer punimet te rreth rrotullimi në magjistrale, pra sot kam diskutuar me menaxherin e projektit dhe ka dërguar e-mail me shkrim kompanisë sepse tani jemi në periudhën kur po dërgojmë e-maile me shkrim në mënyrë që pastaj nëse krijohet mundësia dhe nëse vie deri te shkëputja e kontratës, të kemi argumente dhe ta shkëpusim atë kontratë sepse në këtë rast operatori nuk është duke i kryer punimet, rruga u nisë dhe ka mbet në gjysmë.
Pati pyetje edhe rreth ndriçimit publik në lagjen/rrugën "Haxhi Sadriu", por edhe kërkesa tjera të shumta rreth ndriçimit në përgjithësi e që iu përgjigjem të gjithëve. Kontrata për mirëmbajtje të ndriçimit publik ka qenë një kontratë ku operatorët ekonomikë kanë dërguar ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit edhe është vonuar si kontratë, thënë të drejtën është kontrata e dytë që e kemi lidhë brenda këtij viti sepse ka goxha shumë dëmtime të ndriçimit publik dhe këtë e dim dhe e kemi shumë të qartë, pra është kontrata e dytë që e kemi lidhë brenda këtij viti dhe për këtë kontratë fatkeqësisht është bërë ankesë në OSHP e që si pasoj ka vonesa në lidhjen e saj, por që fatmirësisht javën e kaluar - të premten është lidhë kontrata dhe tani jemi në fazën e identifikimit të planit të menaxhimit fillimisht dhe të identifikimit të të gjitha vendeve ku ka dëmtime, gjë të cilën shpresoj që shumë shpejt të gjitha dëmtimet çka janë komplet në territorin e Komunës së Podujevës do të rregullohen shpejt sepse fundja kontrata është lidhë për këtë qëllim vetëm që është koha në pyetje sepse është lidh frikë dhe duhet të bëhet një plan i menaxhimit nga menaxheri i kontratës, të bëhet identifikimi i të gjitha dëmtimeve dhe të fillohet puna në terren. (kjo përgjigje përveç të tjerëve është edhe për z.Artrit Mulliqin).
Ishte një pyetje edhe nga z.Kasib Bashota që kishte të bënte me rrugën tek varrezat e fshatit Llapashticë, rrugë të cilën tani e kemi paraparë në kontratë edhe pse thënë të drejtën tani më me prioritet i kemi rrugët që qojnë në vendbanime sesa ato që qojnë tek varrezat, pra përgjigje si shkurtë aty ku ka vendbanime, të njëjtën rrugë për tek varrezat e kemi edhe në fshatin Llaushë por edhe të tjera. Lagja Murati në fshatin Llapashticë ka qasje në rrugë në pjesën tjetër, mirëpo nuk do të thotë se nuk bëhet sepse edhe ajo është nevojë për rrugët që qojnë tek varrezat mirëpo prioritare janë vendet e banuara dhe kur të përfundojnë këto pastaj vazhdojmë me rrugët e varrezave.
Pati pyetje nga z.Ragip Fetahu dhe dikush tjetër që nuk po kujtohet tani për momentin, fjala është për gropa apo që lidhet me mirëmbajtjen e rrugëve të asfaltuara, në fakt u përgjigja edhe pak më parë se kemi lidhë kontratë për mirëmbajtjen e rrugëve, jemi në fazën e identifikimit të gropave, dhe jemi në pritje që shpejt të fillohet me punime dhe të mbyllen gropat, mirëpo këtu mund ta them një çështje, mund të ndodh që nuk mund t'i identifikojmë të gjitha gropat ku janë sepse në disa vende më të thella rurale s'mund t'i shohim ne, por unë ju inkurajoj që kudo që shihni ndonjë grup që është në asfalt, drejtohuni tek ne dhe sigurisht në fazën e rregullimit të tyre do t'i rregullojmë të gjitha sepse kontratë kemi, buxhet të mjaftueshëm kemi për këtë vit dhe vetëm kërkohet të dimë sakt ku janë dhe të fillohet me punime.
Pati kërkesë nga z.Naim Çunkau për trotuari në fshatin Bollopojë, mirëpo para pak kohe ne kemi ndërtuar trotuarin në atë fshatë dhe atë bukur të gjatë, pavarësisht kësaj jam në dijeni që si kërkesë është e arsyeshme por thënë të drejtën për këtë vit nuk kemi pasë kontrata për trotuare të reja, ka qenë një kontratë dyvjeçare e lidhur në vitin e kaluar, andaj nuk kemi pasë mundësi të shqyrtojmë asnjë kërkesë për këtë vit që jemi tani, mirëpo ajo kontratë dyvjeçare tani javën e kaluar është mbyll dhe për këtë vit nuk ka mundësi, ndërsa për vitin e ardhshëm do ta shqyrtojmë si kërkesë.
Edhe për mirëmbajtjen e ndriçimit publik është e njëjta përgjigje që e bëra sikurse për të gjithë të tjerët. U mundova të jap përgjigje për të gjithë dhe nuk kam të evidentuar diçka tjetër, mirëpo nëse kam harruar ndonjë mund ta paraqitni sërish.

z.Naim Çunaku, theksoi, e di që keni shtruar trotuare dhe e di që keni shtruar bukur shumë, por unë bëra pyetje dhe pata theksin aty ku është e nevojshme të shtrohet trotuar ngase e di që janë shtruar trotuare në fshatin Bellopojë për të mos përmendur edhe vende tjera e tjera, por nuk u bëra shumë lokalist sepse në fshatin tim nuk kemi asnjë metër trotuar, mirëpo tregova për një rast ku vërtetë për çdo ditë rrezikohen ata nxënës për faktin që tani veç dihet e që u mundova të shpjegoj që në atë pjesë frekuentojnë automjete të natyrës që janë për Burgu e sigurisë së lartë e që sigurisht e dini që varësisht nevojave të tyre zhvillojnë shpejtësi të lartë, pra nuk është kërkesa për pengesa në rrugë (policë të vdekur) sepse mund të pengohet mbarëvajtja e punës së Burgu të sigurisë të lartë, por vërtetë nëse diku mendoj që ka pas nevojë në fshatin Bellopojë, më e nevojshme ka qenë ajo rrugë. Përndryshe jam i vetëdijshëm që keni shtruar trotuar edhe në fshatin Bellopojë, edhe në fshatin Halabak, edhe në fshatin Kaçybeg, por në fshatin Llugë dhe aty që kam kërkuar unë, nuk di që keni shtruar trotuar.
z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, i nderuar z.Naim Çunaku, unë pajtoj edhe një herë që ajo kërkesë është e arsyeshme, madje kudo që ka qarkullim, me theks qarkullim të nxënësve dhe fëmijëve, ka nevojë për trotuare. Edhe trotuari i shtruar në pjesën përkatëse në fshatin Bellopojë është afër shkollës, do të thotë e lidh krejt Lagjen Maloku dhe lagjen tjetër në pjesën e poshtme dhe deri tek shkolla është ndërtuar trotuari sepse edhe në atë pjesë ka qarkullim të mjaftueshëm. Tani nuk do të thotë që atje nuk ka qenë e nevojshme kurse këtu është e nevojshme, mirëpo e kemi ndarë si prioritet dhe e kemi ndërtuar deri tek shkolla, nuk do të thotë që nuk do ta rregullojmë edhe atë trotuar në atë rrugë që u cekë.
Tek rr.Qerim Imeri" apo te Lagja Govori, e kemi rritë paksa sigurinë sepse këtë vit e kemi bërë ndriçimin publik i cili shumë shpejt do të inaugurohet posa të regjistrohet njehsori elektrik nga ana e KEDS-i, pra është një lloj sigurie edhe kjo sepse mendoj se qoftë trotuari qoftë ndriçimi publik janë një lloj sigurie për këmbësorët.
z.Leutrim Krasniqi, drejtor i DPUMM, theksoi, po mundohem edhe unë që shkurtimisht, por nëse dëshironi edhe gjerësisht t'ju përgjigjem pyetjeve të juaja që bëtë.
Pyetja e parë është për rr."Behram Bislimi", gjatë këtij viti është lidhur kontrata për fshatin Orllan me rrethinë dhe është përcaktuar edhe ajo rrugë për asfaltin, pra kontrata është dyvjeçare dhe brenda periudhës së përcaktuar të planit të punës do të përfundohet kjo rrugë.
Sa i përket dritave në Sheshin e qytetit, drejtori parafolës ndoshta harroj të përgjigjet, por e them se ndoshta i nderuar z.Ekrem Rrahmani nuk ke dalë mbrëmë vonë dhe nuk i ke parë sepse gjatë ditës së djeshme janë rregulluar ato drita.
Pati pyetje edhe për rr."Marshi i UÇK-së", apo një segment i asaj rruge në fshatin Repë, edhe kjo rrugë është e planifikuar që të asfaltohet në kontratë brenda këtij viti, kemi udhëzuar edhe operatorin, ka marrë edhe letrën njoftuese sipas procedurës ligjore dhe në rast se nuk e përfundon atëherë do të ndjeken procedurat e tjera ligjore konform kontratës të cilat janë të përcaktuara nga Komuna dhe nga operatori.
Sa i përket procesit të emërtimit të rrugëve, po ashtu është një çështje për të cilën ka disa vite që ka pasur ankesa të shumta rreth emërtimit të rrugëve, shumica e qytetarëve ndoshta nuk kanë qenë të njoftuar, pra janë mbi 500 ankesa të cilat i kemi pranuar. Kemi formuar Komisionin për shqyrtimin e këtyre kërkesave, pastaj kemi edhe rrugë të reja të cilat janë formuar, kështu që shumë shpejt para jush do të jetë edhe materiali për të gjitha rrugët në Komunën e Podujevës, për rrugët të cilat Komisioni ka vlerësuar si të drejta për ndryshimin e emërtimit, rrugët e reja dhe rrugët apo emërtimet me listën rezervë për rrugët të cilat do të jenë në të ardhmen, dhe si proces ta përmbyllim e jo të vazhdojmë çdoherë me ndryshime në bazë të asaj që dikush mund të ketë si propozim.

Sa i përket rrugës së varrezave në fshatin Llapashticë për të cilën drejtori parafolës veçse e përmendi, mirëpo z.Kasib Bashota për momentin nuk është prezent, megjithatë ju njoftoj se është një kontratë që e kemi pasur atje për asfaltim, veçse në mirëkuptim me kompaninë kemi bërë të mundur që të paktën të jetë një trajtim me greder apo një proces i rrafshimit të asaj rruge.
Ka kërkesa të shumta për fshatrat Dumnicë e Epërme dhe Dumnicë e Poshtme, Bajçinë, Llaushë, që nuk i përcaktova, por ka mjaft të tilla, minimalisht janë katër rrugë, mirëpo si kërkesë rr."Avdyl Dushkolli" ka qenë dhe është pranë DPUMM e që do ta shqyrtojmë gjatë vitit të ardhshëm si mundësi për asfaltimin e kësaj rruge lidhëse.
Sa i përket rreth rrotullimit te vendi i ashtuquajtur "Qershiat e Lapapshticës " në magjistralen Podujevë – Prishtinë, jam i njoftuar që ekziston dhe është lidhur një kontratë me një operator për ndërtimin e rreth rrotullimit në fjalë, si dhe për dy urat përkatëse, procesi i shpronësimit ka ardhë thuajse në fazën përfundimtare, është nxjerrë vendimi për preliminar edhe pas përfundimit të këtij procesi do të ndërtohen 2 ura edhe pjesa tjetër e rreth rrotullimit, kurse sa i përket planit dinamik të ekzekutimit të këtij rreth rrotullimi nuk kam informata të tjera sepse veçse është në kuadër të Ministrisë. Pra këto ishin përgjigjet për pyetjet e parashtruara, nëse ka edhe ndonjë urdhëroni.
z.Pajtim Balaj, drejtor i DKRS, theksoi, lidhur me pyetjen e z.Artrit Mulliqi, fusha e futbollit në fshatin Peran është zhvillu në kuadër të një kontrate e cila i përmban 18 fusha sportive, ndër to disa janë të reja dhe disa janë fusha të cilat kanë mbetur në gjysmë për shkaqe të ndryshme dhe që duhet të kompletohen. Në planin dinamik për 2023 parashihet përmbyllja e fushës së futbollit në fshatin Peran.
Projekti i zgjerimit të hapësirave të sporteve marciale te palestra e sporteve që kanë filluar punimet, pastaj është fusha e basketbollit dhe ka qenë një pozicion në fshatin Siboc ku kemi pasur vërshime të mëdha dhe është dëmtuar bukur shumë fusha e sportit por që arkitektët dhe inxhinierët e Komunës e kanë menduar si zgjidhje ndërtimin e një muri mbrojtës.
Edhe njëherë, ndërtimi fushës së futbollit në fshatin Peran është e vërtetë që ka vonesa të mëdha, me të cilat jemi të pakënaqur si Ekzekutiv, dhe në bazë të planit dinamik, nëse nuk arrin me iu përmbyllë ajo kontratë deri në përmbylljen e vitit buxhetor të vitit 2023, ne do t'i marrim të gjitha masat për shkëputjen e asaj kontrate, përndryshe deri më sot operatori ekonomik përkatës është tregu jashtëzakonisht i papërgjegjshëm, por ka zotime prej tij që brenda këtij viti këto projekte që i përmenda për këtë vit do të përfundohen.
Fatkeqësisht, jo veç në këtë kontratë, po në shumicën prej tyre e kemi vështirësi të shumta me operatorët ekonomik, të cilët shkaktojnë vonesa të panevojshme, ndoshta po ngarkohen me shumë punë, po marrin shumë punë edhe nuk po arrijnë me ju dalë në krye shumicës prej tyre.
Shumë prej fushave sportive që i përmenda, janë fushat që ë kontrata për të cilat është ndërprerë në vitin 2021, për shkaqe të njëjta sepse operatorët ekonomik nuk kanë arritur t'i përmbushin në kohë detyrimet që kanë buruar prej kontratës. Pra shqetësimi është me vend, është shqetësim edhe joni, edhe i komunitetit sportiv, mirëpo presim deri në fund ose deri në gjysmën e muajit dhjetor të përfundoj, fjalët janë që bari i ri është porositur, është në Doganë diku, dhe priten punimet.
znj.Adelinë Stublla, drejtoresh e DSHMS, theksoi, falënderoj asambleisten znj.Arnisa Sylejmani për pyetjen e bërë dhe për interesimin në lidhje me banorët e Lagjes së Re sepse vërtetë është një shqetësim që na bezdis të gjithëve, jo vetëm neve si DSHMS po në përgjithësi si qytetarë të këtë të këtij vendi. Çështja është se ne si Drejtori i kemi kryer të gjitha procedurat në aspektin e kërkesave dhe pëlqimeve energjetike, kemi bërë pagesën në aspektin e pëlqimit energjetik. Dhe KEDS tani më ka vendosur trafon në atë pjesë dhe vetëm pritet pëlqimi dhe pranim dorëzimi i punës teknike.
Sa i përket çështjes së ngritur nga znj.Arjeta Salihu që bërë pyetje rreth insulinave, konkretisht vonesave për insulina, ne zakonisht kërkesën e bëjmë me kohë dhe i drejtohet Ministrisë

Shëndetësisë. Normale që vonesa mund të ketë ndonjëherë, mirëpo për momentin kemi insulina dhe kësaj radhe nuk ka pasur vonesa.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se drejtorët e Drejtorive përkatëse i japën përgjigjet e nevojshme. Për sqarime më të detajuara mund të vizitoni drejtorët nëpër zyrat e tyre.
z.Xhevdet Maloku, theksoi, unë nuk mora përgjigje, kështu që po kërkoj një përgjigje, në fakt prita përgjigje prej Drejtorisë që ka të bëjë me infrastrukturë, as nga DKRS as nga DSHMS, kështu që tani nuk e di por mendoj se dikush ndoshta duhet të jap përgjigj.
znj.Sebastina Vokrri, theksoi, kam vetëm një sqarim për drejtorin e DSHPMSH z.Bahri Selimi, konkretisht nuk ishte fjala për fshatin Metehi por për fshatin Surkish, fshat ky i cili është fshati më i afërt i fshatit Sfeçël, kështu që nuk kemi aq shumë dallime me kolegun z.Arjant Topanica, mirëpo gjithsesi ajo rrugë është bukur e gjatë, ndoshta mbi 1 km, dhe kërkesa ekziston madje edhe me foto dhe emër të rrugës (zyrtarisht apo jo zyrtarisht nuk e di por si kërkesë ekziston).
Po ashtu dua ta di nëse mund të më tregoni shkurtimisht, qysh bëhet vlerësimi kur kërkohet të vendoset një pengesë në rrugë (polic i shtrirë).
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, po i drejtohem drejtorit të DSHPMSH për rreth 2-3 çështje të cilat i përmendi. Sa i përket çështjes së vonesave dhe OSHP-së, meqë kontratat po janë kornizë, shembull për ndriçim publik bie fjala, është mirë, meqë po janë njëvjeçare dy-tre muaj para se të përfundoj të vendosen paramasat dhe të mos lihen sepse paska po dihet kjo çështje sepse kur nuk po i'a jepni atij më të lirit me çmim pastaj ai po shkon në OSHP dhe natyrisht se vonohet pastaj ngase OSHP merr 30 ditë, fillimisht ankesa dorëzohet në Komunë që edhe këtu janë 5 dit, mandej kemi rishqyrtimin dhe shkon një procedurë.
Sa i përket dritave, do t'ju bëja një propozim që ta merrni parasysh si për projekt të mirë, nëse veç nuk i'u vie mërzi që jam nga opozita, pra dritat e ndriçimit publik nëpër fshatra edhe kushton shumë lirë t'iu bëhet sistemi automatik për ndezjen e tyre kur të bëhet terr ose pas orës 24;00 të ndalen sepse vetëm qentë lëvizin andej dhe harxhohet rrymë, përndryshe ato drita me kohë nuk po ndezën kur po është e nevojshme e që pas orës 24;00 nuk na duhen, t'iu duhen hajnave dhe qenve.
Po ashtu kam pyetje dhe kërkoj përgjigje të shkurtër rreth mirëmbajtjes verore dhe dimërore, shembull për vitin 2023 janë 280,000.00€, ndërsa ky vit veç shkoj kurse ka qenë e paraparë që në muajin shkurt të bëhet mirëmbajtja e rrugëve, mandej për vitin 2024 janë planifikuar 370,000.00€ mirëpo kontrata kornizë është për 18 muaj, andaj nëse nuk parashihet të shkoj më shumë se viti 2024 atëherë neve deri në fund të vitit 2024 kanë mbete edhe 14 muaj, pyetja është a bartet buxheti dhe shkon për vitin 2025, e nëse kur të jepet tenderi, edhe pse e di që janë në procedura dhe ende nuk e ka marrë askush, dhe e vazhdon tetëmbëdhjetë muaj, ndërsa me këtë buxhet vetëm deri në fund të vitit 2024 dhe të cilën pastaj e ndërprenë, e që do t'i mbeteshin më pak muaj atij operatori, pra nëse ka mundësi vetëm shkurt të na shpjegoni.
znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, edhe unë e pajtohem me drejtorin e DSHPMSH z.Bahri Selimi kur e thot që vendet afër shkollave kanë nevojë t kenë trotuare, por unë mendoj se edhe ato që e kanë konsideroj që duhet me kanë shumë të sigurta. Kjo është gjendja e trotuarit fshatin Dumnicë (paraqet disa foto) do të thotë këndej kalojnë çdo ditë nxënësit në drejtim të shkollës "Lasgush, Poradeci" në fshatin Dumnicë, do të thotë prej fshatit Llaushë në drejtim të Xhamisë për të vazhduar deri tek shkolla, gjendje trotuarit është kështu, duke shtuar edhe pjesë të kanalizimit ku janë plotësisht të hapura në çdo 15 metra e që paraqet rrezik që secilit fëmijë që kalon andej, të bie në ato pjesë. Kështu që pajtohem që duhet me pasë trotuar në afërsi të shkollave dhe ato duhet të jenë të sigurta, por po bëhen gati dy vite që është kjo gjendje e trotuarit atje edhe po besoj që duhet të merret parasysh, sidomos në ato pjesën ku kanalizimet janë të hapura e që shumë lehtë fëmijët mund të rrëshqasin dhe të dëmtohen.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, vetëm për sqarim, disa prej juve jeni duke shfrytëzuar për herë të dytë diskutimet dhe po paraqitni pyetje, ndërsa me Rregulloren e punës kjo çështje sqarohet qartë që lejohen vetëm dy pyetje.
znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, i nderuar Kryesues unë në diskutimin e parë në këtë pikë të rendit të ditës parashtrova vetëm një pyetje, dhe tani kërkova fjalën për të dytën herë dhe parashtrova edhe një pyetje tjetër, kështu që unë vetëm dy pyetje pata.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se për herë të dytë keni të drejtë të merrni fjalën vetëm për pyetjen e parë në rast se nuk ju është dhënë përgjigje nga Drejtori, dhe të kërkoni sërish, por jo të parashtroni pyetje të reja.
z.Ilir Koprani, theksoi, dua të ndërlidhem rreth pyetjes që e parashtrova më herët për drejtorin e DPUMM të cilin e falënderoj për përgjigjen, mirëpo dua të shtoj edhe diçka, konkretisht te pjesa që u tha se janë dy ura, e di dhe e kam parasysh që është kompetencë e Ministrisë, jo e Komunës fal, mirëpo a parashihet dhe a e shihni të arsyeshme që Drejtoria që ju drejtoni të parashtroj kërkesë në Ministrinë përkatëse që në atë vend të ketë edhe një mbikalim pasi që jemi në dijeni që jashtëzakonisht ka frekuentim të madh të banorëve. Pra nëse ka mundësi edhe për këtë kërkoj përgjigje nga drejtori në fjalë.
z.Arjant Topanica, theksoi, sa i përket asaj që drejtori i DSHPMSH e tha kinse unë parashtrova shumë pyetje sepse skam qenë mbledhjen e fundit, mendoj se nuk shumë e pak kërkesa, ka kërkesa dhe ato duhet të zgjidhen. Te pika Të Ndryshme kemi dy minuta kohë dhe mund të paraqesim çfarë të dëshirojmë e jo ashtu siç e tha Kryesuesi lejohen vetëm dy pyetje.
Sa i përket pengesave në rrugën afër shkollës, do të kërkoja që fillimisht të shqyrtohet opsioni për tu heqë ato që janë aktualisht meqë janë shumë afër, dhe pastaj të vendoset ashtu siç e ceka edhe më parë, një pengesë e gjerë dhe mbi të bëhet shenjëzimi si vendkalim për këmbësorë, nëse kjo është e pamundshme atëherë të bëhet vetëm shenjëzimi si vendkalim për këmbësorë, me theks për nxënësit në atë vend.
Sa i përket dëmtimit të mbrojtseve të urës, ka qenë aksident, unë nuk jam në pozitën e hetuesit që ta hetoj këtë rast, pra ka qenë aksident dhe si pasojë e aksidentit janë dëmtuar ato mbrojtse, nuk janë dëmtuar nga ndokush qëllimisht, fshehtas apo natën, andaj për këtë arsye do të doja të merret parasysh kjo çështje ashtu siç e diskutova.
z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, po filloj nga kjo e fundit, jam në dijeni se ka qenë aksident dhe e di që është rasti në Polici, por unë e potencova që fillimisht duhet të gjendet fajtori e pastaj të merren veprime sepse nuk kemi të drejtë ne të intervenojmë për diçka që ende është nën hetime si rast, kështu që po presim edhe disa dit për faktin që policia mua më ka thënë si rast gati është për t'u zgjidhur, prandaj të shohim qysh po e nxjerrët ai rasti. Nëse ai person shpallet fajtor obligohet të kryejë ato punë, jo ne si Komunë, nëse del i pafajshëm atëherë duhet t'i marrim ne dhe të kryejmë punë.
Sa i përket pyetjes se nga kush dhe qysh vlerësohet vendosjen pengesave në rrugë, ne fatmirësisht si Komunë kemi 2 zyrtarë që janë inxhinierë të komunikacionit edhe për çdo kërkesë që marrim ata dalin në terren edhe e shohin se sa është e nevojshme vendosja e pengesave në ato vende. Kërkesa për vendosje të pengesave në rrugë ka shumë, prioritetet ndahen dhe tani kjo është e vetëkuptueshme në një formë, aty ku ka vendbanim më shumë, aty ku ka qarkullim më shumë edhe kryesisht prioriteti kryesor është aty ku ka shkolla dhe që ka lëvizje të fëmijëve dhe nxënësve më shumë, andaj kërkesa e z.Arjant Topanicës për pengesë në afërsi të shkollës përkatëse, po të mos kishte fare gjithsesi do të duhej të vendosej, mirëpo problemi aty është që ka pengesë, ndërsa sa i përket kërkesës për në fshatin Surkish ne duhet të dalim në atë vend dhe të vlerësojmë mundësitë se ka apo nuk ka nevojë.

E kam thënë disa herë se tani vetëm në raste të jashtëzakonshme vendosim pengesa ngase kemi vlerësuar se po pengojnë zjarrfikësit, po e pengojnë ndihmën e shpejtë, po e pengojnë policinë dhe po e pengojnë hapjen apo mbi mbajtjen e rrugëve dimërore e që ka raste kur edhe janë heqë krejt duke u bërë hapja e rrugëve në dimër, andaj t'i kemi parasysh këto gjëra.
Pati një kërkesë nga z.Ekrem Rarhmani mirëpo meqë ai nuk është prezent tani nuk po e jap përgjigjen fare rreth një sistemi smart që kemi menduar ta bëjmë rreth ndriçimit publik për të cilën ai e ceku se nuk ka vlerë të madhe financiare, mirëpo unë ju tregoj që ai sistem ka vlerë rreth 4 milion euro. Po ashtu pati pyetje edhe për mirëmbajtjen verore dhe dimërore, por që nuk është prezent dhe nuk po jap përgjigje fare as për këtë pyetje.
Sa i përket trotuarit në fshatin Dumnicë, fillimisht më vie mirë që ka trotuar në atë pjesë, jam në dijeni se nuk është shumë i mirëmbajtur, por në momentin që të vendoset trotuari, krijohet siguria dhe atë siguri vetëm ne si persona dhe si individ e prishim, e them këtë sepse kur i marrim kapakët e pusetave dhe i çojmë i shesim për një 1.5 apo 2 € për hekur, do të thotë ne e prishim atë siguri.
Nuk ka asnjë ditë që nuk vendosim kapakë të pusetave, dhe ka raste që në të njëjtin vend ku i vendosim dhe ka raste që të nesërmen që i vendosim ata i heqin. Po t'i vendosim kapakët e betonit në ato vende janë të papërshtatshëm ngase krijojnë rrezik për faktin që mbeten më lartë, andaj duhet me patjetër t'i vendosim të hekurit, por që po ndodh po i marrin dhe po i dërgojnë nëpër hekrari për t'i shitë për hekur, çka të bëjmë.
znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, në rregull drejtor kjo që e thua mirëpo dy vite janë shumë të mos vendosen kapakët e pusetave në atë trotuare që janë pothuajse në çdo 15 metra dhe rrezikohen fëmijët të bien në ato puseta.
z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, vazhdoi, vetë ata që kërkojnë siguri, ata e paraqesin rrezikun, në përgjithësi po foli jo vetëm për atë rast, mirëpo kjo mund të shihet edhe këtu në qytet, unë e kam parë vetë kamionetën e vogël duke shkuar rend duke mbledh kapakat e posetave, pra rend vazhdonte duke e ndal kamionetën dhe duke i mbledh dhe qitë në kamionetë, papërgjegjësi është kjo, madje po ta kemi buxhetin e shtetit nuk mund t'i kryen krejt këto punë, e lëre më me një buxhet të Komunës që e kemi rreth 50,000.00€ në vit për mirëmbajtje të kanalizimeve dhe vendosje të kapakëve të pusetave, prandaj e them se duhet të kujdesemi edhe ne vetë paksa për këtë çështje.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Procesverbalin e mbajti;
Enis Sheholli

Nr.Prot.01-060/04-0079519/23
Podujevë, **Kryesuesi i Kuvendit**
31 tetor 2023 **Hilmi Hoxha**

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e XXXI-të (tridhjetenjë)-*e jashtëzakonshme*, mandati VII-të, e mbajtur më 23 nëntor 2023.

Mbledhja filloi në orën 10:20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.
Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.
Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:
(Nga LDK *Valon Demolli; Demokrat Hodolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Adnan Zymeri; Donjetë Sheqiri; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani*; kurse munguan; *Arjant Topanica; Ilir Koprani;*
Nga LVV*, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota*; *Sebastina Vokrri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori, kurse mungoi Lirika Maliqi.*
Nga PDK, *Bashkim Syla; Mimoza Abdullahu,* kurse mungoi *Endritë Murati.*
Nga AAK, *Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.*
Nga OBKD, *Gazmend Islami i cili mungoi me arsyetim shëndetësor me shkrim dërguar Kryesuesit të Kuvendit.*

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi, Drejtorët e Drejtorive të Administratës komunale dhe atë;
(Xhevrie Beqiri-Drejtoria e Administratës DA; Adelinë Stublla-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Pajtim Balaj-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Alban Zeka-Drejtoria e Inspeksionit DI; Lirie Hoti-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE.
Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të KFOR, përfaqësues të mediave lokale dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

z.Hilmi Hoxha, **Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë në këtë mbledhje, në vazhdim theksoi, ashtu siç jeni informuar kjo është një mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit, kuorumi ekziston dhe për momentin në sallë prezent janë 29 anëtar/e të Kuvendit të Komunës, kurse mungojnë z.Ilir Koprani, znj.Lirika Maliqi, znj.Endritë Murati, znj.Mimoza Abdullau dhe z.Gazmend Islami, sa i përket mungesave në mbledhjet e Kuvendit është bërë një praktikë e keqe prej kohës kur është ndryshuar ligji i pagave, mungesat janë rritë, të gjitha komunat janë duke i dërguar listat me mungesa, edhe ne që nga ky muaj do i dërgojmë listat me mungesa dhe se si vepron Ministria e Financave pastaj ne nuk e dimë, kjo varet prej tyre.
Materialin e keni marrë me kohë ashtu edhe rekomandimet e KPF-së dhe për këtë pikë të rendit të ditës është votuar me 8 vota për, në këtë mbledhje kemi vetëm një pikë të rendit të ditës Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik të disa Pronave Shoqërore të cilat janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit andaj pa humbur kohë më shumë e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 29 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në mbledhje, mbështetet Rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

- **Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik të disa Pronave Shoqërore të cilat janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit**

z.Hilmi Hoxha, **Kryesues i Kuvendit,** theksoi, dihet se kjo pikë është shumë e rëndësishme e cila ka ardhë me iniciativën e Kryetarit të Komunës dhe është kërkuar që pronat të cilat menaxhohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit të kalojnë në pronësi të Komunës e që dihet se Komuna jonë ka nevojë për këto prona për realizimin e projekteve.
z.Shpejtim Bulliqi, **Kryetar i Komunës**, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, arsyen e thirrjes së kësaj mbledhje e potencoj edhe Kryesuesi i Kuvendit, është fakt që jemi në një fazë ku disa prej hapësirave të cilat janë duke u menaxhuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit - AKP, janë në fazën e shpalljes publike për t'u tenderuar (privatizim, shitje, likuidim) ose janë në përgatitje të shpalljes publike, dhe duke pas parasysh faktin që si Komunë e Podujevës kemi mungesë të hapësirave publike në menaxhim dhe pronësi të Komunës, dhe duke pas parasysh edhe nevojat e Komunës për të ardhmen për qëllime të investimit të projekteve të caktuara në këto zona të cilat pretendohet se do të dalin në shpallje publike për t'u shitur kemi vendosë që të marrim këtë vendim para datës 29 të këtij muaji që është si afat kohor që planifikohet shitja ose hapja e ofertave në mënyrë që disa prej këtyre aseteve t'i nxjerrim / tërheqim nga ai proces si dhe ato prona dhe hapësira të cilat faktikisht planifikohen në të ardhmen të futen në këtë proces. Do të thotë t'i pengojmë dhe të fillohet me procesin e shpronësimit të këtyre hapësirave dhe pronave të cilat janë të cekura në materialin e dërguar, unë nuk e shohë të rrugës që t'i lexoj të gjitha sepse i keni të cekura në materiale.
Janë hapësira publike duke filluar nga një lokal në sheshin e qytetit të Podujevës, jeni në dijeni që e kemi formuar një Ndërmarrje të re Publike Komunale e cila sigurisht do të ketë nevojë të ketë një hapësirë për zyrat e saj, andaj mendojmë që aseti i cili planifikohet nga AKP që të shitet, është objekti lokal në sheshin e qytetit të Podujevës i cili do të jetë njëri prej aseteve potencialisht të përshtatshme si mundësi e kthimit të tij në zyra të kësaj Ndërmarrje, prandaj mendojmë që duhet ta nxjerrim / tërheqim nga shitja, ta ruajmë si aset komunal dhe besoj shumë që është një vendim shumë i qëlluar t'i ndalim nga privatizimi këto asete sepse në të kundërtën në momentin që privatizohen jeni në dijeni se pastaj ka një kosto shumë më të lartë nëse kemi nevojë për një hapësirë tjetër.
Pastaj bëhet fjalë për një sipërfaqe mbi 2 hektar në afërsi të Lagjes së Dëshmorëve, jeni në dijeni shumë mirë që në atë lokalitet kemi objekte të banimit social dhe shpeshherë kemi donacione dhe mundësi për ta zgjeruar numrin e shtëpive të banimit në mungesë të hapësirave për ndërtimin e shtëpive, prandaj kemi menduar që ajo sipërfaqe të jetë ideale që t'i bashkëngjitet Lagjes së Dëshmorëve dhe faktikisht në momentin kur kemi donacione të caktuara ta kemi pronën e siguruar dhe të jemi më të lirë për të vendosur për zgjerimin e Lagjes me shtëpi të reja të banimit.
Parcelat tjera të propozuara të cilat janë planifikuar për t'i nxjerr / tërheqë nga privatizimi dhe t'i kthejmë në pronësi të Komunës është parcela në fshatin Dumnicë e Poshtme, parcelë e ish Kooperativës Bujqësore në të cilën tani është e ndërtuar nëse nuk gabohem e kemi një pjesë të Qendrës së Mjekësisë Familjare që funksionon aty, forma se si ka shkuar ky proces më parë ndoshta ndokush nga ju mund ta di, unë e di paksa por nuk i di të gjitha, madje jo vetëm këtu por ne kemi edhe në disa vende asete të ndërtuara në pronësi të huaj siç është rasti i shkollës "Dr.Ibrahim Rugova", që sot e kësaj dite është në pronësi të ish Javorit sepse nuk është përfillë asnjë procedurë e shpronësimit në sipërfaqen përkatëse për të hapë mundësinë për realizmin e ndërtimit të saj. Kemi edhe shembuj tjerë që nuk dua t'i diskutoj tani këtu për arsye se ndokush nga ju mund ta dijë por ka edhe të tillë që nuk i dinë dhe nuk kanë informacione, mirëpo këto janë

disa probleme të cilat mund të na shoqërojnë në të ardhmen që ndoshta në një moment të caktuar do duhet të bëjmë domosdoshmërish pagesën prej 20% për ato parcela, apo me kalimin e kohës Qeveria e vendit mund të merr ndonjë vendim që në ato prona ku janë ndërtuar asete, eventualisht të krijohen mundësi të kthimit të atyre pronave edhe pse realisht nuk ka qenë e tyre.
Nëse ju kujtohet, kohë më parë këtu ne kemi marrë një vendim që disa prej objekteve - gërmadhave të ish Kooperativave Bujqësore në fshatrat Dumnicë, Bajçinë, Kërpimeh t'i rrënojmë dhe të bëjmë pastrimin e atyre hapësirave për shkak të rreziqeve që paraqesin, dhe ju e dini se na është kthyer një përgjigje negative, pavarësisht që Kuvendi ka marrë vendim dhe e kemi dërguar te AKP-ja për leje për rrënimin e atyre objekteve mirëpo kjo nuk na është lejuar që të marrim një veprim të tillë, prandaj sot e kësaj dite ato barriera janë në formën çfarë janë dhe duke marrë parasysh edhe këto problemet me objektet tona institucionale që i kemi pjesërisht të atakuara me këto parcela, ne kemi vendosur që të marrim miratimin e juaj si Kuvend që unë si Kryetar Komune të filloj procesin e këtyre pronave dhe këto prona t'i kthejmë në pronësi të Komunës.
Normalisht ne duhet ta paguajmë një çmim prej 20% për të gjitha këto prona, buxhetin besoj se do e sigurojmë dhe më e mira është që në të ardhmen këto do të jenë asete të Komunës dhe pastaj Komuna mund të llogaritë për realizimin e projekteve të caktuara varësisht prej interesit që ka.
Pra nga ky proces Komuna ka vetëm dobi, ne si institucion zgjerohemi me hapësira si prona potenciale për mundësi t'i realizojmë disa projekte siç është rasti në fshatin Kërpimeh ku në zonën kadastrale të fshatrave Revuç dhe Pakashticë e Poshtme është një hapësirë bukur e madhe e që nëse nuk mund të bëhet ndonjë kompleks sportiv, të paktën të rrënohen ato gërmadha, mund të bëhet shesh ajo pjesë dhe të bëhet një park me hapësirë gjelbëruese ku do të mund ta shfrytëzojnë banorët e atij lokaliteti.
Besoj se është interes i përgjithshëm edhe në fshatin Bajçinë sepse e kemi të njëjtën situatë ku kemi të ndërtuar Qendrën e Mjekësisë Familjare në hapësirën e ish Kooperativës Bujqësore si dhe përveç saj është e ndërtuar edhe një e ashtuquajtur shtëpi e pritjes, dhe atë në mënyrë të egër, andaj tani për të mos ardhë deri te problemet që mund të pasojnë në të ardhmen, ne menduam që për këto prona të fillojmë procesin e shpronësimit, besoj se AKP do e zhbllokoj këtë proces dhe pastaj ne pas vlerësimit nga niveli Qendrorë, si komunë do t'i japim mjetet e nevojshme.
Totalin e sipërfaqeve nuk e kam nxjerrë si tërësi e këtyre parcelave të planifikuara, por në propozim ceket për secilën parcelë sipërfaqja e që mund të them se është një sipërfaqe bukur e mirë. Besoj se këtë mund ta përballojmë ekonomikisht në aspektin financiar dhe besoj se në të ardhmen do të jenë asete të rëndësishme për komunitetet tona përkatëse në fjalë.
Prandaj kërkoj nga ju si Kuvend që ta përkrahni këtë propozim dhe njëkohësisht ju informoj se nuk do të jenë vetëm këto asete që janë propozuar sepse në faza të ndryshme varësisht nga rastet ku paraqiten, të drejtën për pronat që janë të rëndësishme për institucionin e Komunës e të cilat mund të kenë sipërfaqe më të mëdha potencialisht, do të bëjmë përpjekje t'i kthejmë në pronësi të Komunës në mënyrë që të kemi asete relativisht të mjaftueshme qoftë për ndonjë investitor qoftë edhe për nevoja tjera të Komunës, andaj shpresoj në mirëkuptim e juaj.
z.Valon Demolli, theksoi, sa i përket këtij propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik në Komunën tonë, ne Grupi i LDK-së e përkrahim sepse e shohim se është interes i Komunës dhe i qytetarëve të komunës së Podujevës.
LDK gjithmonë ka qene përkrahëse e interesave të qytetareve, prandaj ne edhe këtë propozim vendim e përkrahim.

z.Haki Rudari, theksoi, propozim vendimit për shpalljen ne interes të përgjithshëm publik të disa pronave shoqërore të cilat janë nën menaxhimin e AKP-së dhe në të njëjtën kohë ato të shpallen në interes të përgjithshëm për Komunën, mendoj se është një veprim jashtëzakonisht i mirë kur dihet se Komuna ka mungesë të pronave dhe për shumë projekte të cilat do të realizohen në të ardhmen duhet të bëhet shpronësimi i këtyre pronave në mënyrë që Komuna të jetë e përgatitur për realizmin e tyre në të ardhmen.
Në këtë material, te neni 1 i propozim vendimit kemi sipërfaqen prej 17768m^2 në Kërpimeh, pastaj kemi parcelën në Surkish në sipërfaqe 9410m^2, dhe parcela tjera që janë në interes të Komunës dhe propozimet apo projektet të cilat vijnë nga donatorët e jashtëm apo të brendshëm, të mos kenë mungesën e sipërfaqes së tokës. Në të njëjtën kohë do të ndalem te Ligji nr.04/L-144 konkretisht te neni 12 ku thuhet, e drejta e komunës në kthimin e një pjese së tokës së menaxhuar nga AKP-ja, në paragrafin 1 thuhet, Komunat kanë të drejtë për interes publik kthimin e pronës së paluajtshme që përfshinë tokat e ish Ndërmarrjeve Shoqërore në territorin e Komunës dhe tani që administrohen nga AKP, pastaj në paragrafin 2 thuhet, komuna duhet t'i hartojnë listat e parcelave, pra kjo që sot ne jemi duke e bërë hartimin e parcelave të këtyre Ndërmarrjeve Shoqërore në mënyrë që pastaj këto parcela të kthehen në interes publik, mandej në paragrafin 3 thuhet, listat e pronave i harton komuna sipas paragrafit 2 ku ato lista ia dërgojnë Qeverisë ashtu siç e ceku edhe Kryetari i Komunës paraprakisht, dhe nëse disa prona janë në procedurë të privatizimit Qeveria ka të drejtë t'i ndalojë ato dhe natyrisht se me vendim të Komunës ne kemi të drejtë që këto prona t'i kthejmë në aset të Komunës.
z.Bashkim Syla, theksoi, ne Grupi i PDK-së e përkrahim propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik të disa pronave shoqërore të cilat janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, pikat i kam lexuar për pronat që duhet të kthehen në pronë komunale dhe pajtohem me këtë por kam disa dyshime sa i përket lokalit në qytet ish Bankkos që e ceku Kryetari i Komunës, por që mendoj se ajo hapësirë nuk mjafton për zyre të NPL "Eko Llapi". Mjetet që duhet të bëhen si pagesë për atë lokal, mendoj se më mirë është t'i ofrohen zyra tjera siç janë në objektin e vjetër të Komunës sepse ajo hapësirë në atë lokal në shesh nuk i mjafton asaj Ndërmarrje, prandaj e them që të parashihen mundësitë për sigurimin e një hapësire publike për mjetet e NPL "Eko Llapi" sepse asaj i duhen hapësira tjera dhe se besoj që ai lokal mund të jepet për shfrytëzim në interes të dikujt, përndryshe jemi dakord.
z.Ragip Fetahu, theksoi, ideja për rikthimin e pronave publike në pronësi të Komunës është një ide shumë e mirë si dhe bashkëpunimi i institucioneve lokale me nivelin qendror është për tu admiruar. Ky propozim vendim të cilin ne po e marrim sot është i rëndësishëm për tri arsye, së pari ndalon konfliktet mes qytetarëve të cilët shfrytëzojnë pronën publike për interesat e tyre, së dyti prona i kthehet interesit të përgjithshëm qytetar të nivelit lokal dhe ndihmon komunitetet lokale për zhvillimin e projekteve që lehtësojnë jetën e tyre, dhe së treti parandalon uzurpimet e qytetarëve të cilët e shfrytëzojnë ato prona, prandaj ky vendim që ne sot do ta marrim është shumë i rëndësishëm. Ajo që ne duhet të kemi kujdes është se a do të kemi probleme ligjore me këto vendime që ne po i marrim dhe a do të ketë problem me AKP, për shkak të interesit material të saj.
z.Shpejtim Bulliqi, **Kryetar i Komunës**, theksoi, probleme ligjore nuk kemi sepse është një e drejtë e patjetërsueshme e jona që mund ta bëjmë dhe kemi një plus shumë të madh sepse paguajmë vetëm 20% prej totalit të shumave të shpronësimit.
Sa i përket brengës së asamblistit parafolës (i drejtohet z.Ekrem Rrahmani) ju them se unë nuk kam ndonjë interes por ai lokal është menduar për atë Ndërmarrje. Jam i informuar se ai lokal

është më shumë se 80m^2 dhe mund të nxirren disa zyre për administratën e Ndërmarrjes së cekur ndërsa depot dhe pjesët tjera duhet një hapësirë më e madhe sepse në qytet s'ka hapësirë të tillë.
Si do që të jetë, është mirë ta keni parasysh se ne i kemi pas disa objekte në qytet dhe jeni në dijeni se prej atyre objekteve në qytet realizojmë një shumë bukur të mirë të hyrave vetanake kështu që rrezik nuk ka prej kësaj pune, mos u mërzitni sepse në të dyja anët jemi fitues si Komunë.
Në cilin do variant mendoj se është interes i Komunës sepse nëse prona përkatëse do të ketë vlerën 200,000.oo€, 250,000.oo€ apo 300,000.oo€ ne do të paguajmë vetëm 20% të asaj shume dhe sërish ato asete do të mbesin në pronësi të Komunës.
Ndokush mund ta ketë ndonjë interes sepse ato asete jepen në shfrytëzim për një qëllim të caktuar, por synimin e kemi për NPL "Eko Llapi", pra si aset besoj se është i leverdishëm për Komunën.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nuk jam kundër asaj që këto prona të mos kthehen në pronësi të Komunës dhe të kemi mundësi që këto asete të jepen në shfrytëzim apo me qira.
Nuk më pëlqej arsyetimi duke e ndërlidhë lokalin përkatës me themelimin e Ndërmarrjes së re publike komunale, mendoj se Ndërmarrja e cekur zyrat e saj është dashur t'i ketë në objektin e vjetër të Komunës, përndryshe për ta kthyer pronën në pronësi të Komunës jam shumë dakord.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron të shtoj diçka rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e vë në votim propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik të disa Pronave Shoqërore të cilat janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 29 vota Për, nga anëtarët që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik të disa Pronave Shoqërore të cilat janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45

Procesverbalin e mbajti;
Enis Sheholli

Nr.Prot.01-016/01-0083798/23
Podujevë,
23 nëntor 2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e XXXII-të (tridhjetedy)-*e jashtëzakonshme*, mandati VII-të, e mbajtur më 08 dhjetor 2023.

Mbledhja filloi në orën 10:15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.
Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.
Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:
*(*Nga LDK *Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Adnan Zymeri; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani*; kurse mungoi; *Demokrat Hodolli;*
Nga LVV*, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota*; *Sebastina Vokrri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori, kurse mungoi Lirika Maliqi.*
Nga PDK, *Bashkim Syla; Mimoza Abdullahu, Endritë Murati.*
Nga AAK, *Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.*
Nga OBKD, *Gazmend Islami i cili mungoi me arsyetim shëndetësor me shkrim dërguar Kryesuesit të Kuvendit.*

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi, Drejtorët e Drejtorive të Administratës komunale dhe atë;
(Xhevrie Beqiri-Drejtoria e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave DBF; Leutrim Krasniqi-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Pajtim Balaj-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit; Alban Zeka-Drejtoria e Inspeksionit DI; Lirie Hoti-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të KFOR, përfaqësues të mediave lokale dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

z.Hilmi Hoxha, **Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë në këtë mbledhje, në vazhdim theksoi, materialin e keni marrë të gjithë me kohë për këtë mbledhje të jashtëzakonshme e cila është thirr me arsyen se për pikën e parë e rendi të ditës është afati i fundit për miratim kështu që patjetër kjo mbledhje është dashtë të mbahet sot, andaj a jeni që të vazhdohet me punë me këtë rend të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 30 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent për momentin në mbledhje, mbështet Rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës dhe konstatimeve nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 06.12.2023.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, meqë jemi në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore dhe të gjithë jemi dëshmitar të krimit makabër që ka ndodhur ditëve të fundit ndaj një gruaje, andaj kërkoj të mbahet 1 minutë heshtje.

Mbahet 1 minutë heshtje për të ndjerën Liridona Ademaj (e vrarë në mënyrë makabre më datë 29 nëntor 2023)

1. **Propozim vendimi për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023**

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, theksoi, në bazë të Ligjit të ri për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronë, për komunat parashihet mundësia që të bëjnë faljen e tatimit në pronë për vitin 2023 deri në vlerën 100€.
Komuna e Podujevës propozon që të gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës t'iu falet fatura e vitit 2023 deri në vlerën 100€, pra kjo vlen për të gjithë tatimpaguesit në mënyrë proporcionale që do të falen deri në shumën e cekur kurse ata të cilët e kanë vlerën e faturës më të lartë se 100€ duhet ta paguajnë vetëm diferencën e saj, shembull, nëse fatura është 150€ paguhet vetëm diferenca që është 50€. Pastaj ka shumë qytetarë të cilët e kanë paguar faturën e tatimit në pronë për vitin 2023 por atyre do t'ju rimbursohet, pra nuk kanë nevojë të paguajnë faturën e vitit 2024 nëse ajo është nën vlerën 100€, nëse është mbi 100€ duhet ta paguajnë vetëm diferencën e asaj fature, andaj ju ftojmë që ta mbështetni këtë propozim vendim për arsye që t'i ndihmojmë sado pak qytetarëve që financiarisht t'jua lehtësojmë jetën.
z.Valon Demolli, theksoi, falja e borxhit prej 100€ për tatimin në pronë, në Komunën e Podujevës nuk është zgjedhje e duhur, në fakt është gabim pas gabimit e kësaj qeverisje si në rrafshin qendrorë ashtu edhe në rrafshin lokal. Gabim i parë ka qenë kur vet rritja e tatimit në pronë që është bërë nga kjo qeveri e që si LDK kemi thënë që mënyra e vlerësimit është e gabuar.
Dje e rritën për të thënë që sot po jua falim, LDK e ka kundërshtuar këtë falje të tatimit sepse ky është detyrim i qeverisë pas veprimit të papërgjegjshëm nga ngritja e tij.
Në veprimet e tyre çdo ditë e më shumë po e bëjnë të papërballueshme jetesën, po e rëndojnë mirëqenien e po e varfërojnë edhe qytetarin edhe Komunën.
Ne Grupi i LDK-së këtë propozim vendim e konsiderojmë si lojë e radhës me qytetarin për efekte e përfitime elektorale, andaj ftoj Grupin që të mos marrin pjesë në këtë votim.
z.Haki Rudari, theksoi, pa publikimit të Aktgjykimit nr.2296/23 të datës 23.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese, Ministria e Financave i ka njoftuar Komunat për përmbajtjen e këtij Aktgjykimi si dhe për afatin e përcaktuar nga Gjykata për zbatimin e dispozitave ligjore për faljen e tatimit në pronë për vitin 2023 deri në vlerën 100€ dhe si rrjedhojë Komunat janë njoftuar se deri më datën 08.12.2023 mund të vendosin rreth faljes së tatimit në pronë e cila mund të lejohet deri në lartësinë e faturës që e përmenda, prandaj mendojmë se kjo iniciativë është jashtëzakonisht e mirë dhe n interes të qytetarëve. Pse në interes të qytetarëve, sepse vërtetë është një gjendje e rëndë ekonomike dhe sa do pak tek qytetarët mendojmë se kjo falje ua lehtëson barrën tatimpaguesve të cilët në një mënyrë disa prej tyre e kanë kryer – paguar por që ashtu siç e ceku edhe drejtori parafolës kjo do t'ju vazhdohet si paradhënie në vitin 2024.
Deri sa në një kohë është thënë se nuk ka pasë dispozita ligjore apo nuk ka pasë të drejtë ligjore, tani ato çështje janë kryer dhe mendoj që kjo iniciativë duhet të propozohet, duhet të përkrahet

dhe thërras të gjithë kolegët dhe gjitha Grupet që ky propozim të kaloj, të miratohet, të votohet ngase mendojmë se është në interes të të gjithë qytetarëve pa dallime politike.
z.Bashkim Syla, theksoi, ne Grupi i PDK-së e mbështesim propozim vendimin i cili mundëson faljen e borxhit për çdo tatimpagues të Komunës së Podujevës deri në vlerën 100€.
z.Adnan Zymeri, theksoi, absolutisht secili vendim i cili ndikon në jetën e qytetarëve njëkohësisht edhe vendimi për faljen deri në 100€ të tatimit në pronë është vendim shumë i rëndësishëm që në këtë fazë e lehtëson jetën e qytetarëve, mirëpo në të njëjtën kohë do të doja ta dijë nga drejtori i DBF sa i përket implikimeve të këtij vendimi, përkatësish sa është vlera afërsisht e mjeteve të cilat do të falen me këtë vendim dhe kryesisht cilat projekte prek sepse konsideroj se si vlerë dihet të jetë e konsiderueshme që ka edhe implikimet e veta në projekte të cilat ose ka qenë duke i zhvilluar ose që pritet t'i zhvilloj Komuna e Podujevës.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe unë kërkoj një sqarim nga drejtori i DBF-së, këtu thuhet tatimi për vitin 2023, drejtori e sqaroj për ata që vlerën e kanë mbi shumën 100€, mirëpo për ata që e kanë faturën në vlerë më të ulët se 100€ pyes a është diskriminim kjo sepse nëse dikush e ka 50€ - 60€ faturën e vitit 2023 dhe atë e ka paguar, madje ndokush ka paguar edhe kamata dhe dënime, pra a përfshihet kjo fale prej 100€ në kamatë dhe dënim apo vetëm sa e ka tatimin dhe nëse atë e ka më pak se 100€ qysh shkon kjo, a paguhet për dy vite radhazi nëse fatura është 50€ dhe që e ka paguar, apo si qëndron kjo e rregulluar, nëse ka mundësi një sqarim.
z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, z.Adnan Zymeri foli për çështjet e implikimeve të cilat mund të jenë në raport me të hyrat, do të thotë falja e këtij obligimi deri në 100€ ka një ndikim nga falja deri afërsisht 400,000.00€ vlerë nga faturat që do të falen. Shpresojmë që kjo nuk do të ndikoj në asnjë projekt në realizmi për arsye se tani më Komuna e Podujevës e ka një buxhet të miratuar dhe në kuadër të saj janë të planifikuara edhe të hyrat vetanake që janë afërisht 1,800,000.00€.
Kur kemi të bëjmë me çështjen e tatimit në pronë ne kemi shumë llogari të arkëtueshme, ka shumë qytetarë të cilët kanë shumë obligime që kalojnë mbi 3 milion euro obligime tatimore ndaj Komunës së Podujevës. Ne vazhdimisht i kemi tejkaluar planifikimet e përcaktuara nga Ministria e Financave për realizimin e të hyrave vetanake kështu që sërish në bazë të projeksioneve të Ministrisë së Financave ne duhet ti mbledhim afër 800,000.00€ nga tatimi në pronë dhe jemi të bindur se do ta realizojmë këtë projeksion kështu që nuk do të ndikoj në ngecjen e asnjë projekt të planifikuar me buxhetin e viti 2024 sepse do t'i realizojmë ato projeksione nga të hyrat vetanake, madje do të kemi tejkalim sikurse që kemi tejkalim në këtë vite afër gjysmë milion euro nëse i mbledhim si total në bazë të hyrave vetanake të planifikuara dhe realizuara.
Lidhur me çështjet e shtruara nga z.Ekrem Rrahmani, ju sqaroj se fatura do të falet deri në maximum 100€, do të thotë, nëse një qytetar ka faturën e tatimit në pronë 50€ do t'i falet e gjithë fatura, nëse një qytetar faturën e ka 150€, 100€ i falen kurse duhet të paguaj diferencën mbi 100€ e që në ketër rast është 50€. Qytetarët të cilët e kanë paguar faturën e tatimit në pronë për vitin 2023, atyre i'u rimbursohet apo janë në parapagim për vitin 2024. E vërteta është ajo që e ceku edhe z.Ekrem Rrahamni që sistemi ka llogaritur edhe penalitetet edhe përgjatë vitit 2023 por është sistem të cilin e menaxhon Ministria e Financave, ta zëmë, nëse një qytetar ka pasë vonesë në pagesën e këstit të parë deri në muajin prill atij i është llogaritur një penalitet, në rast se e ka paguar me penalitete atij duhet t'i rimbursohet në vitin 2024 komplet shuma e paguar edhe pse nuk ka diçka specifike nga Ministria e Financave mirëpo kjo padyshim duhet të rregullohet në këtë formë që të rimbursohet së bashku me penalitetet e paguara ngase një pjesë e qytetarëve është vë paksa në lajthitje se do të falet jo nuk do të falet, prandaj disa e kanë neglizhuar pagesën e faturës.

z.Arjant Topanica, theksoi, deshta të jap një sqarim të shkurtër lidhur me këtë propozim vendim dhe qëndrimin tonë si Grup i LDK-së se nuk do të thotë dhe nuk jemi asnjëherë kundër çdo vendimi apo veprimi që është për lehtësimin e jetës së qytetarëve, mirëpo duhet bëhet një dallim, ne jemi kundër këtyre politikave që bëhen me qëllime popullsitë, ose forma tjera me inate që njëherë të mos përkrahet një nismë e LDK-së apo çfarëdo partie tjetër që ka qenë për mos rritjen e tatimit në pronë ndërsa pastaj me veprime popullsitë të merret kundërveprimi ai asaj me faljen e borxheve, e them këtë sepse kjo është një lloj shakaje apo lajthitje që i bëhet qytetarëve, do të thotë ne nuk po e përkrahim një vendim kur duhet të falet vetëm pse është nga një parti tjetër, pra vetëm për inate politike, kurse tani të merr veprim të kundërt me atë duke falë borxhe dhe duke u heq në atë që dikush po voton kundër faljes së borxheve, mirëpo nuk vepron as ne e as asnjë asamblistë tjetër kundër një vendimi që është për lehtësuar jetën e qytetarëve.
Pra ne nuk jemi kundër që t'i falen borxhet ose t'i lehtësohet jeta qytetarëve apo çfarëdo veprimi të kësaj natyre, por jemi kundër këtyre lojërave që bëhen me qëllime inatçore, popullsitë ose çfarëdo mënyre tjetër që vetëm në mbështetje të qytetarëve nuk janë.
z.Kasib Bashota, theksoi, unë nuk besoj që ka ndonjë inati këtu sepse po falet secila kategori dhe nuk ka ndarje në vija partiake apo të ngjashme. Pra secila familje në Llap po përkrahet me këtë punë dhe sa herë që ka të tilla në të mirë të qytetarëve unë jam për. Vetëm për hajr me shëndet e gjitha t mirat.
z.Shpejtim Bulliqi, **Kryetar i Komunës**, theksoi, sigurisht që vet fakti i thirrjes së kësaj seance të jashtëzakonshme tregon që kemi sjellë para juve si Kuvend 2 propozime të cilat besoj se kanë një interes të përgjithshëm për qytetarët tanë.
Pa dashtë të replikoj me askënd, të gjithë jemi dëshmitar të faktit që vendimet të cilat kanë pasuar në këtë vendim të rritjes së tatimit në pronë nuk janë vendime që i ka marrë kjo Qeveri aktuale që është, ne mund ta akuzojmë këtë Qeveri mirëpo të gjithë e dimë që ato vendime janë marrë qysh në vitin 2018 kur me Qeverinë e vendit ka udhëhequr ish Kryeministri Hoti, dhe këto vendime të cilat pastaj kanë pasuar kanë rrjedhë nga ai vendim, por nëse kthehemi dhe realisht e shikojmë vlerësimin e pronave është shumë e vërtetë se kanë pësuar ndryshime në këtë periudhë kohore, madje nëse vetëm një shembull të thjesht e marrim tek objektet e banimit, jeni në dijeni shumë mirë se deri para pak kohe çmimi i $1m^2$ të banimit kolektiv këtu ka qenë rreth 650€, kurse sot kemi ndryshime, dhe pasojat e pandemisë edhe pasojat e rritjes së çmimeve të tregut në përgjithësi kanë ngritur edhe çmimin e vlerës së pronës, prandaj është shumë e vërtetë se duke marrë parasysh këtë fakt dhe një ngarkesë pak më e madhe që i'u është bërë qytetarëve kanë pasuar edhe këto kërkesa për t'i nxjerrë me vendim sot ky Kuvend i Komunës.
Pra edhe njëherë e përsërisë që nuk kam qëllim të bëjë replikë me askënd sepse edhe ju sikurse unë i dini këto gjëra, nuk është në pyetje as popullzimi, as politika, por kemi paravetës një propozim vendim i cili po mendojmë se do të ndikoj pozitivisht tek pjesa dërmuese e qytetarëve të Komunës së Podujevës, për të mos thënë tek të gjithë qytetarët e Komunës ngase nga kjo falje do të mund të preken edhe ata të cilët e kanë faturën e tatimit në pronë mbi 100€, andaj unë besoj se është mirë që të gjitha subjektet politike ta përkrahin këtë propozim.
Kemi mundësi dhe hapësirë që diku tjetër të bëjmë politikë, por nuk është në pyetje që në këtë pikë të bëjmë politikë ngase sërish e them që me këtë propozim po i'u ndihmojmë qytetarët tanë, prandaj pa dashtë të zgjasë diskutimin tim po ju ftoj edhe njëherë pozitë - opozitë që ta votoni këtë propozim vendim që ju është përcjellë në mënyrë që të procedohet tutje që sado pak t'iu dalim në ndihmë qytetarëve tanë.

z.Arjant Topanica, theksoi, vetëm deshta ta njoftoj Kryetarin e Komunës se në vitin 2018 nuk ka qenë Kryeministër z.Avdullah Hoti, mirëpo në Qeverinë 2017-2019 ka qenë PAN (koalicioni PAN). Ky propozim vendim sigurisht se do të votohet, do të kaloj dhe sigurisht se do të falen borxhet e që do të jetë mirë për çka e potencova edhe më parë se nuk jemi kundër kësaj, por jemi kundër lojërave që po bëhen duke e vënë topin herë andej e herë këndej, dhe që po bëhen për qëllime tjera e jo për qëllim bazë interesin e qytetarëve.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, atëherë e hedhim në votim propozim vendimin për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 32 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent, me 19 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk morën pjesë në votim) miratohet Propozim vendimi për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe konstatimet nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 06.12.2023

2. **Shqyrtimi i kërkesës për mbështetje financiare Klubin e Futbollit K.F. "Llapi 1932" SH.P.K. Podujevë.**

z.Pajtim Balaj, drejtor - DKRS-së, theksoi, ne si DKRS kemi pranuar një kërkesë nga Klubi i Futbollit K.F. "Llapi 1932", në fund të muajit tetor, mirëpo për shkak që i kemi disa thirrje për mbështetje të Organizatave jo qeveritare që ende nuk janë mbyllur dhe mundësitë buxhetore na kufizojnë që t'i ndihmojmë më shumë. Po ashtu bazë ligjore nuk kemi si Drejtori që t'i mbështesim Organizatat të cilat statusin e kanë Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara-SHPK, prandaj këtë kërkesë e kemi paraqitur para Kuvendit të Komunës sepse Kuvendi është organi që ka përgjegjësinë ligjore të marr vendime të tilla, shuma e propozuar është 20,000.00€ dhe është bazuar në mundësitë buxhetore që ka DKRS. Po mos të kishim një thirrje të hapur e cila aktualisht është në vlerësim, ndoshta kjo shumë do të ishte më e madhe por këto janë mundësitë aktuale që kemi në këtë fund të stinorit.
K.F. "Llapi 1932", në të kaluarën ka dëshmuar suksese, edhe këtë vit ka pasë një ecuri të mirë të garave që e bën një ndër Klubet kryesore konkurruese për të fituar titullin dhe ta sjellë atë në Komunën tonë për herë të parë për KF "Llapin" dhe për herën e tretë për Komunën tonë, andaj ju lus që ta përkrahni këtë pikë të rendit të ditës.
z.Valon Demolli, theksoi, fillimisht shqyrtimi i kërkesës për mbështetje financiare Klubin e Futbollit K.F. "Llapi 1932" SH.P.K. Podujevë me një shumë prej 20,000.00€, mendoj se është qesharake dhe është ofenduese si ndaj KF "Llapi" edhe ndaj qytetarëve Llapjan.
Në emër të Grupit të LDK-së, kërkoj që kjo shumë të rritet, pra të jetë shuma prej 150,000.00€, sepse shuma prej 20,000.00€ nuk i'u mjafton as për ujë të pijshëm KF "Llapit", për një vit.
znj.Sebastina Vokrri, theksoi, Klubin e Futbollit K.F. "Llapi 1932", renditen një ndër klubet e para futbollistike të Kosovës duke kaluar nëpër furtuna të ndryshme kohore. K.F. Llapi i'u qëndroi stoikisht stuhive, thuhet se dikur klubi ishte etnikisht me lojtar serb jo që nuk kishte talent shqiptar por që kishin vështirësi të depërtonin për shkak të diskriminimit nga pushtuesi. Akullin e thyen Shaban Hajrullahu, Avdullah Vokrri, Shaban Hajdari, Ejup Bekteshi, Esat Mehmeti, Xhafer Meta, Hajrush Rama etj, ata ishin ndër lojtarët e parë Shqiptar në këtë Klub i cili gjatë garimit herë në një ligë e herë në tjetrën kishte vështirësi të shumta e sidomos financiare.

Nga ky Klub dolën shumë breza të lojtarëve të kalibrave të ndryshëm si legjenda Fadil Vokrri që emri talenti dhe loja e tij trondit edhe futbollin në ish Jugosllavi. Pas okupimit në vitet e 90-ta, K.F. "Llapi" ishte i pari ekip që hoqi dorë nga garat e okupatorit dhe iu bashkua pavarësimit të klubit kosovar. Pas luftës Klubi u ballafaqua me probleme të natyrave të ndryshme por assesi të dorëzohet falë punës së organeve komunale, donatorëve, lojatareve dhe stafit drejtues si Selatin Vokrri, Esat Mehmeti, Basri Muçolli, Emin Ajvazi, Idriz Mehmeti e të tjerë.
Në vitin 2013, Klubin e mori z.Tahir Batatina i cili filloj ta bëjë riorganizimin e tij dhe me ardhjen e vëllezërve Batatina në krye të Klubit ekipi filloj të këndellet, të ketë stabilitet dhe rezultate të vazhdueshme, formuan akademinë e Klubit ku stërvitin breza të ndryshëm të rinjsh.
Klubi ka edhe ekipin e femrave që është fanar i sukseseve aty ku garojnë.
Klubi "Llapi" ka arritur të fitojë dy herë kupën e Kosovës, ka dalë edhe në gara të fituesve të Kupës në Evropë e që është sukses i madh, prej një fushe që çdo herë ishte e rënduar nga kushtet atmosferike dhe balta, tribuna me dërrasa të kalbura, zhveshtore të mykosura, sot çdo gjë ka ndryshuar për së miri. Falë ndihmës së Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, qeverisjes komunale dhe vëllezërve Batatina, stadiumi është bërë me standarde evropiane ku kohët e fundit po luhen edhe ndeshjet ndërkombëtare, stadium që dikur quhej Stadiumi i Qytetit kurse tani ka kohë që mban emrin e ish komandantit të UÇK-së Zahir Pajaziti.
Duhet cekur se ndihmë për garimin e klubit kanë dhënë edhe mediat e shkruara dhe elektronike, Enver Hyseni i Radio Llapit, Fazli Veliu i Radio Kosovës, dhe Dalip Vokrri për gazetën Sport Plus, nuk i ka ndalur vapa, bora e as shiu që të jenë pranë klubit për të informuar opinionin e gjerë.
Siç dihet për mbarëvajtjen e një klubi duhet të ketë mjetet e shumta financiare prandaj ne si legjislativ komunal duhet t'i dalim në ndihmë sepse Klubi "Llapi" është i gjithë qytetarëve të Komunës tonë, prandaj në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim K.F. "Llapi" me mbështetje financiare në vlerë prej 20,000.00€, duke i uruar suksese në garat e radhës.
z.Qendrim Softolli, theksoi, sa i përket kërkesës për mbështetje të K.F. "Llapi", në parim jam për, sepse duhet të mbështeten të gjitha klubet sportive, jo vetëm Llapi, por të gjitha ato klube që ushtrojnë aktivitete sportive, mirëpo kam një këshill për Kryetarin e Komunës që të jetë më i kujdesshëm në deklarata e tij publike ngase pastaj po i bie "t'i haj fjalët e veta".
Një shqetësim tjetër po e ngrisë sepse të gjithë ne e dimë që ky Kuvend ka marrë një vendim para 2 viteve për ndarjen e mjeteve financiare për familjet në nevojë, kanë kaluar 2 vite dhe asnjë lëvizje nuk është bërë në këtë drejtim.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kjo është një mbledhje e jashtëzakonshme andaj lus të gjithë që të mos dalim nga tema sipas pikës përkatëse të rendit të ditës.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuari Kryesues i Kuvendit, lidhur me këtë që e potencove, në rend dite nuk ishte as historia e K.F. "Llapi" që e diskutoj (*RrRrRrRr*) kolegia parafolëse.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, in nderuari z.Ekrem Rrahmani, tema ishte për K.F. "Llapi" dhe nuk ishte temë jashtë rendit të ditës.
z.Ekrem Rrahmani, theksoi, lidhur me çështjen, a mund të na shpjegoni se a kemi bazë ligjore për marrjen e një vendimi të tillë, nëse dëshirojmë të bëjmë fushatë që të votojmë ne këtu e pastaj të mbetet pezull kjo procedurë atëherë nuk e di se çfarë veprimi do të marrim kur ju e cekët se nuk dihet baza ligjore e këtij vendimi, prandaj ju them mos të marrim vendime të ngutshme por të pyesim sepse Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk është larg, Ministri është i juaji. Pra ta dimë saktë se çfarë po votojmë ne edhe pse kjo shumë është 20,000.00€, njëherë keni deklaruar me fjalët "tuxhar" pastaj jo nuk është "tuxhar", pasi që me 20,000.oo€ qenka kollaj me i ndreq punët me të.

znj.Mimoza Abdullahu, theksoi, ne Grupi i PDK-së e mbështesim kërkesën për mjete financiare për K.F. "Llapi" dhe vetëm i urojmë suksese.
z.Pajtim Balaj, drejtor i DKRS, theksoi, lidhur me propozimin e anëtarit të LDK-së, ne në kuadër të buxheti që kemi si Drejtori nuk kemi mundësi në këtë kohë në stinorin dimëror t'i japim më shumë mjete financiare, ndërsa për pjesën e mbetur në vitin 2024 mund të bisedojmë kur mundësitë buxhetore janë më të mëdha dhe mund të japim një ndihmë më të madhe, përndryshe duhet pasur parasysh që ndihma që ne si Komunë po i japim K.F. "Llapi" nuk është vetëm kjo ndihmë që jepet sot sepse në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit jemi duke e përgatitur investimin që ka vlerën 1,000,000.oo€ për mbulojën e Stadiumit dhe rritjen e kapaciteteve të tij ku do të përfshihen edhe reflektorët që vijnë nga federata.
Kjo ndihmë nuk kufizohet në 20,000.00€ e as në 150,000.00€, por do të kaloj në shumë 1,000,000.oo€ që do të investohen për K.F. "Llapi".
Në kuadër të buxhetit të DKRS-së nuk ekziston mundësia buxhetore që të ndihmohet më shumë K.F. "Llapi", ndërsa sa për sqarim te baza ligjore nuk thash që Kuvendi nuk ka bazë ligjore sepse nuk jam kompetent të bëjë vlerësime të tilla, por DKRS nuk mund t'i përgjigjet kërkesave të tilla sepse si Drejtori nuk ka bazë ligjore për ndarje të një shume të tillë, prandaj ne e kemi sjellë këtë kërkesë para Kuvendit.
z.Ragip Fetahu, theksoi, përkrahja financiare për K.F. "Llapi" nuk është asnjëherë e mjaftueshme por unë kisha një pyetje për drejtorin z.Pajtim Balaj, kjo shumë buxhetore që është paraparë për ndihmë financiare këtë Klub, a është në kuadër të përkrahjes së OJQ-ve dhe grupeve lokale apo është i ndarë.
z.Pajtim Balaj, drejtor i DKRS, theksoi, ky buxhet vjen nga kategoria e subvencioneve por jo nga OJQ-të, kjo për shkak që sikurse K.F. "Llapi" të ishte i regjistruar si OJQ do të kishte mundësi të aplikonte në thirrjen publike për ndarje të subvencioneve, mirëpo Klubi vepron si SH.P.K dhe si i tillë nuk mund të përkrahet drejtpërdrejtë nga Drejtoria përmes thirrjeve publike, rrjedhimisht ata kanë bërë një kërkesë të tillë të cilën ne po ia paraqesim Kuvendit, por buxheti vjen nga kategoria subvencione.
znj.Sebastina Vokrri, theksoi, nëse kolegu kish dëgjuar me vëmendje nuk iu kishte dukur (RrRrRr..), por disa persona këtu janë mësuar vetëm të flasim e mos të dëgjojnë.
Edhe një pyetje për drejtorin e DKRS, kur do të mund të ekzekutohen këto mjete për K.F. "Llapi".
z.Pajtim Balaj, drejtor - DKRS-së, theksoi, kjo është çështje e DBF-së, nuk mund ta them këtë.
z.Xhevdet Maloku, theksoi, ndihma për K.F. "Llapi" gjithmonë është e mirëseardhur, por unë mendoj se në bazë të kërkesës së Klubit kam parë që kërkesa është afërsisht 50,000.00€ për subvencionim, mendoj se shuma 20,000.00€ është shumë pak, prandaj sa do pak t'i afrohemi shumës së kërkuar do ishte më mirë, një rritje sado e vogël e kësaj shume që do jepte një kontribut sa do që të jetë ai.
z.Artrit Mulliqi, theksoi, çka më bëri përshtypje gjatë kësaj seance është që gjatë pikës së parë kur ishte në pyetje falja e tatimit në pronë për qytetarët që ishte një çështje që e prek secilin qytetarë u bë thirrje që mos të votohet për këtë pikë, kurse tani kur është në pyetje që të subvencionohet individi do të thotë po bëhet thirrje për votim, dhe nëse nuk e dini pronar i K.F. "Llapi" është një individ ose është Shoqëri Aksionare e që ne e dimë që është e familjes Batatina.
Po më ndërhyni e që më duket se keni një problem që mësohet në klasën e parë që kur të flet dikush duhet të dëgjohet sigurisht se mësuesit e klasës së parë nuk munden të jenë krenarë në qoftë se ju shohin, jeni duke më qitë jashtë temës se jeni duke më ndërpre fjalimin, kështu që më lëni të përfundoj fjalimin pastaj ju merreni fjalën.

Kur bëhet fjalë për pagesa të individëve po kërkohet shtim i buxhetit, kjo tregon jo ndjeshmëri ndaj parave kur kemi mundësi subvencione të caktuara me para të caktuara që po fliten këtu t'i orientojmë në mënyra shumë më të mira edhe tek shtresat që kanë më shumë nevojë se sa që është K.F."Llapi".

znj.Donjeta Sheqiri, theksoi, vetëm desha t'jua rikujtoj nëse kanë harruar sepse u tha Klubi është biznes individual, por ne nuk e dimë që është biznes individual, përndryshe besoj se duhet t'ia rikujtojmë që edhe Komuna ka aksione në K.F. "Llapi", ndërsa shuma prej 20,000.00€ janë shumë pak e që ndoshta nuk iu dalin as sytë për t'i larë në mëngjes.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nuk më shkon për fytyre që të shtyhem me gjininë e kundërt dhe nuk e pata ndërmend të replikoj, por meqë më etiketoj edhe më detyroj të replikoj.

Kolegia në fjalë doli dhe e lexoj një histori që ia ka shkruar babai i saj, përmendi emra dhe të gjithë i përmendi për me lënë në fund babain e saj kinse gazetar i sportit, mandej pati persona që nuk i përmendi e që e kanë dhënë jetën për klubin e Llapit siç janë vëllezërit Simnica nga fshati Siboc, por doli në foltore për të bërë monolog duke thënë dëgjomni mua, prandaj e them që nuk e dëgjoj askënd unë kur tregon përralla, për më shumë e them se nuk ka thirrje në Komunë prej se është Komuna nga pas lufta që nuk shkruan emri Dalip Vokrri e mori seren, Dalip Vokrri e mori kultivatorin, etj, s'ka send që s'ka marrë, kurse kolegia në fjalë del këtu dhe më kallxon përralla.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, nuk e di çka ka kundër parafolësi që unë të dal dhe të tregoj pak historinë e K.F. "Llapi". Pastaj çka ke ti kundër babait tim (i drejtohet z.Ekrem Rrahmanit), babain tim e njeh një Podujevë, ai ka punuar si gazetarë në kohët më të vështira të K.F. "Llapi", a ke diçka kundër, ndërsa sa i përket subvencioneve që u përmenden, nëse babi im nuk i ka plotësuar kushtet përse s'keni dalë me ankesë, nëse ai nuk i ka plotësuar kriteret atëherë përse ka fituar subvencion. Babi im punon si fermer më shumë se 20 vite kështu që të lutem të kesh kujdes dhe mos hy në çështje personale sepse unë nuk kam asgjë personale madje as emrin nuk ua përmenda dhe nuk iu referova askujt, kështu që kujdes herëve tjera.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DKRS-së, theksoi, ka dy sqarime, e para K.F. "Llapi" është privatizuar vite më parë dhe Komuna nuk është aksionare, tjetra tek shuma që u përmend 50,000.00€, Klubi në fjalë nuk ka kërkuar ndonjë shumë specifike por ka kërkuar mbështetje financiare në bazë të mundësive që ka, kjo është për sezonin vjeshtor, kurse është pjesa tjetër e vitit ku mundemi sërish të diskutojmë dhe t'i shikojmë mundësitë për mbështetje financiare.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, Kultura për që ka një rritje për të cilën e kemi diskutuar disa herë dhe për çka krenohemi që kemi bërë rritje shumë të madhe të buxhetit në kulturë rini dhe sport nga 50,000.00€ që ka qenë në 200,000.00€ që është tani, prap se prap i tërë buxheti në kategorinë e subvencioneve në DKRS është 200,000.00€ dhe këtu bëhet fjalë për mbështetjen e OJQ-ve, aktiviteteve kulturore por edhe Klubet sportive të cilat Komuna e Podujevës ka shumë.

Tani në kuadër të kësaj shume buxhetore besoj se kjo shumë e propozuar është reale sepse në çoftë se Klubi i Hendbollit ka qenë përfituese e shumës 4000€, atëherë përse duhet t'i merre Klubi i futbollit 150,000.00€ edhe pse nuk ekziston ajo mundësi sepse maksimumi i mundësive është shuma 20,000.00€, për më shumë nuk kemi mundësi, madje nuk kemi mundësi të rritim as buxhetin në kategorinë e subvencioneve për arsye se ne tani kemi një buxhet të planifikuar dhe miratuar në kuadër të qarkores Buxhetore të Ministrisë së Financave edhe për vitin 2024 ku sërish DKRS në kategorinë e subvencioneve ka shumën 200,000.00€ e që i bie se nëse Klubit të Futbollit i japim 150,000.00€ asnjë Klub tjetër sportiv në Komunën e Podujevës nuk do të mund të merr asnjë ndihmë financiare e që besoj se pastaj do të ishte ndarje e padrejtë buxhetore ndaj Klubeve tjera sportive.

z.Shpejtim Bulliqi, **Kryetar i Komunës**, theksoi, u mendova të marrë ose jo fjalën mirëpo kur po dëgjoj gjithë këto që po thuhen vërtetë mendova që është mirë t'ju them dhe t'jua rikujtoj disa gjëra për këtë Klub dhe për situatën e tij e që ju LDK besoj që e dini më së miri se qysh është.
E vërejta që paksa ju ka mbet në mendje që si Komunë jemi aksionare në Klub, realisht Komuna ka qenë sepse si Klub ka qenë i Komunës por tani nuk jemi, mirëpo nuk keni faj sepse ka qenë një aksionar por që me letra nuk ka qenë, pra ka qenë aksionar në hije ashtu, andaj ndoshta ajo ju ka mbet në mendje që duhet të vazhdohet ende, nëse nuk e dini një gjë të tillë atëherë del që vonë keni ardh në LDK dhe nuk kam çfarë t'ju bëjë unë tani.
Pra unë nuk e kam bërë këtë Klub kështu siç është tani, as privat e as ashtu siç ka qenë më përpara, ju e dini që keni bërë, ky Kuvend dhe ajo shumicë që ka qenë më parë dhe madje e dinë procesin shumë mirë qysh ka shkuar disa më të moshuar që jeni këtu, por nuk dëshiroj të kthehem në historik të asaj.
Sa i përket asaj se a duhet apo jo të përkrahet ky Klub ajo është një pyetje që mund të shtrohet, pastaj a është apo jo shumë e madhe financiare tani mund ta merrni me mend se ka apo jo ndokush interes nga kjo shumë buxhetore për vet faktin që është kjo shumë që është, unë besoj se tregon mjaftueshëm. Ne i kemi këto mundësi, është kërkesë e Klubit që është parashtruar në DKRS dhe kjo Drejtori e ka paraqitë një projekt propozim, andaj nëse e vlerësoni që është në rregull votojeni dhe shtyjeni përpara, nëse e vlerësoni që nuk është në rregull mund ta lëni dhe nuk ka kurrfarë telasheje absolut ngase nuk do të thotë që të gjitha kërkesat që bëhen këtu duhet të mbështeten.
Nëse ndokush ka ndonjë interes prej kësaj çështjeje është mirë të definohet se për çfarë interesi bëhet fjalë, nëse ka pas ndokush ka pasë më herët, por tani nuk ka askush kurrfarë interesi përveç faktit që ata të rinj meritojnë t'i stimulojmë për të vazhduar tutje.
Ne jemi të vetëdijshëm se shuma prej 20,000.00€ nuk është shumë e cila mund ta zgjidh problemin, por unë as nuk do ta banalizoja ashtu siç e bëtë ju, as për t'i larë sytë as asgjë, por është mundësi financiare në këtë fund vit që mund t'i bëhet konform kërkesës që e ka adresuar Klubi, prandaj e përsërisë që nëse e vlerësoni që është në rregull mund ta votoni dhe ta shtyni përpara, nëse mendoni se është pak dhe ju keni propozim tjetër dhe gjeni fonde se ku mund të merren ndoshta edhe mund të shikojmë një gjë të tillë, por ju jeni në dijeni se tani më jemi në përmbyllje të vitit buxhetor dhe DBF së bashku me DKRS kanë shikuar gjitha mundësitë dhe kanë ardh në përfundim ku dhe sa mund të bëhet kjo mbështetje e që ndoshta për këtë vlen edhe ajo fjala e urtë popullore (shtrij këmbët sa t'i mbërrin jorgani).
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ne mund të vëmë në votim propozimin e z.Valon Demollit për rritjen e kësaj shumë në 150,000.00€ mirëpo po i dëgjojmë edhe mundësit buxhetore që kemi si Komunë, madje edhe mund ta votojmë por të mos mund t'i sigurojmë paratë pastaj, këtu është problemi.
z.Valon Demolli, theksoi, përderisa ka mjete buxhetore të paguhet zhavorr nga buxheti i QKMF-së, përse nuk ka për sport.
Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, rreth kësaj çështje arsyetimet u bënë nga Ekzekutivi dhe unë nuk kam njohuri në këtë punë. Si do që të jetë unë e hedh në votim propozimin e z.Valon Demollit që kërkesa e KF "Llapi" të mbështet me shumën buxhetore 150,000.00€.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 32 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent, 11 vota ishin Për, 15 vota Kundër, 2 vota të Përmbajtura (të tjerët nuk morën pjesë në votim) nuk mbështetet Propozimi që shuma e mbështetjes financiare – subvencionimit të KF "Llapi" të jetë 150,000.00€.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani e hedhim në votim propozimin e sjellur që kërkesa e K.F. "Llapi" të mbështetet me mjete financiare në shumë 20,000.00€, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 32 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent, me 21 vota Për, asnjë votë Kundër, 1 votë të Përmbajtur (të tjerët nuk morën pjesë në votim) mbështetet kërkesa për mbështetje financiare Klubin e Futbollit K.F. "Llapi 1932" SH.P.K. Podujevë, sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, respektivisht: ndahen mjete financiare në shumë 20,000.00€ me destinim për subvencionimin e Klubit të Futbollit K.F. "Llapi 1932" SH.P.K. Podujevë, me qëllim të ndihmës financiare të Klubit në aktivitete dhe zhvillim të garave në Albi Mall Superligën e Kosovës, dhe atë nga buxheti i Komunës së Podujevës, kategoria subvencione dhe transfere, në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, shumë kjo e cila bartet në xhirollogarinë bankare të Klubit në fjalë, dhe që për zbatimin e këtij vendimi, proceduarve dhe dispozitave tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë subvencione do ta bëjnë Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:05

Procesverbalin e mbajti;
Enis Sheholli

Nr.Prot. 010060/04-0086529/23
Podujevë, **Kryesuesi i Kuvendit**
08 dhjetor 2023 **Hilmi Hoxha**

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 58 shkronja h), 14 dhe 17 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, neneve 13 dhe 8 paragrafi 3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Rregulloren (QRK) 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenin 61 paragrafi 1.8, nenin 17 dhe 19 paragrafi 1.3 Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

Propozon
VENDIM

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË VEÇANTË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHEN PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM GJATË VITIT 2024

Neni 1

Kuvendit të Komunës i propozohet për miratim Lista e veçantë e pronave të paluajtshme të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2024.

Neni 2

Lista sipas nenit 1 të këtij vendimi, për secilën pronë, përmban, arsyetimin e interesit publik dhe zhvillimit ekonomik të Komunës, të dhënat kadastrale, qëllimin e dhënies në shfrytëzim, destinimin e pronës, parashikimin e kohës së publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës përkatëse të paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Lista e veçantë e pronave të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2024, përfshirë edhe Certifikatën pronësore, kopjen e planit dhe dokumentacionin tjetër të nevojshëm për secilën pronë.

Neni 4

Pas shqyrtimit dhe miratimit nga Kuvendit i Komunës, për zbatimin e këtij vendimi si dhe procedurave tjera të parapara me Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, obligohet Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë në bashkëpunim dhe koordinim edhe me Drejtoritë tjera të Komunës varësisht fushveprimtarisë përkatëse.

Neni 5

Pas miratimit, Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bera me Rregulloren (QRK) nr.06/2021.

Nr.Pro: 02-463/06-0087501/23
Datë: 14.12.2023
Podujevë

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi

Adresa: Rr "Nuhi Gashi" Pn – 11000, Podujevë – Republika e Kosovës

LISTA E VEÇANTË E PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHEN PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM GJATË VITIT 2024

Nr.r	Të dhënat kadastrale të pronës	Arsyetimi i interesit publik dhe zhvillimit ekonomik	Data e publikimit të njoftimit	Periudha kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës	Destinimi sipas Hartës Zonale Kadastrale
1	Paluajtshmëria e evidentuar në çertifikatën pronësore me Nr.Pro:08-942/06-0086689/23 të datës: 13.12.2023 Njësia kadastrale **P-00893-0** me sipërfaqe **8879m²**, kullosë me klasë 3 në vendin e quajtur "Statofcët" në **Zonën Kadastrale Batllavë**	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastralë është Mars-Qershor 2024	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër	Zonë Pyjore

Adresa: Rr "Nuhi Gashi" Pn – 11000, Podujevë – Republika e Kosovës

2	Paluajtshmëria e evidentuar në çertifikatën pronësore me Nr.Pro:08-942/06-0086689/23 të datës: 13.12.2023 Njësia Kadastrale **P-02159-0** me sipërfaqe **24587 m²**, kullosë me klasë 4 në vendin e quajtur "Zallishte" në **Zonën Kadastrale Batllavë**	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastralë është Mars-Qershor 2024	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër	Zonë Pyjore
3	Paluajtshmëria e evidentuar në çertifikatën pronësore me Nr.Pro:08-942/06-0086689/23 të datës: 13.12.2023 Njësia kadastrale **P-00425-1** me sipërfaqe **133555m²**, Arë e klasës 7 në vendin e quajtur "Bellasicë" **Zona Kadastrale Zakut**	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastralë është Mars-Qershor 2024	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër	Zonë Bujqësore
4	Paluajtshmëria e evidentuar në çertifikatën pronësore me Nr.Pro:08-942/06-0086689/23 të datës: 13.12.2023 Njësia kadastrale **P-00427-0** me sipërfaqe **172523 m²**, Tokë Jo Pjellore në vendin e quajtur "Bellasicë"**Zona Kadastrale Zakut**	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastralë është Mars-Qershor 2024	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër	Zonë Pyjore

Adresa: Rr "Nuhi Gashi" Pn – 11000, Podujevë – Republika e Kosovës

Në bazë të vendimit nr. prot.01-070/04-0071632/23, të datës 27.09.2023, është ngritur Grupi Punues për hartimin e Planit Operativ Emergjent me qëllim të përmirësimit të mëtejmë të , zhvillimin të përgjithshëm të sistemit të menaxhimit të Emergjencave, përmbushjes së objektivave në kuadër të Komunës së Podujevës.

Grupi punues ka përgatitur Draftin e Planit Operativ Emergjent Lokal që paraqet një dokument strategjik dhe konsiderohet si mjet i rëndësishëm parandalues për menaxhimin e emergjencave.

Drafti i Planit Operativ Emergjent Lokal është përgatitur dhe proceduar në Kuvend më datë 27 shtator 2023, diskutimi publik ka zgjatë 30 ditë përkatësisht prej datës 04 tetor 2023, deri më datë 03 nëntor 2023, brenda kësaj periudhe kohore propozimet, sugjerimet, vërejtjet, kanë pasë mundësinë që të paraqiten sa ka zgjatë koha e diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike në e-mail adresën **afrim.mulliqi@rks-gov.net** të cilat pastaj përcjellën në Drejtorinë përkatëse, brenda periudhës së diskutimit/konsulltimit publik.

Debati i përgjithshëm publik me qytetarë është caktuar të mbahet më 31 tetor 2023 duke filluar nga **ora 17;00,** në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhes - salla e mbledhjeve, mirëpo edhe pse janë bërë njoftimet dhe lajmërimet për t'i paraqitur propozimet, vërejtjet apo sqarimet nuk ka pasur pjesëmarrës në diskutim publik e as ndonjë vërejtje sugjerim apo propozim të adresuar në formë fizike dhe elektronike.

Nr.prot. 10-334/07-0084530/23
Podujevë, datë 29 nëntor 2023

Raportin e përgatiti
Afrim Mulliqi

PLANI OPERATIV EMERGJENT LOKAL

PËR

KOMUNËN E PODUJEVËS

PLANI BAZIK

Korrik 2023

Plani Operativ Emergjent Lokal

TABELA E PËRMBAJTJES

PLANI BAZIK 1
SHPALLJA-DEKRETIMI 4
Dekretimi i Planit Operativ Emergjent 4
APROVIMI DHE IMPLEMENTIMI 5
VENDIM 5
PLANI OPERATIV EMERGJENT 5
REXHISTRI I NDRYSHIMEVE/FRESKIMI 6
VËRTETIMI I RISHIQIMEVE 7
LISTA E SHPËRNDARJES 7
Hyrje 8
QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I PLANIT 8
Elementet e Planit 8
Shtrirja 9
II. SITUATA DHE SUPOZIMET (merret nga dokumenti i vlerësimit të rrezikut) 9
Parashikimet 11
III.ORGANIZIMI DHE CAKTIMI I (PËRGJEGJËSIVE) 12
A. DREJTIMI 12
Sektori Privat 14
1. Managjeri i Qendres Operative Emergjente (QOE) - Koordinatori i Menaxhimit Emergjent (KME): 14
2. Zyrtari për Informim Publik (ZIP), (dhe çështjeve të jashtme - FME # 15) 15
DETYRAT E DREJTORIVE, SEKTOREVE DHE ZYRAVE 16
ZYRA E INFORMIMIT PUBLIK 16
Komunikimi (FME # 2): 16
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM 16
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIREQENIE SOCIALE 17
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM 17
INSPEKTORET E PARANDALIMIT NGA ZJARRI DHE FATKEQESIVE TJERA 18
POLICIA E KOSOVES 18
C. SEKTORI I PLANIFIKIMIT (Koordinatori i Menaxhimit Emergjent ose ndonjë i deleguar): 18
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM 19
D. SEKTORI I LOGJISTIKËS (Kordinatori i Menaxhimit Emergjent ose një i deleguar): 19
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM &SEKTORI PRIVAT 19
1. Transporti (FME # 1): 19
2. Punët Publike dhe të Inxhinierisë (FME#3): 19
KRYQI I KUQ I KOSOVES – dega Podujevë 20
Kujdesi Masiv, Strehimit dhe Sherbimeve Humane (FME#6): 20
DREJTORIA E ADMINISTRATËS 20
4. Dega e Mbështetjes me Burime (FME#7): 20
DREJTORIA PER BUJQESI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL 21
KORPORATA ELEKTRO ENERGJETIKE – KEDS Podujevë 21
6. Dega e Energjisë (FME#12): 21
E. SEKTORI I FINANCAVE DHE ADMINISTRATES (KME, zyrtarët e zgjedhur dhe / ose si të deleguar): 21
DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA DHE PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM 21

Rimëkëmbja e Komunitetit dhe zbutja (FME #14): 21
III. KONCEPTI I OPERACIONEVE 22
RENDITJA E VEPRIMIT 22
ORGANIZIMI 22
V. ADMINISTRATA DHE LOGJISTIKA 32
VI. Zhvillimi dhe Mirëmbajtja e Planit 33
VI. TRAJNIMI DHE USHTRIMET A. Autoriteti i Trajnimeve 34
VII. KËRKESAT PËR PLAN, MIRËMBAJTJA DHE SHPËRNDARJA 36
Shtojca 1 – Fjalori i Termeve Kryesore 36
Shtojca 2 – Lista e Shkurtesave 41
Shtojca 3 – Autoriteti dhe Referencat 42
Shtojca4 – Matrica e përgjegjësive 42
Shtojca 5 – bartja e Autoritetit 43
Shtojca 6 – Lista e Shpërndarjes së POE 44
Shtojca 7 – Dokumentet Esenciale 45

***SHPALLJA*-DEKRETIMI**

Dekretimi i Planit Operativ Emergjent

Me autoritetin tim të dhënë dhe në bazë Ligjit mbi Qeverisjen Lokale me **rregullore/politika të dekretimit,** si **kryetar i Komunës së Podujevës** me autoritetin përfundimtar për menaxhimin emergjent në **Komunë,** Unë shpall Planin e Operacioneve Emergjent ("Plani Operativ Emergjent Lokal") të **Komunës**
Plani për **Komunën e Podujevës** ofron reagimin ndaj emergjencave dhe fatkeqësive me qëllim të shpëtimit të jetëve; mbrojtjes së shëndetit publik, sigurisë dhe të mirave materiale; restaurimin e shërbimeve esenciale; dhe për të mundësuar dhe asistuar në rimëkëmbjen ekonomike.

Plani është në pajtim me Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, në pajtim me Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave në Republikën e Kosovë dhe në harmoni me Planin e Reagimit Kombëtar.

Koordinatori i Menaxhimit Emergjent i Komunës së Podujevës në emër të kryetarit të Komunës është i autorizuar të aktivizoj Qendrën Operative Emergjente (QOE), me qëllim të drejtimit dhe kontrollit të operacioneve emergjente të Komunës. Plotësimi i QOE do ta strukturoj implemenitmin e planit.

Për më tepër, **Koordinatori i Menaxhimit Emergjent i Komunës** gjithashtu është i autorizuar që në koordinim me **Kryetarin e Komunës** ta plotësoj/amandamentoj Planin, sipas nevojës për ofrimin dhe krijimin e sigurisë dhe shëndetit të vazhdueshëm të banorëve dhe të mirave materiale të **Komunës**.

Sipas Planit, kryesuesi i secilës drejtori/departament, sektor/divizion apo agjenci të **Komunës** do të caktoj nga një udhëheqës dhe së paku nga një zëvendës për drejtorinë/departamentin, sektorin/divizionin apo agjencinë përkatëse.

Ky Dekret hynë në fuqi me nënshkrimin e tij dhe mbetet në fuqi të plotë derisa të amandamentohet apo shfuqizohet nga dekretet tjera.

Kryetari i Komunës së Podujevës

Dita, Data, Muaji, Viti

APROVIMI DHE IMPLEMENTIMI

VENDIM

PLANI OPERATIV EMERGJENT

DUKE PAS PARASYSH QË: Kryetari i Komunës së Podujevës dhe Asambleja Komunale njohin nevojën për tu përgatitur, reaguar dhe rimëkëmbur nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqesite e shkaktuara nga faktori njeri; dhe

DUKE PAS PARASYSH QË: Kryetari i Komunës ka përgjegjësi ligjore për siguri dhe mirëqenje të qytetarëve dhe vizitorëve të tij; dhe

DUKE PAS PARASYSH QË: **Kryetari** i Komunes ka vendosur dhe caktuar Drejtor dhe Koordinator të Menaxhimti Emergjent:

Pas shqyrtimit të Planit Operativ Emergjent, Kryetari i Komunës së Podujevës dhe Asambleja Komunale, VENDOSIN që ky POE është miratuar zyrtarisht; dhe

ËSHTË VENDOSUR DHE URDHËRUAR që Drejtori i Drejtorise Komunale per Mbrojtje dhe Shpetim (DKMSH), apo i emëruari i tij/saj, janë caktuar me detyrë dhe autorizuar ta mbajnë dhe rishikojnë/ripunojnë sipas nevojës këtë dokument, gjatë periudhës 3 ose 4 vjeqare, apo derisa të urdhërohet ndryshe nga ky bord.

_____

Kryetari i Komunës,
Kryesuesi i Asamblesë

VËRTETON:

_____

Sekretari i asamblese

Ky Plan Operativ Emergjent Miratohet me datën Nentor/Dhjetor 2023

REXHISTRI I NDRYSHIMEVE/FRESKIMI

Të gjitha plotësimet e këtij dokumenti duhet të përcillen. Ky seksion duhet të përfshij një lloj formati për të bërë një gjë të tillë. Së paku duhet të përmbajë: datën e ndryshimit, faqen apo seksionin e ndryshuar, emrin dhe titullin e përsonit që ka bërë ndryshimin.

NDRYSHIMI NUMËR	DATA E NDRYSHIMIT	DATA E REXHISTRIMIT	NDRYSHIMET U BËNË NGA (Nënshkrimi ose inicialet)

VËRTETIMI I RISHIQIMEVE

Rishikimi i rregullt (3 ose 4 vjeqar) i këtij Plani Operativ Emergjent duhet të bëhët nga Drejtoria per Mbrojtje dhe shpetim. Ky rishikim duhet të vërtetohet përmes Kordinatorit komunal të Menaxhimit Emergjent ose Drejtorit te Drejtorise per Mbrojtje dhe Shpetim.

Data	Nënshkrimi

LISTA E SHPËRNDARJES

Pranuesit e kopjes së këtij Plani:

kopja	organizata	Pp pranimi individual I kopjes	D

Plani Operativ Emergjent Lokal

Hyrje

Kriza dhe emergjenca mund të ndodhë në çdo kohë dhe mund të godas një person, një ndërtesë të vetme apo tërë komunitetin. Ky dokument është Plan Operativ Emergjent i Komunës së Podujevës. Emergjencat shkaktojnë konfuzion dhe stres për të gjithë të përfshirët në te. Në mënyrë që të minimizohen këto efekte, aktivizimi dhe implementimi fillestar i planit emergjent duhet të bëhet në mënyrë të qetë dhe të qëndrueshme. Implementimi efikas i planit do të ofroj drejtim të qartë, përgjegjësi dhe vijimsi të kontrollit, për zyrtarët kryesor dhe administratorët. Idea themelore e çdo plani emergjent të ndërtuar mirë, është minimizimi i rreziqeve të mundshme ndaj individëve dhe të mirave materiale gjatë një emergjence. Me qëllim të zvogëlimit të rrezikut të një emergjence, duhet të bëhen vlerësime dhe përmirësime vjetore në planin emergjent.

QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I PLANIT

Qëllimi i këtij plani është që të përshkruaj ato aktivitete që do të ndermerren nga ana e qeverisë komunale dhe zyrtarë të tjerë të komunitetit për të mbrojtur jetën dhe pronën e qytetarëve në rast të një fatkeqësie natyrore ose të shkaktuar nga faktori njeri, duke përfshirë terrorizmin, emergjencat ose fatkeqësitë, si dhe nevojat e Menaxhimit Emergjent, për të patur një Plan të menaxhimit të fatkeqësive për komunën. Plani përbëhet nga: Plani Bazik(themelor), i cili përshkruan parimet dhe doktrinën, Njoftimet dhe doracakun e burimeve, e cila parashikon Listën kontaktuese, mjetet e nevojshme dhe burimet lokale; dhe një seri listash kontrolluese funksionale të cilat japin hollësi për realizimin e specifikave të operacionit. Qëllimi i këtij plani është që të përfshin të gjitha aktivitetet në të gjithë ciklin e menaxhimit të emergjencave, duke përfshirë parandalimin, përgatitjen, reagimin si dhe fazat e rimëkëmbjes. Ky plan është i zbatueshëm për të gjitha organizatat që veprojnë për reagim ose në emër të qeverisë ose të qytetarëve te Podujevës. "Planet e Incidenteve specifike "mund të shtohen në këtë plan nëse është e nevojshme, për të përballuar në mënyrë më efikase kërkesat e paraqitura nga rreziqet e veçanta. Planet e tilla janë të renditura në Shtojcën C.

Elementet e Planit

Ky plan përbëhet nga plani bazik, shtojcat, anekset e funksioneve mbështetëse emergjente dhe anekset për incidente. Plani bazik ofron një përshkrim të qasjes së Komunës ndaj reagimit dhe operacioneve emergjente. Shpjegon politikat, organizimet dhe detyrat që do të përfshihen në reagim ndaj një emergjence. Shtojcat japin definicionin e termeve dhe shkurtesave të përdorura në planin bazik dhe janë vend për çdo skicë, tabelë apo formë mbështetëse. Anekset e funksioneve mbështetëse emergjente përqendrohen në mënyrë të hollësishme në përgjegjësitë, detyrat dhe veprimet operative specifike për përmbushjen e funksionit të caktuar operativ emergjent; ndërsa anekset për incidente përqendrohen në çdo nevojë shtesë të planifikimit apo reagimit, përtej planit të reagimit bazik për skenarin e ngjarjeve të caktuara.

Shtrirja

Shtrirja përcakton reagimin ndaj emergjencave/fatkeqësive për të cilin plani u jep të drejt drejtorive, agjencive dhe lokaliteteve.

Ky plan dhe të gjithë përbërësit e tij janë të aplikueshëm për tërë Komunën e Podujevës .

Personeli apo partnerët të cilët jane te ngarkuar me detyra në këtë Plan do të kenë qasje dhe do të jenë të njoftuar me POE.

II. SITUATA DHE SUPOZIMET (merret nga dokumenti i vlerësimit të rrezikut)

Qyteti/ Komuna e Podujevës, shtrihet në verilindje të Kosovës dhe ka sipërfaqe prej 633 Km2. Në bazë të disa vlerësimeve ka rreth 88499 banorë, ndërsa qyteti i Podujevës 23453 banorë. Përbëhet nga 78 fshatra, me 139 banorë në një km2. 15,141 nxënës ndjekin mësimet në të gjitha nivelet e arsimit, të ndara në 37 SHFMU (Shkolla fillore të mesme e të ulëta), tri SHML (Shkolla të mesme të larta) dhe tri çerdhe për fëmijë. Me gjithsej 1514 të punësuar. Operojnë 3162 biznese me rreth 12.020 të punësuar. Numri më i madh i këtyre bizneseve janë të orientuara ne veprimtari tregtare, shërbyese dhe zejtare.

Nga gjithsej 63.259 ha të sipërfaqes së Komunës, fondi i tokës bujqësore merr pjesë me 33.295 Ha, ndërsa me pyje janë të mbuluara 25.968 Ha. Me investime të reja dhe ruajtjen e këtij fondi të tokës bujqësore garantohet një bazë e mirë për zhvillimin ekonomik të komunës. Lumi i Llap dhe Burimi i Lumit Batllava janë burimet kryesore të ujit në Komunën e Podujevës.
Komuna e Podujevës është pjesë periferike e Kosovës e cila dallohet si njësi administrative me elemente fiziko-gjeografike të veçanta. Shtrihet në pjesën veri-lindore të Kosovës, dhe në jug-perëndim nëpërmes grykës së Lebanës ka lidhje të mira natyrore me fushëgropën e Kosovës për katsishtë Prishtinën. Kufizohet me komunën e Prishtinës në jug, në gjatësi të vogël me Obiliqin, Vushtrrinë, Mitrovicën dhe Leposaviqin në perëndim. E tërë pjesa veriore dhe lindore kufizohet me Republikën e Serbisë. Gjatësia totale e vijës kufitare është 175,2 km.
Komuna e Podujevës shtrihet në mes të gjerësisë gjeografike veriore 420 45I 37II (mali i Braina) dhe 430 08I 19II (mali Pilatovicë) dhe gjatësisë gjeografike lindore 200 58I 13II (mali Shatorrica) dhe 210 26I 37II (maja Ibrahimit).

Komuna ose shteti me të cilën kufizohet	Gjatësia km	Përqindja	Kuota më e lartë metra	Kuota më e ulët metra
Prishtinë	37,39	21,3	1110	550
Obiliq	2,8	1,6	838	710
Vushtrri	18,9	10,8	1220	710
Mitrovicë	17,52	10,0	1540	1080
Leposaviq	7,7	4,4	1770	1400
R. e Serbisë	90,9	51,9	1720	650
Gjithsej	175,21	100		

Plani Operativ Emergjent Lokal

Sipas analizës së rreziqeve të zonës, rreziqet kryesore (sipas prioritetit) në Qytet/Komunë janë vërshimet, zjarret, erozionet, përmbytjet, etj.

Qeveria e Komunës është përgjegjëse për mirëmbajtjen e një plani operativ emergjent dhe kapacitetit reagues për mbrojtjen e jetëve dhe të mirave materiale të qytetarëve nga efektet e fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga faktori njeri.

Plani i Operacioneve Emergjente i Komunës se Podujevës është hartuar në pajitm me rregulloren per hartimin e planeve te reagimit emergjent (http://ame.rks-gov.net). Ky plan do të punohet, përpunohet, ushtrohet, përmirësohet dhe ri-shpërndahet një herë në 4 vjet.

Sipas identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve të hartuar për Komunën e Podujevë.

Rreziku natyror	**Shkallëzimi i karakterit**
Shtërngatë dhe stuhi	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Mot i lig	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Zjarr fushoro-malor	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Zjarr i madh	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Mungesë e Resurseve	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Tërmet	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Vërshim	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Nga faktori Njeri	
Terrorizëm	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Aktivitet kriminal	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Vlerësim i rrezikut të brendshëm	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Epidemi	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Epidemi në Masë	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Trazirë Civile	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Aksident Kimik	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Aksident Radiologjik	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Aksident Biologjik	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Aksident me Eksploziv	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Aksident Nuklear	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Dështim i Komunikimit	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë
Dështimi i Infrastrukturës	Fare/Kufizuar/Mesatar/Kuptimplotë

Treguesit e rreziqeve dhe vlerësimi i dobësive për ngjarjen e rreziqeve mesatare dhe kuptim plote janë punuar për Komunën e Podujevës. Treguesit e rreziqeve kanë vlerësuar shkallën e rrezikut ndaj të cilit janë ekspozuar ndërtesat nga rreziku përkatës. Vlerësimi i cenueshme risë ka llogaritur efektin e mundshëm nëse hapësira e caktuar do të goditet nga rreziku përkatës.
Vlerësimi i kapacitetit mund të përfshihet por edhe t'i referohet planit. Vlerësimi i kapacitetit tregon forcën dhe aftësinë e personelit në procedurat emergjente, rëndësinë e sistemit të instaluar dhe testuar të alarmimit emergjent përgjatë tërë komunitetit dhe ri-fuqizon nevojën e vazhdimit të përpjekjeve për

integrimin e reagimit me planet reaguese të lokaliteteve.

Vlerësimi i Gatishmërisë së Komunitetit Lokal (VGKL).
Procesi për të përcaktuar kapacitetet dhe kufizimet e komunitetit për tu përgatitur dhe për të reaguar ndaj rreziqeve të identifikuara duhet të plotësohet në baza vjetore. VGKL mund të jetë mjet esencial dhe të përdoret për identifikimin e resurseve dhe gjithashtu të përdoret për identifikimin e fushave ku mund të ndërtohen Memorandume të Mirëkuptimit dhe Marrëveshjet për Ndihmë Reciproke.

Parashikimet

Popullata e Komunës se Podujevës është përafërsisht 88499 banorë me tiparet demografike në vijim (ASK 2011):

- **Përqindja e banorëve të moshës 0-19 Vjet :39.89%(35,307 banor)**
- **Përqindja e banorëve të moshës 20-64: 54.38%(48,127 banor)**
- **Përqindja e banorëve të moshës +65: 5.75%(5,065 Banor)**
- **Përqindja e banorëve me kafshë shtëpiake:6002 fermer 5.56% e popullsis**
- **Përqindja e banorëve me nevoja të veçanta:0.09% (878 banor)**

Në tiparet e terrenit të cilat do mund të ndikonin në implementimin e planit përfshihen:

E. Trajnimet, Listat kontrolluese të reagimit dhe dokumentet shoqëruese të tjera, janë në bazë të deklaratave 2 A., B., dhe C. e D. Të këtij plani.

F. Bashkangjitur duhet pasqyruar asistencën tjetër komunave dhe qeverive në pajtim me dispozitat e shkruara ndërqeveritare dhe ndihmë reciproke për mbështetje nga marrëveshjet në fuqi në kohën e emergjencave. (marreveshjet nderkomunale, marreveshjet me sektorin privat, dhe OJQ-te tjera)

G. Kur burimet komunale janë plotësisht të angazhuara dhe ndihma reciproke nga juridiksionet përreth është e dobësuar, Qendra Operative Emergjente (QOE) 112 ne Podujevë është në dispozicion për oordinimin e mbështetjes, që të ndihmojë për të përmbush nevojat e paplotësuara. Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se Regjioni, kërkon ndihmë shtesë, ajo mund kërkohet nga Regjionet tjera, në fund të fundit, mund të kërkoni ndihmë nga qeveria në lidhje me një fatkeqësi të jashtëzakonshme apo të madhe.

H. Në rast se ndodh një evakuim i banorëve të komunës, osc të ndonjë pjese të saj, Shumica e të zhvendosurve do të përdorin burimet e tyre të transportit. Përveç kësaj, ata që posedojnë kafshë, kafshët e tyre shtëpiake do ti transportojnë vet. Ata që posedojnë ferma blegtorale apo kafshë të tjera do të marrin masa të përshtatshme për evakuim.

I. Objektet me Rëndësi të veqantë (Speciale), personat juridik etj, do të zhvillojnë, koordinojnë dhe furnizojnë organizatat e Menaxhimit Emergjent të qytetit me planet e tyre operative emergjente të zbatueshme sipas kodeve, ligjeve, rregullave dhe kërkesave lokale dhe shtetërore.

J. Çdo strukturë e rregulluar, fushat, (amandamentet dhe aktet ri-autorizuese), centralet elektrik, etj, që paraqesin një rrezik të veçantë, do të zhvillojnë, koordinojnë dhe furnizojnë me plane emergjente dhe procedura, agjencionet dhe drejtoritë lokale, regjionale dhe shtetërore, të zbatueshme sipas, kodeve,

ligjeve, rregullave dhe kërkesave.

K. Kurdo që kërkohet, zyrtari i zgjedhur, do të deklarojë një emergjencë për komunën, në pajtim me dispozitat e Menaxhimit të Emergjencave. Në mënyrë të njejtë, në rast të ndonjë emergjence që kërkon veprime mbrojtëse (evakuim ose strehimin), zyrtarët e zgjedhur, do ta bëjnë rekomandimin dhe komunikojnë informacionin për popullsinë me mjete të përshtatshme duke përfshirë Sistemin Emergjent të Alarmimit (SEA), në linjë raportuese ose përmes teknologjive tjera.

L. Në rast se ndodh një zhvendosje, segmente të popullsisë do të duhet të transportohen nga zona e prekur, në vend të sigurt. Varësisht nga faktorët e rrezikut, zonat për strehim mund të jenë të vendosura brenda ose jashtë komunës.

M. Strehimoret emergjente do të aktivizohen nga komuna duke përdorur shkollat publike ose kolegje publike / universitetet (sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera) ose strehimore tjera të caktuara. Strehimoret do të jenë nën përkujdesjen e Organizatave Vullnetare Aktive në fatkeqësit, të tilla si: Kryqi i Kuq i Kosovës. Operatorët e strehimoreve do të sigurojnë nevojat bazë duke përfshirë: ushqimin, veshmbathjen, strehimin, kujdesin mjekësor bazë, dhe të mbajnë regjistrin e banorëve në strehimore.

N. Objektet kritike, si, spitalet, ujesjellesi dhe objektet e kujdesit masiv, duhet të kenë një nivel të jashtëzakonshëm alternativ të energjisë dhe burimeve të energjisë në dispozicion, për të akomoduar për situatat që kanë të bëjnë me humbjen e energjisë komerciale apo burimeve të tjera të energjisë.

III.ORGANIZIMI DHE CAKTIMI I (PËRGJEGJËSIVE)

Ligji Për fatkeqësitë Natyrore dhe fatkeqësitë tjera parashikon që organizatat e shërbimeve emergjente dhe operacionet strukturohen rreth qeverisë ekzistuese konstituive.

Një program i suksesshëm lokal i menaxhimit emergjent përfshin zyrtarët e qeverisë lokale, agjencitë e qeverisë lokale, sektorin privat dhe organizatat jo fitimprurese. Rolet e tyre janë të përmbledhura në vijim.

A. DREJTIMI

Zyrtarët e Zgjedhur-Kryetari i Komunës

- Mbrojnë jetët dhe pronat e qytetarëve;
- Vendosin programin lokal të menaxhimit emergjent;
- Caktojnë menaxherin emergjent lokal; dhe
- Miratojnë dhe Shpallin Planin e Operacioneve Emergjente (POE).

a. Janë përgjegjës për krijimin (vendosjen e një organizimi të Menaxhimit Emergjent komunal;

b. Sigurimin e vazhdimësisë së operacioneve;

c. Vendosjen e linjave të vazhdimësisë për postet kyçe;

d. Caktojnë QOE të drejtorive dhe ato Alternative,

e. Përgatisin dhe mirëmbajnë këto QOE në përputhje me Planin Operative Emergjente Qendrore

f. Themelimin, dhe pajisjen e stafit të një QOE;

g. Rekomandojnë një KME për emërim në përputhje me Kodin e Shërbimit të Menaxhimit Emergjent;

h. Lëshojnë njoftimet emergjente për fatkeqësi dhe rekomandojnë veprimet mbrojtëse (evakuimin, ose vend strehimin) në qoftë se justifikohet situata.
dhe

i. Aplikojnë për fonde shtetërore pas fatkeqësisë. Themelimi i Planit të Lehtësimit / Zbutjes

Kryetari i Komunës apo Drejtori i DKMSH-se

- Përcakton nevojën për evakuim nga zonat e rrezikuara;
- Ushtron drejtimin dhe kontrollin nga QOE gjatë operacioneve të fatkeqësive; dhe
- Mban përgjegjësinë e plotë për mirëmbajtjen dhe plotësimin e planit.

Koordinatori i Menaxhimit Emergjent

Siguron që QOE lokale është në gjendje konstante të gatishmërisë;
Harton dhe mirëmban POE;
Merr detyra të caktuara në mungesë të drejtorit të DKMSH-se; dhe siguron që POE të rishikohet, plotësohet dhe përmirësohet çdo katër vjet.

Drejtoritë Komunale

Hartojnë dhe mirëmbajnë plane dhe procedura standarde operative (PSO);
Përcaktojnë burimet e furnizimeve, pajisjeve dhe transportit emergjent;
Negociojnë dhe mirëmbajnë marrëveshjet për ndihmë reciproke të përcaktuara në plan;
Mirëmbajnë shënime dhe dokumente përkatëse të lidhura me shpenzimet për fatkeqësi;
Mbrojnë dhe ruajnë shënimet/regjistrat esencial për vijimësinë e qeverisjes; dhe
Krijojnë dhe mirëmbajnë listën e radhës së autoritetit të personelit kyç emergjent.

Funksionet Mbështetëse Emergjente (FME)

Një FME është grupim i kapaciteteve te qeverisjes lokale dhe kapacitetet e caktuara të sektorit privat në një struktur organizative për të ofruar mbështetje, resurse, implementim të programit dhe shërbime emergjente të cilat kanë më shumë të ngjarë të nevoiten gjatë emergjencave.

Institucionet operative dhe drejtoritë lokale marrin pjesë në strukturën e FME si koordinator, agjenci parësore të reagimit dhe/apo agjenci mbështetëse, sipas nevojës së mbështetjes së aktiviteteve të menaxhimit të incidentit. FME-të:

Hartojnë dhe mirëmbajnë plane të detajizuara dhe Procedura Standarde Operative (PSO) për t'i mbështet nevojat e tyre funksionale;
Përcaktojnë burimet e furnizimeve, pajisjeve dhe transportit emergjent;
Mbajnë shënime të sakta të dokumenteve për shpenzimet e lidhura me fatkeqësi;
Vazhdojnë të jenë përgjegjës për mbrojtjen dhe ruajtjen e shënimeve/të dhënave esenciale për vijimësinë e qeverisjes; dhe
Vendosin radhën e autorizimeve për personelin kyç emergjent.

Sektori Privat

Sektori privat mund të merret me shumë role të ndryshme, ku mund të përfshihen:

Pronar privat i infrastrukturës kritike;
Organizëm reagues (si: shërbimi privat ambulantor, shërbim i pastrimit ambiental);
Palë e sistemuar apo përgjegjëse: operuesit e pronarëve të objekteve të caktuara të sistemuara mund të kenë përgjegjësi sipas ligjit të përgatiten për incidente dhe t'i parandalojnë ato; apo
Pjestar i organizatës lokale emergjente.

Sektori privat ka përgjegjësinë të:
Planifikoj për veten dhe veprimtarin e tij gatishmërinë, zvogëlimin, reagimin dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë;
Ketë njohuri për procedurat dhe planet lokale të reagimit emergjent; dhe
Zbatojnë veprime mbrojtëse sipas nevojës apo me kërkesën e drejtorit te DKMSH-se.

1. Managjeri i Qendres Operative Emergjente (QOE) - Koordinatori i Menaxhimit Emergjent (KME):

a. Përgatit dhe mban një objekt për QOE të komunës, për shpalljen; rishikimet dhe informatat më të reja për zyrtarët e zgjedhur siç kërkohet;

b. Mirëmban koordinim me Regjionin, dhe jep informata të menjëhershme për emergjenca, që ka në dispozicion;

c. Në bashkërendim me Regjionin, identifikon dobësitë dhe rreziqet që mund të ndikojnë në komunë;

d. Identifikon burimet brenda komunës të cilat mund të përdoren për t'u përgjigjur në një situate emergjente apo fatkeqësi dhe u përgjigjet kërkesave për burime të nevojshme për ndihmë reciproke me partnerët ose regjionin;

c. Zhvillon dhe mirëmbanmban një staf të trajnuar për reagim emergjent aktual dhe një listë kontrolluese të përshtatshme për nevojat emergjent dhe burimet e komunitetit;

f. Mobilizon QOE dhe vepron ose delegon funksionet e Drejtimit (Komandës) në kuadër të QOE gjatë një emergjence;

g. Grumbullon të dhënat për shpenzimet për kryerjen e operacioneve Emergjente; dhe

h. Ndjek trajnime dhe punëtori të siguruara nga regjioni dhe burimet tjera për të mbajtur në aftësi të përhershme Planifikimin dhe Procedurat e Reagimit Emergjent.

2. Zyrtari për Informim Publik (ZIP), (dhe çështjeve të jashtme - FME # 15)

a. Zhvillon dhe mban një listë kontrolluese për funksionin e Informimit Publik.

b. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE;

c. Reagon në QOE ose në teren, sipas nevojës;

d. Koordinon të gjitha informatat e lëshuara në publik apo në media me ZP të regjionit dhe / Qendrën e Përbashkët të Informimit.

e. Koordinon ndërgjegjësimin e publikut për informacion të mediave para një incidenti dhe siguron informata të sakta dhe në kohë për reagim dhe rimëkëmbjen e operacioneve;

f. Këshillon zyrtarët e zgjedhur të Informimit Publik dhe KME aktiviteteve;

g. Zhvillon dhe harton njoftimet e parapregaditura (të shkruara) për përdorim në një kohë të jashtëzakonshme;

h. Zhvillon dhe shpërndan informacionin publik / materialet arsimore lidhur me masat që do të merren gjatë një emergjence duke përfshirë informacionet në lidhje me vend strehimin, rrugët evakuimit, vendet e strehimoreve, transportit dhe vendet e marrjes, etj;

i. Ndërhyn me ZPI të Qarkut dhe Shtetit për zbatim.

j. Punon si një pjesë e Qendrës për Informim të Përbashkët (QPIP), të përcaktuar nga zyrtarët e Regjionit apo Shtetit.

3. Zyrtari për Siguri - Monitoron kushtet e sigurisë dhe zhvillon masat për të siguruar parrezikshmërinë e të gjithë personelit të caktuar.

4. Zyrtari Ndërlidhës - shërben si Kontakt i parë në mbështetjen e

Agjencive për të ndihmuar në incident.

B. SEKTORI I OPERATIVËS (Koordinatori i Menaxhimit Emergjent) ose një i deleguar): është përgjegjës për të siguruar përmbushjen e përgjegjësive të të gjitha degëve të caktuara. Shefi i Sektorit duhet të mbajë përgjegjësi, për drejtorët e degëve ose të deleguarit e tyre, varësisht nga situata dhe disponueshmërinë e personelit. Shefi i Seksionit koordinon punën në bazë të detyrave të caktuara nga drejtori i degës dhe raporton te menaxheri i QOE për përparimin dhe statusin e misioneve të caktuara.

DETYRAT E DREJTORIVE, SEKTOREVE DHE ZYRAVE

ZYRA E INFORMIMIT PUBLIK

Komunikimi (FME # 2):

a. Zhvillon dhe mban një listë kontrolluese për Funksionimin e Komunikimit;
b. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE;
c. Trajnon anëtarë të stafit në funksionimin e sistemit të komunikimit;
d. Siguron mundësinë për të komunikuar ndërmjet QOE, operacioneve në terren dhe Regjionit;
e. Ndihmon në njoftimin e qytetarëve të komunës;
f. Reagon në QOE ose në vendin e Incidentit (fushë), sipas nevojës;
g. Këshillon zyrtarët e zgjedhur të komunikimit dhe KME rreth aktiviteteve dhe
h. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi i Seksionit.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM

2. **Zjarrfikja (FME # 4):**

a. Zhvillon dhe mban një listë kontrolluese për funksionin e zjarrfikësve;
b. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE;
c. Raporton në QOE ose në Vendin e Incidentit, sipas nevojës;
d. Koordinon shërbimet e zjarrfikjes dhe shpëtimit;
e. Merr përgjegjësinë primare për rrugët e njoftimit të publikut;
f. Ndihmon në evakuimin e qytetarëve të prekur, veçanërisht atyre që janë të institucionalizuar, të bllokuar ose të plagosur;
g. Ofron ndriqim dhe burim energjie në rast të ndaljes së energjisë
h. Ofron ndriqim emergjent dhe gjenerimin e energjisë për dritat;
i. Ndihmon në operacionet e riaftësimit dhe pastrimin e rrenojave;
j. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe KME rreth aktiviteteve të zjarrfikjes dhe shpëtimit; dhe
k. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi i Seksionit.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIREQENIE SOCIALE

3. Shëndetësia /Mjekësia (FME # 8):

a. Zhvillon dhe mban një listë kontrolluese për funksionin e shërbimeve Shëndetësore / Mjekësore;
b. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE;
c. Raporton në QOE ose në vendin e incidentit, sipas nevojës;
d. Mirëmban një listë të banorëve me nevoja të veçanta, duke furnizuar me kopje komunën dhe Regjionin;
e. Koordinon aktivitetet e urgjencës mjekësore brenda komunës;
f. Koordinon nevojat institucionale për transport nëse bëhet e domosdoshme Zhvendosja ose evakuimi për spitalet, shtëpitë e shëndetit, kujdesit ditor, Shtëpitë e kujdesit personal apo kujdestarëve të objekteve;
g. Koordinon shërbimet mjekësore të nevojshme për të mbështetur operacionet e Strehimit;
h. Cakton koordinatorin për shëndetin riprodhues që do të koordinoj dhe mbikëqyrë zbatimin e Pakos Minimale të Shërbimeve Bazike:

- shërbimet për shëndet të nënave dhe të të porsalindurve;
- parandalimin e dhunës në baza gjinore përfshirë dhunën seksuale;
- parandalimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme;
- planifikimin familjar dhe planifikimin për shërbime të shëndetit seksual dhe riprodhues gjithëpërfshirëse të integruar në kujdesin parësor shëndetësor.

i. Ndihmon në operacionet e kërkimit dhe shpëtimit;
j. Ndihmon në shërbimet e morgut;
k. Ndihmon në dispozitat e inokulimit për parandalimin e sëmundjeve;
l. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe KME rreth veprimtarive të Shëndetit Publik / Shërbimeve Mjekësore;
m. Koordinon imunizimin e punëtorëve Emergjent;
n. I referohet nevojave të Transportit (Kujdesi shëndetësor, Nevojave Speciale) Për Zyrtarët e logjistikës;
nj. Koordinon dhe bashkëpunon me njësitë e përshtatshme dhe agjencitë lidhur me çështjet e shëndetit publik duke përfshirë edhe raportimin e sëmundjeve Ngjitëse dhe krijimin e zonave karantinë; dhe
nj. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi i Seksionit.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM

4. Kerkimi dhe Shpëtimi (FME # 9):

a. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE;
b. Raporton në QOE ose në vendin e incidentit, sipas nevojës;
c. Koordinon shërbimet e kërkimit dhe shpëtimit;
d. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe të KME rreth kërkimit dhe shpëtimit; dhe
e. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi i Seksionit.

INSPEKTORET E PARANDALIMIT NGA ZJARRI DHE FATKEQESIVE TJERA

5. Reagimi për Naftë dhe Materie të Rrezikshme (FME # 10):

a. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE;
b. Raporton Brenda QOE ose në vendin e Incidentit sipas, nevojës;
c. Koordinon me ekipin për Materie të Rrezikshme siq është e përshtatshme;
d. Koordinon dezinfektimin dhe monitorimin e qytetarëve të prekur dhe punëtorëve emergjent pas ekspozimit nga rreziqet kimike ose radiologjike;
e. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe të KME rreth aktiviteteve për MAT.RREZ;
f. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi i Seksionit.

POLICIA E KOSOVES

6. Siguria Publike dhe Jorrezikshmëria - (FME # 13):
a. Zhvillon dhe mban një listë kontrolluese për Siguri Publike dhe funksionimit të Sigurise;
b. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE;
c. Raporton brenda QOE ose në vendin e incidentit, sipas nevojës;
d. Koordinon shërbimet e sigurisë dhe zbatimit të ligjit;
e. Krijon siguri dhe mbrojtje të objekteve të rëndësishme, duke përfshirë QOE;
f. Siguron qasje dhe kontroll të trafikut për rreth dhe në zonat e prekura;
g. Ndihmon përmes linjave të alarmimit dhe njoftimit për popullatën e kërcënuar.
h. Ndihmon ne evakuimin e qytetarëve të prekur, veçanërisht atyre që janë të institucionalizuar, ngujuar ose të plagosur;
i. Ndihmon në instalimin e shenjave emergjente të jashtëzakonshme dhe paisjeve tjera të lëvizjes së trafikut;
j. Ndihmon në operacionet e kërkimit dhe shpëtimit;
k. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe të KME për Siguri Publike dhe operacionet e Sigurise;
l. Themelon dhe siguron shërbimet e sigurisë të lokacioneve për strehim që operojnë në vende të komunës;
m. Ndihmon operatorët për strehim në shfaqjen e klientëve me histori kriminale duke përfshirë kundërvajtësit seksual.
n. Themelon patrullat e sigurisë për ndonjë zonë të evakuuar, nëse lejojnë kushtet;
o. Bashkëpunon me agjencitë tjera të zbatimit të ligjit në lidhje me hetimet, sigurinë e vendit të krimit etj. dhe
f. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuara nga Shefi i Seksionit.

C. SEKTORI I PLANIFIKIMIT (Koordinatori i Menaxhimit Emergjent ose ndonjë i deleguar):

është përgjegjës për të siguruar funksionimin e Menaxhimit Emergjent sipas përgjegjësive. Shefi i Seksionit duhet mbajë përgjegjësi për drejtimin e degës ose të delegojë detyra, varësisht nga situata dhe

disponueshmëria e personelit. Shefi i Seksionit koordinon punën dhe detyrat e caktuara nga drejtori i degës dhe i raporton menaxherit të QOE në përparimin dhe statusin e misioneve të caktuara.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM

1. Menaxhimit Emergjent- (FME#5):

a. Mbledh, vlerëson dhe jep informacion rreth incidentit;

b. Përcakton statusin dhe ndjekjen (binarët) e burimeve;

c. Përgatit dhe dokumenton Planet e Veprimit të Incidenteve;

d. Shtron kërkesa për raporte të Informacioneve dhe skemave;

e. Mbikëqyr përgatitjen e Planit të Menaxhimit të Incidenteve;

f. Mbledh informata për strategjitë alternative; dhe

g. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi i Sektorit.

D. SEKTORI I LOGJISTIKËS (Kordinatori i Menaxhimit Emergjent ose një i deleguar):
është përgjegjës për të siguruar përmbushjen e përgjegjësive të të gjitha degët e caktuara.Shefi i Seksionit duhet të mbajë përgjegjësitë e drejtorit të degës, ose të delegojë ato, varësisht nga situata dhe disponueshmëria e personelit.Shefi i Seksionit koordinon punën me detyra e caktuara nga drejtori i degës dhe i raporton Menaxherit të QOE në përparimin dhe statusin e detyrave të caktuara.Sektori i Logjistikës gjithashtu siguron mbështetje logjistike për QOE (vetvetiu).

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM &SEKTORI PRIVAT

1. Transporti (FME # 1):

a. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE;
b. Reagon në brenda QOE ose në vendin e incidentit, sipas nevojës;
c. Mirëmban një listë të burimeve të Transportit dhe informatat kontaktuese duke përfshirë kapacitetet në komuna;
d. Koordinon burimet e furnizimit gjatë transportit emergjente;
e. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe KME rreth aktiviteteve të Transportit dhe
f. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi Sektorit.

2. Punët Publike dhe të Inxhinierisë (FME#3):

a. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE;
b. Raporton brenda QOE ose në vendin e incidentit, sipas nevojës;

c. Mirëmban një listë të Punëve Publike të aseteve dhe burimeve;
d. Shërben si ndërlidhje në mes Punëve Publike të komunës dhe e QOE;
e. Koordinon caktimin e burimeve të Punëve Publike;
f. Siguron informacion mbi ujin, kanalizimin, ndërtimit të rrugëve dhe riparimin, inxhinjeringun, inspektimit të ndërtimit dhe të mirëmbajtjes;
g. Këshillon zyrtarët e zgjedhur KME rreth Punëve Publike dhe veprimtarive Inxhinierike; dhe
h. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi I Sektorit.

KRYQI I KUQ I KOSOVES – dega Podujevë

Kujdesi Masiv, Strehimit dhe Sherbimeve Humane (FME#6):
a. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE;
b. Raporton brenda QOE ose në Vendin e Incidentit, sipas nevojës;
c. Ndihmon Administratorin Emergjent të Komunes (FME # 6) në mbajtjen e një liste të Kujdesit masiv - objektet për Strehim duke përfshirë kapacitetet;
d. Koordinon me Kryqin e Kuq të Kosovës dhe agjencive të tjera të përshtatshme;
e. Përgjigjet në Kërkesat për kujdes Masiv – Strehim, në mbështetjen e regjionit gjatë emergjencave;
f. Koordinon me FME#1 (Transporti) dhe FME#7 (Menaxhimi i Burimeve) në lidhje me çështjet e evakuimit;
g. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe KME rreth Kujdesit Masiv, zhvendosjen dhe veprimtarive të strehimit; dhe
h. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi i Seksionit.

DREJTORIA E ADMINISTRATËS

4. Dega e Mbështetjes me Burime (FME#7):

a. Koordinon për materialet, shërbimet dhe objektet në mbështetjen emergjente;

b. Zhvillon procedurat për urdhëra të shpejt për furnizime dhe pajisje dhe përcjell shpërndarjen dhe përdorimin e tyre;

c. Merr pjesë në përgatitjen e Planit të Menaxhimit të Incidenteve;

d. Lehtëson marrjen e furnizimeve emergjente për punëtorët duke përfshirë ushqimin, ujin, dhe nevojat themelore;

e. Lehtëson blerjen e furnizimeve, siç kërkohet, me ushqim, ujë, dhe nevojat për operatorët e strehimit;

f. Siguron, ndjek dhe koordinon burimet e transportit (autobusë, furgonë, ambulancat shtesë, kamionët, etj);

g. Ngrit përqendrimin fushor për burimet e furnizimit dhe të transportit;

h. Merr furnizime, Koordinon shpërndarjen e karburantit emergjent për furnizimin e automjeteve emergjente, objekteve kritike të përshtatshme për të evakuuar, si dhe;

i. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi i Seksionit.

DREJTORIA PER BUJQESI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

5. Dega e Burimeve Bujqësore dhe Natyrore (FME#11):
a. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE;
b. Raporton brenda QOE ose në V.I.(vendin e incidentit), sipas nevojës;
c. Mban një listë për ushqimin dhe kujdesin e kafshëve dhe kontrollin e pasurive;
d. Shërben si ndërlidhje në mes të QOE dhe qështjeve të ushqimit për komunitetit;
e. Koordinon shpërndarjen e informacionit për ushqimin dhe kujdesin e kafshëve dhe kontrollin e komunitetit;
f. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe KME e lidhur me e kujdesin bujqësor, të kafshëve dhe qështjet e kontrollit;
g. Koordinon aktivitetet lokale për strehim të kafshëve me Zyrtarët e Regjionit me FME#11 dhe ekipin ndërlidhës Reagues për Kafshë;dhe
h. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuara nga Shefi i Seksionit.

KORPORATA ELEKTRO ENERGJETIKE – KEDS Podujevë

6. Dega e Energjisë (FME#12):

a. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE;
b. Raporton brenda QOE ose në V.I., sipas nevojës;
c. Mban një listë për energji dhe shërbime të pasurive;
d. Shërben si ndërlidhje në mes të QOE dhe shërbimeve komunale të energjisë /;
e. Koordinon shpërndarjen e informacionit në mes të degës së energjisë / shërbimeve komunale;
f. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe KME të energjisë lidhur me / çështjet e dobishme; dhe
g. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuar nga Shefi i Seksionit.

E. SEKTORI I FINANCAVE DHE ADMINISTRATES (KME, zyrtarët e zgjedhur dhe / ose si të deleguar):
është përgjegjës për të siguruar përmbushjen e përgjegjësive të Rimëkëmbjes Afatgjate dhe zbutjes.Shefi i Seksionit duhet të të mbajë përgjegjësinë e drejtorit të degës, ose t`ua delegojë atyre, varësisht nga situata dhe disponueshmëria e personelit.Shefi i Seksionit koordinon punën e degës sipas detyrave të caktuara nga drejtori dhe përcjell raportet te menaxheri I QOE për përparimin dhe statusin e misioneve të caktuara. Sektori gjithashtu mban regjistrimet e financës dhe personelit për aktivitetet reaguese.

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA DHE PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM

Rimëkëmbja e Komunitetit dhe zbutja (FME #14):

a. Mbikëqyr dhe mban nën kontroll të gjitha analizat e kostos financiare dhe aktivitetet që lidhen me emergjencën;

b. Përcakton koston dhe të dhënat kohore të personelit;
c. Koordinon zhvillimin e vlerësimit të demit;
d. Fillon planifikimin për rimëkëmbjen e funksioneve jetike të komunitetit, dhe
e. Kryen përgjegjësitë tjera të caktuara nga Shefi Seksionit.

A. Zyrtarët e zgjedhur (kryetari dhe drejtorë e drejtorive), janë përgjegjës për mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve. Ata ushtrojnë mbikqyrjen primare dhe kontrollin mbi të katër fazat (parandalimin, përgatitjen, reagimin dhe rimëkëmbjen) e jashtëzakonshme për menaxhimin emergjent të aktiviteteve në kuadër të komunës.

B. Koordinatori Lokal i Menaxhimit Emergjent (KLME-DKMSH-sc ose ndonjë drejtor tjetër i emëruar), do të veprojë në emër të zyrtarëve të zgjedhur. Qendra Operative Emergjent (QOE) është caktuar nga komuna, dhe mund të aktivizohet nga Koordinatori I Menaxhimit Emergjent (KME) apo, zyrtarëve të zgjedhur gjatë një emergjence. Një zëvëndës i KME-së dhe një QOE Alternative do të caktohen për të funksionuar në rastin kur KME primar dhe QOE nuk janë në dispozicion.

C.Ky plan përfshin parimet për "të gjitha rreziqet" sepse shumica e funksioneve të reagimit emergjent, janë të njëjta, pavarësisht nga rreziku. KME do të bëjë mobilizimin e burimeve të personelit që kërkohet sipas situatës emegjente.


D. KME dhe zyrtarët e zgjedhur do të bëjnë marëveshje për ndihmë reciproke me komunat fqinje për ndihmë reciproke emergjente nëse do të jetë e nevojshme.
E. **Komuna do të miratoj dhe të shfrytëzojë Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave (SIME)** dhe të **Sistemin e Komandimit të Incidenteve** (shih më poshtë).

III. KONCEPTI I OPERACIONEVE

RENDITJA E VEPRIMIT

Ky seksion përshkruan menaxhimin e incidentit dhe veprimet që shkojnë nga kërcënimi, njoftimi fillestar, deri në fillim të koordinimit të përpjekjeve për të vlerësuar dhe të ndërprerë kërcënimin, përgatitjen për aktivizimin strukturës së FME-së, në vendosjen e burimeve për reagim dhe operacione në incident, dhe në mbështetje për rimëkëmbje.Këto veprime nuk ndodhin domosdoshmërisht në mënyrë të pjesëshme; shumë prej tyre janë në bashkëveprim, prandaj duhet të ndërmerren reagime individuale ose të shumëfishta ndaj këtyre incidenteve.

ORGANIZIMI



Kur qendra operative emergjente (QOE) lokale është e aktivizuar duhet të ketë koordinim midis menaxherit emergjent dhe komandantit të incidentit për të siguruar reagim të qëndrueshëm:

- *QOE ndjek strukturën e SKI dhe*
- *FME duhet të lidhen me stafin e SKI.*

1. **Komandanti i Incidentit (KI)**, do të trajnohet për vendin e incidentit në bazë të kërkesave të SIME-s (**Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave**). Në mënyrë të njejtë, stafi i QOE gjithashtu do të jetë i trajnuar sipas kërkesave të (SIME-s).

2. ***Post Komandën e Incidentit, në vendngjarje duke përdorur SKI;***


3. Sistemi i Komandimit të Incidenteve (SKI) duhet të ketë:

a. Hark një drejtimësh të kontrollit (staf prej 3 -7. optimale është 5);

b. Përgjegjshmëri të personelit (çdo person i raporton vetëm një person në zinxhirin e komandës); dhe


c. Poste funksionale të stafuara vetëm kur është e nevojshme (përgjegjësitë për çdo post që nuk është I plotësuar (punonjës) mbetet që në të ardhmen të plotësohen me pozita më të larta.

Post Komanda e Incidentit




Plani Operativ Emergjent Lokal


Skema në vijim është një shembull i stafit të një QOE. Më shumë detaje duhet të ofrohen në anekset FME.




Sektori i Operacioneve



FME-të e Shërbimeve Emergjente




FME-të e Shërbimeve Humane




FME-të e Mbështetjes së Infrastrukturës


Shënim: Të gjitha juridiksionet kan personel FME të mbështetjes së infrastruktures dhe mund të modifikohet sipas nevojës.



FME-të e Sektorit të Planifikimit



FME-të e Sektorit të Logjistikës



Sekuenca e Veprimit

Ky seksion përshkruan veprimet e menaxhimit të incidentit duke filluar nga njoftimi fillestar i kërcënimit, tek përpjekjet e hershme koordinuese të vlerësimit dhe penginit të kërcënimit, tek aktivizimi përgatitor i strukturës FME, deri tek dislokimi i resurseve në mbështetje të operacioneve të reagimit ndaj incidentit dhe operacioneve të rimëkëmbjes. Këto veprime nuk ndodhin patjetër sipas radhës; shumë prej tyre mund të ndërmerren njëkohësisht në reagim ndaj kërcënimeve apo incidenteve të vetme apo të shumfishta.

Operacionet e Zakonshme/ Jo-emergjente

Këto janë veprime që zbatohen gjatë fazës jo-emergjente ose periudhat fatkeqësie që do të përgatisin potencialet lokale për reagim nëse është e nevojshme.

Plani Operativ Emergjent Lokal

Këto janë veprime të cilat implementohen gjatë periudhave jo-emergjente apo fatkeqe të cilat do ta përgatisin lokalitetin për reagimin e mundshëm emergjent, nëse bëhet i domosdoshëm.

1. Pajisja e publikut me informacione dhe materiale edukative nëpërmjet gazetave lokale, broshurave, publikimeve në numratorët telefonik, veb-faqeve të komunës dhe mediave tjera.
2. Hartimi, shqyrtimi dhe stërvitja e planeve operative emergjente dhe procedurave standarde operative.
3. Sigurimi i saktësisë dhe besueshmërisë së listave të kontakteve emergjente, listave të resurseve dhe të kontraktuesve emergjent.
4. Plotësimi, rishikimi dhe mirëmbajtja e Planit Operativ Emergjent (POE).
5. POE lokal duhet të përfshijë dispozitën që siguron që të kontaktohet Departamenti i Shërbimeve të Judikaturës Kriminale dhe e Kompenzimit të lëndimeve Kriminale në rast të një emergjence ku ka viktima të llojit të përcaktuar sipas paragrafit xx të Ligjit xx.

VEPRIMET PARA-INCIDENTEVE-ALARMIMI DHE PARALAJMERIMI

Këto janë veprime që zbatohen në qoftë se Menaxheri Emergjent merr njoftimin për një ngjarje të jashtëzakonshme nga Qendra e Situatave ose paralamërime tjera nga burime të besueshme.

Veprimet për:

Komunikimi i njoftimeve dhe paralajmërime:

- *Shëndeti dhe siguria publike;*
- *Shëndeti dhe siguria e reaguesve;*
- *Mbrojtja e pronave; dhe*
- *Aktivizimi i pjesshëm i mundshëm i QOE.*
- Raporti i domosdoshëm për situatën para organeve të qeverisë lokale

1. Alarmo personelin e menaxhimit emergjent dhe cakto modelin e plotësimit me personel.
2. Përcaktoni masat mbrojtëse që duhet të implementohen në përgatitje për situatën.

VEPRIMET REAGUESE

Shembuj të reagimit dhe të veprimeve të ndërmarra për të ruajtur jetën, pronën, mjedisin, dhe gjendjen sociale, ekonomike, politike dhe struktura e këtij komuniteti.

- *Zbatimi i ligjit;*
- *Mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë së reaguesve;*
- *Zjarrfikja;*
- *Shërbimet mjekësore emergjente;*
- *Evakuimet;*
- *Shpërndarja e informacioneve publike;*
- *Veprimet për zvogëlimin e dëmeve shtesë;*
- *Kërkimi dhe shpëtimi urban;*
- *Shëndeti publik dhe shërbimet mjekësore;*
- *Shpërndarja e furnizimeve emergjente;*

- *Pastrimi i rrënojave; dhe*
- *Mbrojtja dhe restaurimi i infrastrukturës kritike.*

Disa çështje që duhet marrë në shqyrtim në këto momente gjat incidentit janë:
1. funksionet ditore të qeverisë që nuk kontribuojnë drejtpërdrejt në operacionet emergjente mund të jenë të pezulluara gjatë kohëzgjatje së reagimit emergjent.
2. Përpjekjet dhe burimet mund të jenë të ridrejtuara për të kryer një detyrë emergjente.
3. Zbatimi i evakuimit urdhërohet sipas nevojës.
4. Strehimoret e nevojshme hapen nga personeli i reagimit emergjent.

Sapo misionet dhe aktivitetet për reagim të menjëhershëm, për të shpëtuar jetën përfundojnë, theksi zhvendoset në operacionet reaguese të rimëkëmbjes, dhe nëse është e aplikueshme në zvogëlimin (zbutjen) e rrezikut.

VEPRIMET E RIMËKËMBJES

Këto veprime do të ndodhin pasi është zbatuar reagimi fillestar. Këto veprime do të ndihmojnë individët dhe komunitetet të kthehen në një qeverisje normale sa më shumë që është e realizueshme. Disa nga veprimet që mund të ketë nevojë të zbatohen gjatë periudhës së rimëkëmbjes janë:
• vlerësimi preliminar i dëmeve
• veprimet afatgjata të rimëkëmbjes
• pastrimi dhe rindërtimi i objekteve publike, bizneseve, dhe vendbanimeve;
• Ri-vendosja e banorëve dhe parandalimi i mëvonshëm i dëmeve të burimeve natyrore; dhe
• mbrojtja e vendeve kulturore dhe arkeologjike gjatë operacioneve tjera të rimëkëmbjes

Qështjet tjera gjatë operacioneve të rimëkëmbjes:

Hapja e një zyre të përbashkët fushore (ZPF), për të ndihmuar të prekurit nga fatkeqësia në qoftë se një ngjarje është deklaruar si Fatkeqësi (shtetërore apo lokale). Kjo zyrë është pika qendrore e komunikimit mes agjencive të shtetit dhe atyre lokale, si dhe organizatave vullnetare për kryerjen e programeve të asistencës së rimëkëmbjes.

1. Brenda 72 orëve të goditjes, bëhe Vlerësimi fillestar i dëmeve dhe paraqitet në QOEL (Qendra Operative Emergjente lokale ose (qendrore).

2. Bëhet vlerësimi i infrastrukturës kritike lokale dhe të përcaktimi i realizueshmërisë për ri-hyrje të banorëve.

3. Fillim i menjëhershëm i riparimeve elektrike, ujit të pijshëm, kanalizimeve, linjave, stacioneve etj.

Veprimet e zbutjes (zvogëlimit të rrezikut)

Këto veprime bëhen për të zvogëluar apo eliminuar rreziqet afat-gjata ndaj njerëzve dhe të mirave materiale dhe efektit të tyre anësor. Gjatë procesit të zbutjes, do duhej të adresohen këto çështje:

- *Granted e programeve për masat e zvoglimit të humbjeve (nëse janë);*
- *Shpërndarja e ekspertizës shkencore për zvoglimin e humbjeve në ndërtime;*

- *Koordinimi me operacionet e Sigurimeve Qendrore për Përmbytje dhe integrimi i zbutjes me përpjekjet tjera të programit;*
- *Bërja e pasqyrimit të rimëkëmbjes nga përmbytjet në hartë për të siguruar implemntim të shpejtë dhe të saktë të programeve të rimëkëmbjes ashtu edhe të zbutjes;*
- *Modelimi parashikues për mbrojtjen e aseteve kritike;*
- *Dokumentimi i hershëm i humbjeve të shmangura si rezultat i masave paraprake të zvogëlimit të rreziqeve; dhe*
- *Edukimi publik dhe tejkalimet e domosdoshme për zvogëlimin e humbjeve.*

1. Rishikoni Planin e Zvogëlimit të të Gjitha Rreziqeve dhe plotësoni sipas nevojës çdo veprim zbutës i cili do të mund të jetë i dobishëm në parandalimin e efekteve të ngjashme nga fatkeqësitë e ardhshme.
2. Punoni me Programin e Zbutjes të DKMSH-se për zhvillimin e projekteve për grante të zbutjes për të ndihmuar në fushat më të rrezikuara.
3. Implementoni masa zbutëse në rindërtimin e infrastrukturës së dëmtuar.

Shpallja e Gjendjes se Gatishmërisë

Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim do të ngrisë gjendjen e gatishmërisë sipas niveleve me vendim, kurdoherë që kërcënimi apo dukuria aktuale e fatkeqësisë është apo kërcënon të jetë e ashpërsisë dhe madhësisë së atillë e cila kërkon shpenzime domethënëse dhe reagim të koordinuar me qëllim të parandalimit apo lehtësimit të dëmit, humbjeve, mjerimit apo vuajtjeve. Niveli i gatishmërisë mund të shpallet nga Kryetari apo Drejtori i DKMSH-se në pajtim me bordin e qeverisjes lokale. Nëse trupi qeveritar nuk mund të mblidhet për shkak të fatkeqësisë apo rrethanave tjera urgjente, drejtori apo në mungesë të tij zëvendës drejtori duhet ta shpallë ekzistencën e një emergjence.

Aktivizimi i Qendrës Operative Emergjente (QOE)

-Menaxheri Emergjent apo koordinatori mund ta aktivizon QOE nëse ekzistojnë rrethanat në vijim:
-Kur ekziston kërcënim i pashmangshëm ndaj sigurisë apo shëndetit publik në shkallë të gjerë;
-Kur është i nevojshëm një reagim dhe koordinim i gjerë i shumë agjencioneve/juridiksioneve për zgjidhjen e një ngjarje emergjente/fatkeqësie apo rimëkëmbjen nga ajo;
-Kur fatkeqësia godet shumë nën ndarje politike brenda komunave apo qyteteve, të cilët varen nga po të njëjtat resurse për zgjidhjen e ngjarjeve të mëdha emergjente; dhe/apo
-Kur për kontrollin e ngjarjeve të mëdha emergjente apo fatkeqësie implementohen direktivat emergjente lokale.

Disponueshmëria e stafit dhe nevojave operacionale mund të lejojnë apo kërkojnë që të kombinohen/bashkohen, apo të mos plotësohen pozitat (përgjegjësitë barten nga pozicioni tjetër i lartë).

Komunikimi, Alarmimi dhe Paralajmërimi do të sigurohet për publikun përmes Sistemit të Alarmimit Emergjent (SAE). Sistemet tjera do të përdoren sipas mundësisë.

F. Kur QOE komunale është aktivizuar, KME do të bëjë kordinimin mes K.I. (Komandanti I Incidentit) në V.I (Vendin e Incidentit) dhe Komitetit komunal per mbrojtje dhe shpetim. Për të siguruar përputhshmëri me operacionet në vendin e incidentit, QOE gjithashtu do të ndjekë një Strukturë të komandës së Incidentit. KME do të marrë rolin e Managjerit të QOE (Drejtimi) dhe, fillimisht, të gjitha rolet e zbrazta, derisa personeli shtesë të mbërrijë në QOE, që KME të mund tua delegojë aktivitetet e tyre.

G. Pamjaftueshmeria e stafit dhe nevojat operacionale mund të lejojnë apo kërkojnë poste të kombinuara, ose pozitat të mos jenë plotësuara duke mbajtur përgjegjësitë për pozicionet e ardhshme të larta.

H. Diagrami i mësipërm është i ngjajshëm me Funksionet Mbështetëse Emergjente (FME) sipas stafit të SKI-së. Kjo shtrirje mund të modifikohet siç kërkohet nga situata e fatkeqësisë ose nevojave politike apo programatike të komunës.

I. Vazhdimësia e procedurave të qeverisë janë të specifikuara në listën e plotë të zyrtarëve të zgjedhur.

J. Kur KME merr njoftimin për një emergjencë nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent ose Instituti Hidrometeorologjik i Kosoves (IHMK) dhe divizioni i sizmologjise/Sherbimi Gjeologjik i Kosovës nga institucionet relevante, ose nga burime të besueshme të tjera, do të vie në konsiderim aktivizimi i pjesëshëm i QOE, dhe do të konsiderohet si gadishmëri emergjente.

K. Komunikimi, Vërejtja dhe alarmimi, do t`i sigurohen publikut nëpërmjet Sistemit Emergjent të Alarmimit (SEA), gjithashtu do të shfrytëzohen edhe Sistemet tjera në dispozicion.

L. Gjatë kohës jo-emergjente, informacionet në lidhje me planet e emergjente dhe veprimet që do të merren nga ana e publikut, në formën e informimit publik, dhe materialeve edukuese, do të sigurohen për publikun, nëpërmjet gazetave komunale, broshurave, drejtorive të botimeve telefonike, web - faqeve komunale etj.

M. Në rast se ndodh një evakuim(zhvendosje apo largim), popullsia (apo segmente të saj) do të evakuohen duke përdorur makinat e tyre, ose do të transportohen nga zona e prekur e identifikuar në vend të sigurt.Varësisht nga faktorët e rrezikut, zonat strehuese mund të jenë të vendosura Brenda ose jashtë komunës.

N. Të zhvendosurit pritet të ndjekin drejtimin dhe udhëheqjen e punëtorëve emergjent, koordinatorëve të trafikut, dhe zyrtarëve tjerë të caktuar emergjent. Rrugët e caktuara Para-evakuimit do të shfrytëzohen kurdo që janë të sigurta dhe praktike. Sektori kritik do të jetë në staf të personelit të kontrollit të trafikut për të lehtësuar një rrjedhë të organizuar të trafikut.

O. Punëtorët Emergjente duhet kompletuar" planet familjare" para emergjente në adresimin e çështjeve të tilla si transporti dhe vendin e evakuimit të menjëhershëm për anëtarë të familjes (bashkëshorti/ja dhe fëmijët).

V. ADMINISTRATA DHE LOGJISTIKA

Në këtë seksion duhet të adresohen me sa vijon:

- *Referencat për Marrveshjet e Ndihmës Reciproke*
- *Autorizimet dhe politikat mbi shtimin e stafit nëpërmjet riemrimit dhe aftësimit të stafit, kërkimin e vullnetarëve së bashku me provizionet përkatëse të detyrimeve;*
- *Politikat e përgjithshme mbi mbajtjen e shënimeve financiare, reportimin, përcjelljen e nevojave të resurseve, përcjelljen e burimit dhe përdorimit të resurseve dhe përfitimin e pronësisë mbi resurset.*

Të gjitha asetet (resurset humane dhe objektet dhe resurset e pajisjeve) e komunitetit do të bëhen fushveprim i /Kryetarit të Komunës së Podujevës për t'i drejtuar në çfardo mënyre për të reaguar ndaj një emergjence.

Kryetari i Komunës gjithashtu mund ta delegoj këtë autoritet tek i emruari i tij apo tek Koordinatori i Menaxhimit Emergjent ashtu siç shkruhet në dosjen e Delegimit të Atoritetit.
Përcaktoni politikat dhe procedurat për përcjelljen dhe raportimin e çdo shpenzimi për shkak të emergjencës. Në shumicën e rasteve, politikat e zakonshme të prokurimit dhe financimit do të mbesin në fuqi, por në rastet e jashtzakonshme, duhet të ndiqen provizione shtesë për ta rritë shpejtësinë e këtyre veprimeve.

Përcaktoni procedurat e nevojshme për përcjelljen dhe mbajtjen e shënimeve që do të përdoren për të siguruar të gjitha kostot emergjente të identifikohen lehtë. Këto çështje janë të shtjelluara më thellësishtë në Tab 1 të Aneksit të Funksionit Mbështetës Emergjent #5.

A. Administrata
1. Qeveritë komunale do të paraqesin raportet e situatës, kërkesat për ndihmë dhe raportet e vlerësimit të dëmit në QOE 112
2. QOE 112 do të dërgojnë raporte dhe kërkesa për ndihmë në QOE/AME

3. Qeveritë komunale dhe QOE 112 do të shfrytëzojnë llogarimbajtjet e para-krijuara dhe metodat e kontabilitetit për të gjetur dhe për të ruajtur të dhënat e shpenzimeve dhe detyrimeve.

4. Do të Rradhisin dhe shkruajnë llojet e regjistrave të aksioneve të ndërmarra nga ana e DKMSH-se. Llogot dhe shënimet do të formojnë bazën për statusin e raporteve të Nivelit lokal dhe Regjionit.

5. DKSHPMSH do të bëj raporte me kohë.

6. Të gjitha të dhënat me shkrim, raportet dhe dokumentet tjera do të ndjekin parimet e SIME-se.

B. Logjistika - Koordinimi i nevojave të paplotësuara:

Kur burimet komunale janë të angazhuara dhe ndihma reciproke është e konsumuar, QOE 112 është në dispozicion për koordinimin e asistencës dhe të plotësojë nevojat e paplotësuara.Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se Regjioni kërkon ndihmë shtesë, ai do të thërrasë në ndihmë reciproke nga Regjionet fqinje. Në fund të fundit, Regjioni do të kërkojë ndihmë nga AME, në lidhje me një faktorësi të madhe apo të

jashtëzakonshme.

VI. Zhvillimi dhe Mirëmbajtja e Planit

Ligji Për Mbrojtje nga fatkeqësitë Natyrore dhe fatkeqësitë tjera, obligon juridiksionet që të zhvillojnë, miratojnë dhe mbajnë plane aktuale të shkruara të menaxhimit emergjent;

Çdo 4 vjet, Komuna e Podujevës do të zhvilloj rishikim gjithpërfshirës të planeve të menaxhimit emergjent për të siguruar që ato të mbeten aktuale dhe që planet e përmirësuara të miratohen formalisht nga Bordi i Drejtorëve.

Shikimet e tilla gjithashtu do të certifikohen me shkrim tek Agjencia e Menaxhimit Emergjent.

Draftimi i një plani emergjent është përpjekje e komunitetit dhe mbështetet fuqishëm ne udheheqjen komunale dhe ekspertët për të siguruar udhëzime gjithpërfshirëse lidhur me analizën e rreziqeve, dizajnimin e ushtrimeve, planifikimin e evakuimeve, menaxhimin emergjent, zbutjen, rimëkëmbjen, gatishmërinë emergjente dhe vetëdijësimin edukativ.

Shembuj të pjesëmarrësve të planit:

- *Koordinatori i Menaxhimit Emergjent*
- *Përfaqësuesit e grupeve të brendshme:*
  - *Drejtorati i Financave,*
  - *Drejtorati për Punë Komunale,*
  - *Drejtorati i Administratës*
  - *Drejtorati i Shëndetësise,*
  - *Drejtorati i Arsimit,*
  - *Drejtorati i Bujqësise,*

- *Përfaqësuesit e grupeve të jashtme:*
  - *Departamenti i Zjarrfikjes i lokalitetit,*
  - *Departamenti i Policisë së lokalitetit,*
  - *Spitalet e lokalitetit,*
  - *Kryqi i Kuq,*
  - *Sektori privat,*
  - *OJQ, etj.*

Koordinatori i Menaxhimit Emergjent do ta plotësoj Planin e Operacioneve Emergjente çdo vit. Koordinatori do të koordinoj me secilën organizat të resurseve emergjente dhe siguroj zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një kapaciteti të duhur të reagimit emergjent.

Është përgjegjësi e Koordinatorit të Menaxhimit Emergjent për të siguruar që plani është i testuar dhe ushtruar sipas orarit të paraparë.

Shembull i një orari të ushtrimeve:

Është e zakonshme që ushtrimet funksionale për disa pjesë të planit planifikohen të mbahet për çdo muaj; Ushtrimet e ashtuquajtura në Tavolinë mbahen çdo gjysëm viti; dhe ushtrimet në shkallë të gjerë mbahen çdo vit.

Koordinatori do ta mirëmbaj orarin dhe do të siguroj që resurset e nevojshme të jenë në dispozicion për t'i kryer këto aktivitete.

Pas çdo stërvitjeje, ushtrimi apo ngjarjeje aktuale, do të ndodh një diskutim i nxeht dhe/apo shqyrtim pas veprimit. Çdo gjetje nga këto shtjellime të pas-ngjarjes do të inkorporohen në plan me rastin e plotësimit të tij.

VI. TRAJNIMI DHE USHTRIMET

A. Autoriteti i Trajnimeve

Personeli i trajnuar dhe i aftë është esencial për ekzekutimin e drejt të Planeve Operative Emergjente dhe nën planeve të Komunës. Drejtori i DKMSH-se do të siguroj që i gjithë personeli reagues ka kuptim të plotë të përgjegjësive të tyre të caktuara për situatata emergjente, sikurse edhe se si rolet dhe përgjegjësitë e tyre ndërlidhen me komponentet tjerë reagues të POE të Komunës. I gjithë personeli do të pajiset me trajnimet e nevojshme për ekzekutimin e këtyre përgjegjësive në një mënyrë efektive dhe të përgjegjëshme.

DKMSH dhe komuna është përgjegjëse për zhvillimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e programit gjithpërfshirës të trajnimieve dhe ushtrimeve të përshtatshëm për nevojat e Komunës. Ky program do të jetë i përbërë prej trajnimeve të përgjithshme, kryesore, specifike për funksione, si dhe si një program i vazhdueshëm rikujtues i dizajnuar për arritjen dhe mbajtjen e një niveli të pranueshëm të gatishmërisë emergjente për Komunën.

Trajnimi do të bazohet në udhëzimet qendrore. Instruktorët do të përzgjidhen nga stafi dhe zyrtarët qeveritar të Komunës, qeveria qendrore, industria private, ushtria dhe grupet vullnetare të trajnuara në shërbimet emergjente dhe reagim emerjgent. Të gjitha trajnimet dhe ushtrimet e zhvilluara në Komunë do të dokumentohen. Nevojat për trajnime do të përcaktohen dhe mbahen shënime për tërë personelin e ngarkuar me detyra të reagimit emergjent në fatkeqësi.

Drejtoria per mbrojtje dhe shpetim do të ndërtoj, planifikoj dhe zhvilloj për çdo vitë ushtrime në tavolinë, funksionale dhe në shkallë të gjerë. Këto ushtrime do të jenë të destinuara jo vetëm për testimin e Planit Operativ Emergjent lokal dhe nën-planeve të Komunës por për t'i trajnuar të gjithë zyrtarët përkatës, personelin e reagimit emergjent, të punësuarit e Komunës dhe për përmirësimin e organizimit të përgjithshëm reagues dhe kapacitetit të Komunës. Grupet gjysëm publike dhe vullnetare dhe/apo agjencitë do të inkurajohen të marrin pjesë. Mangësitë e identifikuara në ushtrime do të adresohen

menjëherë.

Për qëllime të trajnimit dhe ushtrimeve, duhet aktivizuar këtë plan, për të vlerësuar dhe mirëmbajtë gjendjen e gadishmërisë së komunës siç kërkohet.

B. Kërkesat për Ushtrim

Të sigurohen praktika dhe përvoja për të kontrolluar operacionet për ata që kanë përgjegjësi në QOE, kurse KME duhet të aktivizojë këtë plan të paktën çdo tre vjet në formën e një stërvitjeje (Ushtrimi), emergjent.

C. Trajnimi- Linjat e Veprimit

1. Trajnimet për Zyrtarët Publik:

a. **Trajnimi i Reagimit dhe Rimëkëmbjes:**

Programet e trajnimit do t`u ofrohen këtyre zyrtarëve komunal, koordinatorit të Menaxhimit Emergjent, personelit të QOE dhe personelit të shërbimeve emergjente (të policisë, zjarrfikjes dhe dhe Funksioneve Mbështetëse Emergjente), mbi politikat dhe procedurat për një reagim të koordinuar dhe sanimin e një fatkeqësie të jashtëzakonshme. Programet e trajnimit ofrohen nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent të Kosovës dhe koordinohen me Regjione dhe Komuna.

b. Zhvillimi Profesional:

Programet e trajnimit do ti ofrohen komunës dhe stafit të OJQ-ve dhe Sektorit privat për aftësimin dhe teknikat e të shkruarit të planeve, zhvillimin e aftësive profesionale, dhe çështjet e sigurisë në lidhje me përgatitjen komunale për Emergjenca. Programet e trajnimit do të ofrohen nga AME-ja, dhe do të koordinohen nga Kuvendi Komunal.

c. Vlerësimi i Dëmeve dhe Raportimi:

Trajnimet Vjetore do të ofrojnë proozimet për procedurat raportuese të dëmeve, si dhe në vlerësimin e dëmit për personelin që do të punojnë me ekipet regjionale në vlerësimin e dëmeve. Programet e trajnimit do të ofrohen nga AME-ja dhe do të koordinohen nga komuna.

2. Shërbimet Emergjente dhe Agjencitë tjera Reaguese

Ushtrimet, siç tregohet më lartë, do të përdoren si një teknikë për trajnimin e zyrtarëve të zgjedhur dhe të

emëruar, stafit Emergjent lokal dhe Regjional, dhe personelit të shërbimeve, të cilëve u janë caktuar përgjegjësitë Emergjente në këtë plan.Stafi i Drejtorive, inspektoriatit, sektorit privat dhe OJQ-ve, përgjegjës për anekset funksionale, janë të ngarkuar për sigurimin e aftësive, për trajnimin e personelit të cilët zbatojnë dispozitat e tyre në anekset përkatëse.

3. Trajnimiet Shtetërore dhe Lokale

Drejtoria për Mbrojtje dhe shpetim, drejtoritë tjera, sektori privat dhe OJQ-të do të marrin pjesë në programet e trajnimit shtetëror sipas programeve dhe kalendarit të caktuar.

VII. KËRKESAT PËR PLAN, MIRËMBAJTJA DHE SHPËRNDARJA

A. Përgjegjësitë e DKMSH-se: QOE komunale, është përgjegjësi e zyrtarëve të zgjedhur, por zakonisht QOE do të koordinojë në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e planit. Komponentet e Planit do të shqyrtohen dhe të freskohen nga KME çdo dy vjet ose sipas nevojës. Disa anekse të incidenteve specifike kërkojë një rishikim vjetor, në bazë të legjislacionit apo rregulloreve. Kurdo që, pjesët e këtij plani zbatohen, në një rast Emergjent ose ushtrim, duhet të kryhet një rishikim për të përcaktuar ndryshimet e nevojshme.

B. Detyrueshmëria:

Ky plan është i zbatueshëm dhe i aprovuar në bazë të dispozitave të rregullores per metodologjise se hartimit te planeve te reagimit emergjent

C. Zbatimi:

Ky plan do të zbatohet me urdhër të Zyrtarëve Komunal të zgjedhur ose të përfaqësuesit të autorizuar të tyre dhe Koordinatorit Komunal të Menaxhimit Emergjent.

D. Shpërndarja

Ky plan dhe materialet tjera mbështetëse të tij, janë dokumente të kontrolluara. Ndërsa shpërndarja e "Planit Bazik" është e lejueshme, ai përmban: listat kontrolluese, Njoftimet dhe Doracakun e Resurseve, dhe disa Plane të Incidenteve Specifike që përmbajnë përgjigje specifike ose informacione personale dhe nuk konsiderohen të jenë në dispozicion të publikut.Shpërndarja bazohet në rregullore ose funksione (veprime) "duhet të dini" Kopjet e këtij plani, janë shpërndarë në bazë të një liste, të kontrollit të miratuar.Një rexhistër i shpërndarjes, me numrin e kopjes, mbahet në dosje nga KME. Kopjet e kontrolluara dhe të rshikuara do të shpërndahen për të përcaktuar mbajtësit e planit. Rishikimet apo ndryshimet janë të dokumentuara me anë të skemës "Regjistri I Ndryshimeve". Një sistem vërtetimi (marrje) do të përdoret për të verifikuar këtë proces.

Shtojca 1 – Fjalori i Termeve Kryesore

Kryqi i Kuq i Kosovës
Organizat humanitare e udhëhequr nga vullnetarët, të cilët ofrojnë ndihma për viktimat e fatkeqësisë dhe ndihmojnë në parandalimin, përgatitjen dhe reagimin ndaj emergjencave. Këtë e bënë përmes shërbimeve të cilat janë në përputhje me ligjin dhe Parimet e Lëvizjes së Kryqit të Kuq ndërkombëtar.

Sektori i Komandës
Një nga pesë fushat funksionale të Sistemit të Komandës së Incidentit. Funksioni i komandës është të drejtoj, kontrolloj, apo urdhëroj resurset, përfshirë njerëzit dhe pajisjet, për të mirën më të maqdhe të mundshme.

Post Komanda
Lokacion në të cilin zbatohen funksionet parësore të Komandës; zakonisht të bashkvendosura me Bazën e Incidentit. E referuar tek ne, gjithashtu edhe si Post komanda e Incidentit.

Menaxhimi Gjithpërfshirës i Resurseve
Maksimalizon shfrytëzimin e resurseve të disponueshme, konsolidon resurset e përafërta dhe zvogëlon mbingarkesën në komunikim në Operacionet e Komandës së Incidentit.

Koordinimi
Proces i analizimit sistematik të situatës, ndërtimit të informacioneve relevante dhe informimit të personelit përkatës lidhur me alternativat e mundshme për përzgjedhjen e kombinimit sa më efektiv të resurseve të disponueshme për arritjen e objektivave të caktuara.

Emergjenca
Çdo ndodhi, apo kërcënim, çoftë natyrore apo e shkaktuar nga faktori njeri, e cila rezulton apo mund të rezultoj në lëndime apo dëmtime substanciale në popullat apo dëme ose humbje substanciale e të mirave materiale apo resurseve natyrore dhe që mund të përfshij veprim qeveritar përtej asaj të autorizuar me ligjin ekzistues.

Dekontaminimi
Proces i sigurimit të njerëzve, objekteve dhe zonaeve nëpërmjet absorbimit, neutralizimit, zvogëlimit të efektit dëmtues apo zhvendosjes së Materieve tlë Rrezikshme

Emergjencë/Fatkeqësi/Incident
Një ngjarje e cila kërkon reagim kulmor përtej fushveprimit të çdo agjecie apo shërbimi të vetëm dhe që paraqet rrezik për komunitetin apo hapësirën më të gjerë. Një emergjencë është zakonisht një ngjarje e cila mund të kontrollohet brenda fushëveprimit të kapaciteteve lokale; emergjenca e madhe apo fatkeqësia zakonisht kërkon përtej asaj që është e disponueshme në nivel lokal.

Sistemi i Alarmimit Emergjent
Rrjet i stacioneve të shpërndarjes që ndëlidh objektet e autorizuara nga Komisioni Qendror për Komunikim për të operuar në mënyrë të kontrolluar për alarmimin dhe informimin e publikut për veprimet e nevojshme mbrojtëse në raste të fatkeqësive apo situatave emergjente.

Qendra e Operacioneve Emergjente
Objekt nga ku qeveria drejton dhe kontrollon operacionet e saj emergjente; ku informacionet lidhur me gjendjen e situatës emergjente grumbullohen, shkrihen dhe raportohen zyrtarisht; ku koordinimi midis agjencive zë vend; dhe nga ku kërkohet zyrtarisht asistenca nga jashtë.

Plani i Operacioneve Emergjente
Dokument i cili ofron një reagim të paraplanifikuar dhe koordinuar në rast të një situate emergjente apo fatkeqësie.

Menaxhimi Emergjent
Përgatitja për funksionet dhe bartja e tyre (tjetër nga funksionet për cilat parësisht përgjegjëse janë forcat ushtarake) për të parandaluar, zvogëluar dhe sanuar lëndimet dhe dëmet që rezultojnë nga fatkeqësitë natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri. Këto funksione përfshijnë zjarrfikjen, policinë, shëndetin dhe mjekësinë, shpëtimin, paralajmërimin, ingjinierinë, komunikimin, evakuimin, menaxhimin e resurseve, mbrojtjen e bimëve, restaurimin e shërbimeve publike dhe funksionet tjera të lidhura me ruajtjen e sigurisë, shëndetit dhe mirëqenjes së popullatës.

Funksioni i Mbështetjes Emergjente
Fushë funksionale e aktivitetit reagues e themeluar për lehtësimin e shpërndarjes së asistencës qendrore të nevojshme gjatë fazës së reagimit të menjëhershëm në fatkeqësi për shpëtimin e jetëve, mbrojtjen e të mirave materiale dhe shëndetit publik dhe mirëmbajtjes së sigurisë publike.

Ushtrim
Një aktivitet i destinuar për përkrahjen e gatishmërisë emergjente; testimin apo vlerësimin e planeve të operacioneve emergjente, procedurave apo shërbimeve; trajnimin e personelit në detyrat e reagimit emergjent dhe demonstrimin e kapacitetit operacional. Ekzistojnë tri lloje të caktuara të ushtrimeve: në tavolinë, funksional dhe shkallë të gjerë.

Evakuim
Të ndihmuarit e njerëzve për të lëvizur nga pragu apo rreziku i fatkeqësisë në një zonë të sigurisë relative.

Sistemi Informativ Gjeografik
Sistem kompjuterik i aftë për grumbullimin, sortimin, manipulimin dhe pasqyrimin e informacioneve të referuara gjeografike, si psh. të dhënat e përcaktuara sipas lokacionit të tyre.

Materiet e Rrezikshme
Janë substanca apo materie të cilat mund të shkaktojnë rrezik të pa pa pashikueshëm për shëndetin, pasurinë, ose për ambientin, kur përdorën, transportohen, ruhen ose tjetërsohen. Këtu mund të përfshihen materiet që janë të ngurta, të lëngshme ose në gjendje të gaztë. Gjithashtu materiet e rrezikshme mund të përfshijnë substanca toksike, djegëse dhe irrituese, eksploziv ose materie gërryese, si dhe dhe materie radioaktive.

Sistemi i Komandës së Incidentit
Model për reagim ndaj fartkeqësisë I cili përdor terminologji të zakonshme, organizim të përshtatshëm, komunikim të integruar, strukturë komanduese të unifikuar, planifikim të veprimeve, hark kontrolli të

menaxhueshëm, objekte të para-caktuara dhe menaxhim gjithpërfshirës të resurseve. Në SKI ekzistojnë pesë elemente funksionale: Komanda, Operacionet, Logjistika, Planifikimi dhe Financat/Administrata.

Komandant Incidenti
Person përgjegjës për menaxhimin e të gjitha operacioneve të incidentit.

Raporti i Vlerësimit të Dëmeve Fillestsare
Raport i cili ofron informacione lidhur me dëmet e përgjithshme ndaj pronave publike dhe private dhe në këtë mënyrë ofron bazën për shpalljen e gjendjes emergjente apo nevojës për asistencë.

Plani i Komunikimit të Integruar
Ky plan koordinon përdorimin e mjeteve të disponueshme të komunikimit dhe cakton frekuencat për funksionet e caktuara.

Emergjencë Lokale
Gjendje e shpallur nga trupi qeveritar lokal kur, sipas gjykimit të këtij trupi, ndodhja apo rreziku nga ndodhja e fatkeqësisë është apo kërcënon të jetë e përmasave dhe ashpërsisë së atillë, e cila kërkon veprim të koordinuar të qeverisë lokale për të parandaluar apo zbutur humbjen e jetëve, dëmtimin e pronave apo varfërimin. Vetëm Kryetari i Komunës, me kërkesë të trupit qeveritar, mund ta shpall gjendjen emergjente.

Lehtësimi/Zbutja
Aktivitete të cilat faktikisht eliminojnë apo zvogëlojnë gjasat e ndodhjes apo efekteve të një fatkeqësie. Në shembujtë e masave lehtësuese/zbutëse përfshihen (por nuk kufizohen me kaq), punimi i ligjeve apo rregulloreve për shfrytëzimin e tokav, përforcimi i standardeve të ndërtimit, rregulloreve dhe licencave për prodhimin, përdorimin dhe deponimin e materieve të rrezikshme dhe inspektimi dhe zbatimi i këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

Marrveshje për Ndihmë Reciproke
Marrveshje me shkrim midis agjencive dhe/apo juridiksioneve në të cilën ata pajtohen ta ndihmojnë njëri tjetrin, me kërkesë, duke dërguar personel dhe/apo pajisje në një situatë emergjente.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosoves
Agjenci qendrore e cila ofron për popullatën informacione lidhur me motin dhe gjatë emergjencave të lidhura me motin, për zyrtarët shtetëror dhe lokal të menaxhimit emergjent.

Gatishmëria
Hartimi i planeve për të siguruar reagim sa më efikas dhe efektiv ndaj një fatkeqësie apo emergjence. Aktivitetet e gatishmërisë janë të destinuara për të ndihmuar shpëtimin e jetëve dhe zvogëlimin e dëmeve duke i përgatitur njerëzit të reagojnë si duhet kur një emergjencë është e pashmangshme. Gatishmëria gjithashtu përfshinë trajnimet, ushtrimet dhe ngritjen e resurseve të domosdoshme për arritjen e gatishmërisë për të gjitha rreziqet.

Shpallja Presidenciale

Shpallja presidenciale liron burimet e ndryshme të asistencës nga qeveria qendrore bazuar në natyrën e kërkesës nga Kryetari i Komunës, vlerësimit te situatës nga AME-ja (raporti i situatës) dhe rekomandimi i AME-se tek Ministri i Puneve te brendshme si Koordinator nacional per menaxhimin e Incidenteve me karakter kombëtar Shpallje bëhet sipas kushtetutës së Republikës së Kosovës nga kryetari shtetit.

Agjencia Parësore
Përderisa një numër i agjencive lokale do të performojnë një numër të detyrave të ndryshme gjatë fatkeqësisë, në shumicën e rasteve vetëm një prej tyre do të jetë "Agjenci Parësore". Agjencitë parësore do të jenë përgjegjëse për planifikimin e hollësishëm, testimin dhe vlerësimin e funksioneve të tyre përkatëse të mbështetjes emergjente. Drejtori i agjencisë parësore do të shërbej si këshilltar kryesor për Kryetarin e Komunës gjatë fazës së reagimit dhe rimëkëmbjes. Për më tepër Drejtori i agjencisë parësore duhet të siguroj që operacionet esenciale të agjencisë së tij do të vazhdojnë, përveç nëse ndryshe vendoset nga Kryetari i Komunës apo i caktuari i tij.

Qendra Operative Emergjente 112
Qendra lehtëson komunikimin dhe koordinimin midis autoriteteve lokale, rajonale dhe qendrore për të siguruar një reagim efektiv dhe koherent ndaj emergjencave dhe incidenteve rajonale.

Raport Situate
Raport i cili plotësohet në fund të çdo dite operative të qendrës operative emergjente lokale dhe i cili e pajis rajonin me një përmbledhje zyrtare të gjendjes së emergjencës dhe reagimit emergjent lokal. Kopja e raportit duhet të dorëzohet tek QOE Rajonale përmes faksit apo në Departamentin e Menaxhimit Emergjent përmes vebfaqes së tij.

Harku i Kontrollit
Harku i kontrollit është numri i vartësve të cilët mund t'i mbikëqyr në mënyrë efektive një mbikëqyrës. Udhëzimet për një hark të dëshirueshëm të kontrollit rekomandojnë tre deri në shtatë persona. Numri optimal i vartësve është pesë për një mbikëqyrës.

Gjendja Emergjente
Gjendje e shpallur nga Kryeministri kur, sipas gjykimit të tij, një fatkeqësi aktuale apo kërcënuese në çdo pjesë të shtetit është i përmasave dhe ashpërsisë së atillë e cila kërkon asistencë nga shteti për plotësimin e përpjekjeve lokale për parandalimin apo lehtësimin e humbjeve në jetë dhe dëmeve në prona.

Komanda e Bashkuar
Përgjegjësi e ndar për menaxhimin e përgjithshëm të incidentit si rezultatë i incidentit shumë-juridiksional apo shumë-agjencor. Në rastet e prioriteteve dhe qëllimeve kontradiktore, apo ku resurset janë të pakta, duhet të ketë linjë të qartë të autoritetit për vendimmarrje. Agjencitë kontribuojnë në komandën e bashkuar duke përcaktuar qëllime dhe objektiva të përgjithshme, duke planifikuar së bashku aktivitetet taktike, duke kryer operacione të integruara taktike dhe duke ngritë në maksimun shfrytëzimin e të gjitha resurseve të caktuara me detyrë.

Armët e Shkatërrimit në Masë
Çdo eksplodim, ndezës apo gaz helmues, bombë, granatë, raketë e cila ka shtytës të mbushur me më shumë se 4 ounces, apo predhë e cila ka ndezës të mbushur me më shumë se 0.25 ounces, apo minë apo

kurdisje të ngjashme me këto më sipër; apo armë e cila është destinuar për të liruar rreze apo rrezatim në nivelin e rrezikshëm për jetën e njeriut.

Shtojca 2 – Lista e Shkurtesave

SHISHKB	Shërbimi i Inspektimit të Shëndetit të Kafshëve dhe Bimëve
EKRE	Ekipet e Komunitetit për Reagim Emergjent
ZKF	Zyrtari kryesor Financiar
MK	Marrëdhëniet me Komunitetin
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
QRF	Qendra për Rimëkëmbje nga Fatkeqësia
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MRF	Menaxheri për Rimëkëmbje nga Fatkeqësia
SAE	Sistemi I Alarmimit Emergjent
QOE	Qendra Operative Emergjente
FME	Funksion Mbështetës Emergjent
AMA	Agjencioni për Mbrojtjen e Ambientit
ERE-A	Ekipi i Reagimit Emergjent – Elementi Avancues
AME	Agjencioni Qendror i Menaxhimit Emergjent
SKI	Sistemi i Komandës së Incidentit
QBI	Qendra e Bashkuar Informative
ZBF	Zyra e Bashkuar Fushore
MACC	Qendra për Koordinim të Shum-Agjencive
MiM	Memorandum i Marrëveshjes
MeM	Marrëveshje e Mirëkuptimit
SKP	Sistemi Kombëtar i Paralajmërimit
OJQ	organizatë Jo Qeveritare
SKMI	Sistemi Kombëtar i Menaxhimit të Incidenteve
PRK	Plani i Reagimit Kombëtar
SHMK	Shërbimi Meteorologjik Kombëtar
VPD	Vlerësimi Preliminar i Dëmeve

ZIP	Zyrtari për Informim Publik
PeK	Pik e Kontaktit
KSH	Kërkimi dhe Shpëtimi
PSO	Procedurat Standarde Operative
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
OVAF	Organizatat Vullneatare Aktive në Fatkeqësi
ASHM	Armët e Shkatërrimit në Masë

Shtojca 3 – Autoriteti dhe Referencat

i. Ligji për fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera/2006/2012

ii. Ligji për Mbrojtjen nga zjarri/2006/2011

iii. Udhëzimi administrative XIX/2008

iv. Vlersimi i rreziqeve, niveli Qendror dhe Lokal-2009

v. Sistemi i Integruar i Menaxhimit Emergjent. SIME 2010

vi. Plani i Reagimit Kombëtar

vii. Rregullorja per Metodologjine e hartimin të Planeve të Reagimit Emergjent

Shtojca4 – Matrica e përgjegjësive

Agjencia	FME # 1 Transporti	FME # 2 Komunikimi	FME # 3 Punët Publike	FME #4 Zjarrëfikja	FME #5 Menaxhimi	FME #6 Kujdesi msasiv	FME #7 Mbështetja e	FME #8 Shëndeti dhe	FME #9 Kërkimi dhe	FME #10 Materiet e	FME #11 Resurset	FME #12 Energjia	FME # 13
Menaxhimi Emergjent													
Zjarrfikja													
Shërbimi Emergjent													

Mjekësor													
Zbatimi I Ligjit													
Punët Publike													
Planifikimi Hapësinor													
Komuna/Qyteti Qeveria													
Kryqi i Kuq													
Teknologjia Informative													
Shërbimet Sociale													
Financat													
Transporti													
Shkollat publike													
Bordi i Shërbimeve të Komunitetit													
Autoriteti i Ujërave													
Prokurori Public i Qarkut													
Marrëdhëniet me Publikun													
OVAF													
Task Forca Lokale për Rimëkëmbje													

Shtojca 5 – bartja e Autoritetit

Vijimësia e Qeverisjes është kritike për zbatimin e suksesshëm të operacioneve emergjente. Prandaj, në parashikim të çdo eventualiteti që mund të rezultoj në mospraninë e pjesëtarit të ranguar të hierarkisë administrative, janë paraparë linjat në vijim të bartjes së autoritetit. Autoriteti i vendimmarrjes për çdo organizatë apo shërbim është renditur më posht sipas pozitave nga e larta tek më e ulta.

Autoriteti sipas linjës	Organizata/funksioni shërbyes
1. Kryetari i Komunës 2. Komiteti për politikë dhe financa 3. Kuvendi Komunal	1.Kryetari i Komunës 2. Bordi i Drejtorëve 3. Shtabi për menaxhimin krizës 4. Policia e Kosovës 5. Shoqatat dhe OJQ të ndryshme 6. Sektori privat

Shtojca 6 – Lista e Shpërndarjes së POE

Drejtori i Menaxhimit Emergjent
Koordinatori i Menaxhimit Emergjent
Zyra e Komandantit të Stacionit Policor
Departamenti i Zjarrfikjes
Shërbimet
Drejtori i Inspektorëve
Drejtori i Parqeve dhe Rekreacionit
Drejtori i Shërbimeve Sociale
Departamenti i Shëndetësisë/Spitali Rajonal
Prokurori i Qarkut
Qendra e Komunikimit
Bordi i Drejtorëve/Këshilli i Qytetit
Sistemi i Shkollave Publike
Zyra për Informim Publik
Ekipet e Shpëtimit
Ekipi për Vlerësimin e Dëmeve
Departamenti i Transportit
Agjencioni i Menaxhimit Emergjent (AME)
Kryqi i Kuq i Kosoves

Lista vazhdon sipas prioriteteve

Shtojca 7 – Dokumentet Esenciale

Shënimet Gjyqësore

Ruajtja e shënimeve esenciale për lokalitetin është përgjegjësi e Sekretarit të Gjykatës së Qarkut. Të gjitha shënimet esenciale duhet të ruhen në dosje, të vendosura në Zyrën e Sekretarit të Gjykatës së Qarkut. Në këto shënime përfshihen me sa vijon:

Dokumentacioni i Pasurive të Patundshme*
Të Dhënat Kriminale
Testamentet
Regjistrat Civil
Dokumentacioni i Gjykatave Civile
Çertifikatat e Martesave

Evakuimi i dokumenteve në raste të një emergjence do të bëhet vetëm me miratimin e Sekretarit të Gjykatës së Qarkut.

Ngarkimi dhe transporti i këtyre dokumenteve është përgjegjësi e Departamentit të Policisë.

*** Një kopje e mikrofilmit/diskut me të dhënat e patundshmërisë për lokalitetin, duhet të ruhet në Arkiva të sigurtë.**

Agjencionet/Organizatat

Çdo agjenci/organizatë brenda strukturës së pushtetit lokal duhet të themeloj programin për mbrojtjen e dokumenteve/të dhënave të veta. Dokumentet e caktuara si esenciale për vijimin e funksioneve qeverisëse duhet të identifikohen dhe vendosen procedura për mbrojtjen e tyre, siç janë dyfishimi i kopjeve në një vend tjetër dhe/apo përdorimi i objekteve të sigurta për deponim të dokumenteve. Duhet të merren masa për operim të vazhdueshëm të sistemit të përpunimit automatik të të dhënave.